

Draft Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën

Korrik 2021



Përgjegjësi për këtë dokument: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë

Qëllimi i këtij dokumenti: Paraqitja për komente pranë Komunitetit të Energjisë, me qëllim përmirësimin e versionit final të dokumentit PKEK

Versioni i dokumentit: Draft PKEK 19 korrik 2021

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Politikën e Klimës në Vendet e Evropës Juglindore dhe Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, faza III”. Projekti është pjesë e Nismës Ndërkombëtare për Klimën (NNK). Ministria Federale Gjermane për Mjedisin, Mbrojtjen e

Natyres dhe Sigurinë Bërthamore (BMU) mbështet këtë nismë

në bazë të një vendimi të miratuar nga Bundestagu gjerman.

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve dhe akronimeve	i
1 PËRMBLEDHJA DHE PROCESI PËR HARTIMIN E PLANIT	1
1.1 Përmbledhje ekzekutive.....	1
1.1.1 Konteksti politik, ekonomik, mjedisor dhe social i planit	1
1.1.2 Strategjia në lidhje me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë.....	2
1.1.3 Tabelë përmbledhëse me objektivat, politikat dhe masat kryesore të planit	3
1.2 Përmbledhje e situatës aktuale të politikave.....	5
1.2.1 Sistemi kombëtar i energjisë dhe konteksti politik i planit kombëtar	5
1.2.2 Politikat dhe masat aktuale për energjinë dhe klimën lidhur me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë.....	12
1.2.3 Çështjet kryesore me rëndësi ndërkufitare	46
1.2.4 Struktura administrative e zbatimit të politikave kombëtare për energjinë dhe klimën	47
1.3 Konsultimet dhe përfshirja e subjekteve shtetërore dhe rezultati i tyre.....	48
1.3.1 Përfshirja e parlamentit kombëtare.....	49
1.3.2 Përfshirja e autoriteteve vendore dhe rajonale	49
1.3.3 Konsultimet e grupeve të interesit, duke përfshirë partnerët socialë, dhe angazhimi i shoqërisë civile dhe publikut të gjerë	50
1.3.4 Konsultimet e palëve të tjera kontraktuese.....	50
1.3.5 Procesi përsëritës me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.....	50
1.4 Bashkëpunimi rajonal në përgatitjen e planit	51
1.4.1 Elementet që i nënshtrohen planifikimit të përbashkët ose të koordinuar me palë të tjera kontraktuese.....	51
1.4.2 Shpjegimi sesi bashkëpunimi rajonal merret në konsideratë në plan	52
2 SYNIMET DHE OBJEKTIVAT KOMBËTARE.....	53
2.1 Dimensioi i dekarbonizimit	54
2.1.1 Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve.....	54
2.1.2 Energjia e rinovueshme	55
2.2 Dimensioi i efiçencës së energjisë.....	56
2.2.1 Elementet e përcaktuara në nenin 4, germa “b”	56
2.2.2 Strategjia afatgjatë e rinovimit për stokun kombëtar të ndërtesave.....	58
2.2.3 Objektiva të tjerë kombëtarë dhe strategji afatgjata	58
2.3 Dimensioi i sigurisë së energjisë	58
2.3.1 Elementet e përcaktuara në pikën “c” të nenit 4.....	59
2.3.2 Objektivat kombëtare lidhur me diversifikimin dhe fleksibilitetin	60

2.3.3	Objektivat kombëtare lidhur me reduktimin e varësisë ndaj importeve të energjisë.....	61
2.3.4	Objektivat kombëtare lidhur me rritjen e fleksibilitetit	62
2.4	Dimensioni i tregut të brendshëm të energjisë	62
2.4.1	Interkoneksioni i energjisë elektrike.....	63
2.4.2	Infrastruktura e transmetimit të energjisë	64
2.4.3	Integrimi në treg	65
2.4.4	Varfëria energjetike	66
2.5	Dimensioni i kërkimit, novacionit dhe konkurrueshmërisë.....	67
3	POLITIKAT DHE MASAT	68
3.1	Dimensioni i dekarbonizimit	72
3.1.1	Kuadri ligjor gjithëpërfshirës	72
3.1.2	Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve.....	72
2.1.1.	Energjia e rinovueshme	86
3.2	Dimensioni i efikasitetit të energjisë.....	96
3.2.1	Kuadri ligjor gjithëpërfshirës	96
3.2.2	Skemat detyruese të efikasitetit të energjisë dhe masat politike alternative	97
3.2.3	Strategjia afatgjatë e rinovimit dhe nxitja e rinovimit rrënjësor kosto-efektiv	97
3.2.4	Adoptimi i kontratave të performancës së energjisë dhe modeleve të tjera të shërbimeve të EE-së	103
3.2.5	Roli karakteristik i ndërtesave publike dhe prokurimit publik me në fokus efikasitetin e energjisë	104
3.2.6	Promovimi i auditimeve të energjisë dhe sistemeve të menaxhimit të energjisë	106
3.2.7	Informacioni për konsumatorët dhe masat lidhur me trajnimin	108
3.2.8	Efikasiteti i energjisë në transport	109
3.3	Siguria energjetike.....	115
3.3.1	Kuadri ligjor gjithëpërfshirës	115
3.3.2	Spektori i energjisë elektrike	115
3.3.3	Spektori i naftës dhe gazit	117
3.3.4	Bashkëpunimi rajonal	122
3.4	Tregu i brendshëm i energjisë elektrike	124
3.4.1	Kuadri ligjor gjithëpërfshirës	124
3.4.2	Infrastruktura e energjisë elektrike	124
3.4.3	Varfëria energjetike	127
3.5	Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca	128
3.5.1	Kuadri ligjor gjithëpërfshirës	128
3.5.2	Kërkimi.....	128
3.5.3	Novacioni dhe konkurrenca.....	131

4	SITUATA AKTUALE DHE PROJEKSIONET LIDHUR ME POLITIKAT DHE MASAT EKZISTUESE	133
4.1.	Evoluimi i projektuar i faktorëve ekzogjenë kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e sistemit të energjisë dhe të shkarkimeve të GES-ve.	133
4.2.	Dimensioni i dekarbonizimit	150
4.2.1	Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve.....	150
4.2.2	Energjia e rinovueshme	162
4.3.	Dimensioni i efiçencës së energjisë.....	169
4.4.	Dimensioni i sigurisë energjetike	183
4.5.	Dimensioni i tregut të brendshëm të energjisë	188
4.5.1	Interkoneksioni i energjisë elektrike.....	188
4.5.2	Infrastruktura e transmetimit të energjisë	191
4.5.3	Tregjet e energjisë elektrike dhe të gazit, çmimet e energjisë elektrike	193
4.6.	Dimensioni i kërkimit, novacionit dhe konkurrueshmërisë.....	194
5	VLERËSIMI I NDIKIMIT TË POLITIKAVE DHE MASAVE TË PLANIFIKUARA	198
5.1	Ndikimet e politikave dhe masave të planifikuara, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.....	198
5.2	Ndikimet makroekonomike dhe të llojeve të tjera të politikave dhe masave të planifikuara, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.	246
5.3	Përmbledhje e nevojave të investimeve	251
5.4	Ndikimet e politikave dhe masave të planifikuara në shtetet e tjera anëtare dhe në bashkëpunimin rajonal, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.	256
6	Referencat:.....	257
7	Lista e tabelave	260
8	Lista e imazheve	263
9	Shtojcë	270
9.1	Përmbledhje e institucioneve.....	270

Lista e shkurtimeve dhe akronimeve

AK	Autoriteti i Konkurrencës
ACER	Agjencia për Bashkëpunim midis Rregullatorëve të Energjisë
AKEE	Agjencia Kombëtare për Efiçencën e Energjisë
AFD	<i>Agence Française de Développement</i>
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
ALKOGAP	Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë
APEX	Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
ASHRSN	Agjencia Shtetërore e Rezervave të Sigurisë së Naftës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BaU	Punë si zakonisht
PMB	Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore
BRE-E	Burimet e rinovueshme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike
BRE-N & F	Burimet e rinovueshme të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen
BRE-T	Burimet e rinovueshme të energjisë për transport
cap	Për frymë
CAPEX	Shpenzime kapitale
CCL	Grupi Lobues i Qytetarëve për Çështjet Klimatike
CDD	Gradë-ditët e ftohjes
CfD	Kontrata për Diferencat
CH ₄	Metan
CO ₂	Dyoksid karboni
CO ₂ eq	Ekivalent i dyoksidit të karbonit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ECM	Masat për ruajtjen e energjisë
EE	Efiçenca e energjisë
PVEE	Plani i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
EED	Direktiva për Efiçencën e Energjisë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EPBD	Direktiva për Performancën e Energjisë së Ndërtesave
KE	Komuniteti i Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Sinkron Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
ESCO	Shoqëria e Shërbimeve Energjetike
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedor dhe Social
ESO	Operatori i Sistemit të Transmetimit i Bullgarisë
ETS	Sistemi i tregtimit të shkarkimeve
EV	Automjet elektrik
KFE	Konsumi final i energjisë
FiT	Tarifë e stimuluar "feed-in"
GACMO	Modeli i Kostos së Pakësimit të Gazit me Efekt Serrë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GES	Gaze me Efekt Serrë
ha	Hektarë
HDD	Gradë-ditët e ngrohjes
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
ERAL	Ekspertët e reformës në arsimin e lartë
HEC	Hidrocentral
HVDC	Instalime me rrymë të vazhduar, me tension të lartë
IAP	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian
IECC	Komiteti Ndërmintor për Energjinë dhe Klimën
EEl	Efiçenca e Energjisë në Industri
NDC	Kontributet Kombëtare të Pikësnuara
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural
PIPP	Proceset Industriale dhe Përdorimi i Produkteve
SNZHRB	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
SIT	Sistemet inteligjente të transportit
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
STI	Sistemet e Transportit Inteligent
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KfW	<i>Kreditanstalt für Wiederaufbau</i>
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës

GNL	Gaz natyror i lëngëzuar
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEPSO	Operatori i sistemit të transmetimit i Maqedonisë së Veriut
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MMR	Rregullorja për mekanizmat e monitorimit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PMV	Programi i Monitorimit dhe Verifikimit
MW	Megavat
NAMA	Masa Zbutëse Kombëtare të Përshatshme
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
PKKVBRE	Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
INDC	Kontributet Kombëtare të Përcaktuara
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
SKZHI II	Strategjia e Dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKE	Strategjia Kombëtare e Energjisë
nZEB	Ndërtesë me konsum energjie thuajse zero
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PM	Politika dhe masa
PBL	Hua e bazuar në politika
PECI	Projekte me Interes për Komunitetin e Energjisë (lista).
PHEV	Mjet elektrik hibrid me karikim me prizë
PMU	Njësi matëse fazorësh
ERP	Elementet e Reformave Politike
TP	Transporti publik
PV	Fotovoltaik
QA/QC	Garantimi i Cilësisë / Kontrolli i Cilësisë
BRE	Burim i Rinovueshëm Energjie
RFNBO	Lëndë djegëse të rinovueshme me origjinë jobiologjike
SCC	Qendra për Koordinimin e Sigurisë Energjetike
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
PVEQ	Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme
SEE CAO	Zyra e Koordinuar e Ankandëve për Evropën Juglindore në Mal të Zi
SET-Plan	Plani Strategjik për Teknologjitë Energjetike
HECv	Hidrocentral i vogël
SLED	Përkrahje për Zhvillimin me Shkarkime të Ulëta në Evropën Juglindore
TAP	Gazsjellësi Trans-Adriatik
TKPE	Totali i konsumit përfundimtar të energjisë
TEN-E	Rrjetet Transevropiane të Energjisë
TEN-T	Rrjetet Transevropiane të Transportit
toe	tonë ekuivalent naftë
ToR	Termet e referencës
TFEP	Totali i furnizimit me energji primare
TEC	Termocentral
SSTPV	Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020
TYNDP	Plani Dhjetëvjeçar i Zhvillimit të Rrjetit
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KKKBK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
WAM	Me masa shtesë
BP	Ballkani Perëndimor
BB*	Banka Botërore
BP6	Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia
WBIF	Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
WEM	Me masa ekzistuese
ITUP	Impiant Trajtimi i Ujërave të Përdorura

SEKSIONI A: PLANI KOMBËTAR

1 PËRMBLEDHJA DHE PROCESI PËR HARTIMIN E PLANIT

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Shqipëria është angazhuar për përgatitjen e PKEK-së së saj të parë 2021-2030 gjatë vitit 2020. Periudha e zhvillimit është dashur të zgjatet për shkak të pandemisë së COVID-19.

Kjo PKEK bazohet te Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe te NDC-të e para dhe është harmonizuar me draftin e NDC-ve të rishikuara. Diferencat në raport me dokumentet politike janë analizuar dhe mund t'u atribuohen, ndër të tjera, nevojës për përshtatje me evoluimin e bazës së njohurive. Shpjegime të detajuara janë dhënë në kreun 2.

Hartimi i PKEK-së sjell nevojën për një gamë të gjerë të dhënash të besueshme dhe konsistente. Të dhënat më me rëndësi mbi ndryshime klimatike janë mbledhur dhe përpunuar nga projektet e asistencës teknike të UNDP-së gjatë përgatitjes së komunikimeve kombëtare për KKKBNK. Për sa i përket procesit të hartimit të PKEK-së, aksesueshmëria e të dhënave dhe niveli i detajimit nuk kanë qenë gjithmonë në nivele optimale, si pasojë e procedurave dhe afateve të ndryshme. Pavarësisht këtyre sfidave, ecuria me harmonizimin e PKEK-së dhe NDC-ve për progres-raportet dhe përditësimet e ardhshme ka qenë e kënaqshme. Megjithatë, nevojiten masa zyrtare për të garantuar mbledhjen e të dhënave të ndara sipas kategorive, konsistencën e të dhënave dhe transparencën e tyre për aktivitetet e ardhshme.

1.1.1 Konteksti politik, ekonomik, mjedisor dhe social i planit

Konteksti politik:

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se ekzistojnë politika dhe ligje për secilin prej pesë dimensioneve të Unionit të Energjisë.

Shqipëria është përfshirë në procesin e krijimit të një tregu të brendshëm mbështetës në fushën e energjisë dhe në garantimin e sigurisë së energjisë, efijencës së energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit, përfshirë këtu edhe reduktimin e shkarkimeve të GES të përshkuara dhe paraqitura në një sërë masash të planifikuara dhe investimesh të identifikuar në dokumente politike të ndryshme. Strategjia Kombëtare e Energjisë, Plani i Dytë dhe i Tretë i Veprimit për Efijencën e Energjisë, Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë dhe Strategjia e Transportit kanë përcaktuar objektiva dhe pikësnyime për rritjen e sigurisë së furnizimit me anë të investimeve në sektorin e energjisë elektrike, penetrimit të gazit në tregun shqiptar dhe rritjes së përqindjes së BRE-ve dhe EE-së, pasuar nga një reduktim në shkarkimet e GES.

Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” ka hedhur bazat për transpozimin e Rregullores “Për qeverisjen e Unionit të Energjisë” (Rregullorja për Qeverisjen) dhe të legjislacionit përkatës të BE-së për ndryshimet klimatike.

Për implementimin dhe zbatimin e plotë të politikave për energjinë dhe klimën, legjislacioni dytësor për efijencën e energjisë, përfshirë këtu edhe performancën e energjisë në ndërtesa, është miratuar plotësisht gjatë vitit 2020, ndërsa legjislacioni dytësor për burimet e rinovueshme të energjisë është ende në hartim e sipër ose nuk ka filluar ende të hartohet.

Struktura institucionale për planifikimin dhe raportimin e politikave dhe masave në lidhje me energjinë dhe klimën është në zhvillim e sipër. Institucionet dhe profesionet në vijim, të cilat janë krijuar me ligj, mbeten ende për t'u themeluar në praktikë: Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë¹, Operatori i Energjisë së Rinovueshme, shoqëritë elektroenergjetike, Instituti Shkencor i Hidrokarbureve, operatorët e gazit natyror.

Konteksti ekonomik:

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave kombëtare të energjisë dhe hartimi i PKEK-së do të ndikojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Shumë investime që janë parashikuar të realizohen në të gjithë sektorin e energjisë do të kenë një ndikim të madh në rritjen e PPB-ve sektoriale, gjenerimin e të ardhurave dhe rritjen e forcave punëtore në fusha të ndryshme.

Politikat dhe masat që lidhen me ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave, si dhe me ndërtimin e sistemeve fotovoltaike, do të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e punëve ekologjike. Reduktimi i varësisë nga importet e energjisë do të kontribuojnë jo vetëm në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, por edhe në rritjen e stabilitetit makroekonomik dhe politik të vendit përmes zvogëlimit të deficitit në buxhetin e brendshëm.

Konteksti mjedisor:

Politikat energjetike të Shqipërisë ndjekin tri objektiva:

- i) mbështetja për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë,
- ii) rritja e sigurisë së furnizimit me energji,
- iii) mbrojtja e mjedisit.

Burimet e rinovueshme të energjisë, sidomos ato të ndryshme nga burimet hidrike, janë një zgjidhje e mundshme për reduktimin e varësisë strategjike nga importet e energjisë dhe zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që rezultojnë në prodhim hidroenergjetik të pasigurt. Megjithatë, ka disa konflikte interesi me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, të cilat duhet të trajtohen siç duhet.

Konteksti social:

Rritja e nivelit të punësimit, kryesisht përmes investimeve në sektorin e energjisë dhe të ndërtimit, ka sjellë rritje të të ardhurave personale/familjare, duke u shoqëruar kështu me rritje të standardit të jetesës të shoqërisë. Ekziston një lidhje e fortë mes mirëqenies personale dhe asaj sociale, çka nënkupton se investimet jo vetëm që krijojnë vende pune, por edhe ndikojnë te të ardhurat e bashkive dhe ato të qeverisë qendrore përmes taksave, tarifave etj. dhe përdorimit të tyre në forma buxhetore për qëllime të tilla si shëndetësia, arsimiti etj.

Në mënyrë të veçantë, pikësynimet lidhur me Eficientë e Energjisë kanë për qëllim reduktimin e konsumit të energjisë për njësi, duke kontribuar kështu në furnizimin me energji të përballueshme dhe reduktimin e varfërisë.

1.1.2 Strategjia në lidhje me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë

Pesë dimensionet e Unionit të Energjisë janë: I. siguria e energjisë; II. tregu i brendshëm i energjisë; III. eficienta e energjisë IV. dekarbonizimi; dhe V. kërkimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria.

Strategjia në lidhje me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë bazohet mbi katër shtylla:

- (1) Diskutimi dhe shqyrtimi i pikësynimeve, politikave dhe masave sektoriale me qëllim identifikimin e mangësive dhe sinergjive, veçanërisht në lidhje me zbutjen e varfërisë energjetike

¹Deri më tani, ky funksion po ushtrohet nga AKBN-ja. Ende nuk është përcaktuar agjencia që do të marrë përsipër në mënyrë të përhershme përgjegjësitë e saj.

dhe ofrimin e energjisë së përbalueshme për njerëzit, si dhe në lidhje me krijimin e vendeve të punës. Për rrjedhojë, një pikë e rëndësishme fokusi janë edhe masat e financimit.

(2) Vënia në dispozicion, për aq sa është e mundur, e të dhënave sasiore cilësore. Ato duhet të ofrohen me sa më shumë detaje të jetë e mundur për të mbështetur procesin e analizimit dhe arritjes së rezultateve të nevojshme për analizat, planifikimin dhe monitorimin e thelluar në sektorë të ndryshëm të lidhur me energjinë.

(3) Harmonizimi i proceseve të mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave, me qëllim kufizimin e barrës mbi administratën publike përgjegjëse për këto detyra. Kjo përbën një shqetësim të përgjithshëm i cili, rrjedhimisht, lidhet ndër të tjera edhe me hartimin e PKEK-së.

(4) Krijimi i ndërgjegjësimit dhe pranimit të PKEK-së mes të gjitha grupeve të interesit, përmes organizimit të procedurave të informimit dhe konsultimit me publikun.

Baza për këtë është ngritja e një strukture dhe procedure koordinimi mes ministrive dhe drejtorive të ndryshme që luajnë një rol në pesë dimensionet e Unionit të Energjisë.

Komiteti Ndërmintor për Energjinë dhe Klimën (IECC) është ngritur për të garantuar që pikësynimet, politikat dhe masat e hartuara të jenë të realizueshme dhe realiste për sa i përket zbatimit dhe ndikimit të tyre të mundshëm në nivel kombëtar.

Hartimi i PKEK-së konsiderohet si një proces menaxhimi gjithnjë i hapur, bazuar në përmirësimet e vazhdueshme. Situata në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave është veçanërisht sfiduese dhe është identifikuar si një fushë veprimi me prioritet të lartë, me synim përmirësimin e versioneve të ardhshme të PKEK-së.

1.1.3 Tabelë përmbledhëse me objektivat, politikat dhe masat kryesore të planit

Në kreun 3 është dhënë një tabelë përmbledhëse me politikat dhe masat kryesore (Tabela 11: Tabelë përmbledhëse e politikave kyçe që ndikojnë në objektivin kombëtar klimatik deri në vitin 2030). Baza analitike e PKEK-së (krerët 4 dhe 5) shpjegon se pikësynimet ndikohen kryesisht nga mënyra e operimit të impianteve të energjisë së rinovueshme, reduktimi i përdorimit të lëndëve djegëse fosile në transport dhe në industri përmes zëvendësimit të lëndës djegëse dhe masat e efijencës së energjisë që synojnë sektorin e ndërtimit. Edhe menaxhimi i pyjeve ka gjithashtu një ndikim madhor.

Pikësynimet që duhet të arrihen brenda vitit 2030 paraqiten në tabelën në vijim.

Pikësynimet (2030) dhe referenca		Kontributi sipas sektorëve	
Kontributet në shkarkimet e GES-ve (Reduktimi në raport me WEM)	-18,7%		
		Shkarkimet e GES-ve [kt CO ₂ eq] siç është projektuar me masat shtesë për vitin 2030.	
		Kërkesa	4833,0
		Transformimi	250,8
		Konsumi joenergjetik	5139,0

		Për më shumë detaje shihni kreun 5, Tabela 36
Efiçenca e energjisë (Reduktimi i Konsumit Final të Energjisë në raport me WEM)	-8.4%	
		Konsumi final i energjisë [ktoe] siç është projektuar me masat shtesë për vitin 2030
		Sektori i banesave
		348,9
		Shërbimet
		195,2
		Industria
		542,4
		Transporti
		1003,4
		Bujqësia Pylltaria
		110,5
		Peshkimi
		56,0
		Konsumi joenergjetik
		70,6
Pjesa që zë energjia e rinovueshme në kërkesën finale për energji	54.4%	
		Përqindja e BRE-ve në kërkesën finale për energji [përqindje] siç është projektuar me masat shtesë për vitin 2030 * Vlerat mbi 100% janë për shkak të eksporteve të energjisë elektrike.
		BRE- Energjia elektrike
		178,1 %*
		Për më shumë detaje shihni kreun 5, Tabela 40
		BRE-Transporti
		34.6 %
		Për më shumë detaje shihni kreun 5, Tabela 41
		BRE-Ngrrohje&Ftohje
		16.6 %
		Për më shumë detaje shihni kreun 5, Tabela 42

Tabela 1: Objektivat 2030 dhe kontributet në sektor

1.2 Përmbledhje e situatës aktuale të politikave

1.2.1 Sistemi kombëtar i energjisë dhe konteksti politik i planit kombëtar

Sistemi kombëtar i energjisë

Sektori shqiptar i energjisë² mbulon nënsektorët në vijim³:

- Sigurinë e furnizimit dhe infrastrukturën (e energjisë)
- Rregullimin e tregut të energjisë
- Efiçencën e energjisë
- Hidrokarburet
- Energjinë e rinovueshme

Sistemi kombëtar i energjisë për sa i përket kërkesës dhe ofertës dhe sfidat kryesore me të cilat ai përballlet janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në vijim.

Me pak fjalë, varësia nga importi dhe humbjet e mëdha në shpërndarje në rrjetin elektrik janë sfida që duhen trajtuar. Planet për të rritur përdorimin e gazit natyror duhet të zhvillohen në mënyrë të kujdesshme dhe të harmonizohen me plane të tjera, për të garantuar arritjen e pikësnyimeve lidhur me reduktimin e GES-ve dhe reduktimin final të energjisë, si dhe të pikësnyimeve për përmirësimin e EE-së (efiçencës së energjisë).

Shqipëria varet thuajse ekskluzivisht nga energjia hidrike për gjenerimin e energjisë elektrike (98% e energjisë elektrike të gjeneruar prej saj vjen nga burimet hidrike), gjë që e bën atë gjithmonë e më të cenueshme nga kushtet hidrologjike të pafavorshme gjatë verës, veçanërisht për sa u përket efekteve të parashikuara të ndryshimeve klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përveç faktit që prodhimi nuk është konstant, energjia elektrike nga burimet hidrike është e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat. Shqipëria është një importues neto i energjisë elektrike dhe garantimi i sigurisë së furnizimit të saj me energji përbën sfidë. Kësisoj, Shqipëria ka filluar planifikimin e masave të duhura për të rritur investimet në projektet e energjisë së rinovueshme nga burime johidrike. Si pasojë e rënies së kostove të teknologjisë dhe potencialit të konsiderueshëm të vendit për energji të rinovueshme, burimet eolike dhe ato diellore fotovoltaike mund të shfrytëzohen me kosto efektive për të zbutur ndikimin mbi çmimin e energjisë elektrike për konsumatorin fundor. Në fund të vitit 2018 rezultoi një rritje prej 10 MW në energjinë fotovoltaike diellore të instaluar.

Gjatë viteve 2019-2020, Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë parashikon rritjen e prodhimit të energjisë së instaluar me bazë burimet e rinovueshme me 738 MW, si vijon: 57 MW energji hidrike; 490 MW energji fotovoltaike; 150 MW energji eolike; 41 MW MNU (energji e rikuperuar nga mbetjet). Sipas përlllogaritjeve, potenciali përkatës shtesë për gjenerimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri është 1761 GWh. (Burimi: Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019 - 2020)

Megjithatë, për sa u përket veçanërisht kontratave të koncesionit për ndërtimin dhe operimin e HEC-eve, janë shprehur dyshime lidhur me cilësinë e VSM-ve dhe VNM-ve të kryera në lidhje me projektet energjetike. Në përgjithësi, zbatimi i projekteve energjetike ka ecur më ngadalë se ç'ishte programuar, gjë që duhet të trajtohet në planifikimin strategjik. Tabela 2 tregon zhvillimin e ngadaltë të energjisë johidrike në kapacitetet e energjisë së rinovueshme.

² Referuar Strategjisë Kombëtare Sektoriale për Energjinë (NSSE) 2018-2030

³ Referuar ligjit "Për sektorin e energjisë", ligjet për nënsektorë të tjerë dhe NSSE 2018-2030

Viti	2017	2018	2019
Fuqia totale e instaluar	2145 MW	2204 MW	2275 MW
Energjia hidrike	100%		
Energjia fotovoltaike	1 MW	11 MW	15 MW
Prodhimi vjetor	4525 GWh	8552 GWh	5200 GWh
Energjia hidrike	100%		
Energjia fotovoltaike		1,334 MWh	22,190 MWh
Komente	1MW energji fotovoltaike në Korçë, por jashtë sistemit	1MW energji fotovoltaike në Korçë, por jashtë sistemit	

Tabela 2: Gjenerimi i energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë (Burimi: Plani i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019-2020; faqja 24)

Termocentrali i Vlorës (i ndërtuar me financim nga BERZH-i në vlerën 40 milionë euro, financim nga BEI në vlerën 40 milionë euro dhe financim nga BB* në vlerën 20,5 milionë euro) nuk është vënë kurrë në funksionim që prej përfundimit të tij në vitin 2011. Kjo për shkak të një defekti në sistemin e ftohjes së impiantit, i cili nuk është riparuar ende. Pas lidhjes së termocentralit të Vlorës me TAP-in, inkurajohet kalimi i tij nga përdorimi i naftës në përdorimin e gazit. Kjo do të kontribuonte në stabilizimin e gjenerimit të energjisë elektrike gjatë thatësirave në pjesën jugore të Shqipërisë. Megjithatë, kjo do të rrisë konsumin e gazit, e për rrjedhojë edhe shkarkimet e CO₂, dhe duhet marrë në konsideratë përkatësisht në planifikimin strategjik.

Struktura e sistemit shqiptar të energjisë

Më poshtë jepet një paraqitje në formë grafike e strukturës së sistemit shqiptar të energjisë:

Për sa i përket **Konsumit të brendshëm bruto** (për t'u konfirmuar) **për vitin 2019**, në sistemin shqiptar të energjisë kanë mbizotëruar dhe vazhdojnë të mbizotërojnë nënproduktet e naftës për përdorim në transport (rreth 53,3%), të pasuara nga energjia elektrike e prodhuar nga burime hidrike (rreth 28,17%), ndërsa vendin e tretë e mban biomasa (lënda drusore si lëndë djegëse, rreth 6,8%) e cila gjen përdorim për ngrohje, gatim dhe ujë të ngrohtë në banesa. Lënda drusore si lëndë djegëse përdoret kryesisht në banesa (në zonat rurale) dhe në sektorin e shërbimeve (Figura 1).




Figura 1: Konsumi i brendshëm bruto (ktoe)(Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë)

Varësia nga importet është një nga arsyt kryesore pse sistemi shqiptar i energjisë duhet të zhvillohet për t’u transformuar në një sistem energjie të diversifikuar që përdor burime alternative të energjisë, të tilla si gazi dhe burimet e rinovueshme me shkarkime më të ulëta të GES-ve, dhe që zbaton masa të eficientës së energjisë të bazuara në efikasitetin e kostos. Sistemi duhet të mbështetet te prodhimi i brendshëm dhe të jetë i përballeshëm për konsumatorët, duke kontribuar në reduktimin e varfërisë.

Figura 2 tregon varësinë e sistemit të energjisë nga importet. Përqindja e importeve në Konsumin e Brendshëm Bruto është e lartë dhe kjo ndikon në sigurinë e furnizimit. Sistemi i energjisë duhet të jetë më i diversifikuar dhe më efikas, si pasojë edhe e rritjes së kërkesës për vetëplotësim të nevojave për energji.




Figura 2: Përqindja e importeve në konsumin e brendshëm bruto për vitet 2004-2019 (Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë)




Figura 3: Konsumi final i energjisë sipas sektorëve (ktoe) (Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë)

Zhvillimi i konsumit final të energjisë gjatë viteve 2004-2019 mbizotërohet nga transporti, pasuar nga sektori i banesave dhe ai i tregtisë. Specifikisht, në vitin 2019 ka mbizotëruar sektori i transportit me 41,6%, me në vend të dytë sektorin e banesave dhe atë të tregtisë me 34,7%. Industria mban vendin e tretë me 18%, ndërsa pjesa e mbetur i atribuohet bujqësisë dhe sektorëve të tjerë.

Figura 4 tregon se pjesa më e madhe e burimeve të energjisë mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e naftës, veçanërisht në sektorin e transportit, pasuar nga burimet e energjisë hidrike dhe elektrike dhe biomasa.




Figura 4: Konsumi final i energjisë për vitin 2019 sipas lëndëve djegëse dhe sektorëve (Burimi: Bilanci Kombëtar i Energjisë)

Bazuar në dokumentet e politikave të energjisë, sektorët që konsiderohet se kanë një potencial të lartë për kursim energjie janë sektori i transportit, ndërtesat publike dhe private dhe industria.

Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike

Një çështje thelbësore për performancën e shoqërive të transmetimit dhe shpërndarjes, si një aspekt mjaft i rëndësishëm i furnizimit me energji, është fenomeni i humbjeve në transmetim dhe në shpërndarje.




Figura 5: Humbjet në transmetim dhe në shpërndarje në raport me energjinë elektrike të transmetuar dhe të shpërndarë në rrjete (Burimi: raportet vjetore të ERE) (vija e kuqe: humbjet në transmetim, vija blu: humbjet në shpërndarje)

Bazuar në raportet vjetore të ERE, falë investimeve në funksion të efijencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike, ka pasur disa arritje lidhur me reduktimin e humbjeve teknike në transmetim dhe në shpërndarje. Humbjet në transmetim u reduktuan nga 2,46% në vitin 2018 në 2,12% në vitin 2019. Niveli i humbjeve në shpërndarje për vitin 2019 ka pësuar një ulje me 2,17%, krahasuar me 23,96% në vitin 2018. Sipas ERE, humbjet totale në transmetim dhe në shpërndarje arrinin përafërsisht 23,91% në vitin 2019. (Burimi: raportet vjetore të ERE)

Intensiteti i energjisë

Siç mund të shihet nga Figura 6, për vitin 2014 intensiteti i energjisë ka qenë 0,219067 ktoe/miliardë euro PBB, teksa parashikohet të jetë 0,209423 për vitin 2020 dhe 0,175174 ktoe/miliardë euro PBB për vitin 2030. (Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë)

Sistemi shqiptar i energjisë mund të arrijë reduktimin e pikësnyuar të intensitetit të energjisë nëse zbatohen masat e PKVEE-së së 2-të dhe të 3-të.




Figura 6: Intensiteti i energjisë (Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë)

Konteksti politik i planit kombëtar

PKEK-ja hartohet në përputhje me:

- Strategjinë e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II), e cila është harmonizuar me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara;
- detyrimet që burojnë nga nënshkrimi i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK);
- tërësinë e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II) prezanton vizionin kombëtar për zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë përgjatë periudhës 2014-2020, si dokumenti kryesor vizionar dhe planifikues për vendin, dhe është harmonizuar shprehimisht me OZhQ-të. Teksa qëllimi është maksimizimi i përdorimit të treguesve të miratuar në nivel global, vizioni është gjithashtu maksimizimi i përdorimit të treguesve që do të ishin më të rëndësishëm për Shqipërinë⁴.

Referuar Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZhQ 7 - Energji e përbalueshme dhe e pastër, bën thirrje për akses universal në shërbimet energjetike moderne, përmirësim të efikasitetit të energjisë dhe rritje të përdorimit të energjisë së rinovueshme.

Sipas INSTAT-it, treguesit përkatës të furnizimit me energji që masin OZhQ7 në Shqipëri janë:

- Brenda vitit 2030 garantohet akses universal në shërbime energjetike të përbalueshme, të sigurta dhe moderne
- Përqindja e popullsisë me akses në energjinë elektrike është 100%
- Përqindja e popullsisë që mbështetet kryesisht te lëndët djegëse të pastra dhe te teknologjia e pastër është 34,38%

Sfidat me të cilat përballet aktualisht sektori i energjisë në Shqipëri përfshijnë:

- Përmirësimin e kërkesës për energji për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në sektorë të ndryshëm dhe rritjen e nivelit të konsumit të energjisë për frymë;
- Përmirësimin e tendencës së reduktimit të intensitetit të energjisë;
- Rritjen e sigurisë së furnizimit me energji duke përmirësuar efikasitetin e energjisë, duke rritur përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe të burimeve të tjera të brendshme të energjisë, si dhe duke rritur mirëqenien përmes bashkëpunimit dhe integritit rajonal;
- Vazhdimin e investimeve për të përmirësuar më tej performancën duke reduktuar humbjet në shpërndarje në rrjet dhe përmirësimin e normave të grumbullimit.

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe ndryshimeve klimatike në veçanti. Vetë Kushtetuta e Shqipërisë ka përfshirë “një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezin e tanishëm dhe atë të ardhshëm” si një prej objektivave sociale që duhet të merren në konsideratë nga të gjitha institucionet shtetërore.

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), të miratuar në “Samitin e Tokës në Rio” më 1992 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar më 1994, e cila ka përcaktuar objektivin për luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stabilizimit të përqendrimeve të GES-ve në atmosferë dhe kufizimit të rritjes së temperaturave mesatare globale për të përparuar zhvillimin e qëndrueshëm. Shqipëria ka nisur procesin e ndryshimit të statusit nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kuadrin e KKKBNK-së. Procesi është

⁴Rishikimi 3 i Performancës Mjedisore, UNECE

pjesë thelbësore e procesit të integritimit në BE dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të Gazeve me Efekt Serrë (GES-ve), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, si dhe transpozimin dhe zbatimin e tërësisë së legjislacionit të BE-së për ndryshimet klimatike. Me qëllim arritjen e objektivave të reduktimit të shkarkimeve, Marrëveshja e Parisit e miratuar në dhjetor 2015 dhe e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me anë të Ligjit nr. 75/2016, datë 14.07.2016, ka ngritur një “sistem nga poshtë-lart” ku Palëve u duhet të përgatisin dhe të komunikojnë kontribute kombëtare të përcaktuara (NDC) të njëpasnjëshme çdo pesë vite, me synimin për të përmirësuar në mënyrë progresive përpjekjet e tyre. Krahas NDC-ve të tyre, Palët duhet të formulojnë gjithashtu strategji afatgjata zhvillimi për arritjen e niveleve të ulëta të GES-ve brenda mesit të shekullit dhe t'i paraqesin ato brenda vitit 2020, duke demonstruar sesi përpjekjet e tyre do të kontribuojnë në arritjen e objektivit “zero shkarkime” brenda gjysmës së dytë të këtij shekulli.

Përditësimi i radhës i NDC-ve pritet brenda vitit 2020 dhe procesi i hartimit të PKEK-së duhet të jetë në një linjë me procesin e përditësimit të PKEK-së.

Më 2014, Urdhri i Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014, ngriti një grup pune ndërministror për koordinimin e detyrave të ministrive sipas detyrimeve të vendit në bazë të KKKBNK-së. Grupi i kryesuar nga zëvendës ministri i mjedisit përfshin përfaqësues të 12 ministrive shqiptare. Ndër të tjera, grupi ka tagrin për të hartuar politika dhe strategji dhe për të garantuar koordinim ndërinstitucional për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me ndryshimet klimatike.

Kuadri ligjor i Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën

Ndonëse Shqipëria po bën progres për sa i përket transpozimit dhe zbatimit të tërësisë së legjislacionit, mbeten ende disa pika kyçe:

- besueshmëria e bazës së të dhënave për energjinë dhe nevoja për të dhëna makroekonomike shumë më të detajuara me qëllim përmirësimin e analizave, rishikimeve të thelluara dhe monitorimeve të planeve të veprimit dhe strategjive lidhur me energjinë;
- shkalla e ulët e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike;
- nevoja për një kuadër financiar për zbatimin e masave politike.

Një nga shkaqet për moszbatimin e PKVM-ve të mëparshme apo legjislacionit për EE-në ka qenë edhe mungesa e një kuadri financiar për zbatimin e tyre (në formën e një fondi për EE-në apo në formën e një financimi të posaçëm nga shteti). Për të shmangur këtë rrezik, ngritja e mekanizmave të financimit për zbatimin e PKEK-së është çelësi drejt suksesit. Për shkak të kostove mjaft të larta të investimit dhe kohës së gjatë që duhet për realizimin e investimeve në sektorin e energjisë, investimet strategjike në BRE dhe BR po kthehen në problematika kyçe për sa i përket rritjes së sigurisë së furnizimit, reduktimit të shkarkimeve dhe përshtatjes së kërkesës për energji mbi bazën e planifikimit me kosto sa më të ulët.

Transpozimi i direktivave të BE-së në kuadër të tërësisë së legjislacionit të Komunitetit të Energjisë

Informacionet lidhur me statusin e transpozimit dhe zbatimit të direktivave janë dhënë në krerët për dimensionin përkatës. Shqipëria ka përgatitur dhe miratuar disa dokumente politike, strategji dhe plane veprimi të harmonizuara me tërësinë e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për energjinë dhe klimën.

Në vijim përshkruhen dokumentet kryesore politike në lidhje me energjinë:

- Strategjia Kombëtare Sektoriale për Energjinë 2018-2030, e miratuar me VKM nr. 480, datë 31.7.2018, përbën dokumentin strategjik thelbësor për sektorin kombëtar të energjisë, i cili përcakton qartë pikësynimet kombëtare për energjinë për vitin 2030.
- Plani Strategjik për Reformimin e Sektorit të Energjisë në Shqipëri (2018-2020), miratuar me

VKM nr. 742, datë 12.12.2018, është një udhërrëfyes për reformimin tërësor të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ai përbën bazën për Huanë e Bazuar në Politika (PBL) për zbatimin e Elementeve të caktuara të Reformave Politike (18 ERP) të renditura në këtë plan strategjik.

- Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë (2020-2022) përfshin pikat në vijim në lidhje me reformat në sektorin e energjisë: (i) Liberalizimin efektiv të tregut të energjisë, me pavarësi të plotë dhe me një bursë funksionale energjie; (ii) Zbatimin e ligjit për burimet e energjisë së rinovueshme; (iii) Miratimin e legjislacionit dytësor për ligjet mbi eficientësinë e energjisë dhe performancën e energjisë së ndërtesave.
- PKVEE-ja e 2-të dhe e 3-të ka përcaktuar disa objektiva dhe pikësnyime për t'u arritur brenda vitit 2020, si dhe masa për EE-në, investime dhe institucione përgjegjëse.
- Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKKVBRE 2019 – 2020), i miratuar me anë të VKM nr. 580, datë 31.7.2018, parashikon një rritje mesatare të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme me 738 MW, prej të cilave 490 MW nga burimet e energjisë fotovoltaike (PV) dhe 150 MW nga burimet e energjisë eolike.

1.2.2 Politikat dhe masat aktuale për energjinë dhe klimën lidhur me pesë dimensionet e Unionit të Energjisë

Përmbledhje e politikave kryesore

Strategjia Kombëtare e Energjisë për Shqipërinë

Strategjia e Energjisë për Shqipërinë 2018-2030, si dokumenti strategjik thelbësor për sektorin kombëtar të energjisë, është në koherencë të plotë me politikat dhe strategjitë e tjera kombëtare dhe me objektivat e Paktit të Gjellbër Evropian: Furnizimin me energji të pastër, të përballueshme dhe të sigurt; Ndërtimin dhe rinovimin, duke promovuar një sektor ndërtimi më të pastër; Përshpejtimin e kalimit drejt lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe inteligjente; Eliminimin e ndotjes përmes masave për reduktimin e shpejtë dhe efikas të ndotjes.

Pesë dimensionet që mbështet strategjia për energjinë janë:

1. Siguria e energjisë, bazuar në diversifikimin e burimeve të energjisë;
2. Integrimi i plotë në tregun rajonal dhe më pas në atë evropian;
3. Eficientësinë e energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës;
4. Dekarbonizimi i ekonomisë;
5. Kërkimi, inovacioni dhe konkurrenca

Strategjia e Energjisë për Shqipërinë është plotësisht në përputhje dhe e harmonizuar me “Udhërrëfyesin e Ekonomisë me Karbon të Ulët” të BE-së dhe nxit politikat për EE-në, BER-të dhe gazin natyror të cilat promovojnë një klimë të qëndrueshme biznesi që do t'u japë shtysë investimeve me karbon të ulët për periudhën 2017-2030. Siç tregojnë edhe analizat mbi të cilat mbështetet kjo strategji, potenciali i Shqipërisë për reduktimin e GES-ve është shumë herë më i madh se angazhimi fillestar i NDC-ve. Për rrjedhojë, strategjia për energjinë dhe objektivat politike që ajo synon janë në një linjë me qëllimet gjithnjë e më ambicioze të KKKBNK-së dhe BE-së/Komunitetit të Energjisë. Duke pasur parasysh statusin aktual të Shqipërisë si vend kandidat, ka gjasa që ajo të anëtarësohet në BE gjatë periudhës së mbuluar nga kjo strategji. Për këtë arsye, siç e kërkon edhe anëtarësimi i saj në Komunitetin e Energjisë, është me rëndësi thelbësore që strategjia për energjinë të jetë në përputhje edhe me Politikën e BE-së për Ndryshimet Klimatike, duke garantuar që objektivat e politikave të energjisë dhe planet përkatëse të veprimit për energjinë të identifikuar në këtë dokument të jenë në një linjë me ambiciet e shprehura në pikësnyimet e BE-së për reduktimin e CO₂ dhe në qëllimet politike lidhur me ndryshimet klimatike.

Figura e mëposhtme tregon politikat e tjera kryesore në formë të përmbledhur. Një përshkrim më i detajuar mund të gjendet në krrerët lidhur me dimensionet për të cilat instrumentet përkatëse të politikave janë me rëndësi të veçantë.




Figura 7: Përmbledhje e dokumenteve politike (Burimi: Konsolidimi i proceseve të planifikimit klimatik në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, New Climate Institute, maj 2019)

Përmbledhje e institucioneve qeveritare

Institucionet më të rëndësishme në përcaktimin e politikave dhe rregullimin e sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”) dhe Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”). Krahas MIE dhe ERE, janë gjithashtu edhe një sërë ministrish që luajnë një rol më të vogël në sektor, si dhe një sërë agjencish qeveritare të cilave u janë deleguar nga ministritë përgjegjësi në lidhje me sektorin e energjisë elektrike. Këto janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë qeveritare e shoqëritë e përfshira në furnizimin me energji, siç tregohen në figurën më poshtë. Në shtojcë jepet një përshkrim më i hollësishëm i organizatave të paraqitura.




Figura 8: Organigramma e institucioneve qeveritare të përfshira në hartimin dhe zbatimin e PKEK-së

Dimensioni i dekarbonizimit – shkarkimet dhe largimet e GES-ve

Politikat kryesore janë KKP-të dhe Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike.

KKP (Kontributet Kombëtare të Pikësnuara)

Ndonëse Shqipëria ka një ekonomi me karbon të ulët, INDC-të (Kontributet Kombëtare të Pikësnuara) të Shqipërisë synojnë reduktimin e shkarkimeve të saj të CO₂ me 11,5% krahasuar me skenarin bazë për periudhën 2016 deri në 2030. Ky reduktim është i barasvlershëm me një reduktim të shkarkimeve të CO₂ me 708 Gg brenda vitit 2030. Trajektorja e shkarkimeve për Shqipërinë mundëson një tendencë të lehtë drejt arritjes së 2 tonëve shkarkim të GES-ve për frymë brenda vitit 2050, çka mund të merret si pikësynim për tkurrjen dhe bashkërendimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

Mekanizmat kryesorë për arritjen e këtij objekti lidhen me ruajtjen e niveleve të ulëta të shkarkimeve të gazeve serë nga sektori i prodhimit të energjisë dhe zhvillimin e politikave me karbon të ulët me qëllim parandalimin e rritjes së shkarkimeve të gazeve me efekt serrë nga sektorë të tjerë të ekonomisë.

Të gjithë sektorët duhet të kontribuojnë në kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët sipas potencialit të tyre teknologjik dhe ekonomik. Udhërrëfyesi i Ekonomisë me Karbon të Ulët i BE-së bën thirrje për marrjen e masave në të gjithë sektorët kryesorë përgjegjës për shkarkimet në Evropë – sektori i prodhimit të energjisë elektrike, industrisë, transportit, ndërtesave, ndërtimit dhe bujqësisë - dhe nevojiten investime të konsiderueshme në:

- Teknologjitë e reja me karbon të ulët
- Energjinë e rinovueshme
- Eficientën e energjisë dhe
- Infrastrukturën e rrjetit.

Gjatë 2013-2014, me mbështetjen e UNDP-së, u krye një inventar fillestar i NAMA-ve potenciale (Nationally Appropriate Mitigation Action - Masave Zbutëse të Përshtatshme për Vendin) në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2019-2030)

Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2019-2030) është harmonizuar me dokumentet kryesore në vijim:

- Detyrimet në kuadër të Komunitetit të Energjisë
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim – 2015-2020 (Këshilli i Ministrave, 2017)
- Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë (2020-2022)
- Drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKVBRE) i vitit 2019
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Tiranë, qershor 2016)
- Dokumenti i parë për përcaktimin e kontributit kombëtar të përcaktuar (NDC) kundrejt arritjes së pikësnyimit të KKKBNK-së, miratuar me VKM Nr. 762, datë 16.9.2015
- Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKKVBRE 2019 – 2020) (VKM Nr. 580, datë 31.7.2018)

Masat politike më të rëndësishme janë ligjet kryesore që krijojnë kushtet thelbësore për rritjen e numrit të impianteve të energjisë së rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (shihni kreun vijues “Dimensioni i dekarbonizimit – Energjia e rinovueshme”).

Dimensioni i dekarbonizimit – Energjia e rinovueshme

Plani i Shqipërisë për Burimet e Rinovueshme të Energjisë përbën politikën kryesore dhe është harmonizuar nga pikëpamja e qëllimeve, detajeve të sektorit të energjisë dhe afateve kohore me një sërë dokumentesh të tjera strategjike dhe ligjore të miratuara apo të hartuara, që tregohen në tabelat në vijim.

Legjislacioni shqiptar	Direktiva e BE-së	Status quo-ja
Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme”	Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 prill 2009, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme”	→ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian. Ai hyri në fuqi dhe efekt të plotë rreth fundit të shkurtit 2017. → Ky ligj parashtron disa nxitje për operatorët që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, si dhe parashikon të drejtën për të aplikuar pranë ERE-së për marrjen e garancive të origjinës për çdo 1 MWh energji të rinovueshme të prodhuar. → Ligji është relativisht i ri dhe i mungon legjislacioni dytësor i nevojshëm për zbatimin e tij.
Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar	Direktiva 2003/30/KE	→ Direktiva është shfuqizuar në BE dhe në Komunitetin e Energjisë, duke u zëvendësuar me Direktivën 2009/28/KE; Ligji nr. 7/2017 nuk përfshin nenet përkatëse (17 deri në 21) lidhur me biokarburantet. Nevojitet ndryshimi i ligjit ekzistues për biokarburantet ose miratimi i një ligji të ri për të arritur pajtueshmërinë me dispozitat e Direktivës së re të BE-së 2009/28/KE për biokarburantet dhe për të trajtuar çështjen e masave për arritjen e objektivit për biokarburantet, çështjen e ngritjes së një skeme dhe organi për verifikimin e qëndrueshmërisë etj. →Projektligji i vitit 2019 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” zbatohet për aktivitetet e prodhimit dhe të përdorimit të

		biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, të përdorura për motorët me djegie të brendshme në transport, ku nivelet e biodizelit dhe bioetanolit janë në përputhje me standardet shqiptare. Duke filluar nga viti 2020, sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport në treg nuk do të jetë më pak se 10% e sasisë së konsumuar nga transporti në vitin 2018 dhe 2019; niveli i biokarburanteve të prodhuara nga mbetjet, materialet celuloze joushqimore dhe materialet celuloze rezultuese jo mbetje do të jetë sa gjysma e nivelit të synuar të përcaktuar për biokarburantet e tjera.
		Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” përcakton parimet kryesore për zhvillimin e sektorit të energjisë, duke përfshirë centralet e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes. Ligji transponon Direktivën e BE-së 2009/72 për energjinë elektrike dhe shfuqizon ligjin e mëparshëm për energjinë elektrike (Ligji nr. 40/2015, datë 22.5.2003). Ky ligj përfshin gjithashtu kërkesa dhe kritere për dhënien e një licence për kryerjen e një aktiviteti në sektorin e energjisë. Ligji përfshin gjithashtu një sërë dispozitash specifike që rregullojnë ndërtimin e një linje direkte apo të një linje tregtare interkoneksioni.

Tabela 3: Përafrimi i legjislacionit shqiptar për energjinë me Direktivat e BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë për BER-të

Treguesit e energjisë rinovueshme	Vlerësimi i transpozimit	Statusi i zbatimit	Përshkrimet
Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë	√	94%	Shqipëria e ka ndryshuar Planin e saj Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë duke përfshirë një objektiv të rishikuar prej 490 MW për energjinë fotovoltaike diellore dhe 150 MW për energjinë eolike, për të kontribuar në objektivin 38% në 2020. Varësia e madhe nga energjia hidrike ka ndikuar negativisht në përqindjen e energjisë së rinovueshme, e cila është reduktuar në 34,6% për shkak të burimeve të pakta hidrike në vitin 2017.
Cilësia e skemave të mbështetjes	~	82%	Ankandi i parë i energjisë së rinovueshme për 50 MW energji diellore fotovoltaike, i kryer në fund të vitit 2018, mbetet ende për finalizuar. Gjithashtu, mbetet për t'u miratuar edhe paketa kontraktuale. Shqipëria duhet të përmirësojë kuadrin për ankandet e ardhshme.
Integrimi me rrjetin	√	55%	Legjislacioni dytësor për realizimin e aksesit në rrjete dhe të funksionimit të rrjeteve mbetet ende për t'u finalizuar dhe për t'u vënë në dispozicion të të gjithë aplikantëve. Janë miratuar rregullore transitorë të balancimit. Rregullat

			e miratuara për konsumin vetjak mbeten ende për t'u zbatuar në praktikë.
Procedurat administrative	~	50%	Procedurat administrative për dhënien e autorizimeve, lejeve dhe licencave nuk janë efektivizuar dhe duhet të thjeshtohen, duke caktuar një pikë të vetme kontakti për projektet e vogla.
Energjia e rinovueshme në transport	X	1%	Ende nuk është ngritur një regjim qëndrueshmërie për biokarburantet.

Tabela 4: Zbatimi i energjisë së rinovueshme (Burimi: Raporti vjetor i zbatimit 2018/2019, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 1 nëntor 2019, faqja 23/24)

Qeveria Shqiptare dhe ERE-ja janë duke rishikuar aktet nënligjore me qëllim përmbushjen e kërkesave të ligjeve të reja për sektorin e energjisë⁵, duke përfshirë një sërë aktesh nënligjore të miratuara të përcaktuara në vijim:

- VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për strategjinë kombëtare të energjisë 2018-2030”.
- VKM nr. 580, datë 31.7. 2019, “Për miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë” (PKKVBRE 2019 – 2020)” përcakton një objektivi prej 38% për burimet e rinovueshme të energjisë deri në vitin 2020.
- VKM nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”.
- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.
- VKM nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës”.
- VKM nr. 858, datë 4.11.2020, baza ligjore e ndryshuar për zhvillimin e ankandeve hibride, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 349, datë 12.6.2018”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 3.3.2021, “Për përcaktimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, që do të veprojë si një organ tjetër në Kontratën për Diferencë (KpD) për të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe për të gjithë përfituesit që përfitojnë nga tarifa “feed-in” (FIT).
- Urdhri i Ministrit nr. 27, datë 18.1.2021, “Për miratimin e strategjisë së transformimit të skemës së mbështetjes FiT në një skemë mbështetjeje KpD” për energjinë e rinovueshme është hartuar dhe rishikuar nga Komuniteti i Energjisë. Kjo strategji do të ndihmojë në krijimin e një plani për transformimin e skemës aktuale FiT në një skemë mbështetjeje të bazuar në treg.
- VKM nr. 416, datë 13.5.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, i cili përcakton kushtet dhe procedurat e posaçme të rishikimit dhe vendimmarrjes për dhënien e një autorizimi ose lejeje për përdorim të burimeve ujore, duke përfshirë përdorimin e ujit për ndërtim të hidrocentraleve.
- Vendimi i ERE nr. 120, datë 27.7.2017, “Mbi përcaktimin e çmimeve të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW”.
- VKM nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes

⁵ Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i miratuar nga Parlamenti Shqiptar në prill 2015;

Ligji nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, i miratuar nga Parlamenti Shqiptar në Nëntor 2015;

Ligji nr. 7/2017, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, i miratuar nga Parlamenti Shqiptar në shkurt 2017.

së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”

- Është duke u përgatitur rregullorja “Për metodologjinë e përlllogaritjes së çmimit të energjisë elektrike për vetëprodhuesit që përfitojnë nga skema e matjes së energjisë neto”, bazuar në urdhrin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”.
- Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE) ka miratuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 229, datë 20.12.2019, “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, me qëllim shkëmbimin e energjisë së rinovueshme për arritjen e objektivave në vende të tjera që kanë mundësi investimi në BRE.

Strategjia e Energjisë trajton ligjet rregulloret dhe reformat e reja institucionale që po zhvillohen aktualisht në Shqipëri, duke përfshirë nxitjet për EE-në dhe BRE-së, reformën e tarifës së energjisë elektrike, zhvillimin e tregut dhe integrimin me tregun e BE-së dhe tregjet rajonale.

Dimensioni i efijencës së energjisë

Dokumenti politik kryesor është Strategjia Shqiptare e Energjisë. Ajo përcakton objektivat dhe synimet për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji përmes diversifikimit të prodhimit të energjisë, reduktimit të nivelit të humbjeve teknike dhe joteknike të energjisë në rrjet, rritjes së EE-së në mbarë sistemin e energjisë dhe rritjes së përqindjes së BRE-ve bazuar në planifikimin me kosto më të ulët, pasuar nga reduktimi i sasisë së energjisë së importuar, përmirësimi i intensitetit të energjisë dhe reduktimi i shkarkimeve të GES-ve.

Dokumentet politike dhe ligjet kryesore krijojnë një mjedis mundësues për zbatimin e masave të efijencës së energjisë të treguara në tabelën e mëposhtme.

Rishikimi i legjislacionit për EE-në dhe hartimi i akteve nënligjore përbën një masë politike të rëndësishme, pasi lehtëson zbatimin e legjislacionit.

Politikat aktuale të energjisë	Ligji/VKM-ja	Përshkrimi
Politikat dhe legjislacioni në fuqi		
Strategjia Kombëtare e Energjisë	nr. 408, datë 31.7.2018	Përcakton objektivat dhe synimet për mbarë sektorin e energjisë, investimet dhe institucionet përgjegjëse
“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 124/2015 “Për efijencën e energjisë”, të ndryshuar”	Ligji nr. 28/2021	Synimi është përafrimi i plotë me dispozitat e Direktivës 2012/27/BE të Parlamentit Evropian.
Ligji “Për efijencën e energjisë”	Nr. 124/2015, datë 12.11.2015	Transpozim i pjesshëm i Direktivës për EE-në 2012/27/BE. Qëllimet e ligjit janë: a) hartimi i rregullave dhe politikave kombëtare për nxitjen dhe përmirësimin e efijencës së energjisë, me qëllim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe eliminimin e pengesave në tregun e energjisë;

		<p>b) përcaktimi i objektivave kombëtare për eficientë e energjisë;</p> <p>c) rritja e konkurrueshmërisë së operatorëve.</p>
Ligji “Për performancën e energjisë së ndërtesave”	Nr. 116/2016, datë 10.11.2016	<p>Transpozim i Direktivës për EE-në 2010/31/BE (EPBD)</p> <p>Ky ligj synon të krijojë kuadrin ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimatike të vendit, rehatinë e brendshme të ndërtesave dhe efikasitetin e kostos.</p> <p>Legjislacioni dytësor nuk është hartuar ende.</p>
Ligji “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”	Nr. 68/2012	Duhet të riformulohet sipas Politikës së re të BE-së për Projektimin dhe Etiketimin Ekologjik (Direktiva për Projektimin Ekologjik 2009/125/KE dhe Rregullorja Kuadër për Etiketimin BE 2017/1369)
Plani i dytë dhe i tretë Kombëtar i Veprimit për Eficientë e Energjisë, 2017-2020	VKM nr. 709, datë 1.12.2017	Dokumenti synon të japë një përmbledhje të statusit të zbatimit, planeve politike të ardhshme dhe mekanizmave financiarë që do të përdoren për arritjen e objektivave lidhur me kursimet e energjisë në konsumin final të energjisë me 6,8% deri në vitin 2020, përkundrejt skenarit bazë.
“Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020”	VKM nr. 811, datë 16.11.2016	Objektivi kryesor i strategjisë është krijimi i një sistemi efikas transporti që nxit zhvillimin ekonomik dhe përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020 është (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar shqiptar të transportit, dhe gjithashtu; (ii) të përmirësojë qëndrueshmërinë, interkoneksionin, ndërveprueshmërinë dhe integrimin e tij me sistemin më të gjerë të transportit ndërkombëtar dhe evropian dhe me rajonin.
Plani i Transportit të Qëndrueshëm “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020”	VKM nr. 841, datë 16.11.2016	Objektivi kryesor i strategjisë është të krijojë bazat për një sistem efikas transporti që nxit zhvillimin ekonomik.
Legjislacioni dytësor në fuqi për EE-në në ndërtesa dhe në industri		

“Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”	VKM nr. 407, datë 19.6.2019	Sipas Direktivës 2010/31/BE (Direktiva për Performancën e Energjisë së Ndërtesave - EPBD)
“Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”	VKM nr. 342, datë 22.5.2019	Sipas Direktivës 2012/27/BE (Direktiva për Efiçencën e Energjisë - EED)
“Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, të njëjësive dhe të elementeve të ndërtesave”	VKM nr. 256, datë 27.3.2020	Miratur rishtazi sipas Direktivës 2010/31/BE
“Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”	VKM nr. 934, datë 25.11.2020	Sipas Direktivës 2012/27/BE (Direktiva për Efiçencën e Energjisë - EED)
“Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të “certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave””.	VKM nr. 958, datë 02.12.2020	Sipas Direktivës 2012/27/BE (Direktiva për Efiçencën e Energjisë - EED)
VKM-ja “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”, miratur më 24 dhjetor 2020.	VKM nr. 1094, datë 24.12.2020	Sipas Direktivës 2012/27/BE (Direktiva për Efiçencën e Energjisë - EED)
“Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave”	VKM nr. 537, datë 8.7.2020	Sipas Direktivës 2010/31/BE (Direktiva për Performancën e Energjisë së Ndërtesave - EPBD)
“Për rregullat teknike për etiketimin e konsumit të energjisë nga kondicionerët”	VKM nr. 65, datë 21.10.2015	
“Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë””	VKM nr. 928, datë 19.12.2012	

“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)”.	VKM nr. 36, datë 20 janar 2016	
Legjislacioni në zhvillim e sipër		
Nevojitet hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2017 – 2020 për periudhën 2021-2030.		PKEK-ja do të përcaktojë objektivat përkatëse për efiçencën e energjisë dhe shkarkimet e GES-ve për periudhën 2021 – 2030.

Tabela 5: Politikat dhe ligjet kryesore lidhur me dimensionin e EE-së, duke përfshirë legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe të BE-së

Dokumenti që lidhet me strategjinë e energjisë dhe që përcakton objektivat për rritjen e efiçencës së energjisë brenda vitit 2020 është Plani i 2-të dhe i 3-të Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) për Shqipërinë 2017-2020, miratuar me VKM nr. 709, datë 1.12.2017. PKVEE-ja ka përshkruar dhe parashikuar masat që duhet të ndërmerren për EE-në, investimet, institucionet përgjegjëse, shoqëritë e energjisë, sektorin privat dhe aktorët e ndryshëm etj., për sa u përket kursimeve të energjisë, kostove të kursimit të energjisë, ndikimit të shkarkimeve të CO2 dhe efikasitetit të kostos së paketave të ndërhyrjeve. Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë 2017 – 2020 do të përditësohet për periudhën 2021-2030 si pjesë përbërëse e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) 2021 – 2030. PKVEE-ja e 2-të dhe e 3-të e Shqipërisë ka parashikuar një plan për zhvillimin dhe zbatimin e një sërë masave politike për efiçencën e energjisë lidhur me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe konsumin e burimeve të energjisë në të gjithë sektorët e ekonomisë. Masat për EE-në do të kenë veçanërisht tre sektorë në fokus: Ndërtesat, sektorin e energjisë (prodhimit, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë) dhe sektorin e transportit.

Objekivi i përcaktuar për kursimet e energjisë në Konsumin Final të Energjisë për vitin 2020 parashikohet të jetë 6,8% ose 123. 72 Ktoe krahasuar me skenarin bazë për të njëjtin vit 2020.

Në mënyrë të veçantë, objektivat e kursimeve të energjisë nga sektorët në konsumin final të energjisë parashikohet të jenë siç tregohen në tabelën në vijim.

Sektorët deri në 2020	Ktoe
Ndërtesat	37,43
Shërbimet	16
Industria	6,9
Transporti	49,49
Horizontal	13,9

Tabela 6: Kursimet finale të energjisë sipas sektorit

Disa zhvillime dhe zbatime të masave për EE-në në nivelin e konsumit primar dhe final të energjisë

Për shkak të investimeve të planifikuara dhe të realizuara nga shoqëritë shqiptare të energjisë për fuqizimin e kapaciteteve të energjisë elektrike për transmetim dhe shpërndarje, dhe për rritjen e efiçencës së rrjeteve (me më pak humbje teknike dhe joteknike si në transmetim ashtu dhe në

shpërndarje), ka pasur përmirësim të situatës në lidhje me reduktimin e humbjeve teknike dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve të pagesave për faturat e energjisë elektrike (humbjet joteknike).

Sipas raportit vjetor të ERE, **OST** ka ndërmarrë disa investime që kanë rezultuar në një reduktim të nivelit të humbjeve nga 2,3% në vitin 2013 në 2,12% në vitin 2019. OST do të vazhdojë investimet për përmirësimin e rrejtë. (www.ere.gov.al, raportet vjetore)

Konkretisht, në **OSSHE** zbatohet VKM nr. 763, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime në VKM nr. 1086, datë 14.12.2013, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”. Kjo VKM ka zgjatur aktivitetin e task-forcës nga 31.12.2017 deri më 31.12.2019, me qëllim përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe reduktimin e humbjeve joteknike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. OSHEE S.A. është duke përmirësuar vazhdimisht performancën e saj për reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe rritjen e niveleve të arkëtimeve të faturave. (www.ere.gov.al, raportet vjetore)

Rezultatet e arritura tregohen në tabelën më poshtë.

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Niveli i arkëtimeve të faturave	81,04	92,69	100,65	93,50	96,60	101,9 ⁶	98,4

Tabela 7: Niveli i arkëtimeve të faturave në 2013 - 2019 (në %) (Burimi: Enti Rregullator i Energjisë (raportet vjetore të ERE))

Më poshtë përshkruhen disa prej ecurive dhe zhvillimeve të tjera të arritura në lidhje me EE-në në nivelin e konsumit final të energjisë, bazuar në raportin e 2-të vjetor nga AEE-ja.

Në sektorin e ndërtesave kanë nisur aktivitetet në vijim, të cilat pritet të replikohen më gjerë:

- Projekti “Për auditimin e energjisë në ndërtesa publike”, i kontraktuar nga MIE nën buxhetin e shtetit, sipas parashikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020, ka për qëllim:
 - Krijimin e një inventari të ndërtesave publike dhe hedhjen e të dhënave në një server të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, duke i emërtuar dhe kodifikuar ato në regjistrin elektronik kombëtar, i cili ka aftësinë për të integruar dhe për të lejuar të dhënat e tij të integrohen në serverët dhe bazat e të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
 - Auditimin e të gjitha ndërtesave për tri vite dhe regjistrimin e tyre në server me të dhëna lidhur me analizën e efikasitetit të kostos për rinovimin e tyre. Gjatë vitit 2018, janë përzgjedhur 60 ndërtesa që përfaqësojnë të gjitha tipologjitë e identifikuarat e që japin informacionin e nevojshëm për hartimin e politikave të efiçencës së energjisë, duke marrë në konsideratë efikasitetin e kostos.
- Projekti për përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në Qytetin Studenti 2 është përfunduar edhe në disa ndërtesa në Qytetin Studenti 1.
- Bashkia e Tiranës ka zhvilluar projekte për përmirësimin e efiçencës së energjisë duke bërë ndërhyrje në fasadat e shumë ndërtesave private. Këto projekte janë realizuar me investim të përbashkët, 50% nga fondi i Bashkisë së Tiranës dhe 50% nga banorët.
- Në sektorin e transportit, masat për rehabilitimin dhe rindërtimin e disa rrugëve ndihmojnë në reduktimin e konsumit të karburantit nga automjetet. Rritja e përdorimit të biçikletave dhe transportit publik ka lehtësuar reduktimin e përdorimit të automjeteve private. Është vendosur një taksë për të nxitur përdorimin e automjeteve të reja dhe me konsum më të vogël karburanti, që shkarkojnë më pak emetime. Megjithatë, masat për EE-në duhet të zgjerohen ndjeshëm.

⁶ Nivel arkëtimi mbi 100%: Nga arkëtimeve të prapambetura të periudhës 2007-2017 (të paarkëtuara plotësisht gjatë viteve të mëparshme)

- Në sektorin e energjisë, progresi ka qenë mjaft i vogël. Nevoja për përmirësimin e ligjit për EE-në ka të bëjë me skemat e detyrimeve dhe auditet e energjisë, si elementet kyç për identifikimin e konsumit faktik të energjisë dhe të energjisë që synohet të konsumohet pas investimeve në zbatimin e masave për EE-në.

Së fundmi, AEE-ja ka nxjerrë raportin e 4-t vjetor me disa gjetje të reja:

- Aktiviteti më i rëndësishëm i këtij viti ka qenë certifikimi i audituesve të parë të efikasitetit të energjisë. Agjencia ka testuar kandidatët më 21 maj 2020 dhe 26 ekspertët janë certifikuar tashmë si auditues të energjisë në ndërtesa dhe në procese. Aktualisht, AEE-ja është duke marrë raportet e para të auditimit.
- “Bashki me Energji Inteligjente” është një projekt i financuar nga Ambasada Zvicerane. Objektivi i këtij projekti dypalësh është të mbështesë bashkitë shqiptare të përzgjedhura në menaxhimin e energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe në zbatimin e politikës kombëtare të energjisë në nivel vendor. Me këtë qëllim, ai do të pilotojë dhe institucionalizojë një sistem të menaxhimit të energjisë që bazohet në Çmimin Evropian për Energjinë (European Energy Award - EEA) dhe përfshin kërkesat e legjislacionit kombëtar për energjinë. Projekti kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të energjisë, reduktimin e konsumit të energjisë, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.
- Interreg IPA II Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020. Objektivi i projektit është realizimi i investimeve të vogla në nZEB (ndërtesa me konsum energjie thuajse zero) dhe zhvillimi i një qasjeje të përbashkët kundrejt nZEB-ve publike përmes nismave inteligjente dhe krijimit dhe operimit të komuniteteve të energjisë në zonën përkatëse. Produktet kryesore janë:
 - Produkti 1: Studime të detajuara të aplikimeve të nZEB-ve me aplikime të EE-së dhe masa me kosto optimale për shndërrimin e hapësirave publike demonstrative në ndërtesa nZEB në 3 rajonet e zonës ndërkufitare (Artë, Gjirokastrë, Maqedoni Perëndimore).
 - Produkti 2: Zbatimi i investimeve të vogla të lartpërmendura.
 - Produkti 3: Krijimi i një qasjeje të përbashkët që do të lehtësojë dialogun, do të çojë në ndërmarrjen e nismave të përbashkëta, do të krijojë një procedurë të përbashkët dhe do të lehtësojë funksionimin e komuniteteve të energjisë dhe realizimin e investimeve në nZEB në zonën ndërkufitare.
 - Produkti 4: Masa për shpërndarjen e informacionit që ndihmojnë në reklamimin e nZEB-ve në zonë përmes një faqeje interneti, mediave sociale dhe një platforme online, materialeve të komunikimit/shpërndarjes, seminareve tematike lokale në 3 rajonet dhe konferencave për shtyp.
- Më 25 nëntor 2019, në kuadër të projektit REEHUB në bashkëpunim me Universitetin “Marin Barleti”, MIE dhe AEE, u hap Qendra Rajonale për Efikasitetin e Energjisë. Ky projekt synon të rrisë efikasitetin e energjisë së ndërtesave publike brenda zonës së Programit përmes një rrjeti platformash që mundësojnë trajnimin e administratorëve të ndërtesave lidhur me masat e efikasitetit të energjisë. Gjithashtu, projekti synon të garantojë komunikim të përshtatshëm dhe efektiv të konsumatorët dhe rritje të ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e shoqërisë. Rezultati ambicioz është kalimi nga ndërtesat e vjetra në ndërtesa që shpenzojnë shumë pak ose zero energji.
- Më 20 shkurt 2020, në Tiranë u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë dhe GSE SpA (*Gestore dei Servizi Energetici*). Ato duhet të bashkëpunojnë për të mundësuar aktivitete të përbashkëta dhe projekte evropiane të fokusuar tek iniciativat për ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimi i njohurive dhe praktikave të mira, seminarët e posaçme, turet studimore, trajnime dhe projekte demonstruese në sektorët e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë, duke përfshirë teknologjitë novatore që lidhen me projektet e rrjeteve inteligjente dhe matjeve inteligjente.

Ligji nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” është ndryshuar aktualisht për të reflektuar kërkesat e Direktivës për Efikasitetin e Energjisë (duke përfshirë nenin 5 dhe nenin 7) përmes Ligjit nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë””, të ndryshuar.

Ndërtesat e qeverisë qendrore (neni 5 i EPBD-së)

Sipas Ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave, nenit 10 C, bëhet fjalë për të gjitha ndërtesat me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej mbi 500 m², të cilat janë në përdorim nga një autoritet publik apo nga institucione që sigurojnë një shërbim ndaj publikut dhe që frekuentohen shpesh nga publiku.

Duke filluar nga data 9 korrik 2018, kërkesa për kufirin e mësipërm të sipërfaqes së shfrytëzueshme është zvogëluar në 250 m². Në këtë rast, certifikatat e performancës së energjisë duhet të vendosen në vende qartësisht të dukshme nga publiku.

Më 17 dhjetor 2019 u finalizua me sukses procesi i vlerësimit teknik të ofertave të projektimit për projektin e rindërtimit me efikasitetin e energjisë të ndërtesave të “Qytetit Studenti 1”, në bashkëpunim me KfW. Ky është një investim i madh që ka nisur në vitin 2017 me rehabilitimin e “Qytetit Studenti 2”.

Detyrimet e efikasitetit të energjisë (neni 7)

Sektori i ndërtesave rezidenciale dhe banesave private në Shqipëri ka përfituar një fond i cili konsiston në një hua prej 6 milionë eurosh të ofruara nga BERZH për Union Bank në Shqipëri. Nga huaja e BERZH-it kanë përfituar edhe mekanizma të tjerë financimi, si Fondi “Besa”. Ky financim është ofruar në kuadër të Programit prej 85 milionë eurosh të BERZH-it për Financimin e Ekonomisë së Gjellbër në Ballkanin Perëndimor (GEFF).

Në vitin 2018, Bashkia e Tiranës ofroi një fond prej 565 000 € në formë nxitjeje për qytetarët që dëshironin të investonin në efikasitetin e energjisë. Bashkia garanton një pjesë të investimit.

Vlen të theksohet se masat specifike në PKVEE mund t’u nënshtrohen përditësimeve deri në vitin 2030 për të rregulluar më plotësisht vlerësimet e ndikimit dhe për të parashikuar kostot neto për zbatimin e tyre, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Kjo do të thotë se masat e parashikuara në këtë dokument do të kenë plane konkrete zhvillimi për ndërhyrjet e mëtejshme, të cilat do të ofrojnë të dhëna më konkrete mbi zbatimin e tyre.

Strategjia Kombëtare për Energjinë (SKE) 2018–2030 ka përcaktuar institucionet kryesore dhe shoqëritë kryesore të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri, përgjegjëse për zbatimin e saj:

- Aktorët qeveritarë dhe rregullatorë, që përfshijnë organe qeveritare - ministrinë, rregullatorin, agjencitë të cilat ministrinë delegojnë përgjegjësi të caktuara të sektorit;
- Shoqëri me pronësi shtetërore, siç është KESH, OST dhe OSHEE, që janë aktualisht aktorët kryesorë në sektorin e energjisë në Shqipëri, veçanërisht për sa u përket investimeve në EE;
- Bashkitë për detyrat e tyre specifike që kanë të bëjnë me zbatimet e masave të EE-së.

MIE, së bashku me ERE, AKBN dhe AEE, janë përgjegjëse për monitorimin dhe garantimin e një zbatimi efektiv të Strategjisë së Energjisë për të gjithë sektorët përkatës. Për sa i përket zbatimit të masave për EE-në, AEE ka për detyrë të paraqesë pranë MIE raportin vjetor që vlerëson realizimin e masave për EE-në në sasi dhe cilësi, nivelin e investimeve të realizuara, pengesat dhe arsyet pas tyre, si dhe mënyrën e kapërcimit të pengesave, në mënyrë të tillë që të arrihet kursim i energjisë, reduktim i shkarkimeve dhe përmbushje e objektivave të tjera të mbetura.

AEE-ja është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe verifikimin e kursimeve të energjisë të arritura në kuadër të PKVEE.

Dimensioni i sigurisë së energjisë

Objektivat e sigurisë së furnizimit me energji janë përcaktuar në planet strategjike të vendit dhe në vendimet e qeverisë për zbatimin e tyre. Politika e qeverisë për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji bazohet në:

1. diversifikimin e burimeve të energjisë dhe lëndëve djegëse,
2. Sisteme të mjaftueshme e të decentralizuara të prodhimit të energjisë,
3. sisteme dhe rrjete të sigurta transmetimi dhe shpërndarjeje,
4. mirëfunksionimin e tregjeve të energjisë,
5. një politikë të qartë dhe afatgjatë për energjinë që nxit investimet,
6. efikasitetin e energjisë.

Shqipëria nuk ka asnjë central bërthamor në territorin e saj dhe as nuk planifikon të ndërtojë një të tillë. Megjithatë, ekziston një Agjenci Kombëtare Bërthamore, misioni i së cilës është të ngrëjë një sistem për llogaritjen e kërkesës për energji për 20-30 vitet e radhës.

Shqipëria ka dy terminale bregdetare të naftës dhe të gazit: Porto Romano në Durrës dhe Petrolifera në Vlorë. Secili terminal ka kapacitetin për të ruajtur gaz të lëngshëm të naftës, naftë bruto, dizel, gaz dhe lëngje e produkte të tjera të thata.

Përmbledhje e ligjeve kryesore;

- Plani Strategjik për Reformimin e Sektorit të Energjisë në Shqipëri (2018-2020), miratuar me VKM nr. 742, datë 12.12.2018, është një udhërrëfyes për reformimin tërësor të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri. Ai përbën bazën për Huanë e Bazuar në Politika (PBL) për zbatimin e Elementeve të caktuara të Reformave Politike të renditura në këtë plan strategjik.
- Strategjia Kombëtare e Sektorit të Energjisë 2018-2030, miratuar nga VKM nr. 480, datë 31.7.2018
- Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë, miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018
- Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë (2020-2022), miratuar me VKM nr. 92, datë 5.2.2020, parashikon sa vijon në lidhje me reformat e sektorit të energjisë: (i) liberalizimin e tregut të energjisë, me privatësi të plotë dhe me një bursë funksionale energjie; (ii) Zbatimin e ligjit për BRE; (iii) Miratimin e legjislacionit dytësor lidhur me ligjet me EE-së dhe performancën e energjisë së ndërtesave.

Performanca e çdo zone në zbatimin e treguesve të punës është përmbledhur në figurën më poshtë dhe është llogaritur e përgatitur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Bazuar në të, performanca e përgjithshme e Shqipërisë në zbatim për 2018/2019 është 47%.




Figura 9: Performanca e përgjithshme e Shqipërisë në zbatim 2018/2019 (Burimi: Energy-community.org Status 1 nëntor 2019)

Detyrimi për ruajtjen e rezervave të naftës

Sistemi aktual i rezervave të naftës të Shqipërisë për raste emergjencash i është caktuar industrisë së naftës. Sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 5.11.2004, “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”, të ndryshuar, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj kanë detyrimin të ruajnë sasi minimale rezervë, të barasvlershme me 90 ditë shitjesh mesatare, llogaritur mbi bazën e rezultateve faktike të të dhënave nga operacionet e vitit të mëparshëm.

Figura më poshtë tregon zbatimin sipas treguesve të naftës, llogaritur dhe përgatitur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.




Figura 10: Zbatimi sipas treguesve të naftës (Burimi: Energy-community.org Status 1 nëntor 2019)

Megjithatë, sistemi aktual nuk është në përputhje me Direktivën 2009/119/KE dhe, për këtë qëllim, është ngritur një grup pune me urdhër të Kryeministrit në dhjetor 2013. Projektligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” parashikon krijimin e Agjencisë Shtetërore të Rezervave të Sigurisë së Naftës (ASHRSN), e cila do të jetë një organ publik përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë. ASHSNR parashikohet të jetë i vetmi organ në Shqipëri që do të autorizojë blerjen, menaxhimin dhe shitjen e rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të naftës, siç parashikohet në projektligjin e lartpërmendur.

Procedura ligjore për miratimin e projektligjit nga qeveria ka nisur në korrik 2018. Pas reflektimit të komenteve paraprake të ministrive të linjës, projektligji i rishikuar është rishpërndarë për koordinim të këto institucione dhe tek Autoriteti i Konkurrencës, me qëllim përgatitjen e një versioni përfundimtar. Aktualisht, përfaqësues të institucioneve të ndryshme janë duke diskutuar ligjin me synimin për të arritur një draft përfundimtar, i cili duhet të miratohet fillimisht nga qeveria dhe më pas nga Parlamenti shqiptar.

Rezervat e posaçme

Aktualisht Shqipëria nuk ka rezerva të posaçme. Megjithatë, projektligji i ri për rezervat e naftës për raste emergjencash parashikon se qeveria mund të vendosë mbi përbërjen e rezervave të posaçme si pjesë e rezervave të detyrueshme dhe mbi listën e produkteve hidrokarbure të energjisë që do të përdoren, nivelin e rezervave të posaçme dhe kohëzgjatjen e detyrimit për të mbajtur rezerva të posaçme. Sipas këtij projektligji, krijimi dhe mbajtja e rezervave të posaçme ka efekt të paktën një vit kalendarik.

Disponueshmëria dhe aksesueshmëria

Në Shqipëri, projektligji i ri parashikon se “mbajtja e rezervave të detyrueshme përbën prioritet dhe rezervat e detyrueshme duhet të jenë të disponueshme dhe fizikisht të aksesueshme në çdo kohë”. Një pjesë e rezervave të detyrueshme mund të ruhen në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe/ose palët nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, mbi bazën e një marrëveshjeje dypalëshe midis qeverisë dhe shtetit ku do të ruhen rezervat e detyrueshme. Rezervat e detyrueshme të naftës që janë nën pronësi të qeverisë duhet të jenë të siguruara në çdo kohë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për të gjitha humbjet e rezervave dhe dëmet ndaj palëve të treta dhe mjedisit.

Qeveria garanton që të mos ketë pengesa ndaj transferimit të rezervave të detyrueshme nga territori i Shqipërisë drejt një shteti tjetër me të cilin është lidhur një marrëveshje e tillë dypalëshe.

Raportimi

Në Shqipëri, projektligji parashikon se Agjencia e Rezervave Minimale të Naftës do të ruajë dhe përditësojë vazhdimisht të dhëna të detajuara lidhur me të gjitha rezervat që ajo mban, si dhe lidhur me të gjitha rezervat e tjera që mbahen në territorin e Shqipërisë dhe në vendet e treta mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe. Shqipëria paraqet rregullisht Pyetësorin e Naftës të Nismës së Organizatave të Përbashkëta për të Dhënat (JODI).

Procedurat për rastet e emergjencave

Projektligji i ri përcakton procedurat e nevojshme për ndërhyrjen në rastet e mangësive të mëdha të produkteve të naftës në treg. Në rast vështirësish në furnizim, vënia në përdorim e rezervave vendoset nga qeveria, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe me miratimin e komitetit të qeverisë për menaxhimin e krizave. Në rastin e një vendimi ndërkombëtar në fuqi për vënien në përdorim të rezervave të detyrueshme, qeveria ka të drejtën të vendosë për vënien në përdorim të tyre për të përmbushur detyrimet e saj ndërkombëtare. Sipas projektligjit, rregullat dhe procedurat për hartimin e Planit Kombëtar të Reagimit, duke përfshirë përcaktimin e çmimit të tregut dhe përdorimin e rezervave të sigurisë, përcaktohen nga qeveria. Në këtë rast, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ia njofton vendimin e qeverisë menjëherë Komisionit Evropian dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Numri i ditëve të rezervave të naftës në Shqipëri

Sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 5.11.2004, “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”, të ndryshuar, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregimit me shumicë të naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre kanë detyrimin të mbajnë rezerva minimale të barasvlershme me 90 ditë shitjesh mesatare, llogaritur mbi bazën e rezultateve faktike dhe rezultateve të të dhënave nga operacionet e vitit pararendës.

Lloji i karburantit	Sasitë (në tokë)
Naftë bruto	58.154
Benzinë (benzinë për motorë)	21.848
Gazoil/naftë dizel	188.182
Mazut	2.115
Gaz i lëngshëm naftë (GLN)	46.473
Karburant për avionë i tipit vajguri	3.040
Benzinë për aviacion	3
TOTALI	319.815

Tabela 8: Sasitë e rezervave të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj për vitin 2019 (Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

Gazi - Plani i emergjencës për gazin natyror

Dokumentet politike:

- Plani i emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror⁷

⁷ Miratuar me VKM nr. 417, datë 10.5.2017, bazuar në Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Zhvillimi i sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimi i projekteve me prioritet⁸

VKM-të përkatëse japin informacion më të detajuar: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 10.5.2017, “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror”.

Plani Kombëtar i Emergjencës për gazin natyror përcakton standardet lidhur me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, kriteret e detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror dhe detyrat e përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e situatave të emergjencës në furnizimin e klientëve me gaz.

Plani i Emergjencës, specifikisht, përfshin sa më poshtë:

- Përcaktimin e standardeve që kanë të bëjnë me kërkesat minimale të përshtatshme të sigurisë së furnizimit;
- Instrumente dhe masa që garantojnë sigurimin në një masë të përshtatshme dhe të përcaktuar qartë të furnizimit me gaz për klientët e mbrojtur, duke përbushur standardet e sigurisë së furnizimit;
- Instrumente dhe masa për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme, që caktojnë qartë veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe lehtësimin e dëmeve të mundshme të lidhura me to;
- Një program për zvogëlimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror për kategori të veçanta klientësh në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror;
- Rolin dhe përgjegjësitë e sipërmarrësve të gazit dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë masat e ndryshme të ndikimit në rast të një situatë krize në sektorin e gazit natyror;
- Kriteret në lidhje me impiantet e depozitimit, me qëllim përbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontribute të mundshme për impiantet e depozitimit të vendosura ose në Republikën e Shqipërisë ose në një palë tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, apo vend anëtar të Bashkimit Evropian;
- Masa dhe veprime të tjera me rëndësi, që do të ndërmerren për eliminimin apo lehtësimin e ndikimit nga një ndërprerje e furnizimit me gaz natyror, duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme të krizës.

Nga një vlerësim i ndikimit të politikave dhe masave, Shqipëria ndodhet në një fazë të mesme përgatitore për sigurinë e furnizimit. Treguesit cilësorë tregohen në vijim.

1. Kuadri i furnizimit me gaz

Rrjeti ekzistues i gazit është i vjetruar dhe në pjesën më të madhe jofunksional. Prodhimi i brendshëm i gazit natyror është thujse i papërfillshëm dhe pjesa më e madhe e tij konsumohet për nevoja vetjake në prodhimin e naftës dhe nga industria e përpunimit.

Për sa u përket hidrokarbureve, Shqipëria nuk e ka përafruar legjislacionin e saj me Direktivën për Licencimin e Hidrokarbureve, por ka pasur njëfarë progresi me legjislacionin e saj dytësor. Direktiva për sigurinë e instalimeve të naftës dhe gazit në det nuk është transpozuar. Në shkurt të vitit 2018, qeveria shqiptare miratoi “master planin e gazit”, i cili vlerëson nevojat për investim deri në vitin 2040. Në maj të vitit 2018, Albغاز SA, operatori i kombinuar i gazit në Shqipëri, u pranua si vëzhgues në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Gazin. Albغاز duhet të vazhdojë me

⁸ Miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018, bazuar në Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

ngritjen e kapaciteteve të përhershme në mënyrë që të jetë i përgatitur për operimin e infrastrukturës së ardhshme të gazit.

2. Kuadri i furnizimit me energji elektrike

Gjatë viteve në vijim, Shqipëria duhet të ndjekë në veçanti procesin e kalimit drejt diversifikimit përmes reduktimit të përdorimit të burimeve hidrike dhe nxitjes së përdorimit të burimeve alternative të rinovueshme të energjisë, duke vepruar në përputhje me standardet mjedisore.

3. Sistemi i menaxhimit të emergjencave dhe krizave dhe programet e kufizimit të kërkesës

Legjislacioni shqiptar për rezervat e naftës nuk është përafuar me tërësinë e legjislacionit të BE-së. Nuk është bërë asnjë progres drejt krijimit të një organi qendror për mbajtjen e rezervave të naftës. Vendi është duke punuar për vënien në zbatim të një modeli rezervash naftë për rastet e emergjencës dhe për hartimin e një ligji mbi rezervat minimale të naftës bruto të nevojshme të sigurinë e furnizimit.

Shqipëria duhet të finalizojë përafrimin me tërësinë e legjislacionit të BE-së për rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ajo duhet gjithashtu të ndryshojë modelin e saj të rezervave të naftës për rastet e emergjencave.

4. Energjia

Strategjia kombëtare e energjisë 2018-2030 u miratua në vitin 2018. Master plani për gazin u miratua nga qeveria në shkurt të vitit 2018. Nevojiten përpjekje të mëtijshme për miratimin e VSM-së dhe planit të identifikimit të projektit lidhur me master planin për gazin. Miratimi i kësaj VSM-je dhe këtij plani do të kontribuojë në zhvillimin e projekteve të TEN-E. Është bërë progres me përmirësimin e infrastrukturës për transmetimin e energjisë. Gazsjellësi Trans-Adriatik po ecën sipas programit, me 84,1% të projektit të përfunduar në fund të vitit 2018. Gazsjellësi pritet të vihet në punë në vitin 2020. Në master planin për gazin janë parashikuar projekte madhore për interkonektorët e gazit.

Megjithatë, Shqipëria nuk arriti ta transpozonte dhe të vinte në zbatim Rregulloren (BE) 347/2013 “Për udhëzimet për infrastrukturën energjetike transevropiane” brenda datës 1 janar 2017, dhe në Nëntor të vitit 2018 Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë mori një vendim me anë të të cilit Shqipëria u shpall në shkelje të detyrimeve të saj në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Dimensionimi i tregut të brendshëm të energjisë

Për sa i përket tregut të brendshëm të energjisë, Shqipëria ka miratuar legjislacion për gazin dhe energjinë elektrike në përputhje me paketën e tretë të energjisë të BE-së.

Në mars të vitit 2017, Enti shqiptar Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi certifikimin e OST Sh.A. si operator të sistemit të transmetimit, në vijim të marrjes së një opinioni pozitiv nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Asambleja e ENTSO-E e pranoi OST Sh.A. si anëtar me të drejta të plota të rrjetit. Është bërë progres me ndarjen ligjore të operacionit të sistemit të shpërndarjes OSHEE Sh.A. nga aktiviteti i tij i furnizimit.

Çmimet e energjisë elektrike vazhdojnë të jenë të rregulluara, por duhet të liberalizohen gradualisht. Në maj të vitit 2019, qeveria shqiptare miratoi një vendim për krijimin e një burse të energjisë, me tregun day-ahead (të ditës në avancë) dhe intraday (brenda ditës). Tregu i energjisë elektrike mbetet i mbyllur për shkak të një kontrate të rregulluar ndërmjet shoqërive shtetërore të prodhimit dhe furnizimit.

Sektori i energjisë elektrike

Në vitin 2015, Ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” bëri de-rregullimin e çmimeve të prodhimit dhe të tregtimit me shumicë të energjisë elektrike. Megjithatë, tregu i tregtimit me shumicë nuk është liberalizuar ende plotësisht. Operatori i sistemit të shpërndarjes dhe furnitori OSHEE është ende i detyruar të blejë të gjithë sasinë e energjisë elektrike që nevojitet për furnizimin e klientëve në kuadër

të shërbimit universal dhe për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga shoqëria prodhuese KESH, mbi bazën e një kontrate ekskluzive të përbashkët dhe kushteve të rregulluara, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për shërbimet publike në sektorin e energjisë elektrike. Kjo është në shkëlqje të tërësisë së legjislacionit të Komunitetit të Energjisë dhe përbën një pengesë madhore ndaj zhvillimit të konkurrencës në tregun shqiptar të shumicës. Kontrata ndërmjet KESH-it dhe OSHEE-së u zgjat në maj të vitit 2019, por pa miratimin e ERE.

Sektori i energjisë elektrike në Shqipëri karakterizohet nga një strukturë tregu ku pjesa më e madhe e prokurimit të energjisë mbizotërohet nga transaksione dypalëshe për klientë të mëdhenj, ndërsa shumica e klientëve të tjerë dhe tregu i pakicës vazhdojnë t'i nënshtrohen një regjimi rregullator. Nga ana pozitive, ndarja e operacioneve dhe interesave është aktualisht në proces dhe ky aspekt pozitiv në pronësinë e rrjetit të transmetimit u miratua me ligj në vitin 2016.

Rregullat e tregut për funksionimin e tregut të energjisë elektrike sipas modelit të tregut, duke përfshirë funksionimin si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe brenda ditës, u miratuan nga ERE në dhjetor të vitit 2017. U miratua gjithashtu edhe një ligj për prokurimin e balancimit bazuar në treg.

Figura e mëposhtme tregon skemën e tregut shqiptar të energjisë elektrike në korrik 2020.




Figura 11: Skema e tregut shqiptar të energjisë elektrike (Burimi: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë)

Krijimi i një tregu të ditës në avancë është vonuar përtej parashikimit. Në maj të vitit 2019, Këshilli i Ministrave vendosi krijimin e APEX si një subjekt juridik i mëvetësishëm, i ngritur nga operatori i sistemit të transmetimit OST dhe me kapital themeltar të financuar plotësisht nga kjo shoqëri. Vendimi parashikon gjithashtu përfshirjen e mundshme të aksionarëve të tjerë përveç OST-së me anë të një procedure konkurruese dhe përcakton fushën e veprimtarisë së aksionarëve dhe strukturën e kapitalit. Në një vendim tjetër të datës 11 shtator 2019 lidhur me këtë çështje, Këshilli i Ministrave përcaktoi procedurën e detajuar për përzgjedhjen e aksionarëve të APEX dhe përgjegjësitë që u alokohen ministrive përkatëse dhe komitetit përzgjedhës. Këshilli i Ministrave ka përcaktuar kriteret, procedurat dhe kërkesat e ofertimit dhe të përzgjedhjes për çdo kategori individuale të ofertuesve potencialë nga

BE-ja dhe nga Komuniteti i Energjisë, duke përfshirë operatorët e sistemit të transmetimit, operatorët e tregut ndërkombëtar, pjesëmarrësit e tregut dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Ministri përgjegjës për energjinë nis procedurën konkurruese të përzgjedhjes. Megjithatë, afati për nisjen e kësaj procedure është i papërcaktuar.

Rregullat e tregut për funksionimin e tregut të energjisë elektrike sipas modelit të tregut, duke përfshirë funksionimin si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe brenda ditës, u miratuan nga ERE në dhjetor të vitit 2017, dhe zbatimi i tyre i plotë kushtëzohet me krijimin e APEX.

Rregullat përfundimtare të balancimit që do të lejonin zbatimin e plotë të kërkesave të ligjit për një prokurim të shërbimeve të balancimit bazuar në treg nuk janë miratuar ende. Rregullat transitorë të balancimit, të miratuara nga ERE në nëntor 2017, janë ende në fuqi. Disbalancat shlyhen duke përdorur çmimet referencë për orë nga tregu hungarez i ditës në avancë. Ndonëse rregullat lejojnë hyrjen e pjesëmarrësve të rinj në tregun e balancimit dhe ndonëse ka ofrues potencialë të shërbimit të balancimit, KESH mbetet ende ofruesi i vetëm. Ligji dhe modeli i tregut përkrahin mundësinë që operatori i sistemit të transmetimit të shkëmbejë shërbimet e balancimit përtej kufijve, sipas kushteve të bazuara në treg. Kjo mundësi nuk është shfrytëzuar ende. Figura më poshtë tregon zbatimin sipas treguesve të energjisë elektrike, llogaritur dhe përgatitur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.




Figura 12: Zbatimi sipas treguesve të energjisë elektrike (Burimi: Energy-community.org Status 1 nëntor 2019)

Në korrik të vitit 2017, ERE miratoi rregulla për publikimin e të dhënave bazë mbi tregun e energjisë elektrike, duke transpozuar Rregulloren (BE) 543/2013 “Për paraqitjen dhe publikimin e të dhënave mbi tregjet e energjisë elektrike”. OST po publikon në faqen e saj të internetit një pjesë të të dhënave të kërkuara për ngarkesën, prodhimin, infrastrukturën e transmetimit dhe disbalancat, ndërkohë që SEE CAO i përcjell ENTSO-E të dhëna mbi kapacitetin ndërkufitar për qëllime publikimi.

Ndarja e KESH Sh.A.

Shqipëria ka finalizuar plotësisht ndarjen e pronësisë së KESH Sh.A. nga pronësia e OST Sh.A., gjë që përbën detyrim në bazë të Paketës së Tretë të Energjisë.

Ndarja e OST Sh.A.

Ndarja e Operatorit të sistemit të transmetimit të Shqipërisë (OST) është bërë sipas modelit të ndarjes së pronësisë të Paketës së Tretë. OST u certifikua në mënyrë të kushtëzuar në vitin 2017. Pas opinionit

të dhënë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë 01/2017, vendimi i rregullatorit për certifikim përfshinte detyrimin për të transferuar kompetencat për investim në OST nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i ri, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda marsit të vitit 2018.

Ndarja e OSHEE Sh.A.

Në vitin 2018, OSHEE krijoi tri shoqëri bija për të kryer, përkatësisht, funksionet e një operatori të sistemit të shpërndarjes, një furnizuesi shërbimesh universale dhe një furnizuesi dhe tregtuesi të tregut të lirë, duke marrë licencat e nevojshme nga rregullatori ERE.

Tregu i pakicës mbetet pjesërisht i de-rregulluar, për shkak të mundësisë që u është dhënë me ligj të gjitha kategorive të klientëve, me përjashtim të atyre të lidhur me tensionin e lart, për të vazhduar furnizimin nga furnizuesi i mundësisë së fundit, OSHEE, me çmime të rregulluara për një periudhë prej dy vitesh pas miratimit të kushteve teknike për shkëmbimin. Si rezultat, pjesa më e madhe e klientëve mbeten me çmime të rregulluara, me përjashtim të një pjese të klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Kjo cenon të drejtën e kualifikimit dhe interesin e furnizuesve të rinj për të hyrë në tregun e pakicës.

Figura më poshtë tregon situatën në lidhje me hapjen e tregut të pakicës deri në vitin 2018.




Figura 13: Hapja e tregut me pakicë (Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

Klientët në nevojë identifikohen dhe mbështeten mbi bazën e një kuadri ligjor dhe kushteve që nuk kanë lidhje me energjinë dhe rregullohen nga Ministria e Punëve Sociale, e cila alokon mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Rregullat, kushtet dhe mekanizmat për mbështetjen e klientëve në nevojë, në përputhje me tërësinë e legjislacionit dhe të transpozuar në Ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”, nuk janë zbatuar ende.

Sektori i gazit

Shqipëria nuk ka ende një treg gazi dhe nuk është e lidhur me asnjë infrastrukturë ndërkombëtare të gazit. Megjithatë, ekziston një kuadër legjislativ bazë:

- Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ndryshuar me Ligjin nr. 64/2018 dhe Ligjin nr. 89/2018

Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, është përafuar plotësisht me tërësinë e legjislacionit të BE-së, siç është raportuar dhe më parë në kontributin e parë shqiptar në Raportin e

vitit 2016 të KE-së për Shqipërinë. Për zbatimin e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, janë miratuar aktet zbatuese në vijim:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 417, datë 10.5.2017, “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 100, datë 5.8.2015 “Për miratimin e rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, i ndryshuar;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 96, datë 17.6.2016 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 114, datë 8.7.2016, “Për miratimin e rregullores për trajtimin e ankesave të ngritura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet mbajtësve të licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 119, datë 21.7.2016, “Për miratimin e rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 34, datë 2.3.2017 “Për miratimin e udhëzimit mbi kriteret e vendimmarrjes për aksesin në ambientet e depozitimit të gazit natyror”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 77, datë 26.5.2017 “Për miratimin e programit të pajtueshmërisë së sistemit të transmetimit të gazit natyror”r;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 78, datë 26.5.2017 “Për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë në sektorin e gazit natyror”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 95, datë 4.7.2017 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”;
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 97, datë 4.7.2017 “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

VKM nr. 590, datë 9.10.2018, “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”

VKM nr. 69/2018, datë 7.2.2018, “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror”

Në tetor të vitit 2018, Shqipëria miratoi Modelin e Tregut të Gazit Natyror. U përcaktuan rregulla të përgjithshme mbi strukturimin e tregut të gazit natyror, të cilat konsistojnë në tregtimin dypalësh në tregun e pakicës dhe shumicës të gazit natyror, tregun e ditës në avancë të gazit natyror dhe tregun e balancimit të gazit natyror.




Figura 14: Zbatimi sipas treguesve të gazit (Burimi: Energy-community.org Status 1 nëntor 2019)

Modeli i tregut të gazit kërkon miratimin e rregullave të balancimit me bazë tregun nga operatori i sistemit të transmetimit. Tarifatat për shërbimet e balancimit duhet të llogariten dhe të përcaktohen në përputhje me kushtet e bazuara në treg. Duhet të krijohet një treg i ditës në avancë për gazin natyror duke përdorur një platformë të tregtimit të gazit natyror që lejon shitjet dhe blerjet anonime. Ky treg duhet të krijohet me vendim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në konsultim me ERE dhe grupe të tjera interesi.

Enti rregullator shqiptar miratoi një metodologji të tarifës së transmetimit për sektorin e gazit në nëntor të vitit 2017. U prezantua metodologjia hyrje/dalje dhe tarifatat u përcaktuan nga ERE sipas modelit hyrje/dalje.

Në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë, garantohej akses jodiskriminues në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, si dhe në GNL dhe në hapësirat e magazinimit. Një vendim i ERE ka transpozuar ndryshimet e shtojcës I të Rregullores (KE) 715/2009, të miratuar nga Komuniteti i Energjisë. Kodet e rrjetit të transmetimit të TAP dhe Albgaz janë në hartim e sipër.

Në përgjithësi, kodi i TAP përmban të gjitha pikat specifike dhe operacionalizon disa kërkesa të tjera nga vendimi për përjashtim. Për kapacitetet e pa përjashtuara, shërbimet e aksesit të palëve të treta të ofruara nga TAP, tregtimi i kapaciteteve dhe alokimi i kapaciteteve janë në përputhje me Rregulloren (KE) 715/2009, si dhe respektojnë në shkallë të madhe Kodin e Rrjetit për Mekanizmat e Alokimit të Kapaciteteve (Rregulloren (BE) 2017/459).

Për zhvillimin lidhur me ngritjen e kapaciteteve, Albgaz ka përfituar asistencë teknike nga BERZH, i cili po bashkëpunon ngushtë me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ligji për gazin natyror ka përcaktuar kriteret e kualifikimit për të gjithë klientit, në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë. Të gjithë klientët janë të lirë të zgjedhin dhe të ndryshojnë furnizuesin e tyre të gazit.

Klientët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla kanë të drejtën të furnizohen me gaz natyror nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik dhe furnizimi i mundësisë së fundit parashikohet për të gjithë klientët. Ligji ka transpozuar pjesën më të madhe të kërkesave të Direktivës 2009/73/KE lidhur me mbrojtjen e klientëve dhe klientët në nevojë. Megjithatë, kriteret dhe procedurat për përcaktimin e

klientëve që kualifikohen si klientë në nevojë mbeten ende për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave. Plani i Emergjencës për Gazin Natyror është miratuar nga qeveria me asistencën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Rregullat e përgjithshme të procedurave për ndryshimin e furnizuesit të gazit natyror dhe kushtet e përgjithshme për furnizimin e gazit natyror janë miratuar nga ERE në korrik të vitit 2018, në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë.

Ligji i vitit 2015 për gazin ka përcaktuar kërkesat për ndarje në përputhje me Paketën e Tretë të Energjisë. Këto dispozita janë plotësuar më pas me miratimin e mëvonshëm të rregullave të certifikimit. Të dy operatorët e sistemit të transmetimit janë të certifikuar – si Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) AG, operatori i TAP në Shqipëri ashtu dhe Albغاز, operatori i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes nën pronësi shtetërore.

Problematikat lidhur me rregullsinë e procedurës së vendimmarrjes për certifikimin e Albغاز u kthyen në një pikë të nxehtë debatesh në 2018/2019, veçanërisht në lidhje me çështjen e ndarjes së duhur brenda shtetit. Çështja do të trajtohet më tej nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me MIE dhe ERE. Miratimi i një përgjegjësi të pavarur për pajtueshmërinë ishte një hap në drejtimin e duhur, ndonëse i gjithë viti ka kaluar pa ndonjë zgjidhje të kënaqshme.

Ligji për konkurrencën

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” përmban dispozita që përkojnë me nenet 101, 102 dhe 106 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Gjatë periudhës së raportimit, është miratuar legjislacioni dytësor lidhur me kufizimet që nevojiten dhe lidhen me përqendrimet dhe dëmet.

Aktivitetet e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës (AK) në sektorin e energjisë fokusohen kryesisht mbi rekomandimet. Megjithatë, respektimi i plotë i detyrimit të traktatit për zbatimin e tërësisë së legjislacionit mbi konkurrencën kërkon një veprimtari zbatuese më rigoroze nga ana e AK-së.

Mbi bazën e një ankese të përcjellë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, AK-ja ka hetuar shkelje potenciale në treg lidhur me ruajtjen dhe devijimet e energjisë elektrike. Në vendimin e saj, AK-ja ka konstatuar se KESH-i ka abuzuar me pozicionin e tij dominues duke lidhur dy kontrata me GSA SHPK dhe EFT AG, dhe e ka detyruar KESH-in t'i zgjidhë këto kontrata.

Sistemi për tenderimin e kapaciteteve të reja prodhuese

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, është në fuqi. Ky vendim përcakton masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve që përfitojnë nga këto masa, sipas nenit 8, paragrafi 1 të Ligjit nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe objektivave të Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2019 – 2020.

Rregullorja (KE) 1099/2008 “Për statistikave të energjisë”

AKBN-ja ka hartuar një bilanc vjetor të energjisë dhe pyetësorët e përcaktuar në Rregulloren (KE) 1099/2008, si dhe i ka paraqitur pyetësorët vjetorë pranë EUROSTAT-it. Ndarja e konsumit të energjisë në banesa në përputhje me Rregulloren (BE) 431/2014, që ndryshon Rregulloren (KE) 1099/2008, raportohet dhe i transmetohet EUROSTAT-it.

Për sa u përket statistikave vjetore të energjisë, duke përfshirë raportimin e cilësisë, Shqipëria ka zbatuar kërkesat e legjislacionit të BE.

Detyrimet në lidhje me përgatitjen dhe shpërndarjen e statistikave mujore i janë caktuar gjithashtu AKBN-së. Aktivitetet përgatitore për zbatimin kanë nisur në vitin 2014. Megjithatë, disponohen vetëm

të dhëna mujore mbi energjinë elektrike. Ndonëse janë transmetuar të dhëna të përmuajshme të naftës dhe gazit për vitin 2018, ende nuk ka asnjë informacion për vitin 2019.

Pyetësorët dhe metodologjitë e nevojshme për grumbullimin e statistikave të naftës në përputhje me kërkesat e tërësisë së legjislacionit për statistikave dhe rezervat e naftës nuk janë hartuar ende dhe nuk janë publikuar të dhëna as nga AKBN as nga INSTAT. Për më tepër, nuk është bërë asnjë paraqitje të dhënash pranë EUROSTAT dhe Divizionit të Statistikave të OKB.

Paraqitja e të dhënave të përmuajshme mbi qymyrin, gazin, naftën dhe energjinë elektrike pranë EUROSTAT, ose fillimisht pranë OKB-së, nuk ka filluar ende. Kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare, përgatitja e statistikave mujore të energjisë është ende e pavend dhe të dhënat mujore nuk shpërmdahen sipas kërkesave të tërësisë së legjislacionit.

AKBN-ja ka paraqitur pranë EUROSTAT raportin e saj të parë të cilësisë, në përputhje me nenin 5 të Rregullores.

Interkoneksioni i energjisë elektrike

Sistemi i energjisë elektrike në Shqipëri është ndërlidhur me sistemet fqinje të Greqisë dhe Malit të Zi që prej vitit 2014, kur Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (ENTSO-E) miratoi operimin në sinkron të sistemit shqiptar të transmetimit të energjisë elektrike me sistemin kontinental evropian. Në vitin 2018, humbjet në shpërndarjen e energjisë elektrike në rrjetin shqiptar të energjisë ishin mjaft të mëdha, në vlerën 24,4%, ndonëse shënuan një përmirësim të lehtë nga viti 2017, kur niveli i tyre ishte 27,5%.

Akresi i palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe parashikimet lidhur me menaxhimin e kongestionit në linjat ndërkufitare janë në përputhje me tërësinë e legjislacionit të BE. Kapacitetet ndërkufitare të transmetimit në kufijtë me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë alokohen përmes platformës rajonale të koordinuar të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore në Mal të Zi (SEE CAO).

Metodologjitë e llogaritjes së tarifave janë miratuar nga ERE, e cila në dhjetor të vitit 2018 miratoi tarifat për aksesin në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe për furnizimin universal për vitin 2019. Çmimet kanë mbetur të pandryshuara krahasuar me periudhën e mëparshme. Rregullat dhe procedurat për ndërtimin e linjave direkte kanë qenë në fuqi që prej janarit të vitit 2017.

Vonesa në ngritjen e ALPEX, bursës së energjisë elektrike, ka ngadalësuar nismën për ndërlidhjen e tregjeve të ditës në avancë të Shqipërisë dhe Kosovës.

Në mars të vitit 2019, operatori i sistemit të transmetimit, OST, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me operatorin e sistemit të transmetimit të Maqedonisë së Veriut, MEPSO, dhe atë të Bullgarisë, ESO, për zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal përmes asistencës së ndërsjellë. Operatorët shprehën gatishmërinë e tyre për të ndërlidhur tregjet e tyre kombëtare të ditës në avancë dhe realizimi i kësaj varej nga përfundimi i linjës së interkoneksionit 400 kV midis Bitolës dhe Elbasanit.

Një tjetër nismë për ndërlidhjen e tregjeve në fazat e hershme është ajo midis Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Termat e referencës për projektin, të miratuara në janar të vitit 2018, kërkojnë si parakusht ekzistencën e bursave kombëtare të energjisë në të gjitha shtetet palë, si dhe një kuadër ligjor dhe kontraktual të konsoliduar dhe një mjedis rregullator koherent, pa barriera për tregtinë. Deri më tani nuk është miratuar asnjë udhëzues konkret për zbatimin e ndërlidhjes.

Alokimi i kapaciteteve ndërkufitare në kufijtë me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë realizohet me anë të platformës rajonale të koordinuar të SEE CAO. Është zhvilluar metodologjia e zakonshme e llogaritjes së kapacitetit për "rajonin 10 të llogaritjes së kapaciteteve "të fshehura"", i cili përfshin edhe Shqipërinë, dhe zbatimi i saj është në pritje të një rekomandimi nga Bordi Rregullator i Komunitetit të

Energjisë, që pritet të miratohet gjatë vitit 2019. OST ka nënshkruar një marrëveshje me Qendrën për Koordinimin e Sigurisë Energjetike dhe ka filluar prokurimin e shërbimeve në qershor të vitit 2018.

ERE ka miratuar vendime për transpozimin e kodeve të rrjetit për lidhjen e kërkesës, kërkesat për gjeneratorët dhe lidhjen e instalimeve me rrymë të vazhduar, me tension të lartë (HVDC) në qershor 2016. Kriteret e derogimit nuk janë publikuar dhe zbatimi nuk ka filluar ende.

Figura më poshtë tregon rezultatin e përgjithshëm të Shqipërisë për zbatimin e projektit lidhur me masat e buta për një treg rajonal të ditës në avancë dhe balancimin ndërkufitar të energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor (BP), të njohura si masat e buta të BP6.

Objektivi i projektit është krijimi efikas dhe gradual i një tregu rajonal të ditës në avancë dhe zbatimi i balancimit rajonal ndërkufitar në BP dhe në vendet e tij fqinje.

Pjesë e projektit janë 6 shtetet e BP: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.




Figura 15: Zbatimi i masave të buta të BP6 për energjinë elektrike në Shqipëri (Burimi: Energy-community.org Status 1 nëntor 2019)

Infrastruktura e transmetimit të energjisë

Sektori i energjisë elektrike

Figura më poshtë tregon në mënyrë skematike strukturën e rrjetit të transmetimit në Shqipëri.




Figura 16: Skema rrjetit të transmetimit në Shqipëri

Projektet kryesore në interkoneksionet e transmetimit të energjisë elektrike

1.- Linja e interkoneksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) - Prishtinë (Kosovë)

Linja e interkoneksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) - Prishtinë (Kosovë) u përfundua më 28.6.2016.

2.- Linja e interkoneksionit 400 kV Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni e Veriut)

Për sa i përket ndërtimit të linjës së interkoneksionit 400 kV Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni e Veriut), që lidh Shqipërinë me Republikën e Maqedonisë së Veriut, më 10 korrik 2019, aplikantët/shoqëritë përkatëse paraqitën aplikimet e tyre për fazën e parakualifikimit. Me përfundimin e fazës së parakualifikimit për Lotin e parë (linjat e interkoneksionit), u njoftuan ofertuesit fitues. Dokumentet e tenderit do t'u përcillen atyre për të vijuar me fazën e dytë, atë teknike. Për lotin e 2-të (nënstationet, OST S.A është në pritje të miratimit pa asnjë kundërshtim nga KfW për raportimin e vlerësimit të parakualifikimit. Me marrjen e miratimit pa kundërshtime, ofertuesit fitues do të njoftohen dhe atyre do t'u jepen dokumentet teknike për fazën e 2-të (fazën teknike)

Sektori i gazit

Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare të gazit dhe rrjeti ekzistues i gazit është i vjetruar dhe kryesisht jofunksional. Prodhimi i saj i brendshëm i gazit natyror është thuajse i papërfillshëm dhe pjesa më e madhe e tij konsumohet për nevojat vetjake në prodhimin e naftës dhe nga industria e përpunimit.

Gazsjellësi i TAP, i cili është në ndërtim e sipër dhe është planifikuar të vihet në punë drejt fundit të vitit 2020, do të hapë rrugën për furnizuesit e gazit nga fusha Shah Deniz II në Azerbajxhan dhe do ta lidhë vendin me tregun evropian të gazit përmes lidhjeve me Greqinë dhe Italinë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar në dhjetor të vitit 2018 një akt për përcaktimin e zonave të shërbimit për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror. Dispozitat e tij synojnë zhvillimin e infrastrukturës së gazit.

Projektet kryesore në interkoneksionet e gazit

Ndërtimi i linjave të interkoneksionit të gazit në Shqipëri është përshkruar me hollësi në Master Planin e Gazit (MPG) për Shqipërinë, miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit për

zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe për identifikimin e projekteve me prioritet”, si dhe me Vendimin nr. 2 të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), datë 26 korrik 2018

1.- Projekti i Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP)

Projekti TAP filloi zyrtarisht më 17 maj 2016. Në fund të shtatorit të vitit 2019, kishte përfunduar 89,8% e punimeve për projektin TAP. Projekti është zhvilluar sipas programit kryesor lidhur me ndërtimin e pjesës në tokë, ndërtimin e objekteve mbi sipërfaqe (stacionet e valvulave bllokuese, stacionet e kompresorëve dhe terminali i gazsjellësit) dhe ndërtimin e instalimit të gazsjellësit në det. Bazuar në lejet e ndërtimit të nxjerra nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë), TAP përfundoi ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave lidhëse, duke përfshirë ndërtimin e rreth 24,7 km rrugë të reja kalimi dhe përmirësimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rreth 136,2 km rrugë lidhëse. Gjithashtu, u bë përmirësimi i 41 urave dhe u ndërtuan dy ura të reja, përkatësisht në tri qarqet e Beratit, Korçës dhe Fierit.

Pas ndërtimit të gazsjellësit në dhjetor të vitit 2020, Gazsjellësi Trans-Adriatik filloi transportin e parë tregtar dhe në mars 2021 sasia e transportuar arriti 1 BCM (miliardë metër kub).

TAP AG aplikoi pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për t’u licencuar si operator i transmetimit. TAP AG u licencua në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 15, datë 31.1.2019, “Për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB si degë e shoqërisë së huaj aksionare (Sh.A.), Trans Adriatic Pipeline AG”.

Pas këtij vendimi të ERE, TAP AG në bashkëpunim me ERE do të finalizojnë përgatitjen dhe miratimin e Kodit të Transmetimit të Gazit.

Gjatë vitit 2019, Gazsjellësi Trans-Adriatik organizoi një testim të ri të tregut, referuar Vendimit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 17.6.2019, “Për miratimin e “Udhëzuesit për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans-Adriatik”.

TAP AG ka nënshkruar kontratën e mirëmbajtjes me “Albanian Gas Service Company” Sh.A. (një bashkim shoqërisht midis shoqërisë shqiptare të gazit, “ALBGAZ” Sh.A., dhe shoqërisë italiane SNAM S.p.A.), për mirëmbajtjen e TAP gjatë fazës së tij operacionale.

2.- Projekti i Gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP)

Projektimi paraprak po përgatitet në kuadër të WB15-REG-ENE-02 “Projektimi paraprak i Gazsjellësit Adriatiko-Jonian – seksionet e Malit të Zi dhe të Shqipërisë”. Projektimi paraprak po përgatitet nga konsulenti SUEZ (IPF6 TA). Projekti filloi në shtator të vitit 2018 dhe do të zgjasë 24 muaj, deri në shtator të vitit 2020.

Gjatë vitit 2019, përfundoi procesi i rirrugëzimit për seksionin e Shqipërisë, i cili u miratua nga institucionet shqiptare. Më 6 nëntor 2019, konsulenti prezantoi draftin e projektit fillestar për seksionin e Shqipërisë.

3.- Gazsjellësi ndërlidhës Shqipëri - Kosovë (projekti ALKOGAP)

Studimi i parafizibilitetit përfundoi në fund të vitit 2018, në kuadër të WB15-REG-ENE-01 “Studimi i parafizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë” (projekti ALKOGAP), zbatuar nga IPF4 TA me financimin e WBIF përmes një granti prej 0.3 milionë eurosh.

Ministria shqiptare e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë të Kosovës, do të riaplikojnë në thirrjen e radhës të WBIF për grante të asistencës teknike për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS-së/VNM-së së plotë për projektin ALKOGAP.

4.- Depozita nëntokësore e gazit në Dumre (UGS Dumrea)

Projekti “Depozita nëntokësore e gazit në Dumre (UGS Dumrea) u përfshi në Planin Kombëtar Sektorial për sektorin shqiptar të gazit (MPG për Shqipërinë), miratuar nga VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”, si dhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin e tij nr. 2, datë 26 korrik 2018. Projekti UGS Dumrea i është propozuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për t’u përfshirë në Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë (lista PECD). Komiteti Drejtues i WBIF, në mbledhjen e tij të datës 6 dhjetor 2018, miratoi një grant prej 1 milionë euro për përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS-së për këtë projekt.

ToR-të përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS-së për projektin WB20-ALB-ENE-01 “Depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre, Shqipëri” janë përgatitur nga konsulenti dhe i janë paraqitur WBIF-së dhe BERZH-it për procedura të mëtejshme.

Tregjet e energjisë elektrike dhe të gazit, çmimet e energjisë elektrike

Energjia elektrike

Siç parashikohet në nenin 3 të Ligjit nr. 7/2018, datë 15.2.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike””, klienti fundor që furnizohet me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109 të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së

fundit. Në fund të kësaj periudhe, operatori i sistemit do ta ndërpresë furnizimin me energji elektrike për këtë klient.

Ky ndryshim (periudha prej dy vitesh) merr në konsideratë mungesën e përvojës së klientëve për të operuar në tregun e liberalizuar dhe u jep atyre kohën e nevojshme për t’u mësuar me tranzicionin nga tregu i rregulluar në tregun e liberalizuar.

Të gjithë klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV duhet të furnizohen në tregun e parregulluar. Aktualisht, 98 klientë janë të lidhur në rrjetin 35 kV, por deri më tani vetëm një numër i kufizuar i tyre (28 klientë) kanë zgjedhur të furnizohen në tregun e parregulluar. Sipas ndryshimeve të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të gjithë klientët e lidhur me rrjetin 35 kV, brenda fundit të vitit 2019, nuk do të furnizohen nga OSHEE Sh.A. si furnizues i mundësisë së fundit.

Rregullimi dhe përshtatja e çmimit

Për sa i përket rregullimit të çmimit, Enti Rregullator i Energjisë vendosi më 12 dhjetor 2019 që të linte në fuqi tarifat ekzistuese.

Rregullorja (BE) 2016/1952 për statistikat evropiane mbi çmimet e gazit natyror dhe të energjisë elektrike

Statistikat mbi çmimet janë parimisht nën përgjegjësinë e INSTAT. Në mungesë të një ndarjeje të qartë të detyrave midis AKBN-së dhe INSTAT-it, kjo e para ka filluar grumbullimin e të dhënave në bashkëpunim me ERE-në. AKBN-ja është duke mbledhur dhe shpërndarë të dhëna mbi çmimet e energjisë elektrike që u faturohen familjeve. Të dhënat në lidhje me gazin natyror nuk disponohen ende për Shqipërinë. Megjithatë, grupi i të dhënave të përpiluara është ende i paplotë. Çmimet që u faturohen klientëve fundorë industriale janë ende të padisponueshme.

Gjithashtu, ndarja e çmimeve të energjisë elektrike në komponentë kryesorë, sipas kërkesave të rregullores, nuk është bërë dhe nuk i është transmetuar EUROSTAT-it. Grupet e të dhënave që mungojnë përfshijnë komponentët e çmimit që i faturohet klientëve familjarë dhe jofamiljarë. Aktualisht, Shqipëria është e vetmja palë kontraktore që nuk i ka raportuar çmimet e përdoruesit fundor që faturon për klientët jofamiljarë.

Statistikat mbi çmimet e përdoruesit fundor që i faturohen klientëve jofamiljarë (industrialë) dhe ndarja e çmimeve për klientët familjarë dhe jofamiljarë në komponentë të çmimit nuk janë ende të përfunduara dhe nuk janë në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/1952.

Sektori i gazit

Në sektorin e gazit natyror, ERE ka miratuar Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 269, datë 21.12.2018, “Për lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 97, datë 23.4.2018, “Për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albagaz Sh.A. për vitin 2018”, të ndryshuar”. Sipas këtij vendimi, tarifa e transmetimit të gazit natyror do të mbetet e njëjtë deri më 31.3.2019.

Në vitin 2019, ERE filloi procedurat për miratimin e “kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”, përmes Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 168, datë 4.11.2019, “Për nisjen e procedurës së miratimit të “kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”.

Varfëria energjetike

Shqipëria siguron akses në energjinë elektrike për të gjithë popullsinë e saj, përmes një procesi të përfunduar përpara tranzicionit të viteve 90'. Shqipëria ka arritur të ofrojë me sukses akses universal për të gjithë qytetarët e saj dhe vendi mbështetet te prodhimi i brendshëm i energjisë elektrike, i cili bazohet kryesisht te energjia e pastër hidrike. Investimet e konsiderueshme në sektorin e energjisë gjatë viteve të fundit kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe kanë tërhequr interesin e pjesëmarrësve të sektorit privat, duke përfshirë shoqëri ndërkombëtare të njohura, për zhvillimin e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike. Rrjeti i energjisë elektrike po zgjerohet dhe përmirësohet në mënyrë konstante për të përmbushur kërkesat në rritje dhe për të përballuar lidhjet e reja. Gjatë viteve të fundit ka pasur përmirësime të ndjeshme për sa i përket arkëtimit të pagesave për faturat e energjisë elektrike, gjë që ka rezultuar në rritje të performancës së shoqërive shtetërore që përbëjnë bërthamën e sektorit të energjisë.

Pavarësisht përmirësimeve dhe avantazheve që ka mbështetja te burimet e pastra të energjisë, vendi duhet të fokusohet më tej tek aspekti i përballueshmërisë së këtij objekti, pasi çmimet e energjisë elektrike janë relativisht më të larta krahasuar me nivelet në rajon. Ligji shqiptar “Për sektorin e energjisë elektrike” (43/2015) e përkufizon klientin në nevojë (neni 3) si një klient familjar i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta

të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore. Sipas nenit 95, kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë përcaktohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Entin Rregullator të Energjisë. Statusi i klientit në nevojë trajtohet nga politika të ndryshme të fushës sociale dhe të energjisë, në përputhje me Strategjinë Sociale në Komunitetin e Energjisë (2013).

Megjithatë, varfëria energjetike nuk është përkufizuar ende qartë dhe nuk monitorohet në mënyrë sistematike. Nuk asnjë politikë të posaçme në fuqi për eliminimin e varfërisë energjetike. “Në terma të përgjithshëm, varfëria energjetike nënkupton paafhtësinë e një familjeje për të siguruar sasinë e duhur të energjisë në banesë, që do të mundësonte ngrohjen dhe ndriçimin e duhur të hapësirave të banimit, për

të pasur akses në gamën e nevojshme të shërbimeve energjetike dhe për të qenë e aftë të përballojë një sasi të mjaftueshme energjie për nevoja të përditshme.”⁹

Vlerësimi i politikave dhe masave tregon se Shqipëria ka miratuar legjislacionin në lidhje me gazin dhe energjinë elektrike në përputhje me paketën e tretë të energjisë të BE-së. Është miratuar strategjia e re kombëtare për energjinë 2018-2030, si dhe është bërë progres me sektorin e gazit dhe me linjat e interkoneksionit.

1. Rregullat e ndarjes dhe të aksesit të palëve të treta

Shqipëria ka ende për të finalizuar ndarjen e shoqërive të energjisë dhe eliminimin e pengesave ligjore ndaj të drejtës së klientëve për të ndryshuar furnizuesin e tyre të energjisë elektrike.

Në mars të vitit 2017, Enti shqiptar Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi certifikimin e OST Sh.A. si operator të sistemit të transmetimit, në vijim të marrjes së një opinionit pozitiv nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Asambleja e ENTSO-E e pranoi OST Sh.A. si anëtar me të drejta të plota të rrjetit. Megjithatë, ERE vendosi disa kushte për OST Sh.A. në vendimet e saj të fundit për certifikimin. Këto kushte kishin të bënin me transferimin e detyrave lidhur me investimet tek organi i ri shtetëror që ka nën pronësi OST. Këto kushte nuk janë përbushur ende, dhe afati për përbushjen e tyre është shtyrë me tri vite.

Është bërë njëfarë progresi me ndarjen ligjore të operatorit të sistemit të shpërndarjes OSHEE Sh.A. nga aktiviteti i tij i furnizimit. Kjo u arrit falë krijimit të tri shoqërive të reja.

Kuadri ligjor i ERE është në një shkallë të konsiderueshme në përputhje me tërësinë e legjislacionit të BE-së, me përjashtim të disa kompetencave që mungojnë, të cilat ndonëse janë të pakta, janë të një rëndësie thelbësore. Ato përfshijnë të drejtën për të vendosur masa që nxisin konkurrencën, të drejtën për t’u kërkuar operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes që të ndryshojnë kushtet e tyre të përgjithshme dhe të drejtën për të rritur nivelin e sanksioneve që ERE ka të drejtën të vendosë. Nga ana praktike, ERE duhet të shndërrohet në një institucion të pavarur, të mirëpajisur dhe të aftë, që trajton në mënyrë më aktive mangësitë në tregjet kombëtare të energjisë.

2. Harmonizimi i rregullave të tregut në nivel rajonal

Vendi ka pasur vonesa në reformat e tregut të energjisë elektrike dhe duhet të përshpejtojë zbatimin e masave të reformës së lidhshmërisë, veçanërisht duke hequr pengesat ligjore dhe kontraktuale ndaj integritetit të tregjeve të energjisë. Shqipëria duhet të ngrejë një treg të organizuar të energjisë elektrike të ditës në avancë.

Çmimet e energjisë elektrike vazhdojnë të jenë të rregulluara, por duhet të liberalizohen gradualisht me vënien në zbatim të legjislacionit. Në praktikë, liria që u është dhënë klientëve për të ndryshuar furnizues është e vështirë të ushtrohet për shkak të ndryshimeve në ligjin e sektorit të energjisë elektrike. Gjithashtu, ka ende mangësi në zbatim, duke qenë se pjesës më të madhe të klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV u lejohej të blejnë nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe të gjithë atyre që janë të lidhur në nivele më të ulëta tensioni u lejohej që të blejnë nga furnizuesi i shërbimit universal. Tregu i energjisë elektrike mbetet i mbyllur për shkak të një kontrate të rregulluar ndërmjet shoqërive shtetërore të prodhimit dhe furnizimit. Kjo kontratë duhet të zgjidhet menjëherë.

3. Kongjestioni i interkoneksionit dhe menaxhimi i sigurisë

Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare të gazit.

⁹ Energy Poverty in South East Europe – Surviving the Cold. Programi Politik i Evropës Juglindore për Energjinë e Qëndrueshme (SEE SEP), 2016

Sistemi i energjisë elektrike në Shqipëri është ndërlidhur me sistemet fqinje të Greqisë dhe Malit të Zi që prej vitit 2014, kur Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (ENTSO-E) miratoi operimin në sinkron të sistemit shqiptar të transmetimit të energjisë elektrike me sistemin kontinental evropian.

Ajo ka gjithashtu një linjë interkoneksioni me Kosovën. Linja e interkoneksionit 400 kV midis Shqipërisë dhe Kosovës u përfundua në qershor të vitit 2016.

Shqipëria merr pjesë gjithashtu në strategjinë makro-rajonale të BE-së për rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR), për të cilën përmirësimi i lidhshmërisë (për rrjetet e transportit dhe të energjisë) përbën prioritet kryesor.

Rrjetet transevropiane

Shqipëria ka një farë niveli përgatitjeje në fushën e rrjeteve transevropiane. Ajo ka pasur progres në zhvillim e rrjeteve të transportit dhe energjisë. Gjithashtu, është bërë progres edhe me sistemin e saj të interkoneksionit të gazit, me zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans-Adriatik.

Gjatë viteve në vijim, Shqipëria duhet në veçanti:

- të vazhdojë zhvillimin e rrjeteve kryesore të transportit dhe energjisë në përputhje me:
 - (i) strategjitë kombëtare për transportin dhe energjinë;
 - (ii) prioritizimin e investimeve në infrastrukturë në kuadër të kanalizimit të një projekti të vetëm; dhe
 - (iii) axhendës për lidhshmërinë;
- të harmonizojë kuadrin ligjor me tërësinë e legjislacionit të BE-së dhe rregulloret për TEN-T (rrjetet transevropiane të transportit) dhe TEN-E (rrjetet transevropiane të energjisë), duke përfshirë transpozimin e Rregullores (BE) 347/2013 për udhëzimet për infrastrukturën transevropiane të energjisë;
- të zbatojë masat e reformës së lidhshmërisë dhe të fuqizojë kuadrin institucional dhe kapacitetet administrative për zhvillimin dhe monitorimin e TEN-ve.

Shqipëria po bën progres në ngritjen e kuadrit strategjik të vendit **për rrjetet e transportit**. Shqipëria synon të harmonizojë kuadrin e saj ligjor dhe institucional me Rregulloren e BE-së për TEN-T dhe Traktatin e Komunitetit të Transportit, të cilin e ka nënshkruar në qershor të vitit 2017 dhe ratifikuar në shkurt të vitit 2018. Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive në proceset e Observatorit të Transportit për Evropën Juglindore (i cili u zëvendësua me Traktatin e Komunitetit të Transportit në janar 2019) si dhe në ato të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6), me fokus përmirësimin e lidhshmërisë brenda BP6 dhe me BE-në. Strategjia kombëtare e transportit dhe plani i veprimit për periudhën 2016-2020 parashikon një zgjerim të rrjeteve të përgjithshme dhe bazë të TEN-T për të përfshirë edhe Shqipërinë, si dhe një harmonizim me udhëzimet e TEN-T dhe standardet e rregulloret e BE-së. Është bërë progres me hartimin e rishikimit të dytë të planit kombëtar shqiptar të transportit (PKT3), i cili ka përfunduar në janar të vitit 2019.

Shqipëria ka bërë progres me riparimin e infrastrukturës së saj rrugore në rrjetin kryesor. Gjithashtu, ka pasur progres edhe në përgatitjen e projekteve të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, veçanërisht përgjatë korridorit Adriatiko-Jonian dhe korridorit VIII. Përmirësimi i hekurudhës Durrës-Tiranë është planifikuar të fillojë në mesin e vitit 2019. Shqipëria duhet të garantojë që projektet e saj për rrjetin e transportit të zbatohen në përputhje me kuadrin rregullator të TEN-T. Investimet e ardhshme në infrastrukturë duhet të zbatohen në përputhje me standardet e BE-së për prokurimet publike, ndihmën shtetërore dhe VNM-të. Projektet duhet të kanalizohen përmes kanalizimit të një projekti të vetëm, që konfirmon orientimin strategjik të vendit drejt TEN-ve. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për sigurinë në rrugë. Duhet të merren masa më të rrepta për të rregulluar pikat me rrezik përgjatë segmenteve rrugore me nivele të larta aksidentesh. Miratimi i planeve shumëvjeçare të mirëmbajtjes për mbarë rrjetin kryesor (hekurudhor dhe rrugor) mbetet ende një sfidë.

Shqipëria ka arritur harmonizimin e pjesshëm me tërësinë e legjislacionit të BE-së për një zonë të vetme hekurudhore evropiane, ndërveprueshmëri të sistemit hekurudhor dhe korridore hekurudhore për transportin konkurrues të mallrave.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për:

- (i) përafrimin e kuadrit ligjor të brendshëm me direktivën për sistemet e transportit inteligjent,
- (ii) zhvillimin e strategjisë kombëtare për sistemet inteligjente të transportit (SIT); dhe
- (iii) përgatitjen për zbatimin e kësaj strategjie.

Dimensionimi i kërkimit, inovacionit dhe konkurrueshmërisë

Baza ligjore për kërkimin dhe inovacionin është VKM nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin”.

Objektivat kombëtare:

- Reformimi i sistemit institucional të kërkimit shkencor
- Rritja e investimeve në kërkim dhe inovacion me fonde publike dhe burime të tjera alternative, në nivelin 1% të PBB në 2022
- Përfshirja e diasporës shkencore shqiptare në shkencë, teknologji dhe inovacion
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit shkencor dhe bizneseve 2017-2022
- Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor

Ofrimi i mbështetjes për universitetet dhe subjektet e tjera të orientuara drejt kërkimit rregullohet në dokumentet në vijim:

- REPUBLIKA E SHQIPËRISË, KËSHILLI I MINISTRAVE - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, fq. 72.
- VKM nr. 710, datë 1.12.2017, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin”
- DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT, Raporti “Shqipëria 2019”, që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (krua 15 “Energjia”, fq. 74)

Zyra e Erasmus+ (www.erasmusplus.al) mbështet lëvizjen e studentëve dhe të stafit dhe bashkëpunimin e institucioneve të arsimit të lartë, duke ushtruar funksionet në vijim:

- Ajo përpunon, promovon dhe shpërndan informacionin dhe dokumentacionin e programit Erasmus+ të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL);
- Ajo këshillon, informon dhe ndihmon të gjithë personat e interesuar për aplikimin në projektet e Erasmus+;
- Ajo kryen monitorimin dhe zbatimin e projekteve Tempus, të cilat janë ende në zhvillim;
- Ajo mbështet dhe koordinon aktivitetet e grupit kombëtar të Ekspertëve të Reformës në Arsimin e Lartë, ERAL, të cilët kanë rol këshillues dhe mbështetës në arritjen e objektivave të programit Erasmus+;
- Ajo kontribuon në vlerësimin e projekteve që do të dorëzohen në kuadër të komponentit “Ngritja e kapaciteteve të arsimit të lartë” në Erasmus+ (ish-projektet Tempus).

Në vitin 2014, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje me BE-në për të marrë pjesë në programin kuadër për kërkimin dhe inovacionin Horizon 2020 (2014-2020). Informacione të mëtejshme rreth pjesëmarrjes së institucioneve shqiptare kërkimore dhe shkencore në programin Horizon 2020 mund të gjenden në faqen 18 të VKM-së nr. 710, datë 1.12.2017, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin”.

Shqipëria merr pjesë në aktivitete të lidhura me Planin Strategjik për Teknologjitë Energjetike (SET) mbi bazën ligjore në vijim: Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, raporti “Shqipëria 2019”. që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (krua 15 “Energjia”, fq. 74).

1.2.3 Çështjet kryesore me rëndësi ndërkufitare

Bashkëpunimi ndërkufitar është çelësi për rritjen e nivelit të energjisë diellore në rrjetin e energjisë elektrike dhe për arritjen e ekonomive të shkallës për sa i përket financimit të zbatimit të masave për efikasitetin e energjisë, ndër të tjera në rinovimin e ndërtesave, si p.sh. përmes agregimit të projekteve. Në këtë drejtim, është me rëndësi thelbësore që të shkëmbehen përvoja dhe të bashkëpunohet për zhvillimin e strategjive, në mënyrë që të bëhet përafrimi i vendimeve me rëndësi ekonomike.

Një tjetër sektor thelbësor me rëndësi ndërkufitare është sektori i transportit. Dokumenti aktual “Strategjia Kombëtare Sektoriale për Transportin 2016-2020” është përafuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila parashtrohet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj kombëtar shoqëror, demokratik dhe ekonomik përgjatë periudhës 2015-2020. Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës shqiptare të transportit ka qenë dhe mbetet një prej prioriteteve kryesore të qeverisë shqiptare. Synimi ka qenë:

- krijimi i kushteve paraprake për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë,
- rritja e aksesueshmërisë për mallrat dhe pasagjerët në tregti dhe në ofrimin e shërbimeve, dhe
- dhënia e një kontributi të konsiderueshëm në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Prioriteti strategjik është përshpejtimi i integritetit të sistemit shqiptar të transportit dhe ngritja e një tregu të integruar që konsiston në infrastrukturë transporti përmes tokës (rrugor dhe hekurudhor), përmes detit dhe përmes rrugëve të brendshme ujore. Përpos investimeve të konsiderueshme, kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sektori i transportit nuk është ende një nxitës i fuqishëm i zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Financimi i përshtatshëm dhe në kohë i investimeve në programe vjetore dhe afatmesme mbetet problematik. Gjithashtu, cilësia e punëve publike të lidhura me transportin nuk ka arritur ende standardet e BE-së. Përafrimi i politikës shqiptare të transportit me Politikën Evropiane të Transportit dhe koordinimi i infrastrukturës së saj të transportit me atë të vendeve fqinje – vendet e Ballkanit Perëndimor, që përfshijnë Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM), Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën - janë shndërruar në dy prioritetet kryesore për vendimmarrësit shqiptarë në fushën e transportit.¹⁰

Për sa i përket transportit rrugor, sfidat kryesore për periudhën e planifikimit 2016-2020 janë:

- Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me tërësinë e legjislacionit të BE-së për transportin rrugor të mallrave dhe pasagjerëve;
- Përfundimi i ndërtimit të rrjetit rrugor të brendshëm, duke përfshirë arteriet strategjike;
- Përfundimi i studimit të fizibilitetit për autostradën Adriatik-Jon si një korridor veri-jug;
- Reformimi i rrjetit të transportit rrugor ndërrurban për pasagjerët.

Për sa i përket transportit hekurudhor, sfidat kryesore për periudhën e planifikimit 2016-2020 janë:

- Reformimi i sistemit hekurudhor për krijimin e një tregu të hapur për investitorët publikë dhe privatë, qoftë nga aspekti i rregullimit të tregut apo nga ai i menaxhimit të infrastrukturës ose operacioneve hekurudhore;
- Fuqizimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në të gjitha nivelet, veçanërisht me qëllimin për të ngritur në mënyrë efektive strukturën ligjore dhe institucionale që nevojitet për garantimin e operimit të sigurt të një tregu të hapur;
- Krijimi i kushteve ligjore dhe institucionale të favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja; dhe
- Krijimin e kushteve të barabarta me mënyrat e tjera të transportit.

¹⁰ Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020, Raporti i parë i monitorimit, nr. 811, datë 16 nëntor 2016

Për sa i përket integritimit në tregun evropian të energjisë, është i rëndësishëm bashkëpunimi me:

- ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike)
- ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Gazit)

Më shumë informacion jepet në kreun 1.2.2 Dimensioi i tregut të brendshëm të energjisë.

Për qëllimet e inovacionit, është me rëndësi thelbësore që të thellohet bashkëpunimi në fushën e kërkimit lidhur me tema që kanë rëndësi të veçantë për rajonin.

Baza për bashkëpunimin rajonal, duke përfshirë edhe atë ndërkuftar, është Komuniteti i Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë organizon grupe të ndryshme pune të cilat ofrojnë një platformë për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave lidhur me çdo dimension të PKEK-së.

Gjithashtu, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë prezanton studime dhe nisma të rëndësishme për rajonin, duke përfshirë, ndër të tjera:

- Nismën e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor
- Studimin e Komunitetit të Energjisë për çmimet e karbonit (studim i nisur në janar të vitit 2020 <https://energy-community.org/news/Energy-Community-News/2020/02/03.html>)

1.2.4 Struktura administrative e zbatimit të politikave kombëtare për energjinë dhe klimën

Komiteti Ndërmnistror për Energjinë dhe Klimën (IECC) është ngritur si një grup pune ndërmnistror me pjesëmarrjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (e cila, për shkak të shtrirjes së kompetencave të saj, luan rolin më kryesor dhe ka numrin më të madh të përfaqësuesve nga fusha e hidrokarbureve, energjisë, transportit dhe planifikimit urban, si dhe nga një sërë institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me energjinë), Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe INSTAT-it.

IECC-ja është kryesisht përgjegjëse për udhëheqjen politike dhe strategjike, koordinimin dhe vendimmarrjen, verifikimin e rezultateve dhe vlerësimin e miratimit final të objektivave të vendosura gjatë procesit të PKEK-së. Sipas udhëzimeve politike për PKEK-në nga Komuniteti i Energjisë, Komiteti Ndërmnistror për Energjinë dhe Klimën mbledhet jo më rrallë se dy herë në vit.

Është krijuar një Sekretariat Teknik me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili është përgjegjës për detyrat në vijim:

- Menaxhimin e organizimit, projektimit dhe elaborimit të PKEK-së;
- Organizimin e konsultimeve dhe dëgjësive publike;
- Përgatitjen dhe përpunimin e materialit të PKEK që do të përdoret gjatë mbledhjeve dhe konsultimeve me publikun;
- Organizimin e mbledhjeve teknike me të gjitha grupet përkatëse të interesit;
- Lehtësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet grupeve të punës;
- Këshillimin e IECC-së lidhur me përshtatjen e afateve kohore për hartimin e PKEK-së.

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të masave dhe efekteve të tyre sigurohet përmes bashkëpunimit efektiv midis grupeve të interesit (qeverisë dhe autoriteteve vendore e aktorëve të tjerë), mbledhjeve, konsultimeve dhe diskutimeve mbi çështjet e ngritura, duke përcaktuar sfidat dhe hapat për kapërcimin e tyre.

Bashkëpunimi institucionalizohet përmes Komitetit Ndërmnistror. Komiteti mbledhet 4 herë në vit për të koordinuar aktivitetet dhe për të përshtatur afatet kohore. Axhenda përmban një hapësirë për raportimin, një hapësirë për zgjidhjen e problemeve dhe një hapësirë për diskutime strategjike. Procesverbalet u shpërndahen pjesëmarrësve. Grupeve të interesit u jepen një përmbledhje e miratuar në nivel politik përmes shërbimit postar ose përmes faqes së internetit të MIE.

Institucioni qeveritar MIE, përmes AKBN, ERE dhe AEE, ka për detyrë të monitorojë dhe ndjekë zbatimin e SKE në çdo sektor dhe për të gjitha burimet e energjisë. Ato paraqesin pranë MIE raportin

vjetor që vlerëson realizimin në sasi dhe cilësi të masave për EE-në, BRE-të dhe shoqëritë e energjisë, nivelin e investimeve të realizuara, pengesat dhe arsyet pas tyre, si dhe mënyrën e kapërcimit të pengesave, në mënyrë të tillë që të arrihet kursim i energjisë, reduktim i shkarkimeve dhe përmbushje e objektivave të tjera të mbetura.

Në këtë mënyrë mund të monitorohet zbatimi i masave politike të PKEK-së.

1.3 Konsultimet dhe përfshirja e subjekteve shtetërore dhe rezultati i tyre

Me qëllim gjetjen e zgjidhjeve më të mira, arritjeve etj., drafti i PKEK-së u nënshtrohet dëgjësive, diskutimeve dhe shkëmbimeve të opinioneve me pjesëmarrjen e këtyre grupeve të interesit: ministritë/agjencitë e ndryshme që preken drejtpërdrejt apo tërthorazi nga PKEK-ja, njësitë e qeverisjes vendore (ato të mëdha), shoqëria civile, ekspertët e energjisë dhe shoqatat e ndryshme të bizneseve. Grupet e interesit përfshihen pjesërisht/plotësisht gjatë ciklit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të PKEK-së.

Procedurat e konsultimit organizohen sipas Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 30.4.2014, "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore". Ligji nr. 146/2014 përcakton rregullat dhe procedurat për njoftimin dhe konsultimin publik që zhvillohet nga autoritetet/institucionet publike në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.

Është e rëndësishme të theksohet se disa akte legjislative të përfshira në detyrat e organeve qeveritare, bashkive etj., të cilat përkufizojnë qartë të drejtën e grupeve të interesit nga shoqëria civile për t'u përfshirë në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit dhe në vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Sipas procedurave të përcaktuara qartë të MIE, pas konsultimeve të nevojshme përmes takimeve, tryezave të rrumbullakëta, faqeve të internetit etj. me të gjitha grupet e interesit të këtij procesi gjithëpërfshirës, MIE dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të jenë të detyruara të reflektojnë komentet dhe të gjejnë mënyrat e duhura për të kapërcyer pengesat (teknike dhe financiare), duke inkurajuar dhe mbështetur zbatimin e PKEK-së në seksionet e tyre specifike bazuar në udhëzues ose udhërrëfyes të caktuar.

Procesi i konsultimit të PKEK-së menaxhohet si një proces interaktiv nga Sekretariati Teknik në emër të Komitetit Ndërmintor për Energjinë dhe Klimën dhe me mbështetjen e GIZ (shih Figura 17). Sekretariati Teknik organizohet nga MIE.

Procesi i konsultimit është planifikuar si një proces me dy drejtime, pra MIE kërkon komente mbi politikën dhe masat e planifikuara dhe grupet e interesit kanë mundësinë të kërkojnë informacion të mëtejshëm ose specifik mbi tema të caktuara që lidhen me PKEK-në.

Elementet e procesit të konsultimit:

- Të gjitha politikën dhe masat prezantohen në faqen e internetit të MIE dhe të gjitha grupet e identifikuara të interesit mund të japin komentet e tyre (konsultimi online). Një skedar në Word është i disponueshëm për shkarkim dhe komentet mund të paraqiten përmes emailit. Si alternativë, mund të përdoret një instrument anketimi online për të informuar grupet e interesit dhe për të mbledhur komente.
- Grupet e interesit ftohen të kërkojnë informacione të mëtejshme ose specifike në lidhje me PKEK-në.
- Mbledhjet e përbashkëta ose konferencat telefonike me vende të tjera fqinje për shkëmbimin e informacioneve dhe praktikave më të mira janë gjithashtu elemente të rëndësishme të procesit. Kjo vlen për politikën dhe masat për të cilat bashkëpunimi rajonal ose ndërkufitar është thelbësor.
- Përfshirja e ekspertëve përmes grupeve të punës dhe angazhimi i grupeve të jashtme të interesit janë elementet kyçe të procesit. Skema organizative përkatëse tregohet në figurën më postë.

Për shkak të situatës së COVID-19, mbledhjet dhe seminarët fizike janë zëvendësuar me mbledhje dhe seminarë virtuale.

Procesi i konsultimit dokumentohet dhe vlerësohet me qëllim përmirësimit të procedurës në kohën kur duhet të kryhet rishikimi i radhës i PKEK-së.




Figura 17: Përfshirja e ekspertëve përmes grupeve të punës dhe angazhimi i grupeve të jashtme të interesit

1.3.1 Përfshirja e Kuvendit Kombëtar

Pas hartimit të PKEK-së, MIE do të dorëzojë draftin për konsultim pranë institucioneve që janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procesin e zbatimit të investimeve në projekte të lidhura me PKEK-në në të gjitha dimensionet e PKEK-së. Me marrjen e komenteve, MIE reflekton të gjitha sugjerimet e dhëna nga aktorë të ndryshëm në draftin e PKEK-së dhe e paraqet draftin së bashku me reflektimet pranë Kuvendit, më konkretisht pranë një organi specifik brenda Kuvendit, ku procesi vazhdon me diskutime.

Ministritë e përfshira në këtë proces prezantojnë dhe informojnë Parlamentin për avantazhet e pritshme që lidhen me PKEK-në, konkretisht shfrytëzimi i potencialit të plotë të sinergjive midis të gjitha dimensioneve të PKEK-së, në përfitim të shoqërisë dhe mjedisit. Ato kërkojnë mbështetjen e tyre për çështje të ndryshme, si për shembull për miratimin e fondeve të investimit në EE.

Seancat plenare me Parlamentin, si për shembull mbi çështjet e energjisë dhe të klimës, organizohen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi mënyrën e arritjes së ajrit të pastër me shkarkime minimale të GES-ve. Kjo seancë plenare ka për synim të shpjegojë se kjo mund të arrihet përmes një PKEK-je të besueshme (bazuar në SKE dhe PKVEE), një pakete të mjaftueshme investimesh (një pjesë e tyre nga buxheti i shtetit), zbatimit të masave për EE-në, përcaktimit të institucioneve përgjegjëse dhe një procesi monitorimi efektiv.

1.3.2 Përfshirja e autoriteteve vendore dhe rajonale

Qeveritë vendore janë pjesëmarrës aktivë në procesin e hartimit dhe zbatimit të PKEK-së.

Autoritetet e qeverisjes vendore përgatisin periodikisht plane vendore veprimi për mjedisin, në përputhje me strategjitë dhe planet e përmendura në nenin 21 të Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e

mjedisit” (ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004 “Për përgjegjësitë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve në mjedis”, të ndryshuar).¹¹

Prandaj, ato përfshihen në procesin e hartimit të politikave të energjisë në tryezat e rrumbullakëta me aktorë të ndryshëm, duke qenë se do të jenë një aktor mjaft i rëndësishëm për zbatimin e masave të EE-së në projektet e ndërtimit, në projektim, në transport dhe në fushat e shërbimeve. Qeveritë vendore hartojnë Planet e veta të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm në prokurimin e EE për nevojat e tyre. Zbatimi i politikave dhe masave që lidhen me investimet rezultojnë në kursime energjie dhe reduktim të shkarkimeve, si dhe ndikon pozitivisht në tregun e punës, rritjen e PBB-së dhe përfitimet sociale. Institucionet përgjegjëse, së bashku me qeveritë vendore, mund të nxisin bizneset dhe të këshillojnë popullsinë për përdorimin efikas të burimeve të energjisë.

Institucionet kryesore të përfshira në këtë proces janë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Kombëtare për Efiçencën e Energjisë, Agjencia e prokurimit publik, Shoqata Shqiptare e Biznesit, Shoqata Shqiptare e Ndërtuesve, qeveritë vendore shqiptare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Këshillit Kombëtar i Territorit.

1.3.3 Konsultimet e grupeve të interesit, duke përfshirë partnerët socialë, dhe angazhimi i shoqërisë civile dhe publikut të gjerë

Një proces interaktiv që synon pjesëmarrjen në vendimmarrje ose politikëbërje duhet të planifikohet veçanërisht midis aktorëve të përfaqësuar nga institucionet publike, institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore dhe bankave, ESCO-ve dhe institucioneve të tjera financiare, për të dhënë informacion dhe për të shkëmbyer opsione në lidhje me investimet për zbatimin e masave të PKEK-së (Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik").

Procesi i informimit dhe konsultimit publik realizohet mbi bazën e planit të përshkruar në fillim të këtij kreu, sipas parimeve të mëposhtme:

- Transparenca gjatë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- Efektiviteti i procesit të vendimmarrjes;
- Përgjegjësia e autoriteteve/institucioneve publike ndaj palëve/aktorëve të interesuar mbi çështje të caktuara.

1.3.4 Konsultimet e palëve të tjera kontraktuese

Konsultimi i palëve të tjera kontraktuese zhvillohet mbi tema të ndryshme me rëndësi ndërkufitare, dhe mbi tema specifike ku ndarja e praktikave të mira është e dobishme.

Informacione të mëtejshme rreth politikave dhe masave të zbatuara mbi bazën e një bashkëpunimi ndërkufitar ose rajonal mund të gjenden në kreun përkatës 1.4.

1.3.5 Procesi përsëritës me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë është përfshirë që prej fillimit dhe ka ofruar mbështetje për fazën e hartimit duke dhënë informacione dhe duke diskutuar mbi versionet e mëparshme.

¹¹ Raporti mbi analizën e proceseve të paraplanifikimit për HEC-et në legjislacionin shqiptar dhe zbatimin e tij. Tiranë, mars 2018 (hartuar nga Alma Saraci)

Sekretariati ka marrë pjesë në mbledhjet në vijim:

- Mbledhje virtuale për koordinimin joformal ndërmjet anëtarëve të ekipit bazë
- Mbledhjet e grupit të punës të PKEK-së
- Mbledhje të tjera koordinuese

1.4 Bashkëpunimi rajonal në përgatitjen e planit

1.4.1 Elementet që i nënshtrohen planifikimit të përbashkët ose të koordinuar me palë të tjera kontraktuese

Çështjet e planifikimit për energjinë dhe klimën që lidhen me tregun e energjisë konsultohen me palët e tjera kontraktuese të përshkruara në kreun 1.2.2 Dimensioi i tregut të brendshëm të energjisë. Transporti është një tjetër element që i nënshtrohet planifikimit të koordinuar.

Për sa i përket promovimit dhe lehtësimit të mëtejshëm të zbatimit të Master Planit të Gazit, është vendos bashkëpunim ndërministror midis Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë lidhur me projektin e Gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP). Është vendosur gjithashtu bashkëpunim edhe me Kosovën për projektin ALKOGAP.

Procedurat bazohen në marrëveshjet ndërkombëtare të përshkruara më poshtë.

Marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me planifikimin e përbashkët ose të koordinuar:

“Traktati i Komunitetit të Energjisë”, i ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë”. Që prej vitit 2006, tërësia e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë ka evoluar ndjeshëm duke përfshirë direktiva dhe rregullore të reja. Aktualisht, tërësia e legjislacionit përfshin legjislacion mbi energjinë elektrike, gazin, naftën, infrastrukturën, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, mjedisin, statistikat, sigurinë kibernetike dhe klimën. Në sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri, zbatimi është mesatarisht i avancuar¹².

Në sektorin e gazit natyror është nënshkruar marrëveshja trepalëshe **Greqi-Shqipëri- Itali (Marrëveshja Ndërqeveritare - IGA)**, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 104/2013, datë 25.3.2013, “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin e Gazsjellësit Trans-Adriatik (Projekti TAP)”. (Hyrë në fuqi më 19 shkurt 2014).

OST ka nënshkruar **Marrëveshjen Kuadër të Zonës Sinkrone (SAFA)** për Grupin Rajonal Kontinental si anëtar i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) më 6 mars 2019, e cila ka hyrë në fuqi për një kohëzgjatje të pakufizuar më 14.4.2019. Objekti i kësaj marrëveshjeje është të sigurojë një kuadër ligjor për operimin e rrjeteve të ndërlidhura nga OST-të e Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale (anëtarët e ENTSO-E të këtij rajoni) përmes pajtueshmërisë dhe metodologjitë, kushtet dhe vlerat e tjera që ndjek ENTSO-E.

OST ka nënshkruar Marrëveshjen e **Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO)** më 1.4.2014, me objektivin për të kryer alokimin e qartë të kapacitetit ndërkufitar të transmetimit në të dyja drejtimet midis Zonave të Kontrollit të OST-ve pjesëmarrësve, përmes proceseve të ankandit të bazuara në NTC në përputhje me kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike. Operacionet e SEE CAO lidhen me harmonizimin e metodave të menaxhimit të kongestionit në Evropën Juglindore, rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë

¹²Raporti vjetor i zbatimit nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 1 nëntor 2019

elektrike dhe, sipas rastit, zbatimin e tyre në legjislacionin e brendshëm të shteteve përkatëse. Shqipëria ka filluar ankanDET e koordinuara në kufijtë e saj me Malin e Zi që prej majit të vitit 2015.

Bashkimi Evropian dhe vendet e Evropës Juglindore, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia kanë nënshkruar **Traktatin themelues të Komunitetit të Energjisë**, të miratuar me Ligjin nr. 8/2018, në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, tokësor dhe detar, si dhe për zhvillimin e një rrjeti transporti midis Bashkimit Evropian dhe vendeve të Evropës Juglindore. Ndër arsyet e tjera, Shqipëria e nënshkroi këtë traktat për shkak të nevojës së saj për: mbrojtje të mjedisit, zbutje të ndryshimeve klimatike dhe zhvillim të transportit të qëndrueshëm. Shqipëria është angazhuar të zbatojë pjesën e tërësisë së legjislacionit për transportin që lidhet me mjedisin, veçanërisht Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe direktivat për natyrën dhe cilësinë e ujit dhe të ajrit.

Katër planet e veprimit të Komunitetit të Transportit përbëjnë një manual udhëzues mbi të gjitha hapat dhe etapat e rëndësishme, shoqëruar me afate kohore që na udhëheqin drejt realizimit të objektivave mbi bazën e synimeve dhe ambicieve konkrete: rrugë më të sigurta; më pak kohë pritjeje në pikat e kalimit të kufirit; sisteme hekurudhore të sigurta dhe moderne, dhe rrugë të së ardhmes me elementë të integruar ekologjikë dhe dixhitalë. Plani i Veprimit për Rrugët synon të zhvillojë në Ballkanin Perëndimor një rrjet rrugor TEN-T të qëndrueshëm ndaj kushteve të klimës, inteligjent dhe eficient nga pikëpamja e burimeve, përmes përfshirjes së elementeve ekologjike dhe inteligjente në investimet e infrastrukturës rrugore. Qëllimi ynë përfundimtar është të nxisim operacione të transportit rrugor që janë novatore, me shkarkime të ulëta dhe të përshtatshme për epokën dixhitale.

1.4.2 Shpjegimi sesi bashkëpunimi rajonal merret në konsideratë në plan

Bashkëpunimi rajonal mundësohet përmes mbledhjeve të grupeve të punës të organizuara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Projekti CDCP III ka lehtësuar bashkëpunimin rajonal midis Shqipërisë dhe Malit të Zi për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave, veçanërisht në lidhje me qasjet e modelimit për pjesën B të PKEK-së. GIZ zbaton programin rajonal “Zhvillimi i kapaciteteve për politikën e Klimës në Vendet e Evropës Juglindore dhe Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, faza III (CDCP III)”. CDCP III synon të mbështesë qeverinë shqiptare gjatë të gjithë procesit të PKEK-së dhe siguron gjithashtu një platformë për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, ndër të tjerat mbi bazën e nevojave për planifikim të koordinuar midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut.

2 SYNIMET DHE OBJEKTIVAT KOMBËTARE

Shënim paraprak për harmonizimin e PKEK-së, Strategjisë Kombëtare për Energjinë dhe NDC-së

Planet kombëtare ekzistuese që janë marrë në konsideratë në hartimin e këtij dokumenti përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Energjinë dhe Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC). Strategjia Kombëtare për Energjinë ka vendosur si pikësynim që të arrijë një nivel TFEP-je prej 42% dhe një reduktim të përdorimit të energjisë me 15% krahasuar me skenarin bazë për vitin 2030. Modelimi që qëndron në themel të strategjisë ndryshon për nga rritja e PBB-së dhe popullsia. Pikësynimi për energjinë e rinovueshme i Strategjisë Kombëtare për Energjinë përfshin nivele efieçence prej 78% e poshtë për prodhimin e energjisë së rinovueshme. Në konsumin final të energjisë, PKEK-ja arrin gjithashtu një përqindje më të lartë të BRE-ve. Në nivelin sektorial, Strategjia Kombëtare për Energjinë nuk merr në konsideratë rinovimin e konsiderueshëm të parashikuar nga SLED (2015), në të cilin bazohet edhe PKEK-ja. Ajo përdor peleta biomase për ngrohjen e hapësirave, ndërsa PKEK-ja bazohet tek elektrifikimi dhe rinovimi. Në fushën e shërbimeve, Strategjia Kombëtare për Energjinë parashikon një rritje të ndjeshme të kërkesës për energji. Në fushën e transportit, ajo nuk e konsideron opsionin e elektrifikimit dhe nënvlerëson humbjet në rrjetin e transmetimit. Vihet re një diferencë e madhe në shfrytëzimin e gazit natyror, i cili përdoret për plotësimin e 20% të kërkesës finale për energji në 2030 në Strategjinë Kombëtare për Energjinë dhe gjen përdorim në shumë nënsektore, krahasuar me rastet e pakta të përdorimit të sotëm në industri. Pavarësisht këtyre diferencave, krahasimi me Strategjinë Kombëtare për Energjinë ka rezultuar të jetë një referencë mjaft e dobishme dhe e frytshme për punën në lidhje me PKEK-në.

NDC-ja e Shqipërisë u paraqit në vitin 2015 dhe mbulonte vetëm sektorin e energjisë. Paralelisht me elaborimin e PKEK-së, u krye rishikimi i NDC-së nga një ekip tjetër, me qëllimin për të mbuluar të gjithë sektorët e ekonomisë. Rregullorja për qeverisjen parashikon se PKEK-ja ka përparësi ndaj NDC-së. Megjithatë, aktiviteti për elaborimin e NDC-së u krye paralelisht, pavarësisht disa përpjekjeve për të harmonizuar dhe koordinuar përpjekjet. Nga materiali i siguruar nga ekipi i NDC-së, ishte i mundur përmirësimi i objektit të PM-ve (politikave dhe masave) që qëndrojnë në themel të sektorëve joenergjetike, ndërkohë që parashikimet e efekteve janë elaboruar veçmas. Parashikimi i PKEK-së lidhur me sektorin e LULUCF është marrë nga NDC-ja. Parashikimet e NDC-së për sektorin e energjisë thuhet se janë bazuar në Strategjinë Kombëtare për Energjinë, me një përditësim të kufizuar të modelimit që qëndron në bazë të këtij dokumenti. Diferencat me këtë dokument dhe modelimin bazë janë diskutuar më lart.

Shënim paraprak për Strategjinë Kombëtare për Energjinë

Strategjia Kombëtare për Energjinë (SKE) 2018-2030¹³ është një strategji e përgjithshme e sektorit të energjisë dhe për rrjedhojë ka qenë dokumenti kryesor politik në sektorin e energjisë, i cili shërbente si burim informacioni për dimensionet 1-4 të Unionit të Energjisë dhe të PKEK-së së Shqipërisë. SKE (në faqen 107) parashikon se kontributi i investimeve publike është i barabartë me 252 milionë euro për periudhën 2018-2030, kryesisht për përkrahjen e fushatave të ndërgjegjësimit dhe projekteve pilot për promovimin e EE-së në të gjithë sektorët e ekonomisë. Investimet private dhe financimet nga donatorët parashikohen në vlerën 3,399 milionë euro për periudhën 2018-2030.

Për sa i përket dimensionit të dekarbonizimit dhe efieçencës së energjisë, pikësynimet e SKE-së janë përshtatur me evoluimin e bazës së njohurive.

¹³ Miratuar me VKM nr. 480, datë 31.7.2018, bazuar në Ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

2.1 Dimensioni i dekarbonizimit

2.1.1 Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve

Elementet e përcaktuara në nenin 4, pika 1, germa “a”

Pikësynimet bazuar në Pjesën Analitike B të PKEK-së

Për sa u përket shkarkimeve të GES-ve, skenari WAM rezulton në një total shkarkimesh prej 12,6 Mt ekuivalentë të dyoksidit të karbonit në vitin 2030, ndërsa vlerat në skenarin WAM arrijnë 10,2 Mt ekuivalentë të dyoksidit të karbonit, që përkojnë me një reduktim prej 18,7% krahasuar me vlerat e skenarit WAM.

Në krahasim me vitin referencë 2018, WAM përfshin një reduktim të shkarkimeve prej 6,1% në vitin 2030, ku vërehet një rritje në shkarkime në vitet pas 2030-ës, që arrijnë vlera pak më të larta se të 2018-ës në vitin 2040 (plus 4,0%). Në skenarin WEM vërehet një rritje në shkarkime me 15,4% në vitin 2030 dhe një rritje me 30,5% në vitin 2040.

Shkarkimet e GES-ve [kt CO₂eq] sipas parashikimit me masa shtesë për 2030:

Kërkesa: 4833,0

Transformimi: 250,8

Konsumi joenergjetik: 5139,0

Pikësynimet e mëparshme për krahasim

NDC – Kontributi kombëtar i përcaktuar:

Dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të përcaktuar/të pikësnuar kundrejt arritjes së pikësynimit të KKKBNK-së, miratuar me VKM nr. 762, datë 16.9.2015, parashikon se INDC-ja e Shqipërisë (Kontributet Kombëtare të Pikësnuara) përbën një pikësynim të skenarit bazë: Shqipëria synon reduktimin e shkarkimeve të saj të CO₂ me 11,5% krahasuar me skenarin bazë për periudhën 2016 deri në 2030. Ky reduktim është i barasvlershëm me një reduktim të shkarkimeve të CO₂ me 708 Gg brenda vitit 2030. Trajektorja e shkarkimeve për Shqipërinë mundëson një tendencë të lehtë drejt arritjes së 2 tonëve shkarkim të GES-ve për frymë brenda vitit 2050, çka mund të merret si pikësynim për tkurrjen dhe bashkërendimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.

Për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave, mungon referenca për vitin bazë 2005.

Pikësynimi	2020	2025	2030	Burimi
Reduktimi i shkarkimeve të CO ₂ (NDC) krahasuar me 0% në vitin 2015	0%	5.75%	11.5%	Strategjia e Energjisë për Shqipërinë

Tabela 9: Pikësynimet e skenarit bazë të NDC

80% e reduktimit të shkarkimeve të GES-ve në shkallë kombëtare do të arrihet në sektorët e energjisë (me fokus të veçantë të transporti), bujqësisë dhe ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pyjeve (LUCF).

Strategjia Kombëtare për Energjinë:

Strategjia Kombëtare shqiptare për Energjinë¹⁴ është në përputhje me “Udhërrëfyesin e Ekonomisë me Karbon të Ulët” të BE-së dhe nxit politikat e EE-së, BRE-ve dhe gazit natyror që favorizojnë një klimë të qëndrueshme biznesi e cila do të inkurajojë investime me karbon të ulët për periudhën 2017-2030. Ekzistojnë disa skenarë, por skenari i rekomanduar tregonte një reduktim prej 28% krahasuar me një skenar bazë, ose 5276 TCO_{2eq} në 2030.

Parashikimi deri në vitin 2050

Në zhvillim e sipër

2.1.2 Energjia e rinovueshme

Elementet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, germa “a”

Pikësynimet bazuar në Pjesën Analitike B të PKEK-së

Pjesët që zë energjia e rinovueshme në konsumin final të energjisë përcaktohen sipas Direktivës 2009/28/KE (RED; BE (2009); shihni gjithashtu Komisioni Evropian (2018)).

Në terma të përgjithshëm, masat shtesë rrisin përqindjen e burimeve të rinovueshme në energjinë finale nga 33.5% (skenari WEM) vitin 2030 në 54.4% (skenari WAM). Vlerat historike të vitit 2018 arrijnë në 37,9% dhe skenari WAM rezulton në një rritje 20,9% pikë përqindjeje.

Përqindja e BRE-ve në kërkesën finale për energji [përqindje] siç është projektuar me masat shtesë për vitin 2030

* Vlerat mbi 100% janë për shkak të eksporteve të energjisë elektrike.

BRE - Energji elektrike: 178.1 %*

BRE - Transport: 34.6 %

BRE - Ngrohje dhe ftohje: 16.6 %

Pikësynimet e mëparshme për krahasim

Strategjia Kombëtare për Energjinë:

Skenari i Energjisë së Rinovueshme i prezantuar në Strategjia Kombëtare për Energjinë përfshin Planin Kombëtar shqiptar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKVBRE) 2019. Sipas NREAP, Shqipëria është angazhuar të arrijë një pikësynim të detyrueshëm prej 38% për energjinë nga burimet e rinovueshme në konsumin final të energjisë në vitin 2020, duke filluar me 30% në vitin 2009 dhe zhvillimin e mëtejshëm deri në 2030.

Angazhimi i qeverisë për të zhvilluar më tej BRE-të brenda vitit 2030 është shprehur gjithashtu në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Energjinë 2018-2030, miratuar me VKM nr. 480, datë 31.7.2018. Pikësynimi për vitin 2030 do të jetë të paktën 45% e TKPE (totalit të konsumit përfundimtar të energjisë) të parashikuar për këtë vit.

¹⁴ Strategjia e Energjisë për Shqipërinë. Analiza e skenarëve të zhvillimit të energjisë në mbështetje të Strategjisë Kombëtare shqiptare për Energjinë, Raporti për USAID dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, dhjetor 2016

Trajektorët e parashikuara për energjinë e rinovueshme

Trajektorët e parashikuara sipas teknologjisë së energjisë së rinovueshme janë të disponueshme në pjesën B të PKEK-së.

Trajektorët e parashikuara lidhur me kërkesën për bioenergj (të disagreguara) janë të disponueshme në pjesën B të PKEK-së.

Trajektorët e parashikuara për përqindjet e BRE-ve në sektorin e transportit, sektorin e energjisë dhe sektorin e ngrohjes dhe të ftohjes janë të disponueshme në pjesën B të PKEK-së.

2.2 Dimensioani i efikasitetit të energjisë

2.2.1 Elementet e përcaktuara në nenin 4, germa “b”

(1) kontributi i ndikativ kombëtar i efikasitetit të energjisë për arritjen e pikësnyimeve të BE-së për efikasitetin e energjisë prej të paktën 32,5% të 2030, siç përmendet në nenin 1, paragrafi 1 dhe në nenin 3, paragrafi 5 të Direktivës 2012/27/BE, bazuar në konsumin primar ose final të energjisë, kursimet primare ose finale të energjisë ose intensitetin e energjisë.

Pikësnyimet bazuar në Pjesën Analitike B të PKEK-së

Teksa në skenarin WEM, konsumi final i energjisë rritet (në krahasim me vitin 2018) me 20,8% deri në vitin 2030 dhe 46,5% deri në vitin 2040, ai rritet me vetëm 10,7% deri në vitin 2030 dhe 29,0% deri në vitin 2040 në skenarin WAM. Nga ana tjetër, konsumi final i energjisë në skenarin WAM reduktohet krahasuar me skenarin WEM me 8,4% në vitin 2030 dhe 12,0% në vitin 2040.

Konsumi final i energjisë [ktoe] sipas parashikimit me masa shitesë për vitin 2030:

Banesat:	348,9
Shërbimet:	195,2
Industria:	542,4
Transporti:	1003,4
Bujqësia Pylltaria:	110,5
Peshkimi:	56,0
Konsumi joenergjetik:	70,6

Pikësnyimet e mëparshme për krahasim

Strategjia Kombëtare për Energjinë:

Pikësnyimet e efikasitetit të energjisë parashikohen në nivelin e konsumit të brendshëm bruto dhe në nivelin e konsumit final të energjisë, përmes të cilave elaborohen shumë më tepër masa të EE-së për kursimet e energjisë në nivelin e konsumit final të energjisë. Me përjashtim të masave të EE që planifikohet të realizohen me prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, pikësnyimet e EE-së në sektorin e ndërtesave, transportit dhe industrisë janë më të zgjeruara në PKVEE 2-3.

Pikësnyimet e EE-së bazuar në nenin 3 të Direktivës 2012/27/BE, të parashikuara në PKVEE, janë si vijon:

- Objektivi i kursimit të energjisë lidhur me konsumin final të energjisë është parashikuar në vlerën 6,8% në 2020 ose një total prej 123,7 Ktoe energji e kursyer, 10% në 2025 dhe 15,5% në 2030 krahasuar me skenarët bazë përkatës për vitet e lartpërmendura.

Reduktimi i intensitetit të energjisë në PBB me 18% brenda vitit 2030.

(2) sasia kumulative e kursimeve të energjisë për përdorim fundor që do të arrihen gjatë periudhës 2021-2030 sipas germës “b” të nenit 7, pika 1 për detyrimet e kursimit të energjisë në përputhje me Direktivën 2012/27/BE;

Pikësynimet deri në vitin 2030 (ose deri në 2020) sipas nenit 7, pika 1, germa “b” - Skemat e detyrimeve, nuk disponohen ende, për shkak se PKVEE-ja e 2-të dhe e 3-të nuk parashikonte qasjen e propozuar për arritjen e pikësynimeve të nenit 7. Megjithatë, parashikohet miratimi i një ndryshimi në ligjin për EE-në, i cili do ta përfshijë këtë dispozitë.

Projektligji është përgatitur tashmë dhe ndryshimet e ligjit ekzistues do të mbulojnë përfshirjen e elementeve që mungojnë aktualisht, duke përfshirë nenin 4 (Strategjia e rinovimit të ndërtesave), nenin 7 (skemat e detyrimeve të efikasitetit të energjisë dhe alternativat), nenin 14 (nxitja e efikasitetit të energjisë në ngrohje dhe ftohje), nenin 15 (transformimi, transmetimi dhe shpërndarja) dhe nenin 24 (raportimi).

(3) Strategjia për rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale, si publike ashtu dhe private, udhërrëfyesi me treguesit e matshëm të progresit të përcaktuar në nivel të brendshëm, një parashikim i bazuar në prova i kursimeve të energjisë dhe përfitimeve më të gjera, dhe kontributet në pikësynimet e BE-së për efikasitetin e energjisë, sipas Direktivës 2012/27/BE, në përputhje me nenin 2a të Direktivës 2010/31/BE;

Bazuar në nenin 4 të Direktivës 2012/27/BE për efikasitetin e energjisë në rinovimin e ndërtesave, Shqipëria nuk e ka përfunduar ende strategjinë për mbështetjen edhe inkurajimin e investimeve me kosto efektive në rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave. Objektivi është të zhvillohet strategjia për mobilizimin e investimeve në rinovimin e ndërtesave, në përputhje me kërkesat e nenit 2a të Direktivës 2010/31/BE për strategjinë afatgjatë të rinovimit.

Referuar Ligjit për performancën e energjisë së ndërtesave (që transponon Direktivën 2010/31/BE), ai planifikohet të krijojë një plan kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me “performancë energjike thuajse zero”, duke rritur performancën e energjisë së ndërtesave private dhe publike.

(4) Sipërfaqja totale e kateve që do të rinovohet ose kursimet vjetore të barasvlershme të energjisë që duhet të arrihen nga 2021 deri në 2030 në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2012/27/BE për rolin ekzemplar të ndërtesave që strehojnë organe publike;

PKVEE i 2-të dhe i 3-të përcakton një objektiv për shkallën e rinovimit dhe masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë për ndërtesat publike:

Deri në vitin 2020, parashikimi vjetor është si më poshtë:

- Rinovimi me 2% në vit i stokut të ndërtesave publike, duke mundësuar hapësira të ngrohura/ftohura për ndërtesat nën administrim ose përdorim nga autoritetet/institucionet publike për të përmbushur kërkesat minimale të performancës së energjisë.

Deri në vitin 2022, pritet të merren masat e mëposhtme:

- izolim termik me efikasitet të lartë në ndërtesa
- duhet të jepen edhe kredi të buta, si dhe stimuj të tjerë financiarë.

Të dhënat e disponueshme për stokun e ndërtesave publike nuk mjaftojnë dhe duhet të shtjellohen më tej. Informacioni duhet të jetë më i hollësishëm për të përcaktuar totalin e sipërfaqes që duhet të rinovohet dhe nivelin e efikasitetit të energjisë që duhet të arrihet.

Në përgjithësi, sfidat kryesore që duhet të trajtohen janë:

- AKEE duhet të ketë stafin e mjaftueshëm për të menaxhuar të gjitha problemet lidhur me EE-në, PKVEE-në dhe zbatimin e ligjeve “Për performancën e energjisë në ndërtesa”/“Për efikasitetin e energjisë”;
- Duhet të bëhet i disponueshëm legjislacioni primar dhe sekondar për performancën e energjisë në ndërtesa;
- Pyetësorët për buxhetin;
- Audituesit e energjisë dhe certifikimi i audituesve të parë të efikasitetit të energjisë. AKEE ka testuar kandidatët më 21 maj 2020 dhe 26 ekspertët janë certifikuar tashmë si auditues të energjisë në ndërtesa dhe në procese. Audituesit për EE-në do të nisnin punën në varësi të llojit të certifikatës. Duhet të përcaktohet një plan veprimi për të identifikuar detyrat dhe rezultatet e parashikuara.

2.2.2 Strategjia afatgjatë e rinovimit për stokun kombëtar të ndërtesave

Strategjia për rinovimin e stokut të ndërtesave sipas nenit 2, germa “a”, të Direktivës 2021/31/BE nuk është ende e disponueshme. Megjithatë, puna për strategjinë afatgjatë të rinovimit ka nisur në kuadër të projektit SLED¹⁵.

Objektivi i projektit SLED ishte që të jepte informacione mbështetëse për modelimin sektorial të stokut të ndërtesave publike në Shqipëri. Një element kyç i projektit ishte zhvillimi i tipologjisë së parë të ndërtesave publike për Shqipërinë, duke përfshirë tregues të tillë si energjia e lëvruar për burim energjie, energjia primare dhe shkarkimet e dyoksidit të karbonit për ngrohje, ujën e ngrohtë për përdorim në banesa dhe ftohjen. U përcaktuan edhe opsione të ndryshme rinovimi, si dhe kursimet rezultuese të energjisë. Kostot e investimeve specifike janë paraqitur gjithashtu në varësi të llojit të ndërtesës dhe monetizimi i përfitimeve të tjera të tilla si komoditeti termik, shkarkimet e parandaluara të dyoksidit të karbonit, ndikimet ekonomike të parandaluara të ndotësve atmosferikë, ndikimet në punësim dhe zhvillimi ekonomik.

2.2.3 Objektiva të tjerë kombëtarë dhe strategji afatgjata

Ngrohja dhe ftohja

Nuk ka objektiva të tjerë kombëtarë Nuk ka strategji afatgjata për ngrohjen dhe ftohjen.

Sektori i transportit

Strategjia sektoriale e transportit në Shqipëri – Strategjia Finale dhe Plani i Veprimit, VKM Nr. 811, datë 16.11.2016

Plani për Transportin e Qëndrueshëm (06/02/2016) është një dokument kyç (ende projekt-dokument) që i vjen në ndihmë MIE-së për arritjen e kursimeve të pritshme të energjisë për sektorin e transportit në Shqipëri. Megjithatë, horizonti i planifikimit për zbatimin e Planit për Transportin e Qëndrueshëm (PTQ) ishte periudha 2016 – 2020.

2.3 Dimensioni i sigurisë së energjisë

¹⁵ Tipologjia e stokut të ndërtesave publike në Shqipëri dhe modeli i shndërrimit të tyre për shkarkime të ulëta karboni në të ardhmen (2017). Përkrahje për Zhvillimin me Shkarkime të Ulëta (SLED) në Evropën Juglindore (SEE)

2.3.1 Elementet e përcaktuara në pikën “c” të nenit 4

Objektivi i sigurisë energjetike është të garantojë një furnizim afatgjatë, të sigurt dhe cilësor për të gjitha sistemet e prodhimit dhe furnizimit të energjisë. Siguria nënkupton që energjia duhet të jetë e qëndrueshme, e aksesueshme, e përbalueshme dhe e pranueshme në proporcion me zhvillimin e vendit. Për ta arritur këtë objektiv, qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, si strategji e përgjithshme e sektorit energjetik.

Objektivat e sigurisë kombëtare të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe që janë të vlefshme në kuadrin e PKEK-ut lidhur me sigurinë energjetike, janë:

- Shtimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve primare të energjisë në nivel kombëtar, në mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese. Për ta arritur këtë objektiv, është e nevojshme të kryhet një planifikim integral dhe sistematik për furnizimin e të gjithë produkteve dhe formave të prodhimit të energjisë.
- Krijimi i burimeve të ndryshme të furnizimit përmes investimeve të reja, përforsimi i bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhja me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me *Acquis* e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
- Përmirësimi i sigurisë së transmetimit dhe furnizimit të energjisë përmes diversifikimit të rrugëve të furnizimit dhe përmirësimi i sigurisë dhe besueshmërisë së tyre përmes investimeve kosto-efikase. Rritja e sigurisë së furnizimit me energji me kosto të përbalueshme për qytetarët dhe për ekonominë e Shqipërisë.
- Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane. Bashkimi i tregut të energjisë në përputhje me angazhimet e bëra sipas të ashtuquajturit Procesi i Berlinit.
- Siguria e furnizimit me energji bazohet në tregje konkurruese të energjisë, që funksionojnë mirë, dhe që ofrojnë mundësitë e duhura për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit dhe një politikë afatgjatë për energjinë, që nxit investimet.
- Shtimi i kapaciteteve të gazit, naftës dhe energjisë në sistemin energjetik në përputhje me Direktivën 2009/119/KE, datë 14 shtator 2009, duke vendosur detyrimin për ruajtjen e stokut minimal të produkteve.
- Arritja e objektivave të vendit për burimet e rinovueshme të energjisë, eficientë të energjisë, reduktimin e intensitetit energjetik të PBB-së dhe zhvillimin e politikave dhe strategjive kosto-efikase për përmirësimin e performancës së energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale, pritet të ketë një efekt stabilizues në sigurinë e furnizimit.
- Krijimi i një kuadri politikash për energjinë (duke përfshirë politika për eficientë të energjisë për transportin e qëndrueshëm) në fushën e transportit, duke u bazuar në Strategjinë sektoriale të transportit në Shqipëri dhe futja e teknologjive të reja në të gjithë sektorët e tij pritet të ketë një efekt stabilizues në sigurinë e furnizimit, duke reduktuar sasinë e importeve të naftës dhe benzinës.
- Transporti rrugor do të zëvendësohet nga modalitete të tjera transporti, të tilla si transporti hekurudhor apo ujor. Arritja e këtij objektivi do të kontribuojë në reduktimin e konsumit të lëndëve djegëse.
- Rinovimi i industrisë së naftës dhe benzinës dhe i infrastrukturës së furnizimit, sistemeve të kontrollit të cilësisë dhe futja e teknologjive të reja në sektorin e naftës.
- Planifikimi i kërkimit të rezervave të naftës në vend dhe krijimi i stokut të rezervave/sigurisë kombëtare.

Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë, u miratua me VKM Nr. 87, datë 14.02.2018. Ky plan ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të gazit natyror që mundëson një kontribut të ekuilibruar në sistemin e energjisë dhe sigurimin e furnizimit me gaz përmes konkurrencës dhe mbrojtjes së mjedisit. Nevojitet një sistem krejtësisht i ri për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit.

Master plani identifikon objektivat dhe projektet e mëposhtme për gazin, të cilat janë të vlefshme në kuadër të PKEK-ut:

Master Plan i Gazit Natyror parashtron pikat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri, në bazë të gazit natyror të furnizuar përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik (projekti TAP), si dhe për burimet potenciale të gazit, që janë zbuluar dhe konkretizuar në vend ose edhe përmes gazsjellësve të gazit natyror, të tillë si Gazsjellësi Adriatiko-Jonian (projekti IAP) dhe Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë” (projekti ALKOGAP). Shqipëria ka për qëllim të krijojë një depozitë nëntokësore për gazin natyror në zonën e Dumresë, pranë Elbasanit (Projekti Dumrea UGS).

Ndërtimi i gazsjellësit, që do të lidhë projektin TAP pranë Stacionit të kompresorit në Fier me TEC-in e Vlorës dhe të gjithë qarkun e Vlorës, do të bëjë të mundur restaurimin e TEC-it të Vlorës përmes përdorimit të gazit natyror si lëndë djegëse.

Në vitin 2040, konsumi potencial i gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të jetë rreth 770 milionë m³, ndërsa konsumi i parashikuar në rafineritë e vendit mund të jetë rreth 89,2 milionë m³.

Vizioni, objektivat strategjikë dhe projektet e qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit të gazit deri në vitin 2040:

- Krijimi i një klime të favorshme të investimeve, për investimet në sistemin kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit dhe integrimi në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare. Projekti TAP paraqet një mundësi për të bërë të mundur në një shkallë më të madhe konsumin e gazit natyror për familjet, duke krijuar një treg gazi dhe duke shtuar investimet e reja në infrastrukturën e gazit. Zbatimi i "Studimit të fizibilitetit" duhet të jetë prioritar, i ndjekur nga dizajnimi i detajuar dhe krijimi i rrjetit kombëtar për shpërndarjen e gazit, duke përfshirë shtyllat strategjike dhe lidhjen me rrjetet rajonale të gazit;
- Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm, si p.sh., sistemet e tarifave, kodet e rrjeteve, rregullat e furnizimit dhe kodi i tregut në përputhje me *Acquis Communautaire*;
- Krijimi dhe funksionimi i tregut të gazit në përputhje me standardet e BE-së, siç është përcaktuar në Paketën e Tretë të Energjisë të BE-së.
- Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe performancës së rrjetit ekzistues të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit me përfshirjen e shoqërisë në pronësi të shtetit (ALBGAS sh.a.) dhe të shoqërive private të specializuara, përmes një sistemi menaxhimi të asetëve ekzistuese dhe të atyre që do të krijohen gjatë zbatimit të Master Planit. Me përparësi: Rijetësimi i rrjetit ekzistues të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit, që administrohet aktualisht nga shoqëria ALBGAS sh.a., e cila funksionon si operator i kombinuar;
- Me përparësi: Masat parandaluese dhe plani i veprimt për të përmirësuar sigurinë dhe për të zbutur rreziqet e mundshme në rrjetin ekzistues dhe në atë që do të ndërtohet, duke përdorur dhe zbatuar standarde teknike dhe kode për sektorin e gazit, të cilat janë në përputhje me standardet dhe kodet përkatëse të vendeve të BE-së.

2.3.2 Objektivat kombëtare lidhur me diversifikimin dhe fleksibilitetin

Strategjia Kombëtare e Energjisë parashikon nxitjen diversifikimit të përshtatshëm të prodhimit të energjisë përmes investimeve të reja, përforcimin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me *Acquis* e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Në sektorin e energjisë elektrike, Shqipëria varet thuajse ekskluzivisht nga energjia hidrike. Shtimi i BRE-ve, të ndryshme nga energjia hidrike, në strukturën e produkteve të përdorura për prodhimin e energjisë, do të kontribuojë për të reduktuar varësinë nga burimet ujore.

Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike me atë të Kosovës do të intensifikojë diversifikimin e burimeve të energjisë elektrike, pasi kapaciteti hidrik i Shqipërisë është pothuajse 100% (i ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme hidrologjike) ndërsa Kosova ka pothuajse 100% kapacitet termik.

Bashkimi i këtyre dy sistemeve, duke kombinuar prodhimin do të përmirësojë sigurinë e furnizimit përmes përdorimit më efikas të kapaciteteve të linjave ekzistuese të interkoneksionit dhe sinjaleve të tarifave.

Ndërtimi i gazjellësit TAP dhe objektivi përkatës i krijimit të një tregu gazi rajonal pritet të kontribuojë në diversifikimin e burimeve të energjisë. Furnizimi me gaz i termocentralit ekzistues të Vlorës do të kontribuojë në shtimin e diversitetit të burimeve të energjisë.

Pritet që objektivat e biokarburanteve prej 10%, si përqindje e biokarburanteve, përkundrejt konsumit total të lëndëve djegëse në sektorin e transportit në vitin 2030, të kenë ndikim në diversifikimin e burimeve të energjisë në sektorin e transportit.

2.3.3 Objektivat kombëtare lidhur me reduktimin e varësisë ndaj importeve të energjisë

Objektivat kryesore janë:

- reduktimi i varësisë ndaj importeve të energjisë elektrike
- reduktimi i varësisë ndaj importeve të produkteve naftës

Sektori i energjisë elektrike:

Zgjerimi i kapacitetit të ri prodhues në të ardhmen: disa HEC-e të mëdha, të tilla si kaskada mbi lumin Devoll, Kaskada mbi lumin Fan, disa impiante që janë në ndërtim e sipër, si p.sh., impiante fotovoltaike etj., do të kontribuojnë gjithashtu në reduktimin e varësisë ndaj importeve të energjisë.

Sektori i gazit:

Krijimi dhe funksionimi i tregut të gazit dhe krijimi i një klime të favorshme të investimeve, për investimet në sistemin kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit dhe integrimi në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare do të kontribuojë në reduktimin e varësisë ndaj importeve të energjisë dhe në fleksibilitetin e sistemeve kombëtare të energjisë. Furnizimi me gaz i termocentralit ekzistues të Vlorës dhe TEC-i i planifikuar në Korçë do të kontribuojë në reduktimin e sasisë së importeve të energjisë dhe rritjen e diversitetit të burimeve të energjisë.

Sektori i naftës:

Shqipëria është bërë tejet e varur nga produktet e importuara të naftës për shkak të prodhimit në rënie të saj, në kombinim me një kërkesë të jashtëzakonshme në rritje për benzinë, naftë dizel dhe lëndë djegëse të lëngët të rëndë. Sektori i transportit ishte konsumatori më i madh i energjisë. Ai përbënte rreth 40% të totalit të konsumit final (2013). Duke marrë parasysh faktin që Shqipëria vlerësohet si një nga vendet më të pasura të Evropës në rezervat hidrokarbure, nuk janë ndërmarrë shumë masa për rritjen e produktivitetit dhe për përmirësimet teknologjike, të cilat rrjedhimisht janë integruar në PKEK.

Objektivi për të zëvendësuar transportin rrugor ekzistues me modalitete të tjera transporti, të tilla si transporti hekurudhor apo ujor do të kontribuojë për të reduktuar konsumin e lëndëve djegëse.

Objektivi i ndarjes së përqindjes së biokarburanteve kundrejt totalit të konsumit të lëndëve djegëse në sektorin e transportit: 10% në vitin 2020, 10% në vitin 2025 dhe 10% në vitin 2030 në krahasim me 3,55% në vitin 2015 do të kontribuojë gjithashtu në reduktimin e konsumit të lëndëve djegëse në sektorin e transportit.

2.3.4 Objektivat kombëtare lidhur me rritjen e fleksibilitetit

Objektivat kombëtare për vitin 2030 lidhur me rritjen e kontribuimit të burimeve primare energjetike, shtimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, shtimin e penetrimit të gazit natyror, zhvillimin e burimeve të ndryshme të furnizimit përmes investimeve të reja, përforsimin e bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhjen me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe gazit natyror me Kosovën, përmirësimin e sigurisë së transmetimit dhe furnizimit të energjisë përmes diversifikimit të rrugëve të furnizimit dhe përmirësimin e sigurisë dhe besueshmërisë së tyre përmes investimeve kosto-efikase, do të rrisë fleksibilitetin e sistemit kombëtar të energjisë.

Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë, u miratua me VKM Nr. 87, datë 14.02.2018 dhe ka për qëllim të zhvillojë një sistem të qëndrueshëm të gazit natyror, që mundëson një kontribut të ekuilibruar në sistemin energjetik dhe sigurimin e furnizimit me gaz përmes konkurrencës dhe mbrojtjes së mjedisit. Nevojitet një sistem krejtësisht i ri për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit. Në vitin 2040, konsumi potencial i gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të jetë rreth 770 milionë m³, ndërsa konsumi i parashikuar në rafineritë e vendit mund të jetë rreth 89,2 milionë m³. Projektet me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit Natyror për Shqipërinë përshkruhen në kreun 3 të projekt-dokumentit të PKEK-ut.

Zgjerimi i kapacitetit të ri prodhues në të ardhmen: disa HEC-e të mëdha, të tilla si kaskada mbi lumin Devoll, Kaskada mbi lumin Fan, disa impiante që janë në ndërtim e sipër, dy termocentrale të reja në Korçë, Kuçovë etj., do të kontribuojnë gjithashtu në rritjen e fleksibilitetit të sistemit kombëtar të energjisë.

2.4 Dimensioi i tregut të brendshëm të energjisë

Objektivi i tregut të brendshëm të energjisë është që të harmonizojë dhe liberalizojë tregun e brendshëm të energjisë në vend, të adresojë qasjen në treg, transparencën dhe rregulloret, mbrojtjen e konsumatorit, duke mbështetur interkoneksionin dhe nivelet e duhura të furnizimit.

Qëllimi është që të krijohet një treg i energjisë elektrike më konkurrues, me në qendër konsumatorin, fleksibël dhe jo diskriminues, me çmime furnizimi të bazuara në treg. Duke vepruar kështu, ato do të përforcojnë dhe zgjerojnë të drejtat e konsumatorëve individualë dhe të komuniteteve të energjisë, do të trajtojnë varfërinë energjetike, do të qartësojnë detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve të tregut dhe subjekteve rregullatore, si dhe do të trajtojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike, gaz dhe naftë edhe krijimin e rrjeteve rajonale dhe evropiane për transportin e energjisë elektrike dhe gazit.

Për ta arritur këtë qëllim, qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, si strategji e përgjithshme e sektorit energjetik, në të cilën objektivat në lidhje me dimensionin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike janë:

- 1.- Hapja 100% e tregut të energjisë elektrike në vitin 2025
- 2.- Arkëtimi i vlerave monetare= nga shitja e energjisë elektrike: 92% në vitin 2020, 95% në vitin 2025 dhe 98% në vitin 2030 në krahasim me 90% në vitin 2018
- 3.- Krijimi i burimeve të ndryshme të furnizimit, përforsimi i bashkëpunimit dhe integritit rajonal dhe ndërlidhja me rrjetet evropiane dhe rajonale të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në përputhje me *Acquis* e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

4.- Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane. Bashkimi i tregut të energjisë në përputhje me angazhimet e bëra sipas të ashtuquajturit Procesi i Berlinit.

5.- Tregjet konkurruese të energjisë, që funksionojnë mirë, dhe që ofrojnë mundësitë e duhura për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit.

6.- Shtimi i kapaciteteve të gazit, naftës dhe energjisë në sistemin energjetik në përputhje me Direktivën 2009/119/KE, datë 14 shtator 2009, duke vendosur detyrimin për ruajtjen e stokut minimal të produkteve.

7.- Hartimi i planeve për krijimin e tregut shqiptar të gazit dhe integrimin rajonal të tij, si dhe hartimi i planeve për shitjen, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të gazit natyror nga TAP-i dhe burimet e tjera të gazit. Zbatimi i reformave të tregut, që janë të nevojshme për të respektuar *Acquis* e Komunitetit të Energjisë.

8.- Konsolidimi dhe forcimi i mëtejshëm i ALBGAS s.a., në cilësinë e operatorit të kombinuar të sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes së gazit.

Objektivat e gazit natyror në lidhje me tregun e brendshëm të energjisë elektrike, siç përcaktohen në Master Planin e sektorit të gazit natyror të Shqipërisë, për periudhën 2020-2040 janë:

- Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm, si p.sh., sistemet e tarifave, kodet e rrjeteve, rregullat e furnizimit dhe kodi i tregut në përputhje me *Acquis Communautaire*;
- Krijimi dhe funksionimi i tregut të gazit në përputhje me standardet e BE-së, siç është përcaktuar në Paketën e Tretë të Energjisë të BE-së.
- Krijimi i një baze të dhënash për rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe krijimi i depozitave nëntokësore për gazin ose i terminaleve të GNL-së të operatorëve të tregut, të cilat do të bëjnë të mundur monitorimin gjithëpërfshirës të të gjitha aktivitetëve në sektorin e gazit.

2.4.1 Interkoneksioni i energjisë elektrike

Integrimi në tregjet e energjisë, në nivel rajonal dhe BE-je, është një objektiv strategjik i qeverisë Shqiptare për të përmbushur kërkesën e saj në rritje për energji, diversitet të burimeve të energjisë, efikasitet dhe fleksibilitet të sistemit kombëtar të energjisë, Për ta arritur këtë objektiv, Shqipëria duhet të investojë në infrastrukturën e interkoneksionit të energjisë elektrike.

Shqipëria ka infrastrukturë interkoneksioni me Kosovën, Malin e Zi dhe Greqinë përmes gjashtë linjave të interkoneksionit:

- Linja 400 kV Zemblak - Kardia (Greqi)
- Linja 400 kV Tirana 2 - Podgoricë (Mali i zi)
- Linja 400 kV Tirana2 - Kosova B (Kosovë)
- Linja 220 kV Koplík - Podgoricë (Mali i zi)
- Linja 220 kV Fierzë - Prishtinë (Kosovë)
- Linja 150 kV Bistrica 1 - Igumenicë (Greqi).

Analiza në kreun 4 tregon se sistemi i energjisë elektrike nga burimet hidrike të Shqipërisë pritet të pësojë mungesa në vitet me klimë të thatë. Kjo gjë nënkupton se pritet rritje e kapacitetit të shkëmbimit me sistemet e vendeve fqinje në të ardhmen e afërt dhe nevoja për investime për forcimin dhe zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit është e dukshme. Zhvillimi i projekteve të reja do të bazohet në konsideratat teknike dhe ekonomike, si dhe në analizën e kosto-përfitimeve në përputhje me metodologjinë e ENTSO-E.

Forcimi dhe zhvillimi i rrjetit të interkoneksionit do të krijojë kushte më të favorshme teknike për të zhvilluar një treg të integruar të energjisë elektrike në rajon dhe për të ndihmuar sektorin e energjisë elektrike të vendit të vijojë me transformimin drejt një tregu më konkurrues, ndërkohë që harmonizohet me nismën dhe objektivat e Paketës së Tretë të Energjisë. Në kuadër të fokusit të Paketës së Tretë të

Energjisë, integrimi i tregut në nivel ndërkufitar është një hap thelbësor drejt një tregu energjetik rajonal dhe mbarë-evropian.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 parashikon:

- Përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike me *Acquis* e BE-së dhe përmbushjen e detyrimeve të Paketës së Tretë të Energjisë.
- Ndërtimin e një linje të re interkoneksioni 400 kV Elbasan (Shqipëri) - Manastir (Maqedoni e Veriut). Projekti përfshin ndërtimin e një linje të re transmetimi 400 kv Elbasan - Ohër – Manastir prej 151 km (56 km në territorin e Shqipërisë), zgjerimin e nënstacionit Elbasan 2 dhe instalimi i një shunt-reaktori 120 MVar, ndërtimin e një linje të re 400 kV prej 68 km nga Elbasan 2- Fier dhe zgjerimin e nënstacionit të Fierit me 1 autotransformator të ri 400 MVA.

Në planin e zhvillimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit parashikohet edhe zhvillimi i rrjetit ekzistues 400kV përmes mbylljes së unazës 400kV ndërmjet Shqipërisë – Maqedonisë së Veriut–Greqisë, e cila do të sjellë përfitimet e mëposhtme:

- përmirësimin e kapacitetit të rrjetit për të lehtësuar intensifikimin e ngarkesës së parashikuar dhe transitin, koneksionet e reja të prodhimit në kuadër të përmirësimit të kapacitetit të transmetimit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe në rajonin e Ballkanit në përgjithësi,
- përmirësimin e besueshmërisë së rrjetit rajonal, të sigurisë së përgjithshme të furnizimit dhe të fleksibilitetit në funksion të sistemit të energjisë elektrike,
- reduktimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit,
- eliminimin e mbingarkesës në unazën kombëtare 220 kV.
- përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike (normalizimi i niveleve të tensionit, stabilizimi i fluksit të ngarkesës dhe të luhatjeve të frekuencave etj.),
- mbështetjen e potencialit për zhvillimin e një tregu rajonal të energjisë në Evropën juglindore dhe krijimin e mundësive të tregtimit me Bullgarinë dhe Italinë,
- mbështetjen e përbashkët ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë për shkak të llojeve plotësuese të prodhimit (Shqipëria– hidrik, Maqedonia e Veriut – termik),
- reduktimin e kostos së ofrimit të kapacitetit të rezervave dhe ofrimin e mbështetjes së ndërsjellë në raste emergjence.

Aksesi i palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe parashikimet lidhur me menaxhimin e kongjestionit në linjat ndërkufitare janë në përputhje me tërësinë e legjislacionit të BE. Kapacitetet ndërkufitare të transmetimit në kufijtë me Malin e Zi dhe Greqinë alokohen përmes platformës rajonale të koordinuar të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore në Mal të Zi (SEE CAO).

Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Energjisë Elektrike të Kosovës, KOSTT, kanë nënshkruar një marrëveshje për krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë elektrike si dy vende fqinje. Marrëveshja është në përputhje me rregulloret e reja të ENTSO-E, që kanë për qëllim nxitjen e bashkëpunimit të OST-ve për sa i përket operacioneve të sigurta të sistemeve të energjisë dhe reduktimit të kostove.

Rezultatet e skenarit të tregut të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë tregojnë se ka potencial të konsiderueshëm për shfrytëzimin më të mirë të kapacitetit transmetues ndërkufitar dhe për rritjen e mirëqenies përmes optimizimit të tregut të operimit të burimeve të energjisë termike në Kosovë dhe të burimeve hidrike në Shqipëri (përkatësisht, kaskada e lumit Drin), si dhe duke shkëmbyer kërkesat e rezervës balancuese.

2.4.2 Infrastruktura e transmetimit të energjisë

Infrastruktura e transmetimit të energjisë elektrike

Objektivat kryesorë për infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike janë:

- Reduktimi me 1,7% i humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike deri në vitin 2030.

- Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit të transmetimit dhe i sigurisë së furnizimit me energji elektrike
- Përmirësimi i besueshmërisë së rrjetit të komunikimit dhe i sistemit të monitorimit dhe kontrollit në distancë për të forcuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike
- Zhvillimi i rrjetit për të përmbushur kërkesën në rritje për kapacitetin e transmetimit nga konsumatorët industrialë dhe/ose prodhimi hidrik
- Integrimi i përshpejtuar i BRE-ve të ndryshueshme në sistemin e energjisë dhe disponueshmëri më e madhe e rezervave minimale për të balancuar prodhimin e tyre
- Përfundimi brenda afatit i planeve të investimeve, në veçanti i investimeve kapitale, të cilat bëjnë të mundur integrimin e BRE-ve në sistemin e energjisë elektrike
- Mbështetja e transaksioneve të tregut në territorin e shtetit dhe në rajon, në mënyrë që rrjeti i transmetimit të mos përbëjë pengesë për konkurrencën
- Rijetësimi dhe zëvendësimi i njësisve të vjetra të rrjetit
- Shtimi i kapacitetit të transmetimit të linjave individuale, të planifikuara për rijetësim
- Zbatimi i teknologjive të reja në transmetim, nëse justifikohen nga pikëpamja teknike dhe ekonomike

Për shkak të karakteristikave klimatike, Shqipëria është veçanërisht e përshtatshme për zhvillimin e impianteve eolike dhe diellore, si dhe investitorët kanë interes të lartë në ndërtimin e impianteve të reja. Rrjeti ekzistues i transmetimit dhe kapaciteti i interkoneksionit me vendet fqinje janë përmirësuar për të bërë të mundur integrimin e instalimit të parashikuar të BRE-ve,

Projektet kryesore infrastrukturore që pritet të përmbushin objektivat e vitit 2030: shihni kreun 1.2.2-Dimensioni i Tregut të Energjisë.

Objektivat kryesore për infrastrukturën e transmetimit të gazit

Master plani i sektorit të gazit ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të gazit natyror që mundëson një kontribut të ekuilibruar në sistemin energjetik dhe sigurimin e furnizimit me gaz përmes konkurrencës dhe mbrojtjes së mjedisit. Nevojitet një sistem krejtësisht i ri për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit. Pritet edhe krijimi i një sistemi për depozitat e gazit.

Projektet kryesore infrastrukturore që pritet të përmbushin objektivat e vitit 2030: shihni kreun 1.2.2-Dimensioni i Tregut të Energjisë.

2.4.3 Integrimi në treg

Integrimi në tregjet e energjisë, në nivel rajonal dhe BE-je, është një ndër objektivat kryesore të Strategjisë Shqiptare Sektoriale të Energjisë, e cila thekson se siguria energjetike duhet të arrihet në bazë të diversifikimit, konsolidimit dhe besueshmërisë së burimeve të energjisë.

Parimet nga të cilat udhëhiqet Strategjia Shqiptare Sektoriale të Energjisë, janë në harmoni të plotë me parimet e Strategjisë së dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Për sa i përket elementeve të tjera lidhur me integrimin në treg, objektivat përfshijnë:

- Hapjen e plotë (100%) të tregut të energjisë elektrike në vitin 2025
- Diversifikimin e mëtejshëm të burimeve të furnizimit dhe interkoneksionin me rrjetet rajonale dhe evropiane të gazit dhe të energjisë elektrike
- Krijimin e një tregu konkurrues dhe të organizuar që ofron mundësitë e duhura për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke marrë në konsideratë ndikimin specifik të ndryshimeve klimatike në prodhimin kombëtar të energjisë elektrike
- Bashkimin e tregut të energjisë në përputhje me angazhimet e bëra sipas të ashtuquajturit Procesi i Berlinit.

2.4.4 Varfëria energjetike

Varfëria energjetike ende nuk është përcaktuar qartë dhe ende nuk monitorohet sistematikisht.¹⁶ Prandaj, një PaM specifike u integrua në plan.

¹⁶ Energy Poverty in South East Europe – Surviving the Cold. Programi Politik i Evropës Juglindore për Energjinë e Qëndrueshme (SEE SEP), 2016

2.5 Dimensioi i kërkimit, novacionit dhe konkurrueshmërisë

Ky dimension përfshin objektivin për ta transformuar Shqipërinë drejt një ekonomie më konkurruese, të nxitur nga novacioni dhe të bazuar në njohuri. Për këtë qëllim, janë zhvilluar instrumente politikash. Megjithatë, deri më tani nuk është vënë theksi te teknologjitë e pastra të energjisë dhe te teknologjitë me shkarkime të ulëta karboni.

Në përgjithësi, objektivi përfundimtar është që shpenzimet vjetore publike për kërkim shkencor dhe novacion të arrijnë në total 2% të PBB-së deri në vitin 2022 dhe që ky nivel shpenzimesh të ruhet edhe në të ardhmen.

Për periudhën 2020-2022, objektivi për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor është parashikuar si më poshtë:

- Rritje me 10%-15% në vit e numrit të aplikimeve për programet dypalëshe dhe programit Horizon 2020, si dhe për programet e ERASMUS+;
- Financim i punëve kërkimore shkencore për 3,500-4,000 studiues në vit në IAL-të publike për periudhën 2019-2022;
- Fondet e ekselencës dhe novacionit të arrijnë 1% të PBB-së deri në vitin 2020.

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Buxheti i shtetit Lekë (x 1000 Lekë)	6.562.117	7.204.009	7.354.958	9.730.000	9.796.000	11.696.000
PBB (x miliardë Lekë)	1.551,3	1.630,9	1.688,9	1.777,2	1.879,8	1.990,2
% PBB	0.42%	0.44%	0.44%	0.55%	0.52%	0.59%

Tabela 10: Buxheti për Arsimin e Lartë

Më shumë informacion për Kërkimin, Zhvillimin dhe Novacionin mund të gjendet në VKM Nr. 710, datë 1.12.2017, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin", faqja 14.

3 POLITIKAT DHE MASAT

Politikat dhe masat (PaM) për skenarin me PaM ekzistues dhe skenarin me PaM shtesë

Politikat dhe masat e paraqitura më poshtë identifikohen në bazë të përkufizimeve të dhëna në nenin 2 të Rregullores “Për qeverisjen”:

- **“politikat dhe masat”** janë të gjitha instrumentet që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të planeve të integruara kombëtare për energjinë dhe klimën [...]
- **“politikat dhe masat ekzistuese”** janë politikat dhe masat e zbatuara dhe ato të miratuara;
 - “politikat dhe masat e zbatuara” janë politikat dhe masat për të cilat në datën e dorëzimit të planit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës ose të progresraportit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës vlen një ose disa nga sa në vijim: ka në fuqi ligje kombëtare ose në nivel BE-je drejtpërdrejt të zbatueshme, janë përgatitur një ose disa marrëveshje vullnetare, janë caktuar burime financiare, janë mobilizuar burime njerëzore;
 - “politikat dhe masat e miratuara” janë politikat dhe masat për të cilat deri në datën e dorëzimit të planit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës ose të progresraportit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës është nxjerrë një vendim zyrtar qeveritar dhe ka një angazhim të qartë lidhur me vazhdimin e zbatimit;
- **“politikat dhe masat e planifikuara”** janë alternativat në diskutim të cilat kanë realisht gjasa për t’u miratuar dhe për t’u zbatuar pas datës së dorëzimit të planit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës ose të progresraportit të integruar kombëtar të energjisë dhe klimës;

PaM u caktohen skenarëve me PaM ekzistues (skenar WEM) dhe me PaM shtesë (skenar WAM), ku këta të fundit u referohen politikave e masave të planifikuara dhe politikave e masave të reja të cilat kanë realisht gjasa për t’u zbatuar. Modelimi i skenarëve është dokumentuar në kreun 4.

Analiza që rezulton në PaM të reja

Analiza e objektivave konfliktuese dhe sfidave të tjera të identifikuara gjatë punës ka sjellë zhvillimin e PaM-ve të reja të cilat synojnë trajtimin e këtyre çështjeve. PaM të reja që kanë realisht gjasa për t’u zbatuar konsiderohen si pjesë e skenarit WAM, edhe pse janë ende në fazë përgatitore:

- Sistemet e menaxhimit të kërkesës dhe akumulimit të energjisë për fleksibilitetin e rrjetit elektrik R-E6
- Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa EE-L5
- Eliminimi i varfërisë energjetike EM-P1

Harmonizimi i PaM të PKEK-së dhe atyre të KK-së

Për harmonizimin e përgatitjes së PKEK-së dhe KK-së janë bërë përpjekje të konsiderueshme. Pavarësisht zhvillimit të mbledhjeve paraprake koordinuese, në praktikë ka pasur sfida të konsiderueshme për shkak se ekipet dhe afatet kohore të zbatuara për PKEK dhe KK nuk kanë qenë të njëjta. Disponueshmëria dhe transparenca e të dhënave përbënte një tjetër sfidë madhore. Megjithatë, me krijimin e draftit të PKEK-së, është mundur krijimi i një baze transparente të dhënash për përditësimet e ardhshme.

Burimet e PaM-ve

Politikat dhe masat u hartuan në bazë të politikave dhe strategjive të prezantuara në kreun 1, në bazë të studimeve të kryera, si ai SLED, si dhe në bazë të shembujve të praktikave të mira.

Përshkrimi i PaM-ve

Në tabelën e mëposhtme tregohet një përmbledhje e politikave dhe masave kyçe që ndikojnë në objektivin kombëtar klimatik deri në vitin 2030 e në vazhdim.

Përshkrimet e hollësishme gjenden në pjesën e nënkrerëve, sipas dimensionit.

Dimensioni	Nr.	Kodi PaM	Emri i PaM	Lloji i PaM	Caktuar në skenarin
Dekarbonizimi/emetimet dhe eliminimi i GES-ve	1 (1)	G-T1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra urbanë	Rregullator	WAM
	2 (2)	G-T2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave	Rregullator	WAM
	3 (3)	G-T3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës	Rregullator; Fiskal	WEM
	4 (4)	G-B1	Politikat për mbështetjen e BRE për ngrohjen dhe ftohjen	Rregullator; Financiar; Edukativ	WEM
	5 (5)	G-I1	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	Rregullator; Edukativ	WAM
	6 (6)	G-I2	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së	Rregullator	WAM
	7 (7)	G-A1	Promovimi i bujqësisë organike	Rregullator; Financiar	WEM
	8 (8)	G-A2	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri	Rregullator	WAM
	9 (9)	G-A3	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi	Rregullator	WEM
	10 (10)	G-W1	Reduktimi i emetimeve nga mbetjet	Rregullator; Financiar	WEM
	11 (11)	G-W2	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri	Rregullator; Financiar	WEM
	12 (12)	G-W3	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	Rregullator; Financiar	WEM
	13 (13)	G-LF1	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave	Rregullator; Financiar	WAM
	14 (14)	G-LF2	Menaxhimi ekologjik i pyjeve	Rregullator; Financiar	WAM
Energjitë e rinovueshme	1 (15)	R-E1	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla të rinovueshme	Rregullator; Financiar	WEM dhe WAM
	2 (16)	R-E2	Ankandet për kapacitetet e reja të rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë	Rregullator; Financiar	WEM dhe WAM
	3 (17)	R-E3	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW	Rregullator	WEM
	4 (18)	R-E4	Rrjetet i fuqishëm elektrik për t’iu përgjigjur kapacitetit në rritje të energjisë së rinovueshme	Financiar	WEM
	5 (19)	R-E5	Lehtësimi i marrëdhënies rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik.	Rregullator	WEM
	6 (20)	R-E6	Sistemet e menaxhimit të kërkesës dhe akumulimit të energjisë për fleksibilitetin e rrjetit elektrik	Rregullator	WAM
	7 (21)	R-E7	Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit energjetik	Rregullator	WEM

	8 (22)	R-T1	Elektrifikimi i sektorit të transportit	Rregullator	WAM
	9 (23)	R-T2	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	Rregullator; Fiskal	WAM
	10 (24)	R-II	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor	Investues; Financiar; Informativ; Edukativ	WAM
Eficienca e energjisë	1 (25)	EE-O1	Skema detyruese e efijencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Rregullator	WAM
	2 (26)	EE-L1	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	Rregullator	WAM
	3 (27)	EE-L2	Strategjia afatgjatë e rinovimit (<i>për ndërtesat publike dhe private</i>)	Rregullator; Financiar; Informativ	WAM
	4 (28)	EE-L3	Rikonstruksioni i ndërtesës ekzistuese të qeverisë qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)	Investues; Rregullator	WAM
	5 (29)	EE-L4	Rikonstruksioni i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisjes qendrore)	Investues; Rregullator	WAM
	6 (30)	EE-L5	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa (sektori privat)	Financiare; Fiskale	WAM
	7 (31)	EE-S1	Adoptimi i modeleve ESCO	Rregullator; Financiar	WAM
	8 (32)	EE-P1	Masat për efijencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	Rregullator	WAM
	9 (33)	EE-P2	Planet bashkiake të veprimit për efijencën e energjisë, zbatimi dhe raportimi	Rregullator, Edukativ	WAM
	10 (34)	EE-E1	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	Rregullator; Organizativ	WAM
	11 (35)	EE-E2	Sistemet e menaxhimit të energjisë për NMV-të	Rregullator; Organizativ	WAM
	12 (36)	EE-C1	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	Rregullator; Informues	WAM
	13 (37)	EE-T1	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	Informues; Edukativ	WAM
	14 (38)	EE-T2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të makinave.	Rregullator; Financiar; Fiskal	WAM
	15 (39)	EE-T3	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	Rregullator; Financiar; Fiskal	WEM
	16 (40)	EE-T4	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (rrugët, hekurudhat dhe rrugët detare)	Rregullator	WEM
Siguria energjetike	1 (41)	ES-P1	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	Rregullator	WEM
	2 (42)	ES-P2	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica	Rregullator; Financiar	WEM dhe WAM
	3 (43)	ES-O1	Kuadri i plotë ligjor për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët	Rregullator	WAM
	4 (44)	ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit	Rregullator; Financiar	WAM
	5 (45)	ES-O3	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit	Rregullator	WEM

	6 (46)	ES-O4	Shtimi i kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	Rregullator; Financiar	WEM
	7 (47)	ES-O5	Plani i emergjencës për gazin natyror	Rregullator; Financiar	WEM
	8 (48)	ES-O6	Miratimi i ligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”	Rregullator; Financiar	WEM
	9 (49)	ES-R1	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë	Rregullator; Financiar	WEM
Tregu i energjisë	1 (50)	EM-I1	Ndërlidhësit elektrikë	Rregullator; Financiar	WEM
	2 (51)	EM-I2	Reforma ne sektorin e energjisë elektrike	Rregullator	WEM
	3 (52)	EM-I3	Caktimi i një operatori BRE dhe transformimi i tarifave “feed-in”	Rregullator	WAM
	4 (53)	EM-P1	Eliminimi i varfërisë energjetike	Rregullator	WAM
Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca	1 (54)	RIC-E1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin energjetik	Rregullator; Informues; Edukativ; Financiar	WEM
	2 (55)	RIC-E2	Programi kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit	Financiar	WEM
	3 (56)	RIC-E3	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS)	Rregullator	WAM
	4 (57)	RIC-E4	Demonstrimi i novacionit dhe konkurrencës	Financiar	WAM

Tabela 11: Tabelë përmbledhëse e politikave kyçe që ndikojnë në objektivin kombëtar klimatik deri në vitin 2030

3.1 Dimensioni i dekarbonizimit

3.1.1 Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me këtë dimension renditen më poshtë:

1. Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”
2. Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”
3. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
4. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
5. Ligji nr. 9957, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar
6. Kontributet Kombëtare të Pikësnuara për Shqipërinë (INDC)
7. VKM nr. 418, datë 20.5.2020, “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Shqipëri, 2020–2035”
8. VKM nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020”
9. VKM nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”
10. VKM nr. 814, datë 31.12.2018, “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”
11. VKM nr. 633, datë 26.10.2018, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, e ndryshuar
12. VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”
13. VKM nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit, 2016–2020” (SSTPV)
14. VKM nr. 709, datë 29.10.2014, “Për miratimin e SNZHRB - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020”, e ndryshuar
15. Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”
16. Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri (2018)
17. Kontributet Kombëtare të Përcaktuara (versioni draft i vitit 2021)
18. Ligji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” (versioni draft)
19. Plani për Transportin e Qëndrueshëm (versioni draft)

3.1.2 Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

Sektori i transportit

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Transporti
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra urbanë (G-T1)	
Periudha kohore	2020 – në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit, 2016–2020”	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - Riorganizimi i linjave të transportit të udhëtarëve me autobus, në përputhje me Udhëzimin nr. 5628 të ministrit, datë 18.11.2016 - Krijimi i Task-Forcës në përputhje me VKM nr. 465, datë 26.07.2018, “Për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre” - Miratimi i rrjetit në përputhje me Udhëzimin nr. 5628 të ministrit, datë 18.11.2016, “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse” - Ndërtimi i 10 km korsi të dedikuara për biçikletat në Tiranë - Studimi i fizibilitetit dhe termat e referencës për koncesionin e terminalit të ri të udhëtarëve në Tiranë (Bashkia e Tiranës) - Përdorimi i taksive elektrike dhe autobusëve elektrikë për udhëtarët në Tiranë - Ndërtimi i terminalit të ri të udhëtarëve në portin e Vlorës dhe të Durrësit - Studimi “Mundësia e zhvillimit të transportit intermodal në Shqipëri” (Instituti i Transportit i Shqipërisë) 	
Objektivi kryesor i PaM	Objektivat kryesore janë: (i) përmirësimi i infrastrukturës së terminaleve të udhëtarëve; (ii) rritja e efikasitetit të rrjetit të autobusëve ekstra urbanë; dhe (iii) reduktim i shkarkimeve të CO ₂ të shkaktuara nga rrjeti i autobusëve ekstra urbanë.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e efikasitetit ekonomiko-financiar të operatorëve me 30-40% (brenda vitit) - Reduktimi i bllokimit të trafikut si rezultat i reduktimit të numrit të autobusëve në qarkullim në rrjetin rrugor kombëtar. <ul style="list-style-type: none"> o Reduktimi i nisjeve dhe mbërritjeve të autobusëve me 15-20% (brenda një viti) o Reduktimi i shkarkimeve të CO₂ me 15-20%, me reduktimin e autobusëve në qarkullim - Promovimi i transportit multimodal - Rritja e efikasitetit financiar të operatorëve të rrjetit ndërqytetës. - Rritja e besueshmërisë në transportin ndërqytetës - Reduktimi i intensitetit të energjisë në sektorin e transportit me 10%, si rezultat i menaxhimit të mirë - Përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së shërbimit në linjat ndërqytetëse - Reduktimi i nevojave për lëvizshmërinë dhe distancave me anë të planifikimit të integruar - Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe adoptimi i modaliteteve më efektive për trafikun - Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni si biokarburantet e qëndrueshme ose e energjisë elektrike të rinovueshme - Mundësia e kalimit nga modaliteti multimodal në atë intermodal të transportit - Krijimi i terminaleve të udhëtarëve 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Eliminimi i mbivendosjeve të linjave në itineraret e tyre - Përdorimi i teknologjive të reja si “Sistemet e Transportit Inteligent” dhe “Logjistika Inteligente” për të ndihmuar në menaxhimin efikas të sistemeve të transportit - Përmirësimi i cilësisë së rrugëve - Përdorimi i automjeteve me efikasitet energjie, duke reduktuar nevojat për lëvizshmërinë dhe distancat me anë të planifikimit të integruar - Promovimi i transportit publik të udhëtarëve - Rritja e mundësisë së përdorimit të biçikletave - Fushatat e ndërgjegjësimit publik 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Taksa e karbonit - Taksa e rrugës - Caktimi i taksave të qarkullimit dhe kufizimi i përdorimit të automjeteve (përdorim në ditë të caktuara të javës, p.sh. sipas targës së makinës) - Përmirësimi i koeficientit të ngarkesës së automjetit në transportin e mallrave - Përgatitja e një plani optimal parkimi dhe caktimi i tarifave optimale të parkimit, veçanërisht në nyjat kryesore të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave - Reduktimi i përdorimit të burimeve të energjisë
Buxheti (burimi)	<p>Shuma specifike e buxhetit nuk disponohet</p> <p>Buxheti total i parashikuar për investime në sektorin e transportit për një periudhë 20-vjeçare (2019-2038) është 4,888.03 mln euro. Nga këto, 4,458.53 mln euro janë të destinuara për projekte të zhvilluara nga sektori publik, ndërsa 429.5 mln euro janë investime private</p>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit; shoqëritë operatore të transportit ndërqytetës me autobusë; agjencitë e udhëtimit. Autoriteti Rrugor Shqiptar
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Efiçenca e energjisë

Dimensio i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Transporti
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave (G-T2)	
Periudha kohore	2020 – 2025	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 811, datë 16.11.2016, "Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit, 2016–2020"	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - Stimulimi për përdorimin e automjeteve me formë të përmirësuar aereodinamike - Reduktimi i peshës - Përdorimi i automjeteve me performancë të përmirësuar energjetike. - Goma më efikase - Përmirësimi i sistemit të mirëmbajtjes së kamionëve me qëllim reduktimin e niveleve të ndotjes. - Krijimi i një sistemi taksash dhe tarifash për stimulimin e transportit efikas të mallrave. - Përmirësimi i trajnimit të drejtuesve të mjeteve për rritjen e aftësive drejtuese 	
Objektivi kryesor i PaM	Objektivat kryesore sipas Strategjisë Kombëtare të Energjisë përfshijnë një skenar transporti aktiv dhe synojnë reduktimin me 10% të intensitetit të energjisë në sektorin e transportit. Objektivat: Reduktimi i kostove të logjistikës. Reduktimi i trafikut rrugor dhe bllokimit të trafikut.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Integrimi i transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror në transportin e mallrave (afatmesëm, 5-8 vite) - Rritja e efikasitetit të transportit të mallrave - Reduktimi i kohës së transitit dhe kostove të transportit në zinxhirin e transportit të mallrave - Reduktimi i bllokimit të trafikut në rrjetin rrugor kombëtar - Reduktimi i konsumit të energjisë (ton/km) - Reduktimi i shkarkimeve të CO₂ - Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse për automjetet dhe adoptimi i modaliteteve më efikase për trafikun - Përdorimi i lëndëve djegëse me nivele të ulëta karboni si biokarburantet e qëndrueshme ose e energjisë elektrike të rinovueshme - Rritja e investimeve në sektorin e menaxhimit të transportit të mallrave 	

	- Reduktimi i kostos së transportit nga origjina deri në destinacionin e mallrave (gjatë zinxhirit të transportit)
Masat që duhet të zbatohen	- Integrimi i sistemit të transportit të mallrave në rrjetet e BE-së - Krijimi i nyjave intermodale dhe atyre logjistike - Aplikimi i sistemeve inteligjente të transportit (SIT)
Buxheti (burimi)	Shihni G-T1, shuma specifike e buxhetit nuk disponohet
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; portet detare shqiptare, Autoriteti Shqiptar i Hekurudhave, doganat shqiptare, Autoriteti Rrugor Shqiptar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Efiçenca e energjisë

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Transporti
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Fiskal	
Titulli i PaM (kodi)	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës (G-T3)	
Periudha kohore	2020 – në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 633, datë 26.10.2018, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, e ndryshuar; ligji nr. 9957, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar	
Masat e marra deri më sot	- Mosaplikim i tarifës së regjistrimit për automjetet elektrike - Rimbursim nga shteti i një vlere prej 7500 ALL, afërsisht 55 Euro, për PHEV - Përfundim i automjeteve të reja nga taksat për tre vite	
Objektivi kryesor i PaM	Masa synon reduktimin e vjetërsisë mesatare të makinave dhe rritjen e standardit të kërkuar. Masa është konsistente me skenarin zbutës të INDC-së. Ajo përfshin ndalimin e regjistrimit dhe rritjen e taksave për makinat e përdorura, me qëllim reduktimin në maksimum të hyrjes së tyre në tregun shqiptar.	
Rezultatet që duhet të arrihen	- Reduktimi i importimit të automjeteve të përdorura - Shtimi i përdorimit të automjeteve të reja - Shtimi i përdorimit të automjeteve elektrike	
Masat që duhet të zbatohen	- Masat e përshkruara në seksionin e masave të marra deri më sot - Rritja e taksave vjetore në bazë të vjetërsisë së makinës dhe llojit të lëndës djegëse të përdorur	
Buxheti (burimi)	Shihni G-T1, shuma specifike e buxhetit nuk disponohet	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Autoriteti Doganor, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit, njësitë e qeverisjes vendore Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Efiçenca e energjisë	

Sektori i ndërtimit

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Sektori i ndërtimit
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar; Edukativ	

Titulli i PaM (kodi)	<i>Politikat për mbështetjen e BRE për ngrohjen dhe ftohjen (G-B1)</i>
Periudha kohore	<i>2017 – 2030</i>
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”</i>
Masat e marra deri më sot	<i>Deri më tani, janë ndërmarrë aktivitete për rritjen e kapaciteteve.</i>
Objektivi kryesor i PaM	<i>Nxitja e përdorimit të gjerë të energjive të rinovueshme për ngrohje dhe ftohje</i>
Rezultatet që duhet të arrihen	- <i>Rritja e kapacitetit nominal të BRE-ve në ndërtesa</i>
Masat që duhet të zbatohen	- <i>Skemat e incentivave financiare</i> - <i>Skemat rregullatore</i> - <i>Udhëzime ose skema me bazë edukative</i>
Buxheti (burimi)	<i>Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga tarifat e energjisë elektrike</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ERE</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Sektori industrial

Dimensioni i energjisë		<i>1. Dekarbonizimi</i> <i>1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve</i>
Sektori		<i>Industria</i>
Skenari i konsideruar për modelim	<i>WAM</i>	
Lloji i instrumentit	<i>Rregullator; Edukativ</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Zbatimi i ETS-së në Shqipëri (G-I1)</i>	
Periudha kohore	<i>2022 – 2030</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”; VKM nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Ligji 10448, datë 14.7.2011, ngre një sistem për lejet mjedisore lidhur me ushtrimin e disa grupeve të caktuara të aktiviteteve industriale ndotëse, në pajtueshmëri me standardet mjedisore. Operatorët industrialë kanë detyrimin të monitorojnë dhe të raportojnë shkarkimet në mjedis nga këto aktivitete, në bazë të kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore përkatëse.</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Ngritja e ETS-së në Shqipëri do të kontribuojë në arritjen e synimit të NDC-së për reduktimin e shkarkimeve të GES-ve nga sektori i industrisë, si dhe të synimit të PKEK-së për dekarbonizimin e ekonomisë.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Reduktimi i synuar me 50% i shkarkimeve të GES-ve nga sektori i industrisë, deri në vitin 2030</i> - <i>Duke nisur nga viti 2025, prezantimi nga Shqipëria i tregtimit në nivel kombëtar të kuotave pa pagesë, me pjesëmarrjen e industrisë së çimentos, plehëruesve, hekurit dhe çelikut</i> - <i>Ngritja e një sistemi të përshtatshëm monitorimi, raportimi dhe verifikimi (MRV) për monitorimin e shkarkimeve, siç është parashikuar në ligjin “Për ndryshimet klimatike” e miratuar së fundi</i> - <i>Aftësimi, deri në vitin 2027, i 20 operatorëve industrialë në shtojcën II të ligjit 155/2020, për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të GES-ve në pajtueshmëri me udhëzimet e BE-së.</i> 	
Masat që duhet të zbatohen	<i>Projektimi i ETS-së së ardhshme në përputhje me standardet e BE-së, me qëllim lehtësimin e procesit të çdo lidhjeje të mundshme në të ardhmen me ETS-në e BE-së.</i>	

	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i kuadrit legjislativ (legjislacioni dytësor për procedurat e lëshimit të lejeve të shkarkimeve të GES-ve dhe udhëzimet teknike) - Krijimi i një sporteli shërbimi për operatorët industrialë - Caktimi i çmimit të karbonit - Trajnimi i operatorëve industrialë lidhur me: <ul style="list-style-type: none"> o Krijimin e planit të monitorimit (kategorizimi, sistemi me nivele, qasja e bazuar në llogaritje, pasiguria, kërkesa të tjera) o Ngritjen e një kuadri verifikimi dhe raportimi (raport vjetor mbi shkarkimet, shoqëruar me të dhëna të verifikuara lidhur me këto shkarkime; o raport verifikimi, raporti për përmirësimin) o Mënyrën e përfuturit të kuotave në nivel BE-je (blerje, përfitim pa pagesë) apo kthimit të tyre - Nisja e procesit të akreditimit dhe/ose njohja e verifikuesve të jashtëm për shkak të përmasave të tregut.
Buxheti (burimi)	<p>2 mln euro (shifër treguese e bazuar në një analizë krahasuese, e cila mbulon kostot për ndërtimin e kapaciteteve të autoritetit kompetent dhe operatorëve dhe që shërben për ngritjen e kuadrit teknik).</p> <p>Buxheti mund të përftohet përmes mekanizmave të ndryshëm financues në nivel BE-je, si asistenca teknike në kuadër të IPA-s, TAIEX etj.</p>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Dekarbonizimi; ndikimi potencial në efikasitetin e energjisë dhe në kërkim; novacioni dhe konkurrenca

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Industri/ndërsektorial
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së (Rregullorja për mekanizmat e monitorimit) (G-I2)	
Periudha kohore	2022 – në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”; VKM nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”; ratifikimi i KKKBNK-së nga parlamenti shqiptar në vitin 1994	
Masat e marra deri më sot	Përgatitja dhe miratimi i ligjit “Për ndryshimet klimatike” dhe i procesit të rishikimit të NDC-së	
Objektivi kryesor i PaM	Harmonizimi i garantuar me legjislacinin Acquis të BE-së për ndryshimet klimatike dhe përmbushja e kërkesave të KKKBNK-së përmes prezantimit të një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e rregullt të shkarkimeve të GES-ve dhe informacioneve të tjera lidhur me ndryshimet klimatike.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<p>Në përputhje me NDC-në e vitit 2015, duhet të raportohet progresi drejt synimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në sektorin e ndërtimit (izolimi) do të arrihet një reduktim i CO₂ prej 50 kt (ose reduktim me 7% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030 - Në sektorin e industrisë (kaldaia më efikase) do të arrihet një reduktim i CO₂ prej 225 kt (ose reduktim me 32% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030 - Në sektorin e industrisë (ndryshimi i lëndëve djegëse të përdorura) do të arrihet një reduktim i CO₂ prej 52 kt (ose reduktim me 7% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Në sektorin e transportit (masa kosto-efektive) do të arrihet një reduktim i CO₂ prej 116 kt (ose reduktim me 16% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030 - Në sektorin e transportit (kalimi të biokarburantet në masën 10%) do të arrihet një reduktim i CO₂ prej 265 kt (ose reduktim me 38% i totalit të shkarkimeve të GES-ve në vend prej 708 kilotonë), deri në vitin 2030
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i drafteve të reja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin etj., siç kërkohet nga CCL - Një plan zbatimi për MMR-në - Krijimi i një ekipi kryesor për inventarin e GES-ve prej të paktën 6 personash në të gjitha institucionet dhe plotësisht të familjarizuar me detyrat e ekipit të inventarit (ekspertë të sektorit, koordinator, QA/QC, vlerësime mes homologëve) - Krijimi i një ekipi kryesor për MMR-në prej të paktën 10 personash nga institucionet e ngritura, plotësisht të familjarizuar me detyrat për të cilat janë trajnuar dhe të aftë për të kryer detyrat statutore që kërkohen nga MMR - Ndërtimi i kapaciteteve për personelin e kualifikuar të MTM, AKM, MIE, MBZHR dhe për të gjitha grupet e interesit të identifikuar nga CCL - Ndërtimi i kapaciteteve për verifikuesit e kualifikuar, të pavarur dhe të akredituar, të raporteve të monitorimit të GES-ve - Ndërtimi i kapaciteteve për personelin e kualifikuar dhe atë të institucioneve të tjera për përpunimin e të dhënave, zhvillimin e treguesve, menaxhimin dhe arkivimin - Krijimi i grupeve të pasuruara të të dhënave, arkivave dhe shkëmbimi i informacionit midis të gjitha institucioneve të përfshira në MMR - Ngritja e një sistemi elektronik për ngarkimin/shkarkimin e të dhënave të aktiviteteve nga MIE, MBZHR, MTM, AKM dhe të gjitha institucionet e tjera të përfshira në MMR - Përmirësimi i kapaciteteve të koordinimit në MTM dhe i bashkëpunimit ndërinstitucional për zbatimin e politikave të CCL-së, MMR-së dhe ligjeve të tjera të Acquis për ndryshimet klimatike - Pajtueshmëria me kërkesat për raportim të politikave
Buxheti (burimi)	1 mln euro
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia dhe Inspektorati Rajonal i Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit (përgatitja dhe verifikimi i raporteve mbi shkarkimet e GES-
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Sektori i bujqësisë

Dimenzioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Bujqësia
Skenari i konsideruar për modelim	WEM	
Lloji i instrumentit	Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Promovimi i bujqësisë organike (G-A1)	
Periudha kohore	2020 – 2030	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 709, datë 29.10.2014, "Për miratimin e SNZHRB - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020", e ndryshuar	
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte lidhur me progresin, por dihet se Instrumenti IPA (IPARD) e mbështet këtë orientim (bujqësinë organike).	
Objektivi kryesor i PaM	Nxitja e bujqësisë organike, intensifikimi i bujqësisë organike në sektorin e bujqësisë dhe përmirësimi i metodave të plehërimit.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të fermave organike nga 123 (në vitin 2012) deri në 1000 (sipas objektivit, në vitin 2020) - Rritja e sipërfaqes së fermave organike nga 5848 ha (në vitin 2012) deri në 20 000 ha (sipas objektivit, në vitin 2020) 	

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ulja e normës mesatare të plehërimit me 10% nga 2019 deri në 2030 dhe një reduktim me 50% i uresë së shpërndarë nga 2019 deri në 2030</i>
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD)</i> - <i>Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket bujqësisë organike</i> - <i>Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (PMB)</i> - <i>Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së</i> - <i>Mbledhja e të dhënave për feramat organike dhe për sipërfaqen e shfrytëzuar nga bujqësia organike</i>
Buxheti (burimi)	<i>Në total, masat agro-mjedisore, klimatike dhe ato të bujqësisë organike, sipas parashikimit në skemën IPARD II (2014-2020), kanë një buxhet indikativ prej 1,7 mln eurosh dhe një kohë indikative nisjeje në 2018 (programi IPARD, 2014-2020)</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit		Sektori Bujqësia WAM Rregullator
Titulli i PaM (kodi)	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri (G-A2)	
Periudha kohore	2015 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 709, datë 29.10.2014, "Për miratimin e SNZHRB - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020", e ndryshuar; ligji nr. 8244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar	
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte lidhur me progresin.	
Objektivi kryesor i PaM	Ngritja e një mekanizmi të përhershëm kombëtar të monitorimit të tokave dhe aktiviteteve bujqësore në lidhje me shkarkimet e CO ₂ .	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një regjistri kombëtar me mbështetjen e INSTAT në periudhën 2025-2030 - Trajnimi i personelit bashkiak, fermerëve etj. 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD) - Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket metodologjisë së monitorimit. 	
Buxheti (burimi)	Për këtë PaM nuk është përcaktuar një shumë specifike buxheti	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; INSTAT INSTAT; Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit		Sektori Bujqësia WEM Rregullator
Titulli i PaM (kodi)	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi (G-A3)	
Periudha kohore	2019 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 709, datë 29.10.2014, "Për miratimin e SNZHRB - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020", e ndryshuar; ligji nr. 8244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", VKM nr. 608, datë 17.9.2014, "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio".	
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte lidhur me progresin.	
Objektivi kryesor i PaM	Ndalimi i djegies së mbetjeve bujqësore në mjedise të hapura.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Reduktimi i shkarkimeve si rezultat i djegies së mbetjeve bujqësore - Trajnimi i fermerëve etj. 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Intensifikimi i kontrollit të incinerimit të mbetjeve bujqësore - Kontrolli i djegies së mbetjeve bujqësore me anë të marrjes së masave të sigurisë ndaj zjarrit dhe disponimi i një programi të qartë dhe i zonave të përcaktuara për incinerimin e tyre - Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore 	
Buxheti (burimi)	Për këtë PaM nuk është përcaktuar një shumë specifike buxheti.	

Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; INSTAT INSTAT; Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Sektori i menaxhimit të mbetjeve

Dimensioni i energjisë	1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori	Menaxhimi i mbetjeve
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar
Titulli i PaM (kodi)	Reduktimi i emetimeve nga mbetjet (G-W1)
Periudha kohore	2020 – 2035
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 418, datë 20.5.2020, "Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Shqipëri, 2020–2035"; Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri (2018)
Masat e marra deri më sot	15 nga 61 bashki disponojnë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve. 17% e totalit të rrymave të mbetjeve shkojnë për riciklim dhe rreth 10% e mbetjeve të ambalazheve grumbullohen nga bashkitë. 40% e baterive dhe akumulatorëve, 5% e llumrave të ujërave të ndotura dhe 0% e mbetjeve inerte grumbullohen dhe trajtohen në mënyrë të duhur.
Objektivi kryesor i PaM	Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Ngritja e një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve bashkiake, që bazohet në hierarkinë e mbetjeve.
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të disponojnë një plan për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Deri në vitin 2035, do të riciklohet 40% e totalit të rrymave të mbetjeve dhe do të grumbullohet në nivel bashkiak jo më pak se 70% e mbetjeve të ambalazheve. - Deri në vitin 2035, të gjitha bashkitë do të kenë mbyllur vendgrumbullimet e papajtueshme. - Deri në vitin 2035, do të grumbullohet dhe trajtohet si duhet 80% e baterive dhe akumulatorëve, 80% e llumrave të ujërave të ndotura dhe 80% e mbetjeve inerte. - Fillimi i përthithjes së CH₄ në vitin 2025, ndjekur nga një progres linear, derisa të arrihet një përthithje prej 10% nga 1,34 milionë tonë CH₄ në vitin 2030 (vlerësuar me anë të analizës së të dhënave të mjetit GACMO të skenarit të Komunikimit të Tretë Kombëtar dhe NDC-së).
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një plani për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve dhe i një programi për parandalimin e mbetjeve, në mbështetje të zbatimit të dokumentit të politikave strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe planit të veprimit - Mbyllja dhe trajtimi i të gjitha vendgrumbullimeve bashkiake (të papajtueshme) për mbetjet e trashëguara, në përputhje me udhëzimet në fuqi - Instalimi i impianteve të thithjes së metanit në vendgrumbullime - Zbatimi i skemave kombëtare të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet e tyre
Buxheti (burimi)	Vlera e parashikuar për rehabilitimin e vendgrumbullimit është rreth 76 mln euro; vlera për grumbullimin e materialeve të riciklueshme të thata rreth 18,5 mln euro dhe ajo për grumbullimin e mbetjeve organike dhe kompostimin rreth 13 mln euro. (Të gjitha vlerat janë llogaritur për periudhën 2018-2032.)
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; bashkitë Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; bashkitë

Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	
---	--

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Menaxhimi i mbetjeve
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri (G-W3)	
Periudha kohore	2020 – 2035	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 418, datë 20.5.2020, "Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Shqipëri, 2020–2035"; Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri (2018); VKM nr. 178, datë 6.3.2012, "Për incinerimin e mbetjeve"	
Masat e marra deri më sot	Një incinerator i përfunduar dhe funksional në Elbasan dhe dy të tjerë në fazë ndërtimi dhe gati për t'u vënë në funksion së shpejti në Tiranë dhe Fier. Që prej vitit 2020, 6 bashki i dërgojnë mbetjet e tyre në incineratorët përkatës.	
Objektivi kryesor i PaM	Mundësimi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në mënyrë të integruar, në përputhje me standardet e BE-së, në sajë të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Transporti i mbetjeve në impiantet e transformimit të mbetjeve në energji.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i bashkive që dërgojnë mbetjet e tyre në impiantet e prodhimit të energjisë nga mbetjet (WtE) do të shkojë nga 6 në vitin 2019 në 12 në vitin 2025. - Të gjitha bashkitë që bëjnë pjesë në diapazonin e shërbimit të impianteve WtE pritet të dërgojnë mbetjet e tyre brenda vitit 2030 (duke mbuluar rreth 58% të popullsisë shqiptare). 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Pas ndjekjes së të gjitha proceseve paraprake të grumbullimit të diferencuar, riciklimit, kompostimit, asgjësimit të mbetjeve të ngurta, në përputhje me politikat në këtë Dokument dhe skemat teknike të përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, bashkitë dhe prodhuesit e tjerë të mbetjeve mund të dërgojnë në këto impiante të tjera mbetje të djegshme. - Finalizimi i ndërtimit të incineratorëve në Tiranë dhe Fier. 	
Buxheti (burimi)	Kostot e parashikuara për periudhën 2018-2022 për investimet në impiantet e incinerimit me zgarë të lëvizshme në Fier dhe Tiranë janë përkatësisht 25,5 dhe 76 mln euro.	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; bashkitë Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; bashkitë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Menaxhimi i mbetjeve
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës (G-W3)	
Periudha kohore	2020 – 2040	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Master Plani Kombëtar i Ujësjellës Kanalizimeve (2013 – 2040); Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2020-2030 (draft); ligji nr. 9115, datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar; VKM nr. 177, datë 31.03.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"	

Masat e marra deri më sot	Mbulimi me kanalizime në nivel kombëtar ka arritur në 56,3%. Mbulimi me kanalizime, në bazë të tipologjisë së zonave të shërbimit, është 79,5% në zonat urbane dhe 16% në zonat rurale. Vetëm 14,3% e popullsisë urbane është e lidhur me impiant trajtimi të ujërave të përdorura. Në Shqipëri ka 12 impiante aktualisht funksionale të trajtimit të ujërave të përdorura.																
Objektivi kryesor i PaM	Rritja e numrit të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura në Shqipëri dhe e përqindjes së popullsisë së lidhur me impiant trajtimi të ujërave të përdorura.																
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Objektivi për mbulimin me trajtim të ujërave të përdorura nga ITUP është si më poshtë: <table border="1" style="margin-left: 40px;"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Përqindja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>2021</td><td>14</td></tr> <tr><td>2022</td><td>17</td></tr> <tr><td>2023</td><td>20</td></tr> <tr><td>2024</td><td>24</td></tr> <tr><td>2025</td><td>28</td></tr> <tr><td>2026</td><td>32</td></tr> <tr><td>2027</td><td>39</td></tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> - Në 2024 pritet të miratohet strategjia e menaxhimit të llumrave. - Në 2025 pritet të miratohet ngritja e një laboratorit për analizën e llumrave në Shqipëri. 	Viti	Përqindja	2021	14	2022	17	2023	20	2024	24	2025	28	2026	32	2027	39
Viti	Përqindja																
2021	14																
2022	17																
2023	20																
2024	24																
2025	28																
2026	32																
2027	39																
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Harmonizim i plotë me Direktivën “Për trajtimin e ujërave të përdorura urbane” - Zgjerimi i rrjetëve të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura dhe ndërtimi i impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të parapëlqyera nga turistët - Financimi shtetëror për ndërhyrjet e drejtpërdrejta në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të përdorura, mbështetja nga donatorët e huaj (kryesisht IPA III dhe donatorët dypalësh), kompanitë private (përmes Partneriteteve Publike Private.) dhe projekti IPA (III) 2022 për sektorin e ujit në Shqipëri - Mbledhje e tarifave për ujërat e përdorura nga qytetarët 																
Buxheti (burimi)	<p>Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2019-2030 (draft) ka një kosto prej rreth 1,5 miliardë euro, nga të cilat 99,2% i zë infrastruktura dhe 0,8% asistencë teknike.</p> <p>Sipas Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës -Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, buxheti i parashikuar (për furnizimin me ujë, grumbullin dhe trajtimin e ujërave të përdorura) është:</p> <table border="1" style="margin-left: 40px;"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Buxheti i shtetit</th> <th>Investime të huaja</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021</td> <td>36,35</td> <td>46,82</td> <td>83,17 mln euro</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>44,35</td> <td>40,18</td> <td>84,53 mln euro</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Buxheti i shtetit	Investime të huaja	Totali	2021	36,35	46,82	83,17 mln euro	2022	44,35	40,18	84,53 mln euro				
Viti	Buxheti i shtetit	Investime të huaja	Totali														
2021	36,35	46,82	83,17 mln euro														
2022	44,35	40,18	84,53 mln euro														
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; bashkitë Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe e Infrastrukturës së Mbetjeve; ERRU; bashkitë.																
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)																	

Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektori		Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet
Skenari i konsideruar për modelim	WAM	
Lloji i instrumentit	Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave (G-LF1)	
Periudha kohore	2020 – 2030	

Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 814, datë 31.12.2018, "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030"; ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet"
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte për progresin lidhur me masat.
Objektivi kryesor i PaM	Ripyllëzimi i zonave brenda fondit pyjor, fokusimi në zonat me dëmtime nga zjarri dhe shpyllëzimi masiv, zgjerimi me zona të reja të orientuara kryesisht te agropylltaria, gjelbërimi urban dhe rrugor, çka do të sjellin rigjenerimin e pyjeve dhe rritjen e kapacitetit të tyre të përthithjes së karbonit.
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja financiare (kryesisht përmes instrumentit IPARD) - Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket bujqësisë organike - Hartimi, botimi dhe shpërndarja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (PMB) - Trajnimi i fermerëve për zbatimin e Kodit të PMB-së
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Plani kombëtar për mbjelljen në zonat e dëmtuara nga prerja e paligjshme e drurëve dhe në zonat e djegura brenda fondit pyjor - Pyllëzimi me specie të reja të larta për produktet e drurit, duke përdorur hapësirat e lira, tokat djerrë etj. dhe duke bashkëpunuar me individë dhe sipërmarrje - Promovimi i agropylltarisë dhe me pemë frutore, incentiva financiare apo me tokë, fidanë (drurë frutorë / Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - AZHBR), etj. - Promovimi i gjelbërimit rrugor dhe urban në parqe, përreth burimeve ujore dhe në zonat e ndjeshme, me qëllim rritjen e sipërfaqes së mbuluar me pemë/gjelbërim dhe parandalimin e rreziqeve natyrore
Buxheti (burimi)	Fonde shtetërore në vlerën 6,5 mln euro (çdo vit, për sektorin e pyjeve, megjithëse nuk specifikohet nga masat)
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Agjencia Kombëtare e Pyjeve Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (të gjitha të përfshira në zbatim dhe monitorim)
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.1. Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve
Sektor		Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet
Skenari i konsideruar për modelim	WAM	
Lloji i instrumentit	Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Menaxhimi ekologjik i pyjeve (G-LF2)	
Periudha kohore	2019 – 2030	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 814, datë 31.12.2018, "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030"; ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet"; VKM nr. 466, datë 3.7.2019, "Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike"; Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (draft i vitit 2021)	
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte për progresin lidhur me masat.	
Objektivi kryesor i PaM	Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve me qëllim përmirësimin e përthithjes së karbonit dhe mbrojtjen e biodiversitetit.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Në bazë të një prej llogaritjeve të bëra, përmirësimi i menaxhimit të pyjeve, nëse arrihet të zbatohet në mënyrë progresive në një sipërfaqe prej 5000 ha në vit, do të lejojë një normë më të lartë të rritjes së biomasës së pemëve në këto zona. - Në vitin 2030, zbatimi i kësaj mase do të lejojë reduktimin e shkarkimeve vjetore të CO2 me -18 kt, sipas parashikimeve, në raport me skenarin BAU. (Burimi: Kontributi Kombëtar i Përcaktuar 2021 (versioni draft), tabela 4) 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetja financiare përmes buxhetit të shtetit dhe financimit ndërkombëtar - Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket pylltarisë. 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Disa nga masat përfshijnë: Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe kontributit të tyre në ciklet globale të karbonit Mirëmbajtjen e gjallërisë dhe gjendjes së mirë të ekosistemeve pyjore Mirëmbajtjen dhe promovimin e funksioneve produktive të pyjeve (lëndë drusore dhe jodrusore). Mirëmbajtjen e duhur, ruajtjen dhe përmirësimin e diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos tokës dhe ujit)
Buxheti (burimi)	<p>Fonde shtetërore në vlerën 6,5 mln euro (çdo vit, për sektorin e pyjeve, megjithëse nuk specifikohet nga masat)</p> <p>(Në Dokumentin e Politikave nuk disponohen llogaritje financiare për koston e zbatimit të masave, por në dokumentin për ndryshimet klimatike ka një kosto të përlogaritur prej 1,22 mln euro, bazuar gjithashtu në SNZHRB dhe në burimet e tjera për L14)</p>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural</p> <p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural</p>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

2.1.1. Energjia e rinovueshme

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

Energji elektrike, ngrohja dhe ftohja

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja
Skenari i konsideruar për modelim	WEM dhe WAM (shihni seksionin e rezultateve)	
Lloji i instrumentit	Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Mekanizmi i tarifës "feed-in" për kapacitetet e vogla të rinovueshme (R-E1)	
Periudha kohore	2021 -2030	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimtimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020"; VKM nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"	
Masat e marra deri më sot	Në përputhje me strategjinë, duke nisur nga viti 2019, janë nënshkruar njëmbëdhjetë kontrata sipas kësaj skeme.	
Objektivi kryesor i PaM	Objektivi është rritja e kapacitetit të energjisë së rinovueshme, duke siguruar një skemë mbështetjeje (FiT) për kapacitetin e vogël të energjisë së rinovueshme.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Objektivi është nxitja e rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. - Kjo masë kontribuon gjithashtu në objektivin kombëtar për BRE deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë dhe, në mënyrë specifike, për të arritur objektivin lidhur me energjinë e rinovueshme për prodhim të energjisë elektrike (BRE-E- 239 ktoe). <p>Për WEM:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Do të ndërtohen të tjera hidrocentrale të vogla në kuadër të lejeve të dhëna më herët. Pritet që gjatë periudhës 2021-2028 të shtohen 40 MW në vit ose 320 MW në total. 	

	<p>Për WAM:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pritet që gjatë periudhës 2021-2030 në rrejt të shtohen 30 MW energji fotovoltaike në vit ose 300 MW në total deri në 2030. Për teknologjitë e tjera nuk parashikohet ndonjë rritje e ndjeshme.
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha kapacitetet e energjisë së rinovueshme nën 2 MW (ose 3 MW për energjinë eolike) dhe projektet demonstruese dhe ato pilot mund të përfitojnë nga tarifa FiT. - Tarifat janë llogaritur nga ERE në mënyrë që të garantohet një normë e mjaftueshme e kthimit të investimit për të gjithë operatorët e energjisë së rinovueshme. - Enti Rregullator i Energjisë miraton çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, sipas çmimit mesatar për vitin 2017, në përputhje me parashikimet e metodologjisë së përcaktuar në VKM nr. 369. - Duke nisur nga viti 2019, çmimi i ERE i përfshirë në strategji është 100 €/MWh për energjinë e prodhuar nga dielli dhe 76 €/MWh për atë të prodhuar nga era.
Buxheti (burimi)	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga tarifat e energjisë elektrike. Megjithatë, ka një ndikim në buxhetin e blerësit, që së fundmi është në pronësi të shtetit.
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë; operatorët privatë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensio i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WEM dhe WAM (shihni seksionin e rezultateve) Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Ankandet për kapacitetet e reja të rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë (CFD)	
Periudha kohore	2017 e në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020"; ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"	
Masat e marra deri më sot	Janë nënshkruar ankandet e Karavastasë dhe Spitallës.	
Objektivi kryesor i PaM	Objektivi është rritja e kapacitetit të energjisë së rinovueshme (eolike dhe fotovoltaike) me anë të organizimit të ankandëve dhe propozimit të një skeme mbështetjeje në formën e kontratave për diferencë (CFD).	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Objektivi është nxitja e rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. - Kjo masë kontribuon gjithashtu në objektivin kombëtar për BRE-në për vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë. <p>Për WEM:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i parqeve fotovoltaike të Karavastasë dhe Spitallës deri në 2023 (240 MW energji fotovoltaike në total) - Shtimi i kapacitetit eolik me 150 MW deri në 2024 <p>Për WAM:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shtimi i energjisë fotovoltaike me 70 MW në vit nga 2024 deri në 2030 (një total prej 490 MW) - Shtimi i kapacitetit eolik me 60 MW nga 2026 deri në 2030 (një total prej 300 MW) 	

Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Ankandet do të zhvillohen me anë të një procedure konkurrimi (bazuar në treg). - Ofertuesit të zgjedhur nga ankandet do t'i akordohet një kontratë CfD. Me anë të kësaj kontrate CfD, ofertuesi do të marrë një prim progresiv (shuma e energjisë elektrike të shitur në treg dhe primi do të mbeteshin në vlera konstante). - Pagesa e primit progresiv për ofertuesit e zgjedhur do të paguhet nga një subjekt i veçantë, i quajtur Operatori i Energjisë së Rinovueshme. Financimi i këtij subjekti do të bëhet me anë të tarifimit të të gjithë furnizuesve të energjisë elektrike.
Buxheti (burimi)	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga detyrimi për energjinë e rinovueshme që do të paguhej nga çdo furnizues dhe, në hallkën e fundit, nga secili prej konsumatorëve të energjisë elektrike.
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Këshilli i Ministrave; Enti Rregullator i Energjisë; operatorët privatë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja
Skenari i konsideruar për modelim	WEM	
Lloji i instrumentit	Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW (R-E3)	
Periudha kohore	2017 e në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020"; VKM nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"; Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli"	
Masat e marra deri më sot	OSHEE ka përfshirë në faqen e saj të internetit standardet e zbatueshme për matjen, por nuk disponon një bazë të dhënash për projektet e zbatuara.	
Objektivi kryesor i PaM	Objektivi është inkurajimi i familjeve dhe konsumatorëve (për instalimet deri në 500 kW) për të instaluar kapacitete të rinovueshme, si dhe promovimi i vetëkonsumit.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë - Kjo masë kontribuon gjithashtu në objektivin kombëtar për BRE deri në vitin 2030 (42%) lidhur me përqindjen e burimeve të rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë dhe, në mënyrë specifike, për të arritur objektivin lidhur me energjinë e rinovueshme për prodhim të energjisë elektrike (BRE-E- 239 ktoe). - Rritja e kapacitetit të rinovueshëm, kryesisht atij të energjisë fotovoltaike, nuk paraqitet veçmas për këtë masë, por kapaciteti total supozohet të pasqyrohet në R-E1. 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Një masë transparente dhe e thjeshtë për regjistrimin e një impianti pranë OSHEE-së, aksesimi i thjeshtë i informacionit. - Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme apo një konsumator familjar mund të instalojë një kapacitet të përgjithshëm praj maksimumi 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli, me qëllim mbulimin e plotë ose të pjesshëm të nevojave të tij për energji, dhe ta injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes. - Konsumatorët, sipas skemës së matjes neto të energjisë, duhet të instalojnë me shpenzimet e tyre një matës me dy drejtime. - Bilanci neto dhe faturimi bëhen në baza mujore për secilën pikë matëse. Teprica e energjisë elektrike më e madhe se konsumi mujor shitet te furnizuesi i shërbimit universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, sipas çmimit të caktuar nga ERE, bazuar në metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. 	
Buxheti (burimi)	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës mbulohej në mënyrë të tërthortë nga tarifa e energjisë elektrike. Prodhuesit nuk paguhën, por përfitojnë vetëm një reduktim në faturat e tyre të energjisë elektrike.	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	OSHEE, shoqëritë private OSHEE; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja

Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	<i>WEM</i> <i>Financiar</i>
Titulli i PaM (kodi)	<i>Rrjet i fuqishëm elektrik për t'iu përgjigjur kapacitetit në rritje të energjisë së rinovueshme (R-E4)</i>
Periudha kohore	<i>2017 e në vazhdim</i>
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>VKM nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020"; ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"</i>
Masat e marra deri më sot	<i>Investime të vazhdueshme</i>
Objektivi kryesor i PaM	<i>Objektivi është rritja e kapacitetit të rrjetit elektrik, si transmetues ashtu dhe atij shpërndarës, për të përmbushur nevojat për burime energjie të rinovueshme shtesë. Kjo është veçanërisht me rëndësi për rrjetin e shpërndarjes, pasi skemat mbështetëse FiT dhe ato të matjes neto kanë ndikim të konsiderueshëm në rrjetin e shpërndarjes.</i>
Rezultatet që duhet të arrihen	<i>Të njëjta me objektivin kryesor</i>
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i nënstacioneve elektrike - Rikonstruksioni i linjave të transmetimit të energjisë elektrike - Implementimi i Sistemit të Analizimit të Rrjetit nëpërmjet PMU-së (Njësi matëse fazorësh). - Krijimi i nyjave të reja të interkonjeksionit - Përmirësimi i procesit të menaxhimit, kontrollit dhe matjes - Aksesimi dhe garantimi i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në rrjetin e transmetimit
Buxheti (burimi)	<i>Sipas disa vlerësimeve paraprake, për rinovimin e rrjetit të shpërndarjes për një trajtim më të mirë të injektimit të ndryshueshëm të energjisë së rinovueshme në terma afatshkurtër nevojiten rreth 40 deri në 80 mln euro investime.</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Këshilli i Ministrave; Enti Rregullator i Energjisë</i> <i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		<i>Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja</i>
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	<i>WEM</i> <i>Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Lehtësimi i marrëdhënies rregullatore dhe fizike me rrjetin elektrik (R-E5)</i>	
Periudha kohore	<i>2017 e në vazhdim</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>VKM nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020"; ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Nuk disponohet informacion në lidhje me masat e marra deri më sot</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Lehtësimi i rritjes së kapacitetit të ri të energjisë së rinovueshme</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<i>Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me kërkesë të një prodhuesi të energjisë nga burime të rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE, do të propozojnë si pikë lidhjeje me rrjetin e tyre pikën që përmbush kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme prodhuesi nga pikëpamja e koston dhe distancës në rrjet.</i>	

Masat që duhet të zbatohen	<i>Të gjitha masat rregullatore të nevojshme për arritjen e objektivit.</i>
Buxheti (burimi)	<i>Nuk është parashikuar buxhet, pasi bëhet fjalë kryesisht për masa rregullatore.</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Këshilli i Ministrave; Enti Rregullator i Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		<i>Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja</i>
Skenari i konsideruar për modelim	<i>WAM</i>	
Lloji i instrumentit	<i>Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Sistemet e menaxhimit të kërkesës dhe akumulimit të energjisë për fleksibilitetin e rrejtit elektrik (R-EA)</i>	
Periudha kohore	<i>Nuk është përcaktuar ende</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Asnjë masë e marrë deri më sot</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Rritja e operueshmërisë së rrejtit shpërndarës për të përmbushur nevojën për rritje të kapacitetit të rinovueshëm shpërndarës.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Studime paraprake për të vlerësuar potencialin për menaxhimin e kërkesës dhe akumulimin e energjisë - Lidhja me skemën e matjes neto - Instalimi i matësve inteligjentë (strategjia e matjes) 	
Masat që duhet të zbatohen	<i>Operatori i shpërndarjes, së bashku me ministrinë dhe rregullatorin, do të ndërmarrin studime për të vlerësuar potencialin real të menaxhimit të kërkesës dhe akumulimit të energjisë në Shqipëri. Në bazë të këtyre studimeve, duhet të ndërmerren disa masa zbatuese.</i>	
Buxheti (burimi)	<i>Do të përcaktohet në vazhdim</i>	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Këshilli i Ministrave; Enti Rregullator i Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë</i>	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		<i>Energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja</i>
Skenari i konsideruar për modelim	<i>WEM</i>	
Lloji i instrumentit	<i>Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Strategjia e matjes dhe dixhitalizimi i sektorit energjetik (R-E7)</i>	
Periudha kohore	<i>Nuk është përcaktuar ende</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar</i>	

Masat e marra deri më sot	Aktualisht, masat e marr janë: (i) Hartimi i një strategjie matjeje; dhe (ii) Faza pilot për matësit inteligjentë.
Objektivi kryesor i PaM	Krijimi i një strategjie matjeje dhe kalimi drejt një sektori më të dixhitalizuar të energjisë elektrike
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një strategjie matjeje - Instalimi i matësve inteligjentë sipas strategjisë së matjes - Sigurimi i një menaxhimi proaktiv i rjetit të shpërndarjes me anë të përdorimit të mjeteve të përshtatshme informatike dhe të dhënave të matësve inteligjentë (dixhitalizimi)
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një strategjie matjeje - Zbatimi i strategjisë së matjes dhe instalimi i matësve inteligjentë - Ndërtimi i kapaciteteve të operatorëve për administrimin e matësve inteligjentë, si dhe pajisjeve dhe të dhënave përkatëse
Buxheti (burimi)	Do të përcaktohet në vazhdim
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Këshilli i Ministrave; Enti Rregullator i Energjisë, kompanitë private Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Enti Rregullator i Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Sektori i transportit

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Transporti
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Elektrifikimi i sektorit të transportit (R-T1)	
Periudha kohore	2021-2030	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"	
Masat e marra deri më sot	Energjia e rinovueshme për sektorin e transportit (BRE-T) për vitin 2020 mbetet në diapazonin e 20,3 ktoe, nga 62 ktoe që ishte vlera e parashikuar.	
Objektivi kryesor i PaM	Rritja e elektrifikimit në sektorin e transportit	
Rezultatet që duhet të arrihen	10% automjete elektrike (nga e gjithë flota), deri në vitin 2030	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Caktimi i objektivave ligjore ndaj operatorëve ekonomikë, duke përfshirë zbatimin e tyre. Një tjetër është certifikimi i cili garanton pajtueshmërinë e operatorëve ekonomikë me kërkesat e qëndrueshmërisë. - Përcaktimi i elementeve të tjera kyçe të politikave, me qëllim arritjen e objektivit BRE-T për vitin 2030: (i) strategji dhe mekanizma mbështetës për energjinë elektrike në transport; (iii) përcaktim i detyrimeve të subjekteve të caktuara, siç janë parkimet publike ose garazhet publike, për të qenë të pajisur me stacione për karikimin e automjeteve elektrike; (iv) incentiva ose procedura të thjeshtuara për ndërtimin/licencimin e stacioneve të karikimit me energji elektrike për automjetet rrugore ose për ndërtimin/licencimin e stacioneve të rimbushjes me lëndë djegëse hidrogjen; (v) përfundim i plotë nga TVSH për automjetet e reja me motor elektrik me zero km, të përgjithshme më parë në asnjë vend tjetër; (vi) reduktim i importeve të lëndës djegëse fosile, krijim i vendeve të punës, kontribut në PBB, etj. (vii) rishikim i politikave dhe, sipas mundësive, përshtatje e tyre rreth vitit 2025, bazuar në një vlerësim të politikave dhe rezultateve. 	
Buxheti (burimi)	Do të përcaktohet në vazhdim	

Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	
Dimensioni i energjisë	
1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme	
Spektori	
Transporti	
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator; Fiskal
Titulli i PaM (kodi)	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara (R-T2)
Periudha kohore	2021-2030
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Draft ligji "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport"; ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"
Masat e marra deri më sot	Masat e marra deri më sot janë: (i) Nivel zero i akcizës për biodizelin e pastër deri në vitin 2018; (ii) Përfundim nga detyrimet doganore për makineritë dhe pajisjet që do të përdoren për ndërtimin e impianteve të prodhimit të biokarburanteve. Përfundim nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja për: - pajisjet dhe makineritë që konvertojnë plehun në përmirësues organikë të tokës që mund të përdoren për kultivimin e bimëve për qëllimin e energjisë; pajisjet, materialet dhe makineritë bujqësore që do të përdoren nga fermerët vendas për kultivimin e bimëve për qëllime energjetike; pajisjet dhe makineritë teknologjike, kryesore dhe ndihmëse, të impianteve prodhuese të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme; (iii) Publikim nga MIE, nëpërmjet tregtarëve të ligjshëm të automjeteve dhe Klubit të Automobilëve në Republikën e Shqipërisë, i të dhënave mbi efikasitetin e motorëve ekzistues në përputhje me cilësinë e lëndës djegëse të përdorur; (iv) Mbikëqyrje e cilësisë së biokarburanteve nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe zyrat e vlerësimit të kriterëve të qëndrueshmërisë; (v) Përfundim nga taksat për përdorimin e biokarburanteve; (vi) Krite për verifikimin e biokarburanteve; (vii) Detyrim i mbajtësve të "licencës së prodhimit" për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për të raportuar kostot e prodhimit në fabrikë (ex-factory) të këtyre produkteve pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; (viii) Rimbursim i akcizës për biokarburantet e përdorura në sektorin e transportit dhe të ruajtura në territorin e Republikës së Shqipërisë për vlerën e detyrimit të akcizës të paguar deri në 5%. Rimbursim për sasinë e biokarburanteve deri në vitin 2020; (ix) Llogaritje e normës së akcizës në bazë të njësisë së matjes dhe diferencim i saj për disa nga produktet më të rëndësishme energjetike.
Objektivi kryesor i PaM	Qëllimi i politikës është nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme që përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë.
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Alternativat për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme përtej objektivit të vitit 2030 mund të ofrojnë mundësi për eksporte, p.sh. me anë të prodhimit dhe eksportimit të biokarburanteve me bazë vajrat e përdorura të gatimit dhe yndyrat ose me anë të prodhimit të lëndëve djegëse të lëngshme nga energjia elektrike e rinovueshme (RFNBO). - Biokarburantet, duke përfshirë ato me origjinë bujqësore, me origjinë nga mbetjet dhe ato të avancuara, parashikohet të kenë kontributin më të madh në objektivi. - Objektivi i masës 10% të biokarburanteve deri në vitin 2025.
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për tregtim në sektorin e transportit - Promovimi i lëndëve të para për prodhimin e biokarburanteve, me anë të zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë - Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Marrja e masave nga çdo shoqëri që zotëron një licencë të llojit "Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse, me kodin VIII.1.A" për tregti me shumicë, për të garantuar vendosjen në treg të të

	<p>paktën cilësisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme. Përbushja e kriterëve të qëndrueshmërisë nga sasitë në fjalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i kërkesave lidhur me verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve - Detyrimi i përzjerjes - Caktimi i tarifave për certifikatat dhe lejet e nevojshme - Kryerja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror përgjegjës - Vendosja e gjobave për shitësit me pakicë të lëndëve djegëse, nëse nuk parashikohet që biokarburantet e lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, si p.sh. nafta dhe nënproduktet e saj, të përzihen me bionaftë dhe bioetanol në masën 5% - Penalitetet për furnitorët e lëndëve djegëse që nuk përbushin detyrimet e tyre - Përcaktimi i masave mbështetëse të disponueshme për blerësit e automjeteve me lëndë djegëse alternative, si dhe i dispozitave në lidhje me pajtueshmërinë e automjeteve me llojet e ndryshme të lëndëve djegëse alternative
Buxheti (burimi)	<p>124 000,00 euro (burimi: Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri, 2015-2020)</p> <p>Vlera monetare e kostove dhe përfitimeve të ndikimeve potenciale ishte e pamundur të përcaktohej për shkak të të dhënave dhe informacioneve të kufizuara.</p>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<p>Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.</p> <p>Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</p>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Sektori i industrisë

Dimensioni i energjisë		1. Dekarbonizimi 1.2. Energjia e rinovueshme
Sektori		Sektori i industrisë-NMV-të
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Investues; Financiar; Informativ; Edukativ	
Titulli i PaM (kodi)	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin industrial joushqimor (R-1)	
Periudha kohore	2025 dhe në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, "Për eficientësinë e energjisë", i ndryshuar; VKM nr. 369, datë 36.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"; Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli"	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i akteve ligjore - Disa iniciativa nga industrinë lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël. 	
Objektivi kryesor i PaM	Zhvillimi i konceptit të "industrisë së gjelbër", duke promovuar dhe mbështetur shfrytëzimin e aplikimeve në shkallë të vogël të energjisë së rinovueshme në sektorin industrial joushqimor, si dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe aftësive të biznesit me qëllim inkurajimin e sipërmarrjes.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i kapaciteteve të NMV-ve prodhuese vendase me qëllim përshpejtimin e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Kuadrot politike dhe rregullatore që ndihmojnë në zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Përmirësimi i mekanizmave financiare 	

Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - NMV pilot për zbatimin e projekteve demonstruese në shkallë të vogël të energjisë së rinovueshme - Zgjerimi i kapacitetit të zinxhirit lokal të furnizimit dhe tregut të shërbimeve për demonstrimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme (transferimi i teknologjisë, zhvilluesit e projekteve, instalimi, operimi dhe mirëmbajtja, ofruesit e shërbimeve etj.) - Zhvillimi i materialeve të trajnimit nga NMV-të - Zhvillimi i platformave të pjesëmarrjes për promovimin (ndërgjegjësimin), zhvillimin dhe zbatimin e aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Hartimi i politikave dhe rregulloreve për mbështetjen e teknologjive të përzgjedhura të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël - Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve - Rritja e informimit të institucioneve financiare vendase lidhur me energjinë e rinovueshme
Buxheti (burimi)	<i>Buxheti indikativ: 2 mln euro</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Operatorët e industrisë joushqimore; Agjencia për Efiçencën e Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia për Efiçencën e Energjisë</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi; Efiçenca e energjisë; Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca</i>

3.2 Dimensioni i efijencës së energjisë

3.2.1 Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me këtë dimension renditen më poshtë:

1. Ligji nr. 155/2020, datë 17.12.2020, “Për ndryshimet klimatike”
2. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
3. Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”
4. Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për efijencën e energjisë”
5. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
6. Ligji nr. 9463, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
7. VKM nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019-2020”
8. VKM nr. 466, datë 3.7.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planit kombëtar për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”
9. VKM nr. 407, datë 19.6.2019, “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”
10. VKM nr. 342, datë 22.5.2019, “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”
11. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030”
12. VKM nr. 709, datë 1.12.2017, “Për miratimin e planit të dytë dhe të tretë kombëtar të veprimit për efijencën e energjisë, 2017 – 2020”
13. VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”
14. VKM nr. 811, datë 16.11.2016 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit, 2016–2020” (SSTPV)
15. VKM nr. 619, datë 7.9.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efijencën e energjisë, 2011 – 2018”
16. Udhëzimi nr. 3 i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”
17. Strategjia sektoriale e transportit dhe plani i veprimit, 2016–2020 (raporti i monitorimit i vitit 2019)
18. Ligji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport” (versioni draft)
19. Plani për Transportin e Qëndrueshëm (versioni draft)

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

3.2.2 Skemat detyruese të efikasitetit të energjisë dhe masat politike alternative

Dimensioni i energjisë		1. Efikasiteti i energjisë
Sektori		Skemat detyruese të efikasitetit të energjisë dhe masat politike
Skenari i konsideruar për modelim	WAM	
Lloji i instrumentit	Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë (EE-O1)	
Periudha kohore	2023-2030	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015 "Për efikasitetin e energjisë", i ndryshuar nga ligji nr. 28/2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë". Detyrimi sipas nenit 7 të Direktivës për EE-në të transpozuar në ligjin nr. 124/2015, i ndryshuar	
Masat e marra deri më sot	Ligji nr. 28/2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë" ka krijuar bazën për zbatimin e skemave detyruese dhe masave alternative për shpërndarësit, operatorët dhe/ose furnizuesit e tregut të energjisë të Republikës së Shqipërisë për arritjen e kursimeve në konsumin final të energjisë.	
Objektivi kryesor i PaM	Caktimi i objektivave për kursimet në konsumin final të energjisë, që operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë. Sipas një përlogaritjeje bruto të bazuar në një vlerë referencë, në vitin 2030 kursimet e parashikuara do të jenë 37 ktoe.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi racional i burimeve energjetike në nivel kombëtar - Arritja e objektivave të kursimeve kumulative të konsumit final të energjisë, deri më 31 dhjetor 2030 - Arritja e objektivit nga palët e përfshira në detyrim (OP), prej rreth 1,5% shitje vjetore të energjisë të konsumatorët fundorë nga të gjithë shpërndarësit e energjisë ose shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, vlerë kjo e mesatarizuar përgjatë një periudhe trevjeçare; (EED, neni 7) - Kuadri rregullator për krijimin e skemës detyruese 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi nga qeveria i një VKM-je për krijimin e një skeme detyruese të efikasitetit të energjisë (deri në fund të 2022), e cila do të caktojë objektiva për kursimet në konsumin final të energjisë, të cilat operatorët e sistemit shpërndarës dhe/ose furnizuesit e tregjeve të energjisë janë të detyruar t'i zbatojnë - Një metodologji e detajuar për caktimin e skemave detyruese të efikasitetit të energjisë - Masa të miratuara për EE-në, të cilat duhet të zbatohen nga përdoruesit fundorë me mbështetjen e operatorëve të sistemit shpërndarës dhe/ose të furnizuesve të tregjeve të energjisë 	
Buxheti (burimi)	Duke qenë se bëhet fjalë për një instrument rregullator, buxheti lidhet më së shumti me mbështetjen e nevojshme teknike (në bazë të vlerësimit të parë, parashikohen 10-20 mijë euro).	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, Palët në Detyrim (OP), Konsumatorët Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencia për Efikasitetin e Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Siguria energjetike, dekarbonizimi	

3.2.3 Strategjia afatgjatë e rinovimit dhe nxitja e rinovimit rrënjësor kosto-efektiv

Dimensioni i energjisë		2. Efikasiteti i energjisë
Sektori		Efikasiteti i energjisë së ndërtesave
Skenari i konsideruar për modelim	WAM	
Lloji i instrumentit	Rregullator	

Titulli i PaM (kodi)	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa (EE-L1)
Periudha kohore	2020 dhe në vazhdim
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave"
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i legjislacionit përkatës për zbatimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa dhe lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë (EPC) - Lëshimi i 2000 EPC-ve paraprake
Objektivi kryesor i PaM	Zbatimi i PaM në fjalë përbën një nxitës tepër të rëndësishëm për arritjen e niveleve optimale (të realizueshme në aspektin teknik, funksional dhe ekonomik) të konsumit të energjisë në ndërtesa dhe në njësitë e tyre.
Rezultatet që duhet të arrihen	<p>Caktimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e kursimeve të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe jorezidenciale të sapondërtuara, me anë të përdorimit të zarfit termik - Vlerësimin e kursimit të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe jorezidenciale të restauruara (ekzistuese, të rikonstruara), me anë të përdorimit të zarfit termik, pa ndryshim të sistemit të ngrohjes - Rikonstrukcionin e përgjithshëm të zarfit termik të ndërtesave ekzistuese rezidenciale dhe jorezidenciale dhe rikonstrukcionin e sistemit të ngrohjes - Përmirësimin e efikasitetit termik përmes ndërhyrjeve specifike në elemente të veçanta të ndërtesës - Lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i VKM nr.1049, datë 24.12.2020, "Për metodologjinë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa" me anë të softuerëve të miratuar. - Zbatimi i VKM nr. 958, datë 2.12.2020, "Për miratimin e procedurave e të kushteve të certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të modelit, përmbajtjes e kushteve të regjistrimit të "certifikatës së performancës së energjisë së ndërtesave": <ul style="list-style-type: none"> o Lëshimi i certifikatave të performancës së energjisë së ndërtesave (EPC) për: (i) të gjitha ndërtesat apo njësitë e ndërtesave që do të shiten ose do të lëshohen me qira; (ii) të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen ose do të jenë objekt i një rinovimi të konsiderueshëm; (iii) të gjitha ndërtesat në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucione që ofrojnë shërbime publike dhe që vizitohen shpesh nga publiku, me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 250 m²; (iv) Kur një ndërtesë ose njësi ndërtesë shitet apo lëshohet me qira përpara përfundimit të ndërtimit, pronari i saj duhet t'i pajisë këto ndërtesa apo njësi ndërtesash me certifikata të përkohshme të performancës së energjisë që gjatë fazës së projektimit. o Zbatimi i VKM nr. 934, datë 25.11.2020 "Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa" (sistem i pavarur kontrolli) o Ndërtimi i kapaciteteve për autoritetin kompetent dhe audituesit e energjisë lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe përdorimin e softuerëve për lëshimin e EPC-së
Buxheti (burimi)	<p>Buxheti shtetëror, sektori privat</p> <p>Nuk disponohet një total i përlllogaritur i buxhetit, por disa nga fondet e dedikuara janë: (i) Ndihma shtetërore për "bizneset e reja të gjelbra" në Tiranë, me një vlerë totale të fondit për dy vite prej rreth 0,3 mln euro; dhe (ii) 6,5 mln euro "për efikasitetin e energjisë për qytetin student" nga banka KfW</p>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<p>Agjencia për Efikasitetin e Energjisë; Qeveria Vendore</p> <p>Agjencia për Efikasitetin e Energjisë; Qeveria Vendore</p>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Siguria energjetike; dekarbonizimi

Dimensioni i energjisë		2. Efiçenca e energjisë
Sektori		Efiçenca e energjisë së ndërtesave
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator; Financiar; Informativ	
Titulli i PaM (kodi)	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private) (EE-L2)	
Periudha kohore	2022 dhe në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa"; ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, "Për efiçencën e energjisë", i ndryshuar	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkitë; Agjencia për Efiçencën e Energjisë; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Sektori privat</i> <i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Efiçencën e Energjisë; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi, BRE</i>

Dimensioni i energjisë		2. Efiçenca e energjisë
Sektori		<i>Transporti</i>
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	<i>WEM</i> <i>Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (rrugët, hekurudhat dhe rrugët detare) (EE-T4)</i>	
Periudha kohore	<i>2021 – në vazhdim</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>VKM nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit, 2016-2020”; Strategjia sektoriale e transportit dhe plani i veprimit, 2016–2020 (raporti i monitorimit i vitit 2019)</i>	
Masat e marra deri më sot	<p><i>Rishikimi i strukturës aktuale të tarifave në TP (biletat/llojet e kartave dhe çmimet) në terma afatshkurtër.</i></p> <p><i>Përfundimi në qershor 2019 i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan të planifikuar në strategji.</i></p> <p><i>Përfundimi në qershor 2020 i ndërtimit të bajpasit të Fierit.</i></p> <p><i>Nisja e përgatitjes dhe zbatimit të projektit të Qendrës së Menaxhimit të Trafikut për rrejetin kryesor rrugor në Shqipëri, në bashkëpunim me Bankën Botërore.</i></p> <p><i>Përfundimi i terminalit të ri të autobusëve.</i></p> <p><i>Identifikimi i projekteve të zhvillimit për hekurudhat dhe përfshirja e tyre në Paketën e Projekteve Prioritare të Sektorit (PPPS) për sektorin e transportit.</i></p> <p><i>Përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen dhe vënien në përdorim të Sistemit të Monitorimit dhe Informacionit për Trafikun e Mjeteve të Lundrimit në Shqipëri.</i></p> <p><i>Zhvillimi i një plani veprimi të kuantifikuar dhe të integruar strategjiko-operacional për zgjerimin dhe modernizimin e portit.</i></p>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Mbështetja nga kuadri rregullator dhe mekanizmat teknikë e financiarë e intensifikimit të transportit publik, si rezultat i problematikave mjedisore dhe ekonomike.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Shtimi i numrit të autobusëve, shpeshëtisës, cilësisë dhe aksesit të rrugëve, korsive të dedikuara, sistemeve inteligjente të transportit, infrastrukturës hekurudhore, kryqëzimeve të transitit, rritja e faktorit të ngarkesës, çmime konkurruese në raport me transportin privat, përmirësimi i koordinimit ndërmjet mënyrave të transportit - autobusë, trena, anije.</i> - <i>Kalimi i intensifikuar në transportin publik dhe atë aktiv: Arritja e një ndarjeje modale prej 70% për transportin publik dhe atë aktiv për bashkinë e Tiranës.</i> - <i>Reformimi i sistemit hekurudhor duke krijuar një treg të hapur për investitorët publikë dhe privatë, për sa i përket rregullimit të tregut, menaxhimit të infrastrukturës ose shfrytëzimit të hekurudhave.</i> - <i>Modernizimi i infrastrukturës së portit përmes investimeve.</i> - <i>Fuqizimi i Administratës Detare në pajtueshmëri me standardet e BE-së.</i> - <i>Rritja e specializimit të funksioneve të portit me qëllim përforcimin e veçorisë së tyre intermodale, veçanërisht për lidhjen port-hekurudhë.</i> 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik në gjithë qytetin, me anë të përmirësimit të rrejetit lokal të transportit publik, me anë të korsive të dedikuara të autobusëve etj.</i> - <i>Rikonstruksioni i rrugëve që ka nisur tashmë në shkallë të gjerë dhe ka filluar të përmirësojë imazhin e transportit publik nëpërmjet rritjes së numrit dhe shpeshëtisës së autobusëve elektrikë që janë pjesë e rrejetit.</i> 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i Terminalit Publik të Transportit Tiranë dhe i sistemit të autobusëve të tranzitit të shpejtë (Bus Rapid Transit, BRT) Tiranë-Rinas - Unaza e Tiranës (2016 – 2018) (përfundimi i anës jugperëndimore - i shtyrë) - Përmirësimi i transportit publik (flotë e re (elektrike dhe me etiketim) dhe ndërtim i 10 km korsi të dedikuara të biçikletave)
Buxheti (burimi)	Asnjë vlerë e vetme pasi ekzistojnë disa projekte në lidhje me disa ndërhyrje për sistemin e transportit
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	MIE, MFE, bashkitë; Agjencia për Eficiencën e Energjisë; Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Autoriteti Portual Durrës. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Eficiencën Energetike
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Dekarbonizimi, BRE

3.3 Siguria energjetike

3.3.1 Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me këtë dimension renditen më poshtë:

1. Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar
2. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
3. Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet”, i ndryshuar
4. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030”
5. VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”
6. VKM nr. 417, datë 10.5.2017, “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror”
7. Ligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. (versioni draft)

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

3.3.2 Sektori i energjisë elektrike

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Energjia elektrike
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WAM Rregullator; Financiar; Teknik	
Titulli i PaM (kodi)	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës (ES-P1)	
Periudha kohore	2021 – në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030”; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”	
Masat e marra deri më sot	Përgatitja dhe miratimi i procesit.	
Objektivi kryesor i PaM	Rinisja e operimit të TEC-it të Vlorës me furnizim të gazit natyror përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) dhe degës së tij në Vlorë.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Reduktimi i importit të energjisë elektrike - Mbulimi i 20% të deficitit të energjisë elektrike nga TEC-i i Vlorës 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i koncesionit 	
Buxheti (burimi)	Rreth 58 mln euro	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Energjia elektrike
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM dhe WAM (shihni seksionin e rezultateve) Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica (ES-P2)	
Periudha kohore	2021 – në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030”; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - HEC-i i Moglicës - Impianti fotovoltaiik lundruer i Vaut të Dejës - Hidrocentrali i Skavicës (nisja e planit të përbashkët të veprimt në tetor 2020 me “Bechtel”) 	
Objektivi kryesor i PaM	Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës	
Rezultatet që duhet të arrihen	Rritja e pavarësisë energjetike me anë të shtimit të kapacitetit dhe një rezervuari më të madh.	
Masat që duhet të zbatohen	Për WEM: <ul style="list-style-type: none"> - HEC-i i Moglicës (182,5 MW në vitin 2021) - Impianti fotovoltaiik lundruer i Vaut të Dejës (12,9 MW në vitin 2022) Për WAM: <ul style="list-style-type: none"> - Hidrocentrali i Skavicës 	
Buxheti (burimi)	Do të verifikohet në vijim	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Këshilli i Ministrave; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njësitë e qeverisjes vendore Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Dekarbonizimi, BRE	

3.3.3 Sektori i naftës dhe gazit

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Kuari i plotë ligjor për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët (ES-O1)	
Periudha kohore	2018 -2040	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë, 2018-2030”; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”	
Masat e marra deri më sot	Deri në këtë moment, zhvillimi i kuadrit rregullator në Shqipëri është shumë më i avancuar se sa zhvillimi i infrastrukturës. Megjithatë, ka një grup aktesh nënligjore me natyrë juridike, teknike dhe rregullatore të cilat nuk janë miratuar ende.	

	Ndarja dhe certifikimi i dy operatorëve të sistemit të transmetimit. Vënia në funksion e Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP). Miratimi nga Albgaz dhe TAP i kodeve të rregullimit, të cilat janë miratuar nga ERE. Transpozimi nga ERE i kodeve të rregullimit të gazit në Shqipëri. Rregullimi i aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit me anë të tarifave të miratuara në pajtueshmëri me një metodologji hyrjeje/daljeje. Kualifikueshmëri për të gjithë konsumatorët. Zhvillimi i legjislacionit për furnizimin dhe mbrojtjen e konsumatorit. Krijimi i rregullave të emergjencës për gazin.
Objektivi kryesor i PaM	Furnizimi i sigurt dhe i qëndrueshëm i gazit natyror për konsumatorët, përmes krijimit të një tregu konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale dhe evropiane, dhe ofrimi i një shërbimi cilësor, me kosto të arsyeshme, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i një grupi aktesh nënligjore për zbatimin e kërkesave ligjore dhe teknike të ligjit, me qëllim ngritjen e një kuadri ligjor funksional për furnizimin e sigurt të gazit dhe krijimin e një tregu me shumicë të gazit natyror - Identifikimi dhe dorëzimi i akteve nënligjore.
Masat që duhet të zbatohen	- Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike, të transmetimit e të shpërndarjes.
Buxheti (burimi)	Master plani parashikon tre faza zhvillimi: afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGAS Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGAS
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WAM Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit (ES-O2)	
Periudha kohore	2018 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare"	
Masat e marra deri më sot	<p>Komiteti Drejtues i WBIF, në mbledhjen e tij më 6 dhjetor 2018, miratoi një grant prej 1,1 milionë eurosh për përgatitjen e "Tubacioni i gazit Fier – Vlorë: Dizajni i hollësishëm dhe dokumentet e tenderit" Konsulenti Hill International - projekti i Konsorciumit IPF 7 dorëzoi për komente në janar 2020 dokumentin "Metodologjia për tubacionin e gazit Fier - Vlorë: Dizajni i hollësishëm dhe dokumentet e tenderit".</p> <p>"Studimi i Para-fizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë" (projekti ALKOGAP), i zbatuar nga IPF4 TA, i financuar nga WBIF me një grant prej 0,3 mln eurosh. Studimi i Para-fizibilitetit përfundoi në fund të vitit 2018, në kuadër të WB15-REG-ENE-01.</p> <p>WBIF ka dhënë një grant prej 2,5 mln eurosh për projektin paraprak për gazsjellësin Adriatiko-Jonian (pjesa që përshkon Shqipërinë dhe Malin e Zi).</p>	
Objektivi kryesor i PaM	Një sistem i ri, i plotë dhe funksional për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Penetrim i gazit natyror (ktoe) në raport me furnizimin nga totali i burimeve primare energjetike: 0,37% në 2020, 5,1% në 2025 dhe 8,5% në 2030, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Energjinë. - Në vitin 2040, konsumi potencial i gazit natyror për prodhimin e energjisë elektrike mund të jetë rreth 770 milionë m³, ndërsa konsumi i parashikuar në rafineritë e vendit mund të jetë rreth 89,2 milionë m³. - Nga 376 njësi administrative vendore janë zgjedhur 85 prej tyre që kanë potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e rregullimit të shpërndarjes të gazit. 	

Masat që duhet të zbatohen	- Zhvillimi i projekteve dhe investimet në transmetim dhe shpërndarje. TAP, Gazsjellësi Adriatiko-Jonian – IAP etj., sipas përcaktimit në planin strategjik.
Buxheti (burimi)	Buxheti për linjën e re të transmetimit të gazit, i parashikuar nga 150 mln euro deri në 185 mln euro, nga të cilat 67 mln euro janë për 168 km të Gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP)
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGZ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGZ; Enti Rregullator i Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WEM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit (ES-O3)	
Periudha kohore	2018 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030"; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare".	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i kuadrit të nevojshëm ligjor. Shqipëria ka bërë përpertime në aktet nënligjore për gazin natyror që prej miratimit të ligjit "Për gazin" në vitin 2015. Deri në këtë moment, zhvillimi i kuadrit rregullator në Shqipëri është shumë më i avancuar se sa zhvillimi i infrastrukturës. - Kodi i rrjetit Albgaz për sistemin e ardhshëm të transmetimit dhe miratimi i kodit të rrjetit TAP, ky i fundit në përputhje me vendimin e përjashtimit nga ERE dhe autoritetet kombëtare italiane dhe greke. - Transpozimi i kodeve të rrjetit të gazit në Shqipëri nga autoriteti rregullator ERE. - Miratimi i Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit - Identifikimi dhe miratimi i projekteve prioritare - Projekti paraprak për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (pjesa që përshkon Shqipërinë dhe Malin e Zi) – WBIF - Studimi i Para-fizibilitetit për projektin e Gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP) 	
Objektivi kryesor i PaM	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit sipas alternativës më të mirë (Korridor Jugor i Gazit dhe Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë, TAP, IAP, Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë "(projekti ALKOGAP)).	
Rezultatet që duhet të arrihen	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit sipas alternativës më të mirë për zhvillimin e tregut rajonal të gazit dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me gaz.	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit - Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare - Financimi dhe zbatimi i projekteve të miratuara prioritare 	
Buxheti (burimi)	"Studimi i Para-fizibilitetit për Gazsjellësin Shqipëri-Kosovë" (projekti ALKOGAP), i zbatuar nga IPF4 TA, i financuar nga WBIF me një grant prej 0,3 mln eurosh (përfunduar në fund të vitit 2018). 67 mln euro për 168 km janë për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (IAP)	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGZ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGZ; Enti Rregullator i Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë	3. Siguria energjetike
-------------------------------	------------------------

Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Shtimi i kërkim-prodhimit të hidrokarbureve (ES-O4)	
Periudha kohore	2018 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, "Për hidrokarburet", i ndryshuar	
Masat e marra deri më sot	Dorëzimi i draftit final të ligjit "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".	
Objektivi kryesor i PaM	Rehabilitimi i rafinerive të Ballshit dhe Fierit sipas normave dhe standardeve evropiane, duke përfshirë miratimin e normave mjedimore për produktet dhe teknologjitë e tyre, rritja e kapacitetit të përpunimit të rafinerive deri në 1,5 Mt/vit, modernizimi i terminalit të Vlorës, si dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit nga Vlora në Ballsh.	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Përafrimi i Direktivës së Këshillit 2009/119/KE, datë 14 shtator 2009, duke u imponuar shteteve anëtare detyrimin e ruajtjes së rezervave minimale të produkteve të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të saj. - Ngritja e një organi për ruajtjen e rezervave, përgatitja e planeve për vënien në dispozicion të rezervave në rast emergjence, përcaktimi i kapacitetit të ruajtjes dhe blerja e rezervave me miratimin e ligjit dhe në bazë të dispozitave të tij. - Ngritja dhe parashikimi nga legjislacioni i një sistemi për kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse. - Garantimi i monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse nëpërmjet programeve të monitorimit vjetor. 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike - Kryerja e studimeve për rehabilitimin dhe modernizimin e të dy rafinerive - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po merr gjithashtu në konsideratë opsionin e ndërtimit të rafinerive të reja me kapacitet prej 3,2 milionë tonësh. 	
Buxheti (burimi)	Buxheti nuk është vlerësuar pasi kostot e investimeve për studimet e rehabilitimit dhe modernizimit të dy rafinerive varen drejtpërdrejt nga situata reale e instalimeve, pajisjeve dhe nivelit të ndotjes së mjedisit. Ministria e Energjisë dhe Industrisë po merr gjithashtu në konsideratë opsionin e ndërtimit të rafinerive të reja me kapacitet prej 3,2 milionë tonësh.	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBPETROL Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBPETROL; Enti Rregullator i Energjisë	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)		

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Plani i emergjencës për gazin natyror (ES-O5)	
Periudha kohore	2017 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Ligji nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; VKM nr. 417, datë 10.5.2017, "Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror"	
Masat e marra deri më sot	Ndarja dhe certifikimi i Alb gaz në bazë të modelit të pronësisë.	

	<p>Kodi i rrjetit Albgaz për sistemin e ardhshëm të transmetimit dhe miratimi i kodit të rrjetit TAP, ky i fundit në përputhje me vendimin e përjashtimit nga ERE dhe autoritetet kombëtare italiane dhe greke.</p> <p>Transpozimi i kodeve të rrjetit të gazit në Shqipëri nga autoriteti rregullator ERE.</p> <p>Dy terminale bregdetare të naftës dhe gazit në Shqipëri: Porto Romano në Durrës dhe Petrolifera në Vlorë.</p> <p>Propozimi pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përfshirjen e projektit “Depozitimi nëntokësor i gazit natyror në zonën e Dumresë (UGS Dumrea)” në Projektet me Interes për Komunitetin e Energjisë (lista PECL). Miratimi i një granti prej 1 milionë eurosh nga Komiteti Drejtues i WBIF, në mbledhjen e tij më 6 dhjetor 2018, për përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe VNMS-së për këtë projekt. Përpilimi i ToR nga konsulentit, lidhur me përgatitjen e studimit të fizibilitetit dhe VNMS-së për projektin WB20-ALB-ENE-01 “Albania, Dumrea Underground Natural Gas Storage” dhe dorëzimi i tyre pranë WBIF dhe BERZH për procedurat e mëtejshme.</p>
Objektivi kryesor i PaM	Përcaktimi i standardeve në lidhje me kërkesat minimale të përshtatshme për sigurinë e furnizimit me gaz natyror në Republikën e Shqipërisë, i kriterëve të detyrueshme për garantimin e furnizimit të sigurt dhe eficient të gazit natyror, si dhe i detyrave dhe përgjegjësisë të institucioneve për menaxhimin e situatave emergjente në furnizimin me gaz të konsumatorëve.
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i standardeve të kërkesave minimale për sigurinë e furnizimit. - Instrumente dhe masa për të garantuar një furnizim me gaz të përshtatshëm dhe të mirëpërcaktuar për konsumatorët e mbrojtur, në përputhje me standardet e sigurisë së furnizimit. - Instrumente për parashikimin dhe vlerësimin e rreziqeve potenciale, të cilat përcaktojnë qartësisht veprimet për parandalimin e këtyre rreziqeve dhe masat për zbutjen e dëmeve të mundshme të lidhura me to. - Një program për reduktimin ose ndalimin e furnizimit me gaz për kategori të caktuara konsumatorësh në rast të situatave të krizës. - Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësisë të shoqërive të furnizimit me gaz dhe konsumatorëve jofamiljarë, duke marrë në konsideratë treguesit e ndryshëm të ndikimit në raste të krizave në sektorin e gazit natyror. - Përcaktimi i kriterëve lidhur me impiantet e depozitimit, me qëllim përmbushjen e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe i kontributeve të mundshme për impiantet e depozitimit që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, në vendin e një pale tjetër kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian. - Përcaktimi i masave dhe veprimeve me rëndësi për eliminimin ose zbutjen e ndikimit të ndërprerjes së furnizimit me gaz, në përputhje me nivelet e ndryshme të krizave.
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike - Ndërlidhja në gazsjellësit rajonalë dhe ndërkombëtarë - Financimi i projekteve për depozitimin e gazit
Buxheti (burimi)	Buxheti nuk është vlerësuar
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALBGAS, Enti Rregullator i Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Sektori i naftës dhe gazit
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WEM Rregullator; Financiar	

Titulli i PaM (kodi)	<i>Miratimi i ligjit "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" (ES-O6)</i>
Periudha kohore	<i>2010 - në vazhdim</i>
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji i ri "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i cili transponon Direktivën e Këshillit 2009/119 në legjislacionin shqiptar</i>
Masat e marra deri më sot	<i>Përfaqësuesit e ministrive janë në diskutime për draftin final të ligjit "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i cili do t'i dorëzohet Këshillit të Ministrave për miratim.</i>
Objektivi kryesor i PaM	<i>Draft-ligji i ri duhet të përcaktojë procedurat e nevojshme të ndërhyrjes në rast të mungesave të konsiderueshme të produkteve të naftës në treg. Në rast vështirësish në furnizim, vënia në përdorim e rezervave vendoset nga qeveria, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe me miratimin e komitetit të qeverisë për menaxhimin e krizave.</i>
Rezultatet që duhet të arrihen	<i>Ligji i ri "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i cili transponon Direktivën e Këshillit 2009/119 në legjislacionin shqiptar.</i>
Masat që duhet të zbatohen	<i>Miratimi i ligjit të ri nga qeveria dhe parlamenti shqiptar.</i>
Buxheti (burimi)	<i>N/A</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

3.3.4 Bashkëpunimi rajonal

Dimenzioni i energjisë		3. Siguria energjetike
Sektori		Bashkëpunimi rajonal
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	<i>WEM Rregullator; Financiar</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri-Kosovë (ES-R1)</i>	
Periudha kohore	<i>2018 - në vazhdim</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>VKM nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030"; VKM nr. 87, datë 14.2.2018, "Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare".</i>	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Miratimi i kuadrit të nevojshëm ligjor. Shqipëria ka bërë përparime në aktet nënligjore për gazin natyror që prej miratimit të ligjit "Për gazin" në vitin 2015. Deri në këtë moment, zhvillimi i kuadrit rregullator në Shqipëri është shumë më i avancuar se sa zhvillimi i infrastrukturës.</i> - <i>Kodi i rrjetit Albgaz për sistemin e ardhshëm të transmetimit dhe miratimi i kodit të rrjetit TAP, ky i fundit në përputhje me vendimin e përjashtimit nga ERE dhe autoritetet kombëtare italiane dhe greke. Transpozimi i kodeve të rrjetit të gazit në Shqipëri nga autoriteti rregullator ERE.</i> - <i>Miratimi i Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit</i> - <i>Identifikimi dhe miratimi i projekteve prioritare</i> - <i>Projekti paraprak për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (pjesa që përshkon Shqipërinë dhe Malin e Zi) – WBIF</i> - <i>Studimi i Para-fizibilitetit për projektin e Gazsjellësit Shqipëri-Kosovë (ALKOGAP)</i> 	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Lidhja e tubacioneve të reja të transmetimit në Shqipëri me rrjetin rajonal të gazit, sipas alternativës më të mirë (IAP dhe projekti ALKOGAP)</i>	

Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor për një treg të hapur e të liberalizuar, e kodeve teknike dhe normave rregullatore - Përshpejtimi i miratimit të Planit të Zhvillimit të Sektorit të Gazit - Financimi dhe zbatimi i projekteve të miratuara prioritare, etj.
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i kuadrit ligjor, normave rregullatore dhe kodeve teknike e të transmetimit - Marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare - Financimi dhe zbatimi i projekteve të miratuara prioritare
Buxheti (burimi)	67 mln euro janë parashikuar për 168 km të Gazsjellësit Adriatiko-Jonian
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

3.4 Tregu i brendshëm i energjisë elektrike

3.4.1 Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me këtë dimension renditen më poshtë:

1. Ligji nr. 7/2017, datë 2.2.2017, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
2. Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”
3. Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
4. VKM nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030”
5. VKM nr.16, datë 11.01.2017 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e interkonektorëve të rinj”
6. VKM nr. 718, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”
7. Vendimi i bordit të ERE nr. 186, datë 10.11.2017, “Për miratimin e kodit të transmetimit”
8. Vendimi i bordit të ERE nr. 180, datë 8.11.2017, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”
9. Vendimi i bordit të ERE nr. 135, datë 6.9.2017 “Për miratimin e rregullores dhe procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”
10. Urdhri i ministrit të infrastrukturës dhe energjisë, Nr 27, datë 18.1.2021 “Për miratimin e strategjisë së transformimit të mbështetjes feed-in-tariff në kontratë për diferencë”

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

3.4.2 Infrastruktura e energjisë elektrike

Dimensioni i energjisë		4. Tregu i energjisë
Sektori		Infrastruktura e energjisë elektrike
Skenari i konsideruar për modelim	WEM	
Lloji i instrumentit	Rregullator; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Ndërlidhësit elektrikë (EM-I1)	
Periudha kohore	2017 - në vazhdim	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM nr.16, datë 11.01.2017 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e interkonektorëve të rinj”	
Masat e marra deri më sot	VKM Nr.16, datë 11.01.2017 është pjesë e grupit të PaM-eve në lidhje me zhvillimin e tregut të energjisë: (i) VKM Nr. 718, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”; (ii) Vendim i ERE Nr. 186, datë 10.11.2017 “Për kodin e rrjetit të transmetimit”; (iii) Vendim i ERE Nr. 180, datë 8.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës”; (iv) Vendim i ERE “Rregulloja për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”; dhe (v) Vendim i ERE Nr. 135, datë 6.09.2017 “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve (OSSH, OST)”	

Objektivi kryesor i PaM	<i>Përcaktimi i kërkesave dhe procedurave të nevojshme për marrjen e lejes për ndërtimin e linjave të interkoneksionit me tension të lartë (110 kV dhe më të lartë) nga Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit ose investitorët privatë.</i>
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i rrjetit për të përmbushur kërkesën në rritje për kapacitetin e transmetimit - Mbështetja e transaksioneve të tregut në territorin e shtetin dhe në rajon, në mënyrë që rrjeti i transmetimit të mos përbëjë pengesë për konkurrencën - Përfundimi brenda afatit i planeve të investimeve, në veçanti i investimeve kapitale - Integrimi i përshpejtuar i BRE-ve të ndryshueshme në sistemin e energjisë dhe disponueshmëri më e madhe për të balancuar prodhimin e tyre
Masat që duhet të zbatohen	<i>Përmes miratimit të kuadrit ligjor, rregullave rregullatore dhe të kodeve teknike dhe të efikasitetit të energjisë</i>
Buxheti (burimi)	<i>N/A</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		4. Tregu i energjisë
Sektori		<i>Infrastruktura e energjisë elektrike</i>
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	<i>WEM Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Reforma në sektorin e energjisë elektrike (EM-I2)</i>	
Periudha kohore	<i>2018 - në vazhdim</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; Ligji Nr. 7/2017, datë 2.2.2017 "Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; VKM Nr. 742, datë 12.12.2018 "Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri"</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Duhet të theksohet se aktualisht, Shqipëria po ndërmer hapa për disa reforma, mbi të cilat bazohet reforma e sugjeruar në këtë dokument. Këto hapa për reformat përfshijnë, ndër të tjera, hapin e parë për ndarjen e OSHEE-së, Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në Shqipëri, krijimin e Bursës së Energjisë (APEX, tani ALPEX), dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Objektivi i kësaj PaM është që të krijohet një treg të energjisë elektrike të organizuar sipas modelit të BE-së, dhe që udhëhiqet nga parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe qëndrueshmërisë në planin afatgjatë, i cili bazohet gjithashtu në vendosjen e çmimeve konkurruese dhe në bazë të liberalizimit të tregut.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja për kamatëvonesat dhe kryerja e pagesave sistematike nga institucionet publike - Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE-së - Miratimi i një procesi matjeje dhe parashikimi - Hapja e tregut dhe derregullimi i çmimeve - Krijimi i bursës së energjisë - Zbatimi i rregullave dhe mekanizmave të balancimit në bazë të tregut - Caktimi i një operatori BRE dhe transformimi i tarifave "feed-in" - Ofertimi konkurrues për kapacitetin e prodhimit të energjisë së rinovueshme - Miratimi dhe zbatimi i një skeme mbështetjeje për konsumatorët e cenueshëm të shoqërisë - Finalizimi i akteve të legjisllacionit dytësor në përputhje me Acquis e KE - Shtimi i kompetencave dhe nivelit të pavarësisë së ERE 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Skema të reja tarifimi - Bashkimi i tregut për tregun e ditës në avancë - Miratimi i një perspektive strategjike të qartë për KESH - Miratimi i TYNDP - Prokurimi i integruar i të gjitha humbjeve - Marrja e statusit të vëzhguesit nga ERE në ACER - Miratimi i një perspektive strategjike të qartë për OSHEE
Masat që duhet të zbatohen	<i>Përmes asistencës teknike nga burime të ndryshme, do të miratohen ndryshime ligjore dhe rregullatore, si dhe do të zbatohen për të zbatuar reformën dhe për të arritur rezultatet</i>
Buxheti (burimi)	<i>Buxheti indikativ: 2 milionë euro</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë, ERE, OSHEE, KESH Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; KfW dhe AFD (për asistencë teknike)</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	

Dimensioni i energjisë		4. Tregu i energjisë
Sektori		<i>Infrastruktura e energjisë elektrike</i>
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	<i>WAM Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Krijimi i operatorit të BRE-ve dhe transformimi i tarifave “feed-in” (EM-I3)</i>	
Periudha kohore	<i>2021-2023</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji Nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Ligji Nr. 742, datë 2.2.2017 “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; VKM Nr. 742, datë 12.12.2018 “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri”; Urdhri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr 27, datë 18.01.2021 “Për miratimin e strategjisë së transformimit të mbështetjes feed-in-tariff në kontratë për diferencë”.</i>	
Masat e marra deri më sot	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Miratimi i Urdhrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr 27, datë 18.01.2021 “Për miratimin e strategjisë së transformimit të mbështetjes feed-in-tariff në kontratë për diferencë”</i> - <i>Projekti i krijimit të operatorit të BRE-ve, që pritet të miratohet gjatë muajit shkurt 2021</i> - <i>Krijimi i ALPEX</i> 	
Objektivi kryesor i PaM	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Krijimi i një skeme mbështetjeje më transparente për prodhuesit e BRE-ve</i> - <i>Shtimi i likuiditetit të ALPEX</i> - <i>Reduktimi i ndikimit të skemës FiT në blerësin real të energjisë elektrike (OSHEE, FTL)</i> 	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Miratimi i VKM-së për krijimin e operatorit të BRE-ve</i> - <i>Krijimi i strukturës, punësimi i stafit, ngritja e kapaciteteve teknike</i> - <i>Zbatimi i strategjisë së kalimit nga FiT në CfD</i> - <i>Përlogaritja e detyrimit të BRE-ve për 3 vitet e para të funksionimit të operatorit të BRE-ve</i> - <i>Krijimi i modelit për CfD</i> 	
Masat që duhet të zbatohen	<i>Përmes asistencës teknike nga burime të ndryshme, do të miratohen ndryshime ligjore dhe rregullatore, si dhe do të zbatohen për të zbatuar reformën dhe për të arritur rezultatet</i>	
Buxheti (burimi)		
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; KfW dhe AFD (për asistencë teknike)</i>	

Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi, BRE</i>
---	---------------------------

3.4.3 Varfëria energjetike

Dimensioni i energjisë		<i>4. Tregu i energjisë</i>
Sektori		<i>Infrastruktura e energjisë elektrike</i>
Skenari i konsideruar për modelim	<i>WAM</i>	
Lloji i instrumentit	<i>Rregullator</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Eliminimi i varfërisë energjetike (EM-P1)</i>	
Periudha kohore	<i>E papërcaktuar</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Ligji Nr. 43/2015, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; Ligji Nr. 116/2016, datë 10.11.2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave"</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Nuk ka të dhëna</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Objektivi përfshin përcaktimin e konceptit të varfërisë energjetike dhe krijimin e një sistemi kombëtar për monitorimin sistematik të saj dhe rekomandimin e masave për eliminimin e varfërisë energjetike.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<i>Përbushja e kërkesës për përcaktimin e konceptit të varfërisë energjetike dhe mbrojtja e konsumatorëve të energjisë.</i>	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Përcaktimi i qartë i konceptit të varfërisë energjetike.</i> - <i>Krijimi i një sistemi kombëtar për monitorimin sistematik të saj dhe rekomandimin e masave për eliminimin e varfërisë energjetike në bazë të përvojës së vendeve të BE-së.</i> - <i>Studim për të përlogaritur numrin e personave që janë përballur me varfëri energjetike në vend, si dhe arsyet e saj.</i> 	
Buxheti (burimi)	<i>Nuk është përlogaritur asnjë buxhet për këtë PaM</i>	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë; njësitë e qeverisjes vendore Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi; BRE; Efiçenca e energjisë; Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca</i>	

3.5 Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca

3.5.1 Kuadri ligjor gjithëpërfshirës

Aktet ligjore kryesore (duke përfshirë strategjitë dhe planet) në lidhje me këtë dimension renditen më poshtë:

1. Ligji Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
2. VKM Nr. 710, datë 1.12.2017, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (SKSHTI) për periudhën 2017-2022”
3. VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit” (AKKSHI)

Në tabelat më poshtë gjenden politikat dhe masat, të ndara sipas sektorëve përkatës.

3.5.2 Kërkimi

Dimensioni i energjisë		5. Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca
Sektori		
Skenari i konsideruar për modelim Lloji i instrumentit	WEM Rregullator; Informues; Edukativ; Financiar	
Titulli i PaM (kodi)	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin energjetik (RIC-E1)	
Periudha kohore	2018-2022	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	VKM Nr. 710, datë 1.12.2017, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (SKSHTI) për periudhën 2017-2022”; Ligji Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”	
Masat e marra deri më sot	Nuk disponohen raporte lidhur me progresin.	
Objektivi kryesor i PaM	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, evropian dhe botëror në sektorin e energjisë. Ndër të tjera, pjesëmarrja e studiuesve dhe novatorëve shqiptarë në planin SET do të rrisë shanset e tyre në programet evropiane për organizatat kërkimore dhe NVM-të: Platformat evropiane për teknologjinë dhe novacionin (ETIPs) përbëjnë komunitetin e “industrisë/novacionit” të planit SET, ndërsa Aleanca Evropiane për Kërkimet në Sektorin Energjetik (EERA) përbën komunitetin “kërkimor”	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Një numër më i madh marrëveshjesh bashkëpunimi dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e kërkimit shkencor deri në vitin 2022 (p.sh. me pjesëmarrjen e EERA dhe ETIP) - Rritje prej 20% (krahasuar me vitin 2018) e financimit të projekteve rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit deri në vitin 2022 - Krijimi i një Komiteti Koordinimi për programet pasuese të Horizon 2020 (H2020), Erasmus dhe Pogradi i BE-së për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe NVM-ve (COSME) (programet Horizon Europe, Erasmus plus, EISMEA) deri në vitin 2022 - Rritje prej 20% në projektet fituese të këtyre iniciativave deri në vitin 2027 - Zbatim i aktiviteteve në lidhje me Shkencën e Hapur: publikim i të gjitha projekteve kërkimore kombëtare të financuar nga fondet publike (akses i lirë në rezultatet e projekteve) 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetje financiare për iniciativat. - Grante për aktorët e kërkimit dhe novacionit për të marrë pjesë në forume të tilla si EERA dhe ETIP 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Grante për aktorët e kërkimit dhe novacionit për përgatitjen e projekteve / prezantimit të propozimeve - Financimi i mjedisit mundësues (baza e të dhënave, takimet, trajnimet etj.) - Përmirësimi i kuadrit legjislativ për sa i përket klimës së biznesit - Lehtësimi i krijimit të një shoqërie të re (start-up) nga një shoqëri kërkimore ndëruniversitare - Nxitja e kërkimit shkencor dhe novacionit në nivel kombëtar dhe rajonal - Publikimi i mundësive, shembujve të praktikave të mira dhe historive të suksesit në mediat sociale, si dhe në portalet dhe faqet përkatëse të internetit
Buxheti (burimi)	<i>Buxheti i parashikuar është rreth 8,24 mln euro</i>
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit</i> <i>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit</i>
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi, Efiçenca e energjisë</i> <i>Buxheti i planifikuar është plotësues ndaj buxhetit të RIC-E2.</i>

Dimensioani i energjisë		5. Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca
Sektori		
Skenari i konsideruar për modelim	<i>WEM</i>	
Lloji i instrumentit	<i>Financiar</i>	
Titulli i PaM (kodi)	<i>Programi kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit (RIC-E2)</i>	
Periudha kohore	<i>2017 e në vazhdim</i>	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit" (AKKSHI)</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>Në krahasim me vitin 2018, buxheti vjetor i vitit 2020 është rritur me 60%.</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Rritja e përvitshme e shpenzimeve publike për kërkim shkencor që i jepen Institucioneve të Arsimit të Lartë</i> <i>Kjo PaM trajton (1) mungesat në buxhet, personelin dhe kushtet e punës (2) nevojën për përfundimin e kërkimit dhe novacionit në 6 fushat me përparësi duke përfshirë bujqësinë, mjedisin, ujin dhe energjinë dhe teknologjinë e informacionit.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Rritja e përvitshme e shpenzimeve publike për kërkim shkencor që i jepen Institucioneve të Arsimit të Lartë</i> - <i>Objektivi final është që shpenzimet për kërkim shkencor dhe novacion të arrijnë 2% të PBB-së deri në vitin 2022.</i> 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Mbështetje financiare për nismat e dedikuara të kërkimit dhe novacionit në lidhje me energjinë dhe klimën:</i> <ul style="list-style-type: none"> o <i>Kërkim i aplikuar (TRL 6-7)</i> o <i>Projekte demonstruese (TRL8-9)</i> o <i>Aktivitetet e hedhjes në treg</i> o <i>Fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit: "Biznes-Biznes" dhe "Biznes-Klient"</i> 	
Buxheti (burimi)	<i>0,6 mln euro (të parashikuara për vitin 2021)</i>	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe universitetet</i> <i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi, Efiçenca e energjisë</i>	

3.5.3 Novacioni dhe konkurrenca

Dimensioni i energjisë		5. Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca
Sektori		
Skenari i konsideruar për modelim Lloj i instrumentit	WAM Rregullator	
Titulli i PaM (kodi)	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS) (RIC-E3)	
Periudha kohore	2021 – 2027	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Shtylla 2: Zhvillimi ekonomik përmes rritjes së konkurrencës dhe novacionit. Në proces hartimi të modeleve sipas formateve IPSIS.	
Masat e marra deri më sot	Ministria e Financës dhe Ekonomisë planifikon të dizajnojë Strategjinë e re të zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS) dhe Planin e Veprimit 2021 –2027, me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).	
Objektivi kryesor i PaM	<p>Krijimi i një ekonomie shqiptare më konkurruese, e nxitur nga novacioni dhe e bazuar në njohuri që krijon vende të reja pune, të cilat shfrytëzojnë potencialin e tranzicionit digjital dhe transformimin e zinxhirëve të vlerave ndërkombëtare, si dhe përforcimin e zhvillimit të qëndrueshëm, integrimin në rajon dhe në BE.</p> <p>BIDS trajton pesë sfida kryesore a) një kuadër institucional për politikën e NVM-ve; b) aksesin e kufizuar për financimin e NVM-ve c) mospërputhjen e aftësive në tregun e punës dhe pak vende pune të krijuara ; d) aktivitetin e kufizuar të eksportit nga NVM-të shqiptare dhe e) aktivitetet e kufizuara të novacionit dhe shpenzime të kufizuara për kërkimin dhe zhvillimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - BIDS supozohet të përshkruajë transformimin struktural të dëshiruar dhe trajektoren e zhvillimit ekonomik. - BIDS do të harmonizohet me strategjitë dhe programet përkatëse të zhvillimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. - BIDS do të formojë një lidhje qendrore, që do të zhblokojë potencialin e ndërveprimeve me kuadrin strategjik. - BIDS do të ofrojë udhëzime për strategjitë e ardhshme rajonale/sectoriale, të cilat nxisin veprime prioritare ekzemplare me ndikim të madh që mund të ndërmerren përmes masave plotësuese. 	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Programe specifike trajnimi të disponueshme deri në vitin 2023 - Një pikë e vetme plotësisht funksionale për NVM-të deri në vitin 2023 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Finalizimi i kuadrit institucional për politikën e NVM-ve - Përmirësimi i aksesit në fonde për NVM-të <ul style="list-style-type: none"> o Një pikë e vetme për NVM-të - Përputhja e aftësive me tregun e punës dhe adresimi i krijimit të vendeve të pakta të punës <ul style="list-style-type: none"> o Vlerësimi i nevojave për të identifikuar fushat kyçe të ndërhyrjes, të tilla si ndërtimi dhe rinovimi o Përgatitja e kurrikulës për të gjitha nivelet arsimore, duke përfshirë fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të pakualifikuar o Krijimi institucional i programeve të trajnimit, duke përfshirë infrastrukturën trajnuese të nevojshme - Përmirësimi i aktivitetit të eksportit nga NVM-të shqiptare 	
Buxheti (burimi)	Nuk janë vlerësuar	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve) Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve)	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	Dekarbonizimi, Efiçenca e energjisë Përmirësimi i aktiviteteve të novacionit dhe shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin trajtohen nga RIC-E1 dhe RIC-E2.	

Dimensioni i energjisë		5. Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca
Skenari i konsideruar për modelim		Spektori
Lloji i instrumentit		WAM Financiar
Titulli i PaM (kodi)	<i>Demonstrimi i novacionit dhe konkurrencës (RIC-E4)</i>	
Periudha kohore	2021-2025	
Baza ligjore dhe dokumentet e planifikimit	<i>Strategjia e Specializimit Inteligjent në Shqipëri (konceptim i politikës për vendosjen e prioritetëve, sipas të cilës një rajon mund të përfitojë nga specializimi në një fushë të caktuar të shkencës dhe teknologjisë)</i>	
Masat e marra deri më sot	<i>U ndërmor një Strategjia e Specializimit Inteligjent, e mbështetur nga instituti Fraunhofer ISI. Janë identifikuar fushat me përparësi për Shqipërinë, të cilat janë të vlefshme për PKEK-un. Uji dhe energjia, bujqësia, ushqimet dhe bioteknologjia, biodiversiteti dhe mjedisi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK).</i>	
Objektivi kryesor i PaM	<i>Objektivi i përgjithshëm: Arritja e zhvillimit dhe punësimit, duke i mundësuar qarqeve të Shqipërisë që të identifikojnë dhe zhvillojnë avantazhet e tyre konkurruese specifike në fushat e Ujit dhe Energjisë, ushqimeve dhe bioteknologjisë, biodiversitetit dhe mjedisit, TIK-ut. Objektivi specifik: Të demonstrojë se si autoritete vendore, universitetet, bizneset dhe shoqëria civile e një qarku të caktuar punojnë bashkërisht për të zhvilluar avantazhin e tyre konkurrues specifik në një fushë me përparësi, si dhe përfitimet që sjell kjo gjë.</i>	
Rezultatet që duhet të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Studim fizibiliteti për projektin demonstrues, i disponueshëm deri në vitin 2022 - Projekt demonstrues që përfshin krijimin e infrastrukturës në nivel qarku për novacion dhe trajnim (seminare të përbashkëta, laboratore testimi, krijimi i hapësirave, etj.) deri në vitin 2025 	
Masat që duhet të zbatohen	<ul style="list-style-type: none"> - Sipas një qasjeje nga poshtë-lart, autoritetet vendore, universitetet, bizneset dhe shoqëria civile punojnë së bashku për të zbatuar strategjitë afatgjata të zhvillimit. <ul style="list-style-type: none"> o Vlerësimi i nevojave: Identifikimi i qarkut dhe fusha kryesore e ndërhyrjes o Studimi i fizibilitetit: ToR, Prokurimi, Zbatimi o Zbatimi i projektit demonstrues 	
Buxheti (burimi)	<i>Studim fizibiliteti: përlogaritja e kostos 150,000 euro; sugjerim për projektin e financuar nga donatorët. Kostoja dhe financimi i projektit demonstrues do të përcaktohet nga studimi i fizibilitetit.</i>	
Subjekti zbatues (Subjekti monitorues)	<i>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komuniteti i Biznesit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit</i>	
Marrëdhënia me dimensionet e tjera (nëse ka)	<i>Dekarbonizimi, Efiçenca e energjisë RIC-E1 dhe RIC-E2 trajtojnë rezultatet specifike si të tilla, ndërsa RIC-E4 fokusohet në bashkëpunimin e aktorëve të zinxhirit të vlerave dhe në mjedisin mundësues. RIC-E3 trajton aspektet rregullatore në lidhje me kuadrin institucional, aksesin në fonde dhe aftësitë.</i>	

SEKSIONI B: BAZA ANALITIKE

4 SITUATA AKTUALE DHE PROJEKSIONET LIDHUR ME POLITIKAT DHE MASAT EKZISTUESE

4.1. Evoluimi i projektuar i faktorëve ekzogjenë kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e sistemit të energjisë dhe të shkarkimeve të GES-ve.

i. Parashikimet në nivel makroekonomik (PBB-ja dhe shtimi i popullsisë)

Nxitësit makroekonomikë që janë objekt i kësaj analize bazohen në projeksionet më të përditësuara në dispozicion. Projektioni i PBB-së bazohet në përlllogaritjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (IMF 2021). Kjo gjë përfshin ndikimin që pandemia COVID-19 pati në zhvillimin ekonomik që nga viti 2020, me një rënie të PBB-së prej 7.7%. Faza e rikuperimit nis në vitin 2021 me një rritje të PBB-së prej 6.5%, e cila me kalimin e kohës ulet në 3.4% në vitin 2025-ën, duke mbajtur të njëjtën rritje vjetore deri në vitin 2040. Figura 18 tregon zhvillimin real të PBB-së (vlera monetare në vitin 2015).

Zhvillimi i popullsisë është harmonizuar me të dhënat zyrtare të Institutit Shqiptar të Statistikave, INSTAT, bazuar në skenarin e mesëm (Statistical Database 2021). Popullsia do të pësojë një tkurrje të lehtë nga 2,87 milionë në vitin 2018 në 2,76 milionë në vitin 2030 dhe deri në 2,60 milionë në vitin 2040. Figura 19 tregon zhvillimin e popullsisë.




Figura 18: Zhvillimi real i PBB-së për vitet 2012 - 2040




Figura 19: Zhvillimi i popullsisë për vitet 2012-2040

ii. *Ndryshimet sektoriale që pritet të kenë ndikim mbi sistemin e energjisë dhe shkarkimet e GES-ve.*

Krahas PBB-së dhe popullsisë, shpërndarja e vlerës së shtuar në sektorët me kërkesë për energji luan një rol të rëndësishëm në konsumimin e energjisë. Figura 20 tregon përqindjen e sektorit industrial, të shërbimeve dhe atij bujqësor ndërmjet viteve 1995 dhe 2018. Supozohet që përqindjet e vlerës së shtuar midis sektorëve janë në vazhdimësi të tendencave ekzistuese. Dinamika e rritjes së sektorit të shërbimeve pritet të vijojë të rrisë përqindjen relative të vlerës së shtuar.




Figura 20: Përqindja e vlerës së shtuar e sektorëve me kërkesë për energji, e analizuar shprehimisht në modelin ndërmjet viteve 1995-2018

Krahas ndikimeve në nivel makroekonomik, larmia e ndryshimeve strukturore ndikon në konsumin e energjisë në nivel sektorial. Pasojat më të rëndësishme paraqiten në vijim, të renditura sipas sektorit.

Sektori i banesave

Numri i pjesëtarëve në familje po ulet nga 3,9 persona për familje në vitin 2012, në 3,4 persona për familje në vitin 2030, duke u ulur më tej në 3,2 persona për familje në vitin 2040 (Statistical Database 2021). Sipërfaqja e banueshme për person konsiderohet të rritet nga 43.4m² në vitin 2012 në 46.6 m² në vitin 2018 deri në 52.6 m² në vitin 2030. Ajo do të rritet më tej në 59.2m² në vitin 2040. Në përgjithësi, sipërfaqja totale e banueshme do të rritet nga 125,7 milionë m² në vitin 2012 në 145 milionë m² në vitin 2030, si dhe vijon rritjen në 154 milionë m² në vitin 2040, pavarësisht reduktimit të popullsisë. Figura 21 Tregon zhvillimin e klasifikimit të ndërtesave sipas vjetërsisë në bazë të SLED-it SLED (2015), që këtu merret si projeksion. Shkalla e rikonstruksionit është e lartë, duke rezultuar në një përqindje sipërfaqeje të banueshme prej 37% deri në vitin 2040, e cila është ndërtuar ose rinovuar pas vitit 2015. Shkatërrimi më i theksuar vërehet në godinat e ndërtuara midis viteve 1961 dhe 1990.




Figura 21: Zhvillimi i sipërfaqes së banueshme sipas vitit të ndërtimit. Burimi: SLED 2015, përfaqësimi ynë

Është e dukshme edhe shpërndarja e sipërfaqes së banueshme në varësi të llojeve të ndryshme të ndërtesave. Në Tabela 12 klasifikohen këto lloje ndërtesash.

Lloji i ndërtesës	Numri i banesave për ndërtesë
Shtëpi të veçuara	1
Shtëpi pjesërisht të veçuara	2
Shtëpi në rend	3-4
Bloqe apartamentesh (pallate)	>4

Tabela 12: Ndarja e llojeve të ndërtesave

Me përqindjen relativisht të pandryshuar të shtëpive të veçuara, për sa i përket sipërfaqes së banueshme (duke u reduktuar nga 56,3% në vitin 2012 deri në 56,2% në vitin 2040), shtëpitë pjesërisht të veçuara dhe shtëpitë në rend kanë ndryshimin më të lartë në përqindje, duke u ulur nga 11,8% në 8,2% dhe nga 3,9% në 3,1% përkatësisht. Rritja më e madhe shihet në blloqet e apartamenteve, duke u ngritur nga 28,1% në vitin 2012 në 32,5% në vitin 2040.

Ndikimi i ndryshimit në përbërjen e banesave ul intensitetin e energjisë për shkak të konsumit të ulët të energjisë për sipërfaqe të banueshme në blloqet e apartamenteve krahasuar me llojet e ndërtesave më të vogla. Figura 22 tregon zhvillimin e sipërfaqes së banueshme sipas llojit të ndërtesës. Për më tepër, ndërtesat më të reja dhe më të mëdha kanë tendencën të përdorin një përqindje më të ulët të lëndës drusore si lëndë djegëse për ngrohjen e hapësirës dhe të ujit, duke i hapur shteg ngrohjes elektrike dhe gjithnjë e më shumë edhe pompave të nxehtësisë. Pritet të ketë një efekt kursyes në varësi të llojit të ndërtesës për përdorimin më të lartë të ngrohjes së hapësirave për shkak performancës energjetike të përmirësuar. Kësisoj, përhapja e pajisjeve ftohëse të hapësirave në banesa pritet të rritet ndjeshëm nga 45% në vitin 2012 në Zonat A dhe B në 71% në Zonën A dhe 74% në Zonën B, në vitin 2040. Në Zonën C, përhapja pritet të rritet nga 1,5% në vitin 2012 në 37% në vitin 2040. Kjo gjë çon në rritjen e konsumit të energjisë për ftohjen e hapësirave, që nuk kompensohet nga performanca energjetike e përmirësuar. Shkalla e rikonstruksionit të banesave rrjedhimisht ka përqindjen më të madhe në reduktimin e intensitetit energjetik dhe një kategorizim të ndryshueshëm të lëndëve djegëse të përdorura në sektorin e banesave. Përdorimi i lëndës drusore si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave reduktohet nga 33,2% në vitin 2012 në 26,7% në vitin 2040, kur nuk merren parasysh politikat dhe masat. Brenda të njëjtës periudhë, përdorimi i energjisë elektrike rritet nga 41,4% në 45,5%. Pjesa e mbetur mbulohet nga GLN-ja.

Intensiteti energjetik për ngrohjen dhe ftohjen e banesave përcaktohet nga gradë-ditët e ngrohjes (HDD) dhe gradë-ditët e ftohjes (CDD). Vlerat janë marrë për tre zona klimatike. Zona A është rajoni bregdetar me klimën më të ngrohtë, Zona B është pjesa qendrore duke përfshirë kryeqytetin, Tiranën, që ka klimë transitore ndërsa Zona C është pjesa lindore malore e vendit, me klimën më të ftohtë.

Gradë-ditët	Zona A	Zona B	Zona C
HDD (17,5°C)	1330	1534	2600
CDD (18,5°C)	870	760	350

Tabela 13: Gradë-ditët e ngrohjes dhe ftohjes (temperatura bazë e HDD: 17.5°C, temperatura bazë e CDD 18.5°C) Burimi: SLED 2015




Figura 22: Përqindja e llojeve të ndërtesave sipas sipërfaqes së banueshme. Burimi: SLED 2015, përfaqësimi ynë

Sektori i shërbimeve

Në sektorin e shërbimeve, nxitësi më i rëndësishëm është performanca e fortë e rritjes në vlerën e shtuar, siç tregohet në zhvillimin sektorial të ekonomisë në Figura 20. Në vitin 2040, sektori do të arrijë një vlerë të shtuar 2,6 herë më të lartë se vlera bazë e vitit 2012 (në vlerat reale të Euros). Performanca më e fuqishme e rritjes vjen nga nënsektorët e akomodimit dhe shërbimit ushqimor, duke u rritur 5,3-fish ndërmjet viteve 2012 dhe 2040.




Figura 23: Vlera e shtuar e nënsektorëve në sektorin e Shërbimeve, e normalizuar deri në vitin 2012

Industria

Në sektorin e industrisë, kërkesa për energji përcaktohet nga vëllimi i prodhimit, i cili nga ana e tij projektohet për t'u rritur së bashku me PBB-në. Ndarja e vlerës së shtuar ndërmjet nënsektorëve parashikohet të mbesë konstante, Sektori më i rëndësishëm për sa i përket kërkesës për energji është ai mineral, i cili mbizotërohet nga prodhimi i çimentos. Në vend prodhohet edhe një sasi e moderuar hekur-kromi dhe ka një prodhim të kufizuar të aluminit dhe plumbit të ricikluar. Përpunimi i ushqimeve, pijeve dhe duhanit nuk luan një rol të konsiderueshëm në konsumin e energjisë. Kërkesa për energji rritet në të gjithë sektorët me vëllimin e prodhimit, i cili rritet sipas projeksioneve të rritjes së PBB-së. Kjo gjë kompensohet pjesërisht nga një shtim i efikasitetit prej 0.1% në vit.

Transporti

Nxitësi kryesor i sektorit të transportit është kërkesa për lëvizshmëri, që vërehet në kërkesën gjithnjë e më rritje në vit për person/km, siç tregohet në Figura 24. Ky variabël ka përjetuar rritje të fortë në të shkuarën dhe parashikohet të vijojë rritjen me një shkallë të paprecedentë. Transporti i mallrave parashikohet që të rritet në paralel me PBB-në.

Krahas kërkesës totale për transport, përqindja midis mënyrave të transportit është një faktor i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë, shihni Figura 25 për shifrat lidhur me transportin e udhëtarëve. Transporti me makinë zë përqindjen më të madhe e transportit të udhëtarëve, ndërsa transporti me motoçikletë dhe sisteme navigimi zë një përqindje të vogël. Transporti i përbashkët dhe publik luan një rol të rëndësishëm, Transporti hekurudhor është i papërfillshëm, prandaj transporti me autobus është mënyra e vetme e transportit rrugor të përbashkët. Kjo gjë ka pësuar rënie nga 15,4% në vitin 2015 në më pak se 11% në vitin 2018. Kjo përqindje parashikohet të rikuperohet në 13,7% deri në vitin 2030 dhe të mbetet e qëndrueshme në periudhën më pas. Ajo përkon me një rritje të numrit total të kilometrave të autobusëve edhe pas vitit 2030 për shkak të rritjes së përgjithshme në sektorin e transportit. Një faktor

tjetër i rëndësishëm për rregullimin e kërkesës për energji në transportin e udhëtarëve është ngarkesa e mjeteve, por kjo gjë nuk parashikohet të ndryshojë përmes masave ekzistuese. Transporti i mallrave kryhet me kamionë dhe një përqindje e vogël në rrugë hekurudhore dhe me sisteme navigimi. Transporti i mallrave pritet që të rritet në paralel me PBB-në. Përqindjet ndërmjet këtyre mënyrave nuk do të pësojnë ndryshime deri në vitin 2040.




Figura 24: Kërkesa vjetore për transportin e udhëtarëve në Shqipëri, duke rezultuar në vlera historike dhe rritje të mëtejshme




Figura 25: Përqindjet e mënyrave të transportit të udhëtarëve në Shqipëri, të projektuara me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Kërkesa për energji në sektorin e transportit përcaktohet edhe nga teknologjia e përdorur për vënie në lëvizje dhe lëndët djegëse përkatëse. Siç është përmendur më lart, transporti i udhëtarëve dhe në veçanti ai me makina është nxitësi kryesor i kërkesës për energji. Figura 26 tregon se si teknologjitë e reja janë projektuar për të hyrë në stokun e automjeteve për transportin e udhëtarëve në Shqipëri. Parashikohet që të vijojë rritja e ndjeshme e automjeteve hibride benzinë-gaz. Teksa makinat e përdorura mbizotërojnë tregun e automjeteve dhe jetëgjatësia mesatare e makinave është rreth 14 vjet, asimilimi i teknologjive të reja, si p.sh. automjetet elektrike, nuk do të përmbillet deri në vitin 2040.




Figura 26: Përqindjet e teknologjive në transportin e udhëtarëve me makina sipas statistikave historike të automjeteve në vitet 2016-2018 dhe siç është projektuar duke marrë në konsideratë masat ekzistuese deri në vitin 2040

Motoçikletat	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Benzinë	16.0%	16.0%	16.0%	15.8%	15.4%	14.9%	14.2%	13.5%
Me benzinë; elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me benzinë-gaz								
Me Benzinë; Gaz; Elektrike								
Elektrike	0.1%	0.1%	0.1%	0.2%	0.5%	1.0%	3.3%	5.5%
Gaz				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me naftë dizel; Gaz								
Hidrogjen								
Me naftë dizel	83.9%	83.9%	83.9%	83.0%	80.8%	78.4%	74.6%	70.7%
Me naftë dizel; Elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Makinat								
Benzinë	15.0%	15.0%	15.0%	14.1%	13.4%	12.7%	11.7%	10.6%

Me benzinë; elektrike	0.1%	0.1%	0.1%	0.4%	1.1%	1.9%	2.7%	3.5%
Me benzinë-gaz	6.3%	6.3%	6.3%	7.7%	11.5%	15.2%	18.9%	22.6%
Me Benzinë; Gaz; Elektrike				0.5%	0.7%	1.0%	1.2%	1.4%
Elektrike				0.2%	0.5%	1.0%	3.3%	5.5%
Gaz				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me naftë dizel; Gaz				0.5%	0.7%	1.0%	1.2%	1.4%
Hidrogjen								
Me naftë dizel	78.7%	78.7%	78.7%	76.0%	69.9%	63.6%	55.8%	48.1%
Me naftë dizel; Elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Autobusët								
Benzinë	16.0%	16.0%	16.0%	16.0%	15.0%	15.0%	14.0%	13.0%
Me benzinë; elektrike	-	-	-	0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me benzinë-gaz								
Me Benzinë; Gaz; Elektrike	-	-	-					
Elektrike	-	-	-	0.1%	0.5%	1.0%	3.3%	5.5%
Gaz					1.0%	2.0%	3.0%	3.0%
Me naftë dizel; Gaz	-	-	-					
Hidrogjen	-	-	-	-	-	-	-	-
Me naftë dizel	84.0%	84.0%	84.0%	83.0%	81.0%	78.0%	74.0%	71.0%
Me naftë dizel; Elektrike	-	-	-	0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Kamionët								
Benzinë	15.9%	15.9%	15.9%	15.6%	15.0%	14.5%	13.9%	13.4%
Me benzinë; elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me benzinë-gaz	0.7%	0.7%	0.7%	0.8%	1.2%	1.6%	1.9%	2.3%
Me Benzinë; Gaz; Elektrike								
Elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Gaz				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%
Me naftë dizel; Gaz								
Hidrogjen								
Me naftë dizel	83.4%	83.4%	83.4%	82.3%	79.4%	76.5%	73.5%	70.6%
Me naftë dizel; Elektrike				0.3%	1.1%	1.9%	2.7%	3.4%

Tabela 14: Përqindjet e teknologjive në transportin e udhëtarëve sipas statistikave të automjeteve në vitet 2016-2018 dhe siç është projektuar duke marrë në konsideratë masat ekzistuese deri në vitin 2040

Sektorët e tjerë me kërkesë për energji

Sektorët e tjerë me kërkesë për energji dallohen sipas bilancit të energjisë së Shqipërisë, duke u ndarë në varësi të sektorëve të bujqësisë dhe peshkimit. Kërkesa për energji në sektorin bujqësor nxitet nga

vëllimi i prodhimit, i cili është rritur gjatë viteve të shkuara dhe aktualisht (rritje prej 39% në vitin 2030, rritje prej 83% në vitin 2040, krahasuar me vitin 2018). Prodhimi i produkteve të peshkimit nxitet nga rritja e PBB-së (rritje prej 40% në vitin 2030, rritje prej 95% në vitin 2040, krahasuar me vitin 2018). Shtimi i efikasitetit projektohet deri në 0.1% në vit për peshkimin dhe bujqësinë.

Mos shfrytëzimi jo-energjetik i mbajtësve të energjisë lidhet me prodhimin në sektorin e kimikateve (që rritet me PBB-në, më pak se 1% e kërkesës jo-energjetike) dhe me kërkesën totale për transport.

Transformimi i energjisë

Sektorin e transformimit të energjisë përfshin nxjerrjen e naftës, rafinimin, prodhimin e energjisë elektrike, transmetimin dhe shpërndarjen.

Shqipëria kishte rezerva të provuara naftë prej rreth 220 milionë fuçi në vitin 2018. Ajo nxirret në një kantier kryesor dhe rafinohet nga dy rafineri të vjetra. Për shkak të kapacitetit të kufizuar të rafinimit, një pjesë e mirë e naftës bruto eksportohet ndërsa produktet e naftës importohen.

Prodhimi i energjisë elektrike bazohet pothuajse ekskluzivisht në energjinë hidrike dhe rrjedhimisht rinovohet. Aspektet e sigurisë energjetike luajnë një rol gjithnjë e më të madh me ndryshimin e klimës dhe reduktimin e reshjeve. Vitet me klimë të thatë dhe prodhim të ulët hidroenergjetik, aktualisht nuk mund të kompensohen nga teknologji të tjera prodhimi. Zgjidhjet e mundshme përfshijnë forcimin e interkoneksionit në aspektin energjetik me vendet fqinje, në kombinim me zgjerimin e burimeve të tjera të rinovueshme, të tilla si energjia diellore ose eolike, të cilat i nënshtrohen ndryshimeve të përkohshme të ndryshme krahasuar me energjinë hidrike. Panelet diellore fotovoltaike pësojnë rritje në gjenerimin e energjisë me masa ekzistuese. Për më tepër, është marrë në konsideratë që termocentrali i Vlorës të furnizohet me gaz natyror. Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) ka nisur punën në fund të vitit 2020 dhe sjell gaz nga Azerbajxhani. Gazi ka natyrë shumë fleksibël në gjenerimin e energjisë por do të rrisë shkarkimet e GES të sektorit të prodhimit të energjisë elektrike. Mbështetja në gazin e importuar jo domosdoshmërisht e përmirëson situatën e sigurisë energjetike.

Teksa rrjetet e transmetimit janë solide dhe nuk pësojnë humbje shumë të larta, rrjetet e shpërndarjes pësojnë humbje të larta prej pothuajse 20%. Parashikohet që këto humbje të reduktohen nga masat ekzistuese në vitet e ardhshme.

Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve

Përqindja më e madhe e shkarkimeve të PIPP-ve (10,9% e shkarkimeve totale në vitin 2018 në lidhje me ekuivalentët e CO₂) rrjedh nga prodhimi i çimentos (85,6% e shkarkimeve të PIPP-ve), të cilat do të vazhdojnë të rriten bashkë me prodhimin e çimentos. Rritja parashikohet të vazhdojë në paralel me rritjen e PBB-së, e cila është gjerësisht në përputhje me rikonstruksionin në sektorin e banesave dhe kërkesën në sektorët e tjerë. Prodhimi i hekur-kromit (që rritet me PBB-në) rezulton po ashtu në një përqindje të vogël të shkarkimeve (4,7% e shkarkimeve PIPP-ve), siç rezulton edhe prodhimi i çelikut (1,8%) dhe i gëlqeres (1.1%). Tendencat e shkarkimeve të agjentëve ftohës që përdoren në vend të substancave që hollojnë shtresën e ozonit parashikohet të vazhdojnë rritjen deri në vitin 2024 me tendencat historike (Hidrofluorokarboni (HFC) 134a duke arritur në 60 tonë në vit, HFCan 227 duke arritur 15 tonë në vit, si substancat mbizotëruese deri më tani). Pas vitit 2024, shkarkimet e këtyre substancave nuk rriten më tej në përputhje me amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit.

Bujqësia

Zhvillimi i shkarkimeve nga burimet jo-energjetike në sektorin bujqësor (28,4% e shkarkimeve totale) përcaktohet nga gjëja e gjallë dhe praktikat bujqësore. Numri i të gjitha specieve të gjësë së gjallë ka qenë relativisht konstant në vitet e shkuara, me përjashtim të shpezëve dhe derrave. Numri i specieve

përkatëse rrjedhimisht e ka vazhduar këtë trend rritës. Praktikrat e menaxhimit të plehëruesve nuk parashikohet të ndryshojnë.




Figura 27: Gjëja e gjallë kronologjikisht dhe deri në vitin 2050

Krahas gjësë së gjallë, shkarkimet nga bujqësia vijnë nga praktikrat e menaxhimit të fushave. Përqindja e bujqësisë organike projektohet të rritet në 10% në vitin 2030 nga 1% në vitin 2018, por një rritje e mëtejshme nuk projektohet të ndodhë pas vitit 2030. Praktika e djegies së mbetjeve parashikohet të ndalojë deri në vitin 2025. Aplikimi i uresë do të përgjysmohet deri në vitin 2030, pa rënie të mëtejshme më pas.

LULUCF

Aktualisht, sektori i LULUCF është një burim shkarkimesh (12,1% e shkarkimeve totale), pasi kapaciteti natyror i përthithjes së karbonit nuk mund të kompensojë shkarkimet që vijnë nga menaxhimi i pyjeve. Kjo gjë nuk projektohet që të ndryshojë me masat ekzistuese. Zjarret në pyje janë një tjetër burim shkarkimesh, të cilat mund të bëhen një faktor mbizotërues në bilancin e përgjithshëm të GES-ve. Menaxhimi i përmirësuar i pyjeve mund të ndihmojë edhe në reduktimin e ndikimit dhe shpërndarjes së zjarreve në pyjeve, megjithatë vijon të projektohet një rritje në sipërfaqen mesatare të zjarreve (4.8kha), (rritje prej 50% deri në vitin 2050), pa marrë në konsideratë rastet e zjarreve të mëdha.

Mbetjet

Shkarkimet nga sektori i mbetjeve (10,8% e shkarkimeve totale, duke llogaritur mbetjet e ngurta dhe trajtimin e ujërave të ndotura)

Shkarkimet nga menaxhimi i mbetjeve të ngurta nxiten nga gjenerimi i përgjithshëm i mbetjeve për frymë, të cilat parashikohen të rriten nga 584 kg/frymë në vitin 2018 me një normë rritjeje vjetore prej 1,5% deri në përafërsisht 700 kg/frymë në vitin 2030 dhe 811 kg/frymë në vitin 2040. Më pas, menaxhimi i mbetjeve përcakton sasinë e shkarkimeve të gjeneruara. Aktualisht, mbetjet e ngurta mbetet gjerësisht të pamënaxhuara, të asgjësuar në vend-depozitime të hapura dhe që nuk janë të menaxhuara. Përmes politikave të caktuara, të miratuara ndërkohë nga Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, kjo praktikë pezullohet deri në vitin 2030. Menaxhimi i plotë i asgjësimit të mbetjeve të ngurta

do të arrihet deri në vitin 2030. Krahas kësaj, sasia e mbetjeve që grumbullohet në vend-depozitime do të reduktohet në 45% në vitin 2030 dhe në 24% në vitin 2035 (nga 81% që ishte në vitin 2018), me një sasi në rritje të riciklimit (që është rritur nga 14% në vitin 2018 në 38% në vitin 2030 dhe 46% në vitin 2035) dhe rritje të nivelit të djegies në impiantet e incinerimit të mbetjeve me rikuperim energjie (2,2% në vitin 2018, 4,4% në vitin 2025, 17% në vitin 2030 dhe 30% në vitin 2035). Aktualisht ekziston një përqindje e vogël incinerimi të pakontrolluar (1,8% në vitin 2018); praktika projektohet të reduktohet në vitet e ardhshme dhe të ndërpritet përfundimisht në vitin 2035.

Aktualisht, në Shqipëri ujërat e përdorura mbeten kryesisht të patrajtuara, por një grup politikash ekzistuese që është marrë në konsideratë edhe gjatë modelimit, ka si synim të arrijë një shkallë lidhjeje me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura prej 39% deri në vitin 2027. Modelimi parashikon lidhje të plotë në vitin 2050.

Politikat e pasqyruara në model

Tabelat e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të këtyre politikave të renditura si të vlefshme për skenarin e masave ekzistuese. Tregon se si politikat janë pasqyruar gjatë veprimtarisë së modelimit që është objekt i këtij dokumenti. Efektet kryesore janë përshkruar në paragrafët e mësipërm.

Shkurtimi	Emri	Efektet në variabël
ES-O3	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit	i nënkuptuar
ES-R1	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe Gazsjellësi Shqipëri – Kosovë	i nënkuptuar
ES-P2 (WEM)	Ndërtimet e reja të impianteve	Politika e hartuar pjesërisht për skenarin WEM (masat e marra deri në vitin 2019) dhe pjesërisht për skenarin WAM (masat e marra që nga viti 2020). Kjo listë përfshin pjesën WEM: <ul style="list-style-type: none"> • Impianti fotovoltaik lundruar i Vaut të Dejës (12,9 MW nga viti 2022) • Hidrocentrali i Moglicës (182,5 MW nga viti 2021)
G-B1	Politikat për mbështetjen e BRE për ngrohjen dhe ftohjen	Përqindja e paneleve diellore për ngrohjen e ujit do të rritet me 12 pikë përqindjeje (%) deri në vitin 2030 dhe me 20 pikë përqindjeje (%) deri në vitin 2050. Pompat e nxehtësisë që zëvendësojnë 50% të ngrohjes elektrike të ambienteve deri në vitin 2050, duke ulur intensitetin energjetik të ngrohjes së ambienteve.
EE-T3	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	Përqindja e përdorimit të automjeteve është si më poshtë, duke devijuar nga WEM autonome ¹⁷ në vitin 2023, përdorimi i hidrogjenit nis në vitin 2030. Makinë: Hibride-gaz (duke marrë shkas nga rritja autonome WEM, e cila arrin 5% në vitin 2050): 5% në vitin 2030; 10% në vitin 2050

¹⁷ Skenari i WEM autonome është baza teknike pa asnjë politikë.

		<p>Autobus: Automjet elektrik (EV): 3,5% në vitin 2030; 7% në vitin 2050; Hibride-gaz: 5% në vitin 2030; 30% në vitin 2050; Hidrogjen: 15% në vitin 2050</p> <p>Kamion: Hibride-gaz 4% në vitin 2030; 10% në vitin 2050; Hidrogjen: 0% në vitin 2030; 15% në vitin 2050</p> <p>Në të gjitha automjetet që punojnë me lëndë djegëse fosile vërehet një rënie e intensitetit energjetik të konsumuar me 10% ndërmjet viteve 2023 dhe 2033</p>
EE-T4	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (rrugët, hekurudhat dhe rrugët detare)	<p>Përqindja e transportit me autobus për person/km rritet (rreth 10% në vitin 2018) me 25% në vitin 2030 duke filluar në vitin 2019 (përkon me 12,5% të përqindjes totale, që është vlera e vitit 2012).</p> <p>Përqindja e transportit të udhëtarëve në rrugë hekurudhore rritet pas vitit 2024, duke shkuar në 2% në vitin 2030. Ai vazhdon të punojë me naftë.</p> <p>WEM sheh një rritje të konsiderueshme të kërkesës për transport.</p>
G-T3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës	Nuk është zbatuar shprehimisht, WEM autonome sheh një rritje të konsiderueshme të automjeteve hibride.
EM-I1	Interkonektorët e energjisë elektrike	i nënkuptuar
EM-I2	Reformat ne sektorin e energjisë elektrike	i nënkuptuar
ES-O4	Shtimi i kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	Rritja e kapacitetit të rafinimit nga 1000 deri në 1500 kilotonë të ekuivalentit të naftës (ktoe) të inputit të naftës bruto në vit duke nisur nga viti 2025. Reduktim i NO _x , SO ₂ dhe shkarkimeve të pluhurave në nivelet e direktivës së BE-së për shkarkimet industriale
ES-O5	Plani i emergjencës për gazin natyror	I nënkuptuar
R-E1 (WEM)	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla nga burimet e rinovueshme	40 MW në hidrocentral (në lumë të rrjedhshëm) të shtuar nga viti 2021 për çdo vit derisa të arrijë 320 MW në vitin 2028
R-E2 (WEM)	Ankandet për kapacitetet e reja nga burimet e rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë	<p>Parku Fotovoltaik i Spitalës (100 MW duke nisur nga viti 2023)</p> <p>Impianti fotovoltaik i Karavastasë (140 MW duke nisur nga viti 2023)</p> <p>Impianti eolik i Lezhës: 150 MW hyn në funksion në vitin 2024</p>
R-E3	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW	Rritja e kapacitetit është pjesë e R-E1
R-E4	Rrjet i fuqishëm elektrik për t’iu përgjigjur kapacitetit në rritje të energjisë së rinovueshme	Reduktim gradual i humbjeve të transmetimit nga 23,7% në vitin 2014 në 12% në vitin 2030

R-E5	Lehtësimi i lidhjes fizike dhe rregullatore	i nënkuptuar
R-E7	Strategjia e matjes dhe digjitalizimi i sektorit energjetik	i nënkuptuar
G-A1	Promovimi i bujqësisë organike	<p>Intensifikimi i bujqësisë organike, që ndikon në shkarkimet e N2O nga tokat e trajtuara. Intensifikimi i bujqësisë organike nga 1% në vitin 2012 në 4% në vitin 2020, tendenca vazhdon teksa PaM mbetet në fuqi deri në vitin 2030, duke arritur 8%.</p> <p>Aplikimi i uresë reduktohet me 50% ndërmjet viteve 2019 dhe 2030.</p> <p>Shkarkimet specifike të fushave jo-organike reduktohen me 10% ndërmjet viteve 2019 dhe 2030 për të pasqyruar një nivel më të mirë plehërimi.</p> <p>Bujqësia organike zë 5848 ha në vitin 2012, 6,9 kha tokë bujqësore në vitin 2012.</p>
G-A2	Monitorimi i tokave bujqësore	Nuk është modeluar.
G-A3	Djegia e tokave bujqësore	Sipërfaqja e djegies së tokave bujqësore do të reduktohet në 0 në vitin 2025, duke nisur që nga viti 2020.
G-W1	Reduktimi i emetimeve nga mbetjet	<p>Rritja e përqindjes së riciklimit në 40% në vitin 2035 (14,6% në vitin 2018) duke reduktuar sasinë totale që grumbullohet në vend-depozitime, duke ruajtur përbërjen.</p> <p>Mbyllja e të gjitha vend-depozitimeve të pamanaxhuara dhe të pakategorizuara deri në vitin 2035 (rënie lineare), duke i zëvendësuar me vend-depozitime të menaxhuara.</p> <p>Incinerimi dhe djegia në mjedis të hapur do të zbrasin në 0 deri në vitin 2035.</p> <p>Zbatohet masa e rikuperimit të metanit duke filluar në vitin 2025, duke rikuperuar 10% të shkarkimeve të CH4 nga vend-depozitimet në vitin 2030.</p> <p>Rregullore e miratuar në maj të vitit 2020, duke e bërë atë një kandidat të mundshëm për WAM.</p>
G-W2	Impiantet e incinerimit të mbetjeve	<p>Përqindja e mbetjeve që shkon për incinerim dyfishohet deri në vitin 2025 nga 2,2% që është aktualisht.</p> <p>Niveli i incinerimit shkon në 30% në vitin 2035, që përkon me sasinë prej 55% që grumbullohet në vend-depozitime dhe për incinerim.</p> <p>Rregullore e miratuar në maj të vitit 2020, duke e bërë atë një kandidat të mundshëm për WAM.</p>
G-W3	Trajtimi i ujërave të përdorura	<p>Norma e lidhjes me impiantin e ujërave të përdorura rritet ashtu siç përshkruhet te PaM, duke shkuar në 39% në vitin 2027. Kjo tendencë vijon derisa të arrijë 100% në vitin 2050.</p> <p>Në mënyrë që të mos rriten shkarkimet, sistemi i ujërave të përdorura duhet të jetë aerob dhe i mirë-menaxhuar, gjë që</p>

		parashikohet në model (shkarkimet e CH4 janë 0 në modelin e kësaj kategorie).
ES-O6	Miratimi i ligjit "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe produkteve të saj".	Nuk është zbatuar. Stoku i rezervave të naftës bruto të eksportuar nuk është modeluar në mënyrë të qartë.
RIC-E1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin energjetik	Nuk është zbatuar, nuk bën pjesë në objektin e modelimit.
RIC-E2	Programi kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit	Nuk është zbatuar, nuk bën pjesë në objektin e modelimit.
ES-P1	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	Disponueshmëria e termocentralit të Vlorës 8000 orë në vit (nga 0) dhe kalimi në operim me gaz natyror si lëndë djegëse kryesore duke nisur nga viti 2025. Kapacitet prej 97,17 MW

Tabela 15: Zbatimi në modelimin e politikave dhe masave të renditura në kreun 3, si të vlefshme për skenarin me masa ekzistuese

iii. Tendencat energjetike në nivel botëror, çmimet ndërkombëtare të lëndëve djegëse fosile, çmimi i karbonit sipas ETS të BE

Çmimi i naftës në model supozohet të ketë pësuar rënie në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19.

Figura 28 paraqet zhvillimin. Kjo gjë ndihmon në konsumin final të energjisë në sektorin e banesave, Zhvillimi i supozuar i çmimit të gazit paraqitet në Figura 29.

Çmimet e karbonit sipas ETS të BE nuk merren në konsideratë në skenarin e masave ekzistuese deri në vitin 2040. Vendosja e çmimit të karbonit konsiderohet pjesë e një politike shtesë, efekti i së ciksë përshkruhet në Seksionin 5. Në BE po zhvillohet një mekanizëm për rregullimin e kufijve të karbonit, por kjo gjë nuk është modeluar për të ndikuar në zhvillim.

Progresioni i ndryshimit të klimës rezulton në ndryshime për sa i përket disponueshmërisë së energjisë së rinovueshme. Teksa Shqipëria prodhon pothuajse 100% të energjisë elektrike nga burime hidroelektrike, ndryshimet përkatëse në ciklin e ujit kanë rëndësi thelbësore. Sipas një studimi të Bankës Botërore (World Bank ESMAP 2009), prodhimi nga rezervuarët e impianteve hidroelektrike pritet të rritet me 15% deri në vitin 2050. Pritet që prodhimi i impianteve hidroelektrike në lumenj të rrjedhshëm të pësojë një rënie prej 20%. Prodhimi i energjisë fotovoltaike pritet të rritet me 5% deri në vitin 2050. Për të studiuar efektet e viteve me disponueshmëri të ulët të burimeve ujore, ushtrimi i modelimit që është objekt i këtij dokumenti i konsideron vitet që kanë disponueshmëri të ulët hidrike çdo 5 vjet (duke filluar në vitin 2022). Në këto vite, disponueshmëria e hidrocentraleve konsiderohet të jetë vetëm 60% në raport me vitet e tjera. Efektet e këtij ushtrimi janë të dukshme në disa nga figurat e paraqitura në krerët e mëposhtëm.




Figura 28: Çmimi i naftës (dollarë/fuçi). Të dhënat historike sipas treguesit referencë të naftës bruto për Evropën (Brent), Burimi: Enerdata, Mesatarja botërore e të dhënave të projeksionit Burimi: World Bank 2021




Figura 29: Çmimi i gazit natyror (dollarë/Mil BTU). Burimi: World Bank 2021

iv. *Progresi i kostove teknologjike*

Gjatë prodhimit të energjisë elektrike, teknologjitë më të rëndësishme të përdorura janë rezervuarët e impianteve hidroelektrike, të ndjekura nga impiantet hidroelektrike në lumenj të rrjedhshëm dhe në rritje e sipër renditet energjia fotovoltaike. Termocentrali i Vlorës u përfundua në vitin 2011, por asnjëherë

nuk është bërë funksional. Planifikohet rijetësimi i impiantit që përdor gaz natyror, i cili fillimisht punonte me naftë, pas përfundimit të Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) për gaz natyror.

Supozimet e kostove jepen në Tabela 16. Tabela paraqet kostot përkatëse për dispeçim. Krahas kësaj, kostot totale të sistemit përcaktohen edhe nga kostot e kapitalit të investimeve. Ndonëse sistemet tradicionale energjetike nuk pritet të pësojnë ulje në kostot e investimit, impiantet eolike dhe diellore do të vijojnë të jenë objekt i një rënieje të ndjeshme në kostot e investimeve. Vini re se këto kosto aktualisht nuk cenojnë dispeçimin në sistemin Shqiptar të energjisë elektrike.

Teknologjia e prodhimit të energjisë elektrike	2019	2040
Hidroelektrike Kostoja fikse e operimit dhe mirëmbajtjes (dollarë/kapaciteti MW _{el})	60 000	60 000
Energji fotovoltaike Kostoja e ndryshueshme e operimit dhe mirëmbajtjes (dollarë/prodhimi MWh _{el})	10	10
Energji eolike në tokë Kostoja e ndryshueshme e operimit dhe mirëmbajtjes (dollarë/prodhimi MWh _{el})	15	15
Energji termike Kostoja e ndryshueshme e operimit dhe mirëmbajtjes (dollarë/prodhimi MWh _{el})	89	113
Energji termike, gaz natyror Kostoja e ndryshueshme e operimit dhe mirëmbajtjes (dollarë/prodhimi MWh _{el})	60	85

* merr në konsideratë një efikasitet përpunimi prej 48.06%

Tabela 16: Kostot e prodhimit të energjisë elektrike sipas teknologjisë. Burimi: IEA Global Energy Outlook 2020, Analiza e kostove për energjinë hidrike nga agjencia IRENA

4.2. Dimensioni i dekarbonizimit

4.2.1 Shkarkimet dhe eliminimi i GES-ve

i. Tendencat në shkarkimet dhe eliminimin e GES-ve sipas ETS-së të BE-së, përpjekjet e përbashkëta dhe sektorët LULUCF, si dhe sektorët e ndryshëm të energjisë

Tendencat afatgjata lidhur me shkarkimet e GES-ve nuk mund të vlerësohen me lehtësi për Shqipërinë, për shkak të statistikave të kufizuara në dispozicion, veçanërisht në sektorët jo-energjetikë. Disa burime të dhënash, pjesërisht krahasuese, janë vlerësuar dhe përpiluar sipas njohurive më të mira, kryesisht duke u bazuar në Bazën e të dhënave statistikore të vitit 2021 Statistical Database 2021 (2021), e plotësuar nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ekspertët lokalë, Raporti Dyvjeçar i Përditësimit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 2021). Dokumentacioni i detajuar i modelit mund të vihet në dispozicion. Bilanci i energjisë sipas nënsektorëve është i disponueshëm duke nisur vetëm nga viti 2016. Për këtë arsye, trendet historike paraqiten këtu duke filluar nga ai vit. Trendet aktuale paraqiten deri më dhe duke përfshirë vitin 2018. Veprimtaria e modelimit që është objekt i këtij dokumenti nis projektimin në vitin 2019. Për të përmbledhur më mirë zhvillimet historike dhe projeksionet e ardhshme duke marrë parasysh masat ekzistuese, figurat dhe tabelat paraqiten këtu vetëm një herë, në seksionin e mëposhtëm.

ii. *Projeksionet e zhvillimeve sektoriale me politikat dhe masat ekzistuese në nivel kombëtar dhe BE-je, të paktën deri në vitin 2040 (duke përfshirë edhe vitin 2030)*

Duke marrë në konsideratë masat e klasifikuara si WEM në kreun 3, dhe të përmbledhura në Tabela 15, imazhet dhe tabelat e mëposhtme paraqesin shkarkimet e GES-ve për sektorë të ndryshëm. Sipas rastit, shkarkimet ndahen në nënsektorë, duke paraqitur një nivel në rritje të detajit sektorial.

Për t'i kuptuar më qartë, këto imazhe tregojnë vlerat për tendencat historike duke nisur nga viti 2016 deri në vitin 2018, të pasuara nga projeksionet deri në vitin 2040. Tabela 17 Rëndit vlerat historike të paraqitura në imazhe, si dhe projeksionet për vitet 2020, 2025, 2030, 2035 dhe 2040.

Tendenca e përgjithshme e shkarkimeve është në rritje (Figura 30), me shkarkime të kufizuara nga sektori i transformimit të energjisë. Në vitet me klimë të thatë (çdo pesë vjet ose në çdo dy dhe shtatë vite), shkarkimet rriten me përdorimin e shtuar të termocentralit. Figura 31 paraqet shkarkimet e drejtpërdrejta nga sektorët me kërkesë për energji. Nxitësi kryesor është sektori i transportit, i ndjekur nga ai industrial. Kini parasysh se këto shkarkime industriale janë vetëm shkarkimet në lidhje me energjinë.




Figura 30: Shkarkimet e GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për ekonominë në tërësi për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019- deri në 2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 31: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për sektorët me kërkesë për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

Imazhet e mëposhtme (Figura 32 deri në Figura 36) paraqesin shkarkimet nga nënsektorë të ndryshëm. Në sektorin e banesave, një ndryshim në strukturën e strehimit dhe ndryshimi teknologjik për ngrohje dhe ujë të ngruhtë rezultojnë në një reduktim modest të shkarkimeve. Në sektorin e shërbimeve, shkarkimet totale mbeten relativisht konstante dhe ndryshimet shihen vetëm te nënsektorët. Teksa kërkesa për energji në industri (e nxitur nga rritja në prodhim) sheh një rritje së bashku me PBB-në, shkarkimet rriten tej mase, ndërsa sektori minerar, p.sh. sektori i prodhimit të çimentos mbetet deri më tani burimi më madhor i shkarkimeve. Vini re se ky nënsektor dekarbonizohet me vështirësi dhe elektrifikohet shumë pak, në dallim nga nënsektorët e tjerë, të tillë si sektori i prodhimit të aliazheve të hekurit, që kryhet në furnalata me hark elektrik pa shkarkime lokale lidhur me energjinë. Shkarkimet nga sektori i transportit vijnë të rriten, ndërkohë që elektrifikimi i transportit rrugor nuk mund të kompensojë rritjen e kërkesës për lëvizshmëri.

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 32: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për sektorin e banesave për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 33: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për sektorin e shërbimeve për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 34: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për industrinë (me kërkesë për energji) për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 35: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për sektorin e transportit për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

Shkarkimet nga sektori i transformimit të energjisë përcaktohen pjesërisht nga prodhimi i energjisë elektrike në termocentralin e Vlorës, i cili i nënshtrohet rioperimit me gaz natyror. Sidoqoftë, me hidrocentralet ekzistuese dhe planet përkatëse, përdorimi i këtij centrali është i kufizuar në vitet me

klime të thatë me disponueshmëri të ulët të burimeve ujore. Vetëm në gjysmën e dytë të viteve 2030 kërkesa për energji elektrike rritet në ato nivele që kërkojnë përdorimin e centralit në çdo vit. Krahas gjenerimit të energjisë, shkarkimet nga sektori i transformimit të energjisë përcaktohen nga nxjerrja e naftës dhe veprimtaria e rafinimit, e cila është relativisht konstante në skenarin WEM, me përjashtim të një rritjeje të vogël në vitin 2025.

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 36: Shkarkimet e drejtpërdrejta të GES-ve (ekuivalentët e CO₂) për sektorin e transformimit të energjisë për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

Figura 37 paraqet shkarkimet nga burimet jo-energjetike. Teksa shkarkimet nga bujqësia mbeten konstante, sektori LULUCF mbetet burim shkarkimesh. Shkarkimet e sektorit të mbetjeve bien pas vitit 2025, ndërsa shkarkimet nga PIPP vazhdojnë të rriten edhe pas vitit 2030. Këto sektorë trajtohen më me hollësi në vijim.

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 37: Shkarkimet e GES-ve nga burime jo-energjetike (ekuivalentët e CO₂) për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

Duke vështruar Figura 38, duket qartë që prodhimi i çimentos është gjithashtu nxitësi kryesor i shkarkimeve të PIPP, ashtu si për shkarkimet energjetike. Kini parasysh: Teksa sektorët e tjerë industrialë luajnë një rol të vogël, është me rëndësi të rregullohen shkarkimet e agentëve ftohës të përdorur në vend të substancave që hollojnë shtresën e ozonit, që janë burimi i dytë më i madh i shkarkimeve në sektorin e PIPP. Pjesa më e madhe e shkarkimeve nga bujqësia (Figura 39) vjen nga fermentimi enterik, i cili nuk parashikohet të ndryshojë pasi numri i gjësë së gjallë do të mbetet pothuajse i pandryshuar. Një reduktim i vogël në këtë sektor arrihet me reduktimin e aplikimit të uresë. Shkarkimet e LULUCF (Figura 40) projektohen të mbeten më shumë pozitive. Kapaciteti natyror i përthithjes së karbonit në pyje nuk mund të kompensojë shkarkimet për shkak të menaxhimit të pyjeve. Rastet e shumta të zjarreve në pyje nuk janë marrë parasysh në model, por sipërfaqja mesatare e prekur nga zjarret në pyje projektohet të rritet. Shkarkimet e sektorit të mbetjeve (Figura 41) pësojnë rënie për shkak të një ndryshimi në praktikën e menaxhimit të asgjësimit të mbetjeve të ngurta, ndryshimit të përqindjeve të riciklimit dhe menaxhimit të vend-asgjësimit të mbetjeve. Kjo gjë nuk rezulton në rënie totale të shkarkimeve, teksa vend-asgjësimet ekzistuese të mbetjeve vijojnë të shkarkojnë. Reduktimet e shkarkimeve arrihen edhe nga një ndryshim në praktikën e menaxhimit të ujërave të përdorura, duke devijuar kryesisht nga shkarkimet e drejtpërdrejta në lumenj në vende të mirë-menaxhuara pa shkarkime metani.

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 38: Shkarkimet e GES-ve (ekuivalentët e CO₂) nga proceset industriale dhe përdorimi i produkteve për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 39: Shkarkimet e GES-ve nga burime jo-energetike (ekuivalentët e CO₂) nga veprimtaritë bujqësore për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 40: Shkarkimet e GES-ve nga burime jo-energjetike (ekuivalentët e CO₂) nga përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimi të tokës dhe pyjet (LULUCF) për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

100-Year GWP: Direct (At Point of Emissions)

Scenario: WEM, All Fuels, All GHGs




Figura 41: Shkarkimet e GES-ve nga burime jo-energjetike (ekuivalentët e CO₂) për sektorin e mbetjeve për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar për vitet 2019-2040

Tabela e mëposhtme paraqet shkarkimet e sektorëve, nënsektorëve dhe degëve të ndryshme të sistemit të energjisë në Shqipëri, siç është projektuar me masat ekzistuese, për sa i përket kt CO2eq (potenciali i ngrohjes globale për 100 vite).

Dega [ekuivalentët e CO2 në kilotonë]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Kërkesa	3903,9	4331,4	4396,3	4346,4	4963,6	5507,8	6025,9	6636,8
Transformimi	181,7	220,4	179,0	199,2	250,8	250,8	267,8	372,7
Konsumi joenergjetik	6253,7	7056,3	6314,6	6365,2	6721,6	6811,3	7001,3	7196,2
Totali	10339,3	11608,1	10889,9	10910,9	11936,0	12569,9	13295,0	14205,7
Kërkesa								
Sektori i banesave	338,4	333,8	328,9	323,6	297,7	275,6	262,6	257,0
Shërbimet	180,9	200,7	221,2	199,2	205,0	206,8	207,4	205,5
Industria	637,3	985,9	1047,8	988,6	1232,5	1449,5	1704,7	2004,8
Transporti	2487,4	2518,7	2497,4	2530,6	2869,2	3160,9	3371,8	3615,5
Bujqësia Pylltaria	171,0	174,5	184,4	194,4	222,1	253,7	289,7	330,9
Peshkimi	88,9	117,7	116,6	110,0	137,2	161,3	189,7	223,1
Totali	3903,9	4331,4	4396,3	4346,4	4963,6	5507,8	6025,9	6636,8
Kërkesa - Banesa								
Ngrohja e hapësirave	303,6	300,1	296,4	291,2	265,8	245,3	231,0	223,8
Pajisjet elektro-shtëpiake	33,6	32,6	31,6	31,5	31,4	29,8	31,3	32,9
Ftohja e hapësirave	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ngrohja e ujit	1,2	1,1	1,0	0,9	0,6	0,4	0,3	0,3
Totali	338,4	333,8	328,9	323,6	297,7	275,6	262,6	257,0
Kërkesa - Shërbimet								
Tregtia	48,9	52,3	57,7	52,3	58,8	62,9	64,7	64,0
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	10,0	11,8	14,2	12,1	15,8	19,2	21,6	22,7
Administrata publike	22,1	25,4	27,5	25,7	22,1	19,1	16,7	14,5
Arsimi	15,1	17,3	18,6	17,4	14,9	12,9	11,2	9,8
Shëndetësia	16,5	18,8	21,2	19,8	17,0	14,7	12,8	11,2
Shërbime të tjera	68,2	75,1	81,9	71,9	76,5	78,0	80,3	83,3
Totali	180,9	200,7	221,2	199,2	205,0	206,8	207,4	205,5
Kërkesa - Industria								
Hekuri dhe çeliku	10,2	15,9	9,5	9,0	11,2	13,1	15,5	18,2
Metalet joferrrike	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Kimike	21,5	22,9	22,2	21,0	26,1	30,8	36,2	42,5
Minerar	470,0	758,0	847,3	799,4	996,6	1172,1	1378,4	1621,1
Nxjerrja e xeheroreve	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ushqimet, Pijet, Duhani	68,0	79,3	68,8	64,9	80,9	95,1	111,9	131,5

Dega [ekuivalentët e CO2 në kilotonë]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Spektori i tekstilit, veshmbathjet e lëkurës	5,8	6,6	6,6	6,2	7,8	9,1	10,8	12,6
Shtypshkronja	3,8	4,3	4,3	4,1	5,1	5,9	7,0	8,2
Inxhinieria Metale të tjera	3,1	6,3	6,5	6,1	7,7	9,0	10,6	12,5
Të tjera	54,7	92,8	82,6	78,0	97,2	114,3	134,5	158,1
Totali	637,3	985,9	1047,8	988,6	1232,5	1449,5	1704,7	2004,8
Kërkesa - Transporti								
I udhëtarëve	1691,4	1720,8	1697,9	1782,4	1958,6	2122,1	2228,7	2364,5
I mallrave	796,0	798,0	799,4	748,2	910,5	1038,9	1143,1	1250,9
Totali	2487,4	2518,7	2497,4	2530,6	2869,2	3160,9	3371,8	3615,5
Transformimi								
Prodhimi i energjisë elektrike	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	17,0	121,9
Rafinimi i naftës	29,1	81,8	47,4	22,1	73,7	73,7	73,7	73,7
Nxjerrja e naftës	152,6	138,6	131,6	177,1	177,1	177,1	177,1	177,1
Totali	181,7	220,4	179,0	199,2	250,8	250,8	267,8	372,7
Jo-energjetik								
PIPP	1216,8	1224,9	1233,1	1186,5	1494,2	1742,1	2035,1	2381,4
Bujqësia	2472,7	2415,0	2376,6	2366,6	2327,7	2290,1	2294,1	2298,4
LULUCF	1356,7	2117,9	1361,2	1431,6	1445,7	1459,9	1474,1	1488,4
Mbetjet	1207,4	1298,4	1343,7	1380,6	1454,0	1319,2	1198,0	1028,0
Totali	6253,7	7056,3	6314,6	6365,2	6721,6	6811,3	7001,3	7196,2
Jo-energjetik - PIPP								
CO ₂ nga industria e çimentos	1056,3	1056,3	1056,3	998,6	1251,2	1478,9	1748,0	2066,1
CO ₂ nga industria e gëlqerës	13,8	13,8	13,8	13,0	16,3	19,3	22,8	27,0
CO ₂ nga industria e qelqit	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga karbonatet e tjera	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga industria e prodhimit të çelikut dhe hekurit	22,1	22,1	22,1	20,9	26,2	31,0	36,6	43,3
CO ₂ nga aliazhet e hekurit	57,9	57,9	57,9	54,8	68,6	81,1	95,8	113,3
HFC134a	40,5	45,2	49,9	59,2	78,0	78,0	78,0	78,0
HFC227ea	26,1	29,5	33,0	39,8	53,6	53,6	53,6	53,6
Ekuivalentët e CO ₂ nga R404a	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1
Ekuivalentët e CO ₂ nga R407a	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ekuivalentët e CO ₂ nga R410a	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1

Dega [ekuivalentët e CO ₂ në kilotonë]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Ekuivalentët e CO ₂ nga R507a	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	1216,8	1224,9	1233,1	1186,5	1494,2	1742,1	2035,1	2381,4
Jo-energjetike - Bujqësia								
CH ₄ nga fermentimi enterik	1778,2	1730,5	1697,5	1697,7	1698,3	1698,8	1699,4	1700,1
CH ₄ nga menaxhimi i plehëruesve	295,1	287,5	283,8	284,3	286,7	289,3	292,0	295,0
N ₂ O nga menaxhimi i plehëruesve	99,0	96,4	94,8	94,7	95,3	95,8	96,4	97,0
N ₂ O nga menaxhimi i tokave	155,8	155,8	155,8	151,6	142,9	134,3	134,3	134,3
CO ₂ nga kalcifikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga aplikimi i uresë	143,8	143,8	143,8	137,3	104,6	71,9	71,9	71,9
CH ₄ nga djegia e fushave	0,7	0,7	0,7	0,7	0,0	0,0	0,0	0,0
N ₂ O nga djegia e fushave	0,2	0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	2472,7	2415,0	2376,6	2366,6	2327,7	2290,1	2294,1	2298,4
Jo-energjetik - LUCLUF								
CO ₂ nga kultivimi i produkteve pyjore drusore	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga shkarkimet pyjore	3344,6	3344,6	3344,6	3344,6	3344,6	3344,6	3344,6	3344,6
CO ₂ nga shpyllëzimi	-2161,6	-2161,6	-2161,6	-2161,6	-2161,6	-2161,6	-2161,6	-2161,6
CO ₂ nga zjarret në pyje	80,2	841,3	84,7	154,2	165,8	177,5	189,2	200,9
CH ₄ nga zjarret në pyje	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
N ₂ O nga zjarret në pyje	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga tokat bujqësore	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga kullotat	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga ligatinat	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
CO ₂ nga banesat	93,5	93,5	93,5	94,5	96,9	99,4	101,9	104,6
CO ₂ nga toka të tjera	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	1356,7	2117,9	1361,2	1431,6	1445,7	1459,9	1474,1	1488,4
Jo-energjetik - Mbetjet								
CH ₄ nga mbetjet e ngurta	1024,3	1115,8	1161,4	1201,1	1289,4	1186,4	1085,1	935,1
CH ₄ nga ujërat e përdorura	115,4	115,3	115,0	112,8	98,9	68,5	50,1	32,3
N ₂ O nga ujërat e përdorura	67,1	67,0	66,8	66,6	65,7	64,3	62,8	60,6
CH ₄ nga djegia	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
N ₂ O nga djegia	0,6	0,3	0,4	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	1207,4	1298,4	1343,7	1380,6	1454,0	1319,2	1198,0	1028,0

Tabela 17: Shkarkimet e GES-ve (kt CO₂eq) për degë të ndryshme të ekonomisë për periudhën kohore (2016-2018) dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040.

Disa nga shkarkimet përlllogariten për gazet e ndryshme nga CO₂. Siç vërehet më lart, ato jepen në lidhje me ekuivalentin e potencialit të CO₂ të tyre për ngrohjen globale për 100 vite. Për ta plotësuar, tabela e mëposhtme paraqet faktorin e përdorur për të përlllogaritur këtë vlerë nga shkarkimet fizike të gazeve përkatëse. Vini re se disa nga hidrofluorokarburet raportohen dhe projektohen për sa i përket drejtpërsëdrejti ekuivalentëve të dyoksidit të karbonit.

Efekti	Shkurtimi	Potenciali i ngrohjes globale për 100 vite (tCO ₂ eq/t)
Dyoksidi i karbonit	CO ₂	1
Metani	CH ₄	30
Oksidi i azotit	N ₂ O	265
HFC-134a	CH ₂ FCF ₃	1300
HFC-227ea	CF ₃ CHFCF ₃	3350

Tabela 18: Potenciali i ngrohjes globale për 100 vite për gazet e marra në konsideratë në projektion.

4.2.2 Energjia e rinovueshme

- i. *Përqindja aktuale e energjisë së rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë dhe në sektorë të ndryshëm (ngrohja dhe ftohja, energjia elektrike dhe transporti), si dhe për teknologjinë në secilin nga këta sektorë.*

Vlerat aktuale në energjinë e rinovueshme trajtohen së bashku me projektionet me masat ekzistuese në seksionin e ardhshëm.

- ii. *Projektionet treguese të zhvillimit me politikat ekzistuese për vitin 2030 (me një parashikim për vitin 2040)*

Objektivat aktuale në energjinë e rinovueshme përcaktohen në totalin e furnizimit me energji primare (TFEP). Për referencë, tabela e mëposhtme paraqet përqindjen aktuale të energjisë së rinovueshme në TFEP dhe projektionin deri në vitin 2040 duke marrë në konsideratë masat ekzistuese. Figura 42 dhe Tabela 19 paraqet vlerat absolute të burimeve të energjisë së rinovueshme në furnizimin neto me energji primare, dhe tregon përqindjet e mbajtësve të energjisë së rinovueshme në TEFP. Më shumë detaje për TFEP, veçanërisht në kategorizimin e lëndëve djegëse me lëndët djegëse fosile jepen në seksionin 4.3.




Figura 42: Burimet e rinovueshme të furnizimit me energji primare dhe totali i konsumit neto për periudhën kohore (2016-2018) dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040.

	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Lënda drusore si lëndë djegëse	154,1	149,4	150,0	146,6	141,7	136,4	131,1	132,1
Eolike	0,0	0,0	0,0	0,0	28,2	28,2	28,2	28,2
Diellore	11,1	12,0	13,2	16,5	54,7	58,9	61,7	65,0
Hidrike	613,6	388,7	736,1	576,2	542,2	582,1	646,0	686,8
Hidrogjen	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	8,2	19,4
Mbetjet e ngurta urbane	0,0	0,0	0,0	0,4	0,0	0,0	0,2	1,3
Biomasa	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Biodizel	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	2275,8	2361,3	2342,7	2273,2	2552,4	2773,8	3027,9	3358,9

Tabela 19: Vlerat absolute për disa lëndë djegëse në TFEP, të shprehura në ktqe, në veçanti ato të marra në konsideratë për përqindjet e rinovueshme të TFEP.

Dega	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Lënda drusore si lëndë djegëse	6.8%	6.3%	6.4%	6.4%	5.6%	4.9%	4.3%	3.9%
Eolike	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	1.1%	1.0%	0.9%	0.8%
Diellore	0.5%	0.5%	0.6%	0.7%	2.1%	2.1%	2.0%	1.9%
Hidrike	27.0%	16.5%	31.4%	25.3%	21.2%	21.0%	21.3%	20.4%
Hidrogjen	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%	0.6%
Mbetjet e ngurta urbane	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Biomasa	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Biodizel	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Totali	34.2%	23.3%	38.4%	32.5%	30.0%	29.0%	28.9%	27.8%

Tabela 20: Përqindjet në TEFP për lëndët djegëse të marra në konsideratë në përqindjen e rinovueshme të TEFP.

Për qindjet e rinovueshme në konsumin final të energjisë përcaktohen sipas Direktivës 2009/28/KE (“Për energjinë e rinovueshme (RED)”; EU (2009); shihni gjithashtu European Commission (2018)). Imazhet e mëposhtme paraqesin të dhëna historike sipas për qindjes së BRE për vitet 2016-2018 dhe projeksionet me masat ekzistuese. Për për qindjen në sektorin e transportit (BRE-T), kjo përfshin shumëfishuesit për përdorimin e energjisë elektrike në transportin rrugor dhe hekurudhor, gjë që shpjegon rritjen e fuqishme (energji elektrike përdoret për të përmbushur pak më shumë se 5% të kërkesës finale për energji në sektorin e transportit në vitin 2040). Nuk janë marrë në konsideratë biokarburantet e avancuara (me shumëfishues të shtuar). Për qindja e energjisë së rinovueshme për ngrohjen dhe ftohjen (BRE-N & F) ulet teksa për qindja e lëndës drusore si lëndë djegëse për ngrohje reduktohet. Për qindja e energjisë elektrike të rinovueshme (BRE-E) përcaktohet gjerësisht nga prodhimi hidroenergjetik, ndërkohë që parashikohen rritje për panelet diellore. Imazhet e mëposhtme japin detaje teknologjike për secilin tregues BRE.




Figura 43: Përqindjet e BRE-ve në kërkesën finale për energji, të përlogaritura sipas RED (Direktiva 2009/28/KE) për periudhën kohore 2016-2018 dhe projeksionet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

[%]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
BRE-E	92,8	96,4	95,4	112,6	122,5	106,9	89,6	82,4
BRE-T	0,1	0,1	0,1	2,5	8,6	19,8	29,6	36,5
BRE-N & F	22,3	20,4	21,1	21,4	19,0	17,2	15,2	14,0
BRE	36,7	37,0	37,9	39,2	39,1	33,5	28,9	27,2

Tabela 21: Përqindjet e BRE-ve në kërkesën finale për energji, të përlogaritura sipas RED (Direktiva 2009/28/KE) për periudhën kohore 2016-2018 dhe projeksionet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese




Figura 44: Përqindja e BRE-E (përqindja e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike) të përlogaritura sipas RED (Direktiva 2009/28/KE) për periudhën kohore 2016-2018 dhe projeksionet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

[%]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Hidrike	92,8	96,4	95,4	112,0	110,1	96,6	80,3	74,1
Eolike	0,0	0,0	0,0	0,0	6,2	4,4	3,9	3,5
Diellore	0,0	0,0	0,0	0,6	6,2	5,9	5,4	4,9
Lëndët djegëse të ngurta	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Të gjitha burimet e tjera të rinovueshme	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
BRE-E totale	92,8	96,4	95,4	112,6	122,5	106,9	89,6	82,4

Tabela 22: Përqindja e BRE-E (përqindja e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike) të përlogaritura sipas RED (Direktiva 2009/28/KE) për periudhën kohore 2016-2018 dhe projeksionet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

Imazhi i mëposhtëm paraqet lëndët djegëse që përdoren aktualisht në sektorin e transportit, si dhe projeksione deri në vitin 2040. Nuk janë marrë në konsideratë për qindjet e biodizelit, dhe kjo gjë nuk projektohet të ndikojë në masat ekzistuese. Energjia elektrike përdoret për të përmbushur një kërkesë të kufizuar të kërkesës për energji në sektorin e transportit. Ajo është kryesisht e rinovueshme.




Figura 45: Burimet e energjisë në sektorin e transportit, për të shoqëruar dhe shpjeguar përqindjen e BRE-T, të paraqitur në Figura 43

Lënda djegëse	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Energji elektrike	0.0%	0.0%	0.0%	0.5%	1.7%	4.0%	6.1%	8.3%
Benzinë	16.4%	16.4%	16.3%	16.5%	17.4%	18.4%	19.3%	20.4%
Me naftë dizel	81.6%	81.5%	81.6%	79.7%	75.8%	70.9%	65.1%	59.0%
GLN	2.1%	2.1%	2.1%	3.2%	5.1%	6.8%	8.8%	10.9%
Hidrogjen	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.7%	1.4%
Biodizel	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Totali	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 23: Përqindjet e burimeve të energjisë në sektorin e transportit për periudhën kohore 2016-2018, dhe siç është projektuar deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

Përqindja e BRE-N & F kombinon të gjitha energjitë e rinovueshme, të ndryshme nga energjia elektrike, nxehtësia dhe biolikuidet në sektorët e ndryshëm nga transporti. Ajo përfshin sektorin e banesave, shërbimeve, industrisë, bujqësisë dhe të peshkimit, si dhe të lëndëve djegëse, të energjisë diellore, lëndës drusore, hidrike dhe të biomasës. Nga këto, vetëm panelet diellore dhe lënda drusore e përdorur si lëndë djegëse luan rol kryesor, pasi të dy përdoren për ngrohjen e ambienteve dhe të ujit, si dhe për disa procese industriale. Sektori i bujqësisë dhe peshkimit nuk përdor energji të rinovueshme (me përjashtim të energjisë elektrike, i cili nuk merret në konsideratë këtu). Tabela e mëposhtme paraqet përqindjen e energjisë diellore dhe të biomasës pyjore, krahasuar me totalin e energjisë përfundimtare, në secilin prej tre sektorëve të mbetur.

Vini re se përqindja e BRE-N & F raporton përqindjen e energjisë së rinovueshme në krahasim me kërkesën finale për energji, të ndryshme nga energjia elektrike, që shpjegon përqindjen e lartë të BRE-N & F krahasuar me vlerat e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Lënda djegëse	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Sektori i banesave								
Lënda drusore si lëndë djegëse	24.8%	24.4%	24.3%	23.9%	23.0%	21.8%	19.9%	18.8%
Diellor e	1.3%	1.4%	1.5%	1.5%	2.4%	3.3%	3.9%	4.5%
Shërbimet								
Lënda drusore si lëndë djegëse	6.1%	6.1%	6.1%	6.1%	6.1%	6.1%	6.1%	6.1%
Diellor e	2.3%	2.3%	2.3%	2.3%	2.3%	2.3%	2.3%	2.3%
Industria								
Lënda drusore si lëndë djegëse	3.3%	1.7%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%
Diellor e	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%
Totali								
Lënda drusore si lëndë djegëse	7.6%	7.1%	7.1%	7.1%	6.1%	5.4%	4.7%	4.3%
Diellor e	0.5%	0.6%	0.6%	0.6%	0.7%	0.8%	0.8%	0.8%

Tabela 24: Përqindja e energjisë diellore dhe të biomasës pyjore në kërkesën finale për energji të sektorëve që shfrytëzojnë këto lëndë djegëse. Vini re se përqindjet këtu nuk janë të njëjta me përqindjen e BRE-N & F, pasi BRE-N & F nuk i referohet energjisë finale, por energjisë finale të ndryshme nga energjia elektrike.

Figura 46 Paraqet kërkesën finale për energji për ngrohjen e hapësirave në sektorin e banesave, si sektori me kërkesën më të lartë për energji të rinovueshme, të ndryshme nga energjia elektrike. Kërkesa finale për energji reduktohet gradualisht teksa zhvillohet skema e fuqishme e rinovimit, që shpjegohet në seksionin 4.1.ii. Rinovimi dhe rikonstruksioni rezultojnë në reduktimin e intensitetit të energjisë finale

për ngrohje. Krahas kësaj, supozohet që pompat e nxehtësisë do të zëvendësojnë përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje nëse kryhet rinovimi rrënjësor, i cili nënkupton p.sh. zëvendësimin e dritareve në përputhje me SLED (2015). Energjia që gjendet në nxehtësinë e ambientit nuk pasqyrohet shprehimisht në projeksion, por vetëm energjia elektrike e përdorur për të vënë në funksion pompën e nxehtësisë. Kjo gjithë përcakton intensitetin e energjisë finale për ngrohjen e hapësirave, e cila rrjedhimisht pëson një reduktim të ndjeshëm.




Figura 46: Energjia finale dhe lëndët djegëse të përdorura në sektorin e banesave për ngrohjen e hapësirave në të gjitha kategoritë e ndërtesave dhe rajoneve gjeografike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar deri në vitin 2040 me masat ekzistuese.

4.3. Dimensioni i efikasitetit të energjisë

i. Konsumi aktual i energjisë primare dhe finale në ekonomi dhe sipas sektorëve (duke përfshirë sektorin e industrisë, të banesave, të shërbimeve dhe të transportit)

Konsumi aktual final i energjisë në Shqipëri (2018) është 2102,1 ktoe, ndërsa i energjisë primare 2342,7 ktoe. Diferenca përcaktohet nga humbjet në transmetimit dhe rafinimit të naftës bruto në produkte të rafinuara. Aktualisht, një pjesë e madhe e naftës bruto eksportohet dhe nuk përpunohet në rafineritë e vendit. Siç u përmend më lart, një bilanc energjetik i detajuar në nivel nënsektori të kërkesës industriale është i disponueshëm vetëm që nga viti 2016. Vlerat historike për vitet 2016-2018, paraqiten më poshtë në kombinim me projeksionet që marrin në konsideratë politikat dhe masat ekzistuese.

ii. Potenciali aktual për aplikimin e kogjenerimit me efikasitet të lartë, si dhe ngrohja dhe ftohja efikase në nivel urban

Furnizimi me energji elektrike i Shqipërisë bazohet ekskluzivisht në energjinë hidrike, ndërkohë që impiantet fotovoltaike janë projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040. Aktualisht nuk operohet asnjë central i vënë në funksion me lëndë djegëse fosile, as me gjenerim energjie elektrike nga biomasa.

Prandaj, kogjenerimi i nxehtësisë dhe energjisë elektrike nuk është një opsion i mundshëm. Momentalisht, nuk ekzistojnë dhe as nuk janë të planifikuara, rrjetet për furnizim me ngrohje në nivel urban. Mundësia për këto rrjete do të merrej në konsideratë në zonat urbane me të mëdha. Ekziston një industri e kufizuar për sa i përket ofrimit të burimit për furnizim me ngrohje në nivel urban (prodhimi i çimentos, hekurit dhe çelikut dhe i aliazheve të hekurit). Ekziston një potencial i mundshëm për furnizimin me ngrohje në nivel urban, pasi përdorimi i lëndëve drusore si lëndë djegëse për qëllime ngrohjeje është më i lartë në ndërtesat më të vjetra, të cilat janë objekt i një skeme rikonstruksioni të fuqishme. Aktualisht, projektet përkatëse nuk planifikohen apo parashikohen që të kryhen.

iii. *Projeksionet që marrin në konsideratë politikat, masat dhe programet ekzistuese të efikasitetit të energjisë, siç përshkruhen në pikën 1.2. (ii) për konsumin e energjisë primare dhe finale për secilin sektor të paktën deri në vitin 2040 (duke përfshirë edhe vitin 2030)*

Furnizimi neto me energji primare në Shqipëri është aktualisht (vlera e vitit 2018) 2342.7 ktoe dhe projektohet të rritet në 2773.8 ktoe deri në vitin 2030 dhe në 3358.9 ktoe deri në vitin 2040. Figura 47 paraqet furnizimin me energji primare për Shqipërinë, siç projektohet me masat ekzistuese deri në vitin 2040. Imazhi paraqet vlerat neto të secilës kategori të lëndëve djegëse. Duke qenë se këto vlera janë për energjinë primare, energjia elektrike paraqitet vetëm kur nuk prodhohet brenda vendit nga burime primare energjetike (kryesisht hidrike), por kur importohet (kryesisht në vitet kur disponueshmëria e burimeve ujore është reduktuar qëllimisht për të studiuar efektin e saj në sistemin e energjisë. Kërkesa totale për energji primare rritet, veçanërisht duke u nxitur nga kërkesa për lëndë djegëse për transport. Kërkesa në rritje për energji elektrike përmbushet nga furnizimi në rritje me energji hidrike. Tabela 25 paraqet vlerat për çdo lëndë djegëse të marrë në konsideratë. Vini re se vlerat negative tregojnë eksportin e lëndës djegëse në fjalë.




Figura 47: Furnizimi me energji primare për periudhën historike 2016-2018 dhe siç është projektuar deri në vitin 2040 me masat ekzistuese Vlerat negative tregojnë eksportet.

Lëndë djegëse [ktoe]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Energji elektrike	15,2	253,2	-70,9	0,6	0,0	0,0	0,0	21,6
Gaz natyror	51,2	53,9	45,7	47,1	54,1	60,5	76,3	130,4
Benzinë	136,7	137,5	136,2	140,7	170,6	204,2	237,6	279,3
Vajgur për avionë	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Vajgur	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Naftë dizel	895,9	802,4	766,8	747,1	590,4	671,1	725,9	783,5
Mbetjet e lëndës djegëse të lëngët	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
GLN	165,9	170,1	174,2	176,5	195,7	216,5	248,0	289,6
Naftë	-32,2	-100,5	-54,7	-65,8	-234,4	-234,3	-234,3	-234,3
Naftë bruto	269,2	605,4	377,1	452,2	1292,2	1292,2	1292,2	1292,2
Linjit	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Lënda drusore si lëndë djegëse	154,1	149,4	150,0	146,6	141,7	136,4	131,1	132,1
Qymyr	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Eolike	0,0	0,0	0,0	0,0	28,2	28,2	28,2	28,2
Diellore	11,1	12,0	13,2	16,5	54,7	58,9	61,7	65,0
Hidrike	613,6	388,7	736,1	576,2	542,2	582,1	646,0	686,8
Ngrohje	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Hidrogjen	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	8,2	19,4
Mbetjet e ngurta urbane	0,0	0,0	0,0	0,4	0,0	0,0	0,2	1,3
Katran	-14,9	-41,7	-24,2	-28,2	-94,0	-94,0	-94,0	-94,0
Bitum	-28,5	-80,0	-46,3	-54,0	-180,0	-180,0	-180,0	-180,0
Koks naftë	-33,5	-100,0	-59,6	-70,4	-242,3	-241,5	-240,6	-239,5
Lubrifikues	12,0	11,3	12,8	12,1	15,0	17,7	20,8	24,5
Qymyr i paspecifikuar	59,8	99,6	186,3	175,6	218,1	255,9	300,3	352,5
Biomasa	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Biodizel	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Totali	2275,8	2361,3	2342,7	2273,2	2552,4	2773,8	3027,9	3358,9

Tabela 25: Furnizimi me energji primare (në ktoe) për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar deri në vitin 2040 me masat ekzistuese Vlerat negative tregojnë eksportet.

Konsumi finali energjisë është aktualisht (vlera e vitit 2018) 2102.1 ktoe dhe projektohet të rritet në 2540.0 ktoe deri në vitin 2030 dhe në 3080.5 ktoe deri në vitin 2040. Konsumi final i energjisë përdoret sinonimisht me kërkesën finale për energji, dhe në vijim do të referohet me shkurtimin KFE. Tabela 26 Paraqet totalin e kërkesës finale për energji. Paraqitet edhe raporti i KFE ndaj TEFP; vërehet një rritje e lehtë për shkak të veprimtarisë së shtuar të rafinimit nga 89,7% që është sot në 92% në vitin 2030 për shkak të një ndryshimi në veprimtarinë e rafinimit dhe rënies së humbjeve në transmetim.

	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Kërkesa finale për energji [ktoe]	2039,40	2109,70	2102,10	2076,10	2313,60	2540,00	2782,70	3080,50
KFE ndaj TEFP	89.6%	89.3%	89.7%	91.3%	90.6%	91.6%	91.9%	91.7%

Tabela 26: Kërkesa finale për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar deri në vitin 2030, dhe për vitet 2035 dhe 2040 me masat ekzistuese

Figura 48 dhe Tabela 27 paraqesin përqindjet e sektorëve të ndryshëm në kërkesën finale për energji. Përqindja e konsumit të energjisë nga sektori i banesave reduktohet.




Figura 48. Përqindjet e kërkesës finale për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç projektohet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

Dega	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Sektori i banesave	23.9%	22.8%	22.6%	22.7%	19.5%	17.1%	15.3%	14.0%
Shërbimet	9.1%	9.7%	10.8%	9.8%	9.1%	8.3%	7.6%	6.8%
Industria	14.8%	19.1%	19.2%	18.3%	20.5%	21.9%	23.6%	25.0%
Transporti	40.2%	39.3%	39.1%	40.5%	41.9%	43.3%	43.7%	44.0%
Bujqësia	3.6%	3.5%	3.8%	4.1%	4.2%	4.4%	4.5%	4.7%
Peshkimi	1.4%	1.8%	1.9%	1.8%	2.1%	2.2%	2.4%	2.5%

Jo-energetik	7.0%	3.7%	2.6%	2.8%	2.8%	2.8%	2.9%	3.0%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 27: Përqindjet e kërkesës finale për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç projektohet deri në vitin 2040 me masat ekzistuese

Imazhet e mëposhtme paraqesin kërkesën finale për energji sipas sektorëve, që ndahen në nënsektorët përkatës, për vlerat historike nga vitet 2016-2018 dhe projeksionet deri në vitin 2040. Si për shkarkimet e GES-ve, kjo pasohet nga një tabelë që paraqet vlerat për vitet 2016-2018, 2020, 2025, 2030, 2035 dhe 2040. Secili imazh që paraqet kërkesën për energji sipas nënsektorëve, shoqërohet nga një imazh që tregon kategorizimin e lëndëve djegëse në atë nënsektor, por nuk renditet si referencë në përshkrimin e mëposhtëm. Paragrafët e mëposhtëm theksojnë vërejtjet kryesore, ndërsa imazhet janë grupuar për të lehtësuar kuptueshmërinë.

Figura 49 tregon kërkesën e përgjithshme për energji. Sektori që kërkon më së shumti energji është ai i transportit. Kjo kërkesë do të pësojë rritje deri në vitin 2040. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për industrinë, por në një nivel më të ulët. Kërkesa për energji nga sektori i banesave do të pësojë një rënie të ulët.

Figura 51 Paraqet më me detaje sektorin e banesave, kërkesa e të cilit për energji për ngrohjen e hapësirave do të reduktohet, por do të kompensohet nga një rritje për ftohja e hapësirave dhe përdorimin e pajisjeve elektro-shtëpiake. Në sektorin e shërbimeve (Figura 53) vërehen ndryshime shumë të vogla, si në kërkesën totale për energji ashtu edhe në kategoritë e lëndëve djegëse. Kërkesa për energji në sektorin e industrisë projektohet të rritet së bashku me PBB-në (Figura 55) pa kategorizim të lëndëve djegëse dhe masa të kufizuara të efikasitetit të energjisë. Kërkesa për lëvizshmëri projektohet të rritet, ashtu si dhe kërkesa për energji (Figura 57). Në transportin e udhëtarëve (Figura 59), transporti hekurudhor parashikohet të kërkojë më shumë energji drejt vitit 2030, ndërkohë që transporti rrugor i nënshtrohet elektrifikimit. Mallrat do të transportohen (Figura 61) gjithnjë e më pak në rrugë hekurudhore, pasi pjesa më e madhe e tyre do të dërgohet përmes transportit rrugor. Pas vitit 2030, një pjesë e vogël e hidrogjenit pritet të inkorporohet në sistem.

Energy Demand Final Units

Scenario: WEM, All Fuels




Figura 49: Konsumi final i energjisë (ktOE) për të gjithë sektorët kryesorë me kërkesë për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units

Scenario: WEM




Figura 50: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktOE) për të gjithë sektorët kryesorë me kërkesë për energji për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 51: Konsumi final i energjisë (ktOE) për sektorin e banesave për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM




Figura 52: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktOE) për sektorin e banesave për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 53: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e shërbimeve për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM




Figura 54: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e shërbimeve për vlerat historike nga vitet 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units

Scenario: WEM, All Fuels




Figura 55: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e industrisë për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units

Scenario: WEM




Figura 56: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e industrisë për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 57: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e transportit për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM




Figura 58: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e transportit për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 59: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të udhëtarëve për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM




Figura 60: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të udhëtarëve për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 61: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të mallrave për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM




Figura 62: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të mallrave për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WEM, All Fuels




Figura 63: Konsumi final i energjisë (ktoe) për kërkesën jo-energetike për mbajtësit e energjisë për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat për kërkesën finale për energji (në ktoe) për sektorët dhe nënsektorët me kërkesë për energji, siç është projektuar me masat ekzistuese.

Dega [ktoe]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Sektori i banesave	486,8	481,9	474,8	471,8	451,7	434,4	427,0	431,2
Shërbimet	185,0	205,3	226,2	203,8	209,7	211,6	212,1	210,2
Industria	301,7	402,7	402,8	380,1	473,8	557,3	655,4	770,8
Transporti	819,4	829,8	822,7	840,2	969,2	1098,6	1215,0	1355,6
Bujqësia Pylltaria	74,0	74,1	80,3	84,7	96,7	110,5	126,2	144,1
Peshkimi	29,1	38,5	40,5	38,2	47,6	56,0	65,8	77,4
Jo-energjetik	143,3	77,4	54,7	57,3	64,9	71,6	81,2	91,2
Totali	2039,4	2109,7	2102,1	2076,1	2313,6	2540,0	2782,7	3080,5
Sektori i banesave								
Ngrohja hapësirave	322,3	317,1	311,8	306,1	279,4	256,7	239,1	231,3
Pajisjet elektro-shtëpiake	92,6	92,8	91,0	92,3	96,4	97,8	101,2	104,9
Ndriçimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ftohja hapësirave	25,0	25,3	25,6	26,7	29,1	32,3	36,8	42,2

Ngrohja e ujit	46,9	46,7	46,4	46,6	46,7	47,6	49,8	52,8
Totali	486,8	481,9	474,8	471,8	451,7	434,4	427,0	431,2
Shërbimet								
Tregtia	50,0	53,5	59,0	53,5	60,1	64,4	66,2	65,5
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	10,3	12,1	14,5	12,4	16,2	19,6	22,1	23,3
Administrata publike	22,6	26,0	28,2	26,3	22,6	19,6	17,1	14,8
Arsimi	15,5	17,7	19,0	17,8	15,2	13,2	11,5	10,0
Shëndetësia	16,9	19,2	21,7	20,3	17,4	15,1	13,1	11,4
Shërbime të tjera	69,8	76,9	83,8	73,6	78,2	79,8	82,1	85,2
Totali	185,0	205,3	226,2	203,8	209,7	211,6	212,1	210,2
Industria								
Hekuri dhe çeliku	18,9	20,5	27,2	25,7	32,0	37,6	44,2	52,0
Metalet joferrike	4,3	4,2	4,3	4,0	5,0	5,9	6,9	8,1
Kimike	14,9	15,3	15,0	14,2	17,7	20,8	24,4	28,7
Minerar	157,1	243,0	247,2	233,2	290,8	342,0	402,2	473,0
Nxjerrja xeheroreve	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ushqimet, Pijet, Duhani	47,4	50,6	47,4	44,7	55,8	65,6	77,1	90,7
Spektori i tekstilit, veshmbathjet e lëkurës	14,4	14,5	13,9	13,1	16,3	19,2	22,6	26,5
Shtypshkronja	8,2	8,3	8,3	7,8	9,8	11,5	13,5	15,9
Inxhinieria Metale të tjera	3,3	5,5	7,6	7,2	9,0	10,6	12,4	14,6
Të tjera	33,2	40,8	32,0	30,2	37,6	44,2	52,0	61,2
Totali	301,7	402,7	402,8	380,1	473,8	557,3	655,4	770,8
Transporti								
I udhëtarëve	558,7	568,4	560,8	593,5	663,1	740,8	804,1	884,1
I mallrave	260,8	261,4	261,9	246,7	306,1	357,9	410,9	471,4
Totali	819,4	829,8	822,7	840,2	969,2	1098,6	1215,0	1355,6
Transporti i udhëtarëve								
Hekurudhor	0,4	0,3	0,3	0,0	6,2	42,4	48,2	54,2
Me sisteme navigimi	20,5	20,5	20,5	21,7	24,8	28,3	32,2	36,1
Motoçikletë	2,0	2,0	2,0	2,1	2,4	2,7	3,0	3,3
Makinë	501,3	513,0	505,5	535,2	585,2	612,0	659,7	724,1

Autobus	34,5	32,7	32,6	34,5	44,5	55,3	61,0	66,4
Totali	558,7	568,4	560,8	593,5	663,1	740,8	804,1	884,1
Transporti i mallrave								
Hekurudhor	0,8	1,2	1,2	1,1	1,4	1,7	2,0	2,3
Me sisteme navigimi	14,9	15,8	16,7	15,8	19,8	23,4	27,6	32,7
Kamion	245,1	244,5	244,0	229,8	284,9	332,8	381,3	436,4
Totali	260,8	261,4	261,9	246,7	306,1	357,9	410,9	471,4
Jo-energjetik								
Kimike	0,3	0,4	0,4	0,4	0,4	0,5	0,6	0,7
Të tjera	143,0	77,0	54,4	57,0	64,4	71,1	80,6	90,5
Totali	143,3	77,4	54,7	57,3	64,9	71,6	81,2	91,2

Tabela 28: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorë dhe nënsektorë të ndryshëm për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat ekzistuese deri në vitin 2040

- iv. *Nivelet kosto-optimale të kërkesave minimale të efikasitetit të energjisë, që rrjedhin nga përlllogaritjet në nivel kombëtar, në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2010/31/BE*

Në zhvillim e sipër

4.4. Dimensioi i sigurisë energjetike

Do të përfshihet sipas Rregullores “Për qeverisjen”: i. Kombinimi i energjisë aktuale, burimet energjetike kombëtare, varësia nga importet, duke përfshirë rreziqet përkatëse ii. Projektionet e zhvillimit me politikat dhe masat ekzistuese të paktën deri në vitin 2040 (duke përfshirë edhe vitin 2030).

- i. *Kombinimi i energjisë aktuale, burimet energjetike kombëtare, varësia nga importet, duke përfshirë rreziqet përkatëse*

Kombinimi aktual i energjisë elektrike në Shqipëri konsiston pothuajse vetëm në energji hidrike. Në një nivel ende shumë të ulët por gjithnjë e një rritje, energjia diellore po integrohet në kombinim. Sidoqoftë, burimet fosile të energjisë nuk janë fare pjesë e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Edhe pse në vitin 2011 është përfunduar një projekt për një termocentral që punon me naftë në Vlore me kapacitet 97 MW, ai nuk u vu kurrë në funksion. Planifikohet rijetësimi i impiantit pas rinovimit për përdorim me gaz natyror, në kuadër të një politike të skenarit me masa ekzistuese.

Për sigurinë energjetike është thelbësor mungesa e një rezerve prodhimi të energjisë elektrike që përdor një teknologji tjetër për të kompensuar vitet me klimë të thatë me prodhim të ulët hidroelektrik. Në të kaluarën, kjo gjë ka çuar në rritje të shpeshta të importeve të energjisë elektrike, që kanë ndodhur për herë të fundit në vitin 2017, kur përqindja e importit neto për konsumin bruto të energjisë u rrit në 39%, me eksportet neto prej 1% si në vitet 2018 ashtu dhe në 2018.

Figura 64 tregon konsumin e brendshëm bruto, që mbetet pothuajse konstant me një rritje të vogël. Paraqitet edhe prodhimi, importet neto dhe përqindje e importit




Figura 64: Përqindja e importit të energjisë elektrike (të dhënat historike 2004 - 2018)

Krahas sektorit të energjisë elektrike, furnizimi me lëndë djegëse fosile dhe produkte të lëndëve djegëse fosile luan një rol thelbësor në sigurinë energjetike në Shqipëri. Edhe pse është prodhues i naftës bruto, vendi varet ndjeshëm nga importet e produkteve të naftës së rafinuar për shkak të kapaciteteve të ulëta dhe të vjetruara të rafinimit. Figura 65 tregon qartë se si prodhimi i naftës bruto është dukshëm më i lartë se sa prodhimi i produkteve të naftës së rafinuar.

Figura 66 tregon importet neto të produkteve të lëndëve djegëse. Vlerat negative nënkuptojnë që eksportet i kanë tejkaluar importet, ndërsa vlerat pozitive nënkuptojnë që importet i kanë tejkaluar eksportet. Siç mund të shihet, nafta bruto eksportohet gjerësisht, ndërsa produktet e naftës së rafinuar kryesisht importohen. Kjo gjë përkon me varësinë e ndjeshme ndaj importit.




Figura 65: Prodhimi i lëndëve djegëse (të dhënat historike 2011 - 2018)




Figura 66: Importet neto të lëndëve djegëse (të dhënat historike 2011 - 2018)

ii. Projektionet e zhvillimit me politikat dhe masat ekzistuese të paktën deri në vitin 2040 (duke përfshirë edhe vitin 2030)

Për projektionet nga viti 2019-2040, konsumi i brendshëm bruto i energjisë elektrike pritet të rritet vazhdimisht deri në vitin 2040. Varësia nga importet në vitet me prodhim të ulët hidroelektrik është një problem i përsëritur në skenarin që merr parasysh masat ekzistuese. Nga të dhënat historike rezulton se në çdo pesë vjet kishte vite me prodhim të ulët hidroelektrik, më i fundit ishte viti 2017. Prandaj, në model zbatohen vitet në fjalë çdo pesë vite duke nisur nga viti 2022, siç mund të shihet në Figura 67 nga rritja e përqindjes së importit (përlogaritur në raport me kërkesën për energji). Me përjashtim të këtyre viteve, importet neto janë 0 nga fundi i viteve 2030, kur përqindja e importeve është vazhdimisht në rritje duke paraqitur mungesë kapaciteti në prodhim për të përmbushur kërkesën për energji. Ndryshimet në kushtet klimatike ndikojnë në këtë gjë, pasi nivelet e precipitimit pritet të ulen, duke rezultuar në një prodhim prej 20% për hidrocentralet në lumenj të rrjedhshëm dhe 15% në rezervuarët e impianteve hidroelektrike nën nivelet e vitit 2010 deri në vitin 2050 (World Bank ESMAP 2009).




Figura 67: Prodhimi i energjisë, kërkesa dhe importet për skenarin me masa ekzistuese (projeksioni për vitet 2019 - 2040).

[ktoe]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Kërkesa për energji elektrike	479,9	489,9	507,6	493,5	526,4	570,8	630,4	705,1
Gjenerimi i energjisë elektrike	613,6	388,7	736,1	580,	608,5	648,7	716,4	779,6
Importet e energjisë elektrike	15,2	253,2	0,0	0,6	0,0	0,0	0,0	21,6
Përqindja e importit	3.2%	51.7%	0.0%	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	3.1%

Figura 68: Prodhimi i energjisë, kërkesa dhe importet për skenarin me masa ekzistuese.

Në prodhimin e lëndëve djegëse, një politikë për të rinovuar rafineritë ekzistuese të naftës do të rrisë kapacitetin e rafinimit nga një milion ton naftë bruto në vit në 1,5 milion tonë. Politika do të hyjë në fuqi në vitin 2025, siç tregohet nga një rritje në produktet e naftës në Figura 69.

Ky ndryshim rezulton në dinamika të ndryshueshme në importet neto të lëndëve djegëse. Ndonëse historikisht, sasi të mëdha të naftës bruto janë eksportuar dhe produktet e naftës janë importuar për shkak të mungesës së kapacitetit të rafinimit (shihni Figura 66), kapaciteti i rritur i rafinimit i redukton eksportet e naftës bruto në pothuajse zero duke nisur nga viti 2025 dhe i redukton ndjeshëm importet e produkteve të naftës, si dhe varësinë ndaj tyre, siç mund të vërehet në Figura 70.




Figura 69: Prodhimi i lëndëve djegëse (projeksioni për vitet 2019 - -2040)




Figura 70: Importet neto të lëndëve djegëse (projeksioni për vitet 2019 - -2040)

4.5. Dimensioni i tregut të brendshëm të energjisë

4.5.1 Interkoneksioni i energjisë elektrike

i. Niveli aktual i interkoneksionit dhe interkonektorët kryesorë

Shqipëria ka pesë linja interkoneksioni me një kapacitet total të instaluar prej 4096 MVA me të gjitha subjektet politike fqinje, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut (Energy Community Secretariat 2021) siç paraqitet në tabelën Tabela 29.

Niveli i tensionit (kV)	Zbarra 1 (kombëtare)	Zbarra 2 (jo-kombëtare)	Nga Shqipëria në	Fuqia maksimale aktive
400	Zemblak	Kardia	Greqi	1215
400	Tiranë 2	Podgoricë	Mali i Zi	1197
400	Koman	Kosovë B	Kosovë	1185
220	Koplik	Podgoricë	Mali i Zi	270
220	Fierzë	Prizren 2	Kosovë	270

Tabela 29: Interkonektorët ekzistues ndërkufitarë. Burimi: (Energy Community Secretariat 2021)

Ndërmjet viteve 2004-2018, importet e energjisë elektrike përmes këtyre interkonektorëve varionin midis 370 GWh në vitin 2005 dhe 3251 GWh në vitin 2014 (mesatarisht 1815 GWh). Eksportet varionin midis 0 dhe 2934 GWh (mesatarisht 325 GWh). Përdorimi i interkonektorëve (importe + eksporte) varionte midis 42 GWh në vitin 2016 dhe 4920 GWh në vitin 2010 (mesatarisht 2140 GWh).

Figura 71 Paraqet shpërndarjen gjeografike të linjave kryesore të transmetimit dhe interkonektorëve.




Figura 71: Harta e linjave kryesore të transmetimit dhe e interkonektorëve. Burimi: përfaqësimi ynë bazuar në OST 2018

Figura 72 tregon një skemë të interkonektorëve ndërkufitarë duke përfshirë kapacitetin nominal të transmetimit të interkonektorëve (Fuqia maksimale aktive në MW) dhe kapacitetin maksimal ndërkufitar që i është dhënë pjesëmarrësve të tregut për përdorim tregtar (NTC). Duhet pasur parasysh, se vënia në punë e linjës 400 kV Tiranë 2 - Koman - Kosovë B, në dhjetor të vitit 2020, bëri të mundur rritjen e kapaciteteve nominale të transmetimit në kufirin me Kosovën dhe Greqinë, nga 250 MW që ishte më parë në 400MW.




Figura 72: Kapacitetet e interkonektorëve Burimi: Energy Community Secretariat 2021

Për të llogaritur objektivin e interkoneksionit, NTC në drejtimin e importit vendoset në raport me kapacitetin e prodhimit të energjisë së rinovueshme. Siç tregohet në Tabela 30, vërehet se objektivi i interkoneksionit prej 15% deri në vitin 2030 është arritur ndërkohë, dhe do të vazhdojë i tillë të paktën deri në vitin 2030, në skenarin me masa ekzistuese.

Viti	2019	2021	2030	2040
Kapaciteti nga burimet e rinovueshme (MW)	2 343	2 623	3307	3 307
Importi maksimal i NTC (MW)	910	1210	1810	1810
Niveli i interkoneksionit	39%	46%	55%	55%

Tabela 30: Niveli i interkoneksionit, siç është përlllogaritur për skenarin me masa ekzistuese

ii. Projektionet e kërkesave të zgjerimit të interkonektorëve (edhe për vitin 2030)

Vendi i vetëm fqinj që aktualisht nuk është i lidhur me rrjetin e transmetimit të Shqipërisë përmes interkonektorëve është Maqedonia e Veriut (përveç Italisë). Një marrëveshje është nënshkruar në muajin shkurt të vitit 2020 për ndërtimin e një linje 400 KV të transmetimit me fuqi maksimale aktive prej 1195 MW nga Fieri përmes Elbasanit në qytetin e Manastirit në Maqedoninë e Veriut. Kjo linjë do të mbështesë potencialin për zhvillimin e një tregu rajonal të energjisë në Evropën juglindore dhe krijimin e mundësive të tregtimit me vendet midis Bullgarisë dhe Italisë.

4.5.2 Infrastruktura e transmetimit të energjisë

i. Karakteristikat kryesore të infrastrukturës ekzistuese të transmetimit për energjinë elektrike dhe gazin

Deri më sot, Shqipëria nuk ka një infrastrukturë për transmetimin e gazit natyror. Megjithatë, Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) ka nisur punën në fund të vitit 2020 dhe lidh Italinë, Shqipërinë dhe Greqinë me Gazsjellësin Trans-Anadollian në Turqi dhe Gazsjellësin e Kaukazit Jugor në Azerbajxhan dhe Gjeorgji. Në këtë mënyrë, gazsjellësi mund të transportojë deri në 10 miliardë metër kub gaz natyror nga fushat e gazit në Itali, Shqipëri, Greqi dhe (përmes një pike shtesë interkoneksioni) në Bullgari. Për shkak të mungesës së infrastrukturës, në kohën e hartimit të këtij dokumenti (prill 2021), gaz natyror nga gazsjellësi nuk është përdorur ende në Shqipëri. Për këtë arsye, analiza e mëposhtme kufizohet në infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike. Informacioni është marrë kryesisht nga Plani për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit në Shqipëri nga operatori i sistemit të transmetimit OST (OST 2018).

Pesëmbëdhjetë nënstacione (400 kV, 220 kV dhe 150 kV) operohen nga Sistemi i Transmetimit të Energjisë në Shqipëri, si dhe

- 445,7 km linja 400 kV,
- 1250 km linja 220 kV, 3
- 4,4 km linja 150 kV dhe
- 1606,7 km linja 110 kV.

Hydrocentralet kryesore të “Kaskadës së Lumit Drin” (i Fierzës, Komanit dhe i Vaut të Dejës) në pjesën veriore të Shqipërisë, janë të lidhur me rrjetin e transmetimit 220 kV, që përbën edhe lidhjen kryesore në zonat me ngarkesën më të madhe në Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Fier. Rrjeti 110 kV mbulon të gjitha zonat urbane të vendit, në mënyrë që të furnizojë Sistemin e shpërndarjes që aktualisht operohet nga OSHEE dhe është 100% në pronësi të shtetit. (OST 2018)

Më shumë se 70% e totalit të kapacitetit të instaluar të prodhuar është i lidhur me rrjetin 220 kV. Autotransformatorët 220/400 kV kanë një kapacitet prej 1200 MVA dhe rrjeti prej 110 kV është i lidhur me Unazat energjetike 400 kV nga dy autotransformatorë 150 MVA të instaluar në pjesën juglindore të rrjetit, në nënstacionin e Zemblakut.

Transmetimi i energjisë elektrike nga burimet kryesore të prodhimit në qendrat më të mëdha të konsumit kryhet përmes rrjetit 220 kV dhe më tej përmes transformimit 220/110 kV (2390 MVA). Rrjeti 110 kV që furnizon të gjithë nënstacionet prej 110 kV, më parë përfaqësonte nyjat kryesore të ngarkesës, ndërkohë që realisht janë lidhur rreth 20% e kapacitetit të instaluar të prodhimit (OST 2018).

Figura 73 Paraqet strukturën kryesore të rrjetit të transmetimit në Shqipëri.




Figura 73: Struktura e Sistemit të Transmetimit në Shqipëri: Burimi: OST 2018

ii. *Projeksionet e kërkesave të zgjerimit të rrjetit të paktën deri në vitin 2040 (edhe për vitin 2030)*
Gjatë viteve të fundit janë realizuar projekte të rëndësishme, të cilat kanë reduktuar ndjeshëm përqindjen e energjisë elektrike të pafurnizuar, si dhe humbjet në transmetim. Në vitet 2005-2017, humbjet në energji në rrjetet e transmetimit janë reduktuar nga 4,56% në 2,08%. Kjo shifër nuk përfshin humbjet në sistemin e shpërndarjes (OST 2018).

Sipas përlogaritjeve në modelin e skenarit me masa ekzistuese, rritja vjetore e kërkesës për energji është një deri në dy për qind ndërmjet viteve 2019 dhe 2040. Për ta përmbledhur, kërkesa për energji elektrike rritet nga 512 ktoe në vitin 2019 në 533 ktoe në vitin 2030 dhe 621 ktoe në vitin 2040. Në të njëjtën kohë, kapacitetet e prodhimit rriten nga 2343 MW në vitin 2019 në 2965 MW në vitin 2030 dhe në 3228 MW.

Rrjetet e transmetimit duhet t'i përshtaten ngarkesës në rritje dhe zgjerimit, ndërkohë që nevojitet efikasitet më i madh. Plani për Zhvillimin e Rrjetit në Shqipëri (OST 2018) parashikon një sërë projektesh për përmirësimin e rrjeteve të transmetimit, siç paraqitet në Tabela 30.

Projekti	Përfitimet
Zgjerimi i nënstacionit të Komanit me një autotransformator 345 MVA 400/220 kV, zbarrë dyfishe 400 kV dhe dy dalje të reja linje 400 kV.	<ul style="list-style-type: none"> Ky investim është i nevojshëm për të mundur një ekuilibër më të mirë të rrjeteve 220 kV dhe 400 kV, përmes shpërndarjes së flukseve të energjisë të prodhuara nga HEC-i i Komanit me humbjet më të pakta;

	<ul style="list-style-type: none"> Do të vërehet përmirësim i ndjeshëm edhe në profilin e niveleve të tensionit gjatë periudhave të mira hidrologjike.
Linja e re e transmetimit 220kv me dy qarqe Tirana2 – Rrashbull	<ul style="list-style-type: none"> Projekti është tejet i rëndësishëm për sistemin e transmetimit në Shqipëri, pasi ka të bëjë me problemet në vijim: linja ekzistuese ka ngarkesë maksimale, mospërmbushje e kriterëve të sigurisë N-1 humbje të mëdha në transmetim dhe sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike të pafurnizuar. Ai do të përmirësojë furnizimin me energji elektrike në një rajon të madh gjeografik, që përfshin qarkun e Durrësit, Kavajës dhe pjesën jugore të Shqipërisë. Projekti përmbush kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe Evropian lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Investimi i propozuar pritet të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë në tërësi dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë. Ai do të shtojë mundësitë për zhvillimin e turizmit për shkak të furnizimit të përmirësuar me energji.
Ndërtimi i nënstacionit (Ns) 400/110 kV Tirana3 dhe përforcimi i Rrjetit unazor 110 KV të Tiranës	<ul style="list-style-type: none"> Tranzitim i flukseve të energjisë nga rrjeti 400 kV i interkoneksionit në rrjetin kombëtar 220 kV Rritje e sigurisë së operimit të sistemit; Tranzitim i flukseve të energjisë nga rrjeti 400 kV i interkoneksionit në rrjetin kombëtar 220 kV Rritje e ndjeshme të sigurisë së operimit të sistemit; Cilësi më e lartë e furnizimit me energji elektrike si dhe rritje e besueshmërisë së furnizimit për rajonin e Tiranës; Pakësim i humbjeve në rrjetin e transmetimit; Reduktim i energjisë së pafurnizuar. Projekti përmbush kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe Evropian lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Tabela 31: Projektet në vazhdim dhe të planifikuara të rrjeteve të transmetimit. Burimi: OST 2018

4.5.3 Tregjet e energjisë elektrike dhe të gazit, çmimet e energjisë elektrike

i. Situata aktuale e tregjeve të energjisë elektrike dhe të gazit, duke përfshirë çmimet e energjisë elektrike

Tregjet e energjisë elektrike dhe të gazit përshkruhen në seksionin përkatës në kreun 1.

Duke qenë se bursa e energjisë nuk është ende funksionale, nuk ka referencë për çmimet aktuale të energjisë elektrike. Aktualisht po organizohen vetëm tregti dypalëshe. Për sa i përket tregut me pakicë, çmimi i energjisë elektrike për pjesën më të madhe të klientëve vijon të rregullohet sipas një detyrimi të shërbimit publik.

Ndërkohë që për sa i përket çmimit të gazit, aktualisht nuk ekziston një treg me pakicë për të.

ii. *Projeksionet e zhvillimit me politikat dhe masat ekzistuese të paktën deri në vitin 2040*
Në zhvillim e sipër

4.6. Dimensioni i kërkimit, novacionit dhe konkurrueshmërisë

i. *Situata aktuale në sektorin e teknologjive me shkarkime të ulëta të karbonit dhe për aq sa është e mundur, pozicioni i saj në tregun botëror (kjo analizë duhet në kryhet në nivel BE-je ose botëror)*

Shqipëria ka marrë pjesë në programin “Horizon 2020” dhe është shtet pjesëmarrës në “Horizon Europe”. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, organizatat dhe shoqëritë kërkimore kanë marrë pjesë me sukses në projektet përkatëse.

ii. *Niveli aktual i shpenzimeve publike dhe, sipas rastit, i shpenzimeve private për kërkim dhe novacion për teknologjitë me shkarkime të ulëta karboni, numri aktual i patentave dhe numri aktual i studuesve*

Në rang kombëtar, nuk ekziston një program specifik për kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive me shkarkime të ulëta karboni. Për sa i përket sektorit privat, nuk është i disponueshëm informacioni lidhur me shpenzimet private për kërkim dhe novacion për teknologjitë me shkarkime të ulëta karboni, numrin aktual të patentave dhe numrin aktual të studuesve.

iii. *Kategorizimi i elementeve të çmimeve aktuale që përbëjnë tre komponentët kryesorë të çmimeve (energji, rrjeti dhe taksat/detyrimet)*

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kategorizimi i komponentëve të çmimit të energjisë, si dhe tarifrat aktuale Kursi i këmbimit prej 1 euro = 123.8 Lekë është përdorur në të gjitha tabelat.

		Çmimet mesatare të energjisë elektrike në EUR/kWh				
Konsumatorit Lloji i	Tensionit Niveli i	Energjia dhe Furnizimi	rrjeti Kostot		TVSH-ja e përfshirë	TVSH-ja e përfshirë
			Transmetimi	Shpërndarja		
Privat, i furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit	35 kV	0,071	0,006	0,012	0,090	0,108
Privat	20 kV	0,051	0,006	0,032	0,089	0,107
Privat	10/6 kV	0,044	0,006	0,039	0,089	0,107
Furrat e bukës, prodhimi i grurit	10/6 kV	0,013	0,006	0,039	0,057	0,069
Privat	0,4 kV	0,068	0,006	0,039	0,113	0,136
Furrat e bukës, prodhimi i grurit	0,4 kV	0,017	0,006	0,039	0,061	0,074

Banesat	Tension i ulët	0,032	0,006	0,039	0,077	0,092
----------------	-----------------------	-------	-------	-------	-------	-------

Tabela 32: Komponentët e çmimit të energjisë për çmimet mesatare të energjisë elektrike

Çmimet mesatare të energjisë elektrike gjatë orëve të pikut në EUR/kWh						
Konsumatorit Lloji i	Tensionit Niveli i	Energjia dhe Furnizimi	rrjeti Kostot		TVSH-ja e përjashtuar	TVSH-ja e përfshirë
			Transmetimi	Shpërndarja		
Privat, i furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit	35 kV	0,093	0,006	0,012	0,111	0,134
Privat	20 kV	0,065	0,006	0,032	0,102	0,123
Privat	10/6 kV	0,057	0,006	0,039	0,102	0,123
Furrat e bukës, prodhimi i grurit	10/6 kV	0,021	0,006	0,039	0,066	0,079
Privat	0,4 kV	0,085	0,006	0,039	0,130	0,156
Furrat e bukës, prodhimi i grurit	0,4 kV	0,026	0,006	0,039	0,071	0,085
Banesat	Tension i ulët	0,032	0,006	0,039	0,077	0,092

Tabela 33: Komponentët e çmimit të energjisë për energjinë elektrike gjatë pikut të kërkesës

Lloji i aktivitetit:	Tarifë e miratuar
Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike	0,75 Lekë/kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	1,5 Lekë/kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	3,9 Lekë/kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	4,79 Lekë/kwh

Çmimi i shitjes për klientët në 20 kV	11 Lekë/kwh në pik 12,65 Lekë/kwh
Çmimi i shitjes për klientët në 10/6 kV	11 Lekë/kwh në pik 12,65 Lekë/kwh
Tarifa për shërbimin e transmetimit të gazit natyror	28 Lekë/m ³ ose 2,64 Lekë/kwh

Tabela 34: Tarifat e miratuara nga ERE, Enti Rregullator i Energjisë

iv. *Përshkrim i subvencioneve të energjisë, duke përfshirë lëndët djegëse fosile*

Subvencionet për lëndët djegëse fosile

Prodhimi i energjisë në Shqipëri bazohet ekskluzivisht në energji hidrike dhe kjo tendencë do të vijojë në planin afatshkurtër. Shqipëria nuk varet nga qymyri ose lëndë djegëse fosile të tjera për prodhimin e energjisë elektrike, prandaj subvencionet për lëndët djegëse fosile nuk janë të nevojshme.

Subvencionet për burimet e energjisë së rinovueshme

Në këtë aspekt, politikat për adresimin e skemave të mbështetjes ose mekanizmat e subvencioneve janë kryesisht të orientuara për të promovuar prodhimin e energjisë elektrike nga BRE. Kjo politikë është në përputhje me objektivin kombëtar të arritjes së 38% të konsumit final të energjisë nga BRE-të deri në vitin 2020.

Ligji 7/2017 “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (BRE)” parashikon krijimin e dy llojeve të mbështetjes financiare për BRE-E.

- **Tarifa "feed-in"**, është skema ligjore e mbështetjes financiare për çmimin e blerjes së energjisë së prodhuar nga BRE, me kapacitet të kufizuar prodhimi deri në 2 MW për impiantet fotovoltaike dhe deri në 3 MW për parqet eolike. Këto projekte janë Miratuar nga Ministria sipas procedurave të VKM 822/2015, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”. Metodologjia e miratuar nga VKM 369, datë 26.4.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, parashikon miratimin nga ERE të çmimit fiks që prodhuesi do t'i shesë OSEE-së për 15 vite.
- Vendorsja e tarifës “**Feed-in Premium**”, (tarifa FiP) është skema ligjore e mbështetjes financiare për çmimin e blerjes së energjisë së prodhuar nga burimet e BRE, me kapacitet të instaluar prodhimi deri në 2 MW për impiantet fotovoltaike dhe deri në 3 MW për parqet eolike.

Metodologjia e skemave të mbështetjes, sipas kapacitetit të impiantit të BRE-së, është miratuar nga VKM 369/2017, bazuar në ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme (BRE)”.

- Për impiantet fotovoltaike me kapacitet deri në 2MW janë aplikuar skemat e mbështetjes me tarifën e rregulluar “feed-in” (FiT). Për vitin 2017, çmimi ka qenë 100 € / MWh. Për vitin 2018 e më tutje, ky çmim është rishikuar në 71,2 Euro/Mwh.
- Për kapacitetet e instaluar mbi 2MW aplikohet skema e mbështetjes në bazë të ankandeve sipas CfD-ve (Kontratat për Diferencat), të cilat rezultuan tërheqëse për investitorët e interesuar. Kjo skemë ka rezultuar e suksesshme dhe përvoja e marrë do të shërbejë si bazë për të orientuar politikat e çmimeve të këtyre teknologjive në të ardhmen.
- Për parqet eolike me kapacitet deri në 3MW, skemat e mbështetjes bazohen në një tarifë të rregulluar “feed-in” (FiT). Për vitin 2017, çmimi është vendosur në 76 €/MWh dhe nuk është marrë asnjë vendim tjetër nga ERE për periudhën 2018-2020. Për kapacitetet e instaluar mbi

3MW, duhet të aplikohet skema e mbështetjes në bazë të ankandit, e cila ofrohet përmes një CfD-je. Në tremujorin e dytë të vitit 2021, është shpallur një ankand për kapacitetin e parqeve eolike.

Figura 118: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të mallrave për vlerat për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat shtesë deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WAM RE full capacity




Figura 119: Kategorizimi i lëndëve djegëse për konsumin final të energjisë (ktoe) për sektorin e transportit të mallrave për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat shtesë deri në vitin 2040

Energy Demand Final Units
Scenario: WAM RE full capacity, All Fuels




Figura 120: Konsumi final i energjisë (ktoe) për kërkesën jo-energjetike për mbajtësit e energjisë për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masat shtesë deri në vitin 2040

Tabela e mëposhtme paraqet kërkesën finale për energji në nënsektorë të ndryshëm në njësi kiloton ekuivalent naftë.

Dega [ktoe]	2016	2017	2018	2020	2025	2030	2035	2040
Sektori i banesave	486,8	481,9	474,8	469,7	412,3	348,9	319,9	298,2
Shërbimet	185,0	205,3	226,2	202,6	201,1	195,2	188,4	180,0
Industria	301,7	402,7	402,8	379,7	468,2	542,4	628,3	727,9
Transporti	819,4	829,8	822,7	840,2	923,8	1003,4	1089,7	1193,0
Bujqësia Pylltaria	74,0	74,1	80,3	84,7	96,7	110,5	126,2	144,1
Peshkimi	29,1	38,5	40,5	38,2	47,6	56,0	65,8	77,4
Jo-energjetik	143,3	77,4	54,7	57,3	64,2	70,6	80,0	89,9
Totali	2039,4	2109,7	2102,1	2072,5	2213,8	2326,9	2498,4	2710,6
Sektori i banesave								
Ngrohja e hapësirave	322,3	317,1	311,8	305,4	254,5	203,8	176,8	157,2
Pajisjet elektro-shtëpiake	92,6	92,8	91,0	91,5	88,5	81,0	78,1	75,1
Ndriçimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ftohja e hapësirave	25,0	25,3	25,6	26,6	26,8	26,2	28,1	29,9
Ngrohja e ujit	46,9	46,7	46,4	46,3	42,5	37,9	36,9	36,0

Totali	486,8	481,9	474,8	469,7	412,3	348,9	319,9	298,2
Shërbimet								
Tregtia	50,0	53,5	59,0	53,1	58,5	61,0	60,9	58,4
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	10,3	12,1	14,5	12,3	15,8	18,6	20,4	20,7
Administrata publike	22,6	26,0	28,2	26,2	19,9	15,2	11,5	8,7
Arsimi	15,5	17,7	19,0	17,8	14,3	11,5	9,4	7,6
Shëndetësia	16,9	19,2	21,7	20,3	16,4	13,2	10,7	8,6
Shërbime të tjera	69,8	76,9	83,8	73,0	76,2	75,7	75,6	76,0
Totali	185,0	205,3	226,2	202,6	201,1	195,2	188,4	180,0
Industria								
Hekuri dhe çeliku	18,9	20,5	27,2	25,6	31,6	36,6	42,4	49,1
Metalet joferrike	4,3	4,2	4,3	4,0	4,9	5,7	6,6	7,7
Kimike	14,9	15,3	15,0	14,1	17,4	20,2	23,4	27,1
Minerar	157,1	243,0	247,2	233,0	287,3	332,8	385,6	446,7
Nxjerrja e xeheroreve	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Ushqimet, Pijet, Duhani	47,4	50,6	47,4	44,7	55,1	63,8	73,9	85,7
Spektori i tekstitit, veshmbathjet e lëkurës	14,4	14,5	13,9	13,1	16,1	18,7	21,6	25,1
Shtypshkronja	8,2	8,3	8,3	7,8	9,6	11,2	12,9	15,0
Inxhinieria Metale të tjera	3,3	5,5	7,6	7,2	8,9	10,3	11,9	13,8
Të tjera	33,2	40,8	32,0	30,1	37,2	43,0	49,9	57,8
Totali	301,7	402,7	402,8	379,7	468,2	542,4	628,3	727,9
Transporti								
I udhëtarëve	558,7	568,4	560,8	593,5	645,3	688,9	728,5	778,5
I mallrave	260,8	261,4	261,9	246,7	278,5	314,5	361,2	414,5
Totali	819,4	829,8	822,7	840,2	923,8	1003,4	1089,7	1193,0
Transporti i udhëtarëve								
Hekurudhor	0,4	0,3	0,3	0,0	6,2	42,4	48,2	54,2
Me sisteme navigimi	20,5	20,5	20,5	21,7	24,8	28,3	32,2	36,1
Motoçikletë	2,0	2,0	2,0	2,1	2,3	2,4	2,6	2,7
Makinë	501,3	513,0	505,5	535,3	574,2	573,2	598,7	634,4
Autobus	34,5	32,7	32,6	34,5	37,7	42,5	46,9	51,1
Totali	558,7	568,4	560,8	593,5	645,3	688,9	728,5	778,5
Transporti i mallrave								
Hekurudhor	0,8	1,2	1,2	1,1	1,4	1,7	2,0	2,3

Me sisteme navigimi	14,9	15,8	16,7	15,8	19,8	23,4	27,6	32,7
Kamion	245,1	244,5	244,0	229,8	257,3	289,4	331,6	379,5
Totali	260,8	261,4	261,9	246,7	278,5	314,5	361,2	414,5
Jo-energjetik								
Kimike	0,3	0,4	0,4	0,4	0,4	0,5	0,6	0,7
Të tjera	143,0	77,0	54,4	57,0	63,8	70,1	79,4	89,1
Totali	143,3	77,4	54,7	57,3	64,2	70,6	80,0	89,9

Tabela 47: Konsumi final i energjisë (ktoe) për sektorë dhe nënsektorë të ndryshëm për vlerat historike për periudhën kohore 2016-2018 dhe siç është projektuar me masa shtesë deri në vitin 2040

Dimensioni i sigurisë së energjisë

Prodhimi i energjisë elektrike dhe sektori i prodhimit të naftës janë dy fushat kryesore në Shqipëri për sigurinë energjetike.

Me masa shtesë, varësia nga importet në vitet me klimë të thatë (supozohet në vitet 2022, 2027, 2032, 2037) është pothuajse joekzistente, siç paraqitet në Figura 121. Në vitet e tjera, Shqipëria pritet të jetë një eksportuese neto e energjisë elektrike gjatë vënies në funksion të impianteve hidroelektrike me kapacitet të plotë. Në vitet normale (pa klimë të thatë), eksporti i energjisë elektrike pritet të jetë pothuajse në nivel të barabartë me kërkesën kombëtare, duke arritur 97% tepricë të energjisë elektrike në vitin 2030.




Figura 121: Kërkesa për energji elektrike, prodhimi, eksportet dhe importet në skenarët me masa shtesë dhe me prodhim të energjisë së rinovueshme me kapacitet të plotë, si dhe tepricë për eksport (projeksioni për vitet 2019 - 2040). WEM dhe "WAM-ER për të përmbushur kërkesën" (referuar me shkurtimin 'WAM mdem') paraqiten gjithashtu

Siç shihet në Figura 122, hidrocentralet prodhojnë pjesën më të madhe të energjisë elektrike, të cilët preken në masë të madhe nga vitet e thata dhe pasojat e ndryshimeve klimatike (modeluar si reduktim ndaj disponueshmërisë së burimeve ujore, shihni kreun 4). Pavarësisht rritjes së kërkesës për energji

elektrike, hidrocentralet e vogla (sHPP në Figura 122) shohin një rritje të saj. Impiantet që punojnë me gaz përdoren vetëm gjatë viteve me klimë të thatë pasi nuk funksionojnë me kapacitet të plotë, por shërbejnë vetëm si rezervë në rast mungese të burimeve ujore, apo të burimeve të tjera të rinovueshme. Teksa në skenarin WEM vërehet përdorimi i TEC-eve (vetëm Vlora në rastin e skenarin WEM) në çdo vit duke nisur nga viti 2035, kjo gjë nuk është më e nevojshme në skenarin WAM me rritjen e disponueshmërisë së prodhimit të energjisë së rinovueshme. Mungesa e energjisë elektrike, që nxit dispecimin e TEC-it, shfaqet në stinët e vjeshtës dhe dimrit gjatë viteve me klimë të thatë, kur disponueshmëria e energjisë diellore është e ulët,




Figura 122: Prodhimi i energjisë elektrike sipas skenarit WAM për impiantet e ndryshme (PP, H - hidrike, S- panele diellore fotovoltaike, W - eolike, T - gaz për përdorim termik). HECv janë HEC-et e vegjël që llogariten bashkërisht, siç tenderohen impiantet fotovoltaike dhe impiantet eolike.

Në prodhimin e naftës, shtimi i kapacitetit të rafinimit pas rinovimit pritet të rrisë prodhimin e produkteve të naftës, siç mund të shihet në Figura 123. Dinamikat e importit do të ndryshojnë, në kuptimin që vendi do të ndryshojë nga të qenit një eksportues neto i naftës bruto në vend përdorues të naftës bruto pa importe ose eksporte në sasi të mëdha. Importet e produkteve të naftës do të reduktohen në një masë shumë të vogël, duke reduktuar ndjeshëm varësinë nga importet, siç paraqitet në Figura 124.

Vërehet rritje e kërkesës për gaz natyror, i cili importohet përmes TAP-it (Figura 124). Gazi natyror përdoret për prodhimin e energjisë, por edhe në sektorin e banesave (1,5% e KFE në vitin 2030) dhe të shërbimeve (8,0% e KFE në vitin 2030), ku zëvendëson përdorimin e GLN-së. Në sektorin e industrisë, kufizohet dhe reduktohet përdorimi i gazit natyror, i cili resht së përdoruri për prodhimin e energjisë elektrike.




Figura 123: Prodhimi i lëndëve djegëse me masa shtesë (projeksioni për vitet 2019-2040)




Figura 124: Importet neto të lëndëve djegëse me masa shtesë (projeksioni për vitet 2019-2040)

- ii. *Vlerësimi i ndërveprimeve ndërmjet politikave (ndërmjet politikave dhe masave ekzistuese dhe politikave dhe masave të planifikuara, në kuadër të një dimensionit të politikave ekzistuese dhe ndërmjet politikave dhe masave ekzistuese dhe politikave dhe masave të planifikuara të dimensioneve të ndryshme) të paktën deri në vitin e fundit të periudhës së mbuluar nga plani, në veçanti për të marrë njohuritë themelore të ndikimit të politikave të efikasitetit të energjisë/kursimit të energjisë për madhësinë e sistemit të energjisë dhe për të reduktuar rrezikun e investimeve të paleverdishme në furnizimin me energji*

Rezultatet e modelimit të paraqitura në këtë kapitull dhe për masat ekzistuese në kreun 4 përshkruajnë sistemin e energjisë në formë të agreguar, duke marrë parasysh politikat e përshkruara në kreun 3.

Secila politikë individuale ka një efekt individual nëse zbatohet në sistemin ekzistues. Megjithatë, ndërveprimet ndërmjet politikave duhet të merren në konsideratë, pasi kjo gjë mund të përforcojë apo pakësojë efektin e tyre në vlerat përfundimtare për kursimin e energjisë. Për shembull, mund të hartohen politika, që ndër të tjera, kanë si objektiv zëvendësimin e sobave me dru për ngrohjen e hapësirave, në favor të ngrohjes me energji elektrike dhe pompat e nxehtësisë. Zëvendësimi i lëndës djegëse në vetvete do të rezultojë në reduktim të konsumit të energjisë (veçanërisht në rastin e pompave të nxehtësisë) por efekti më i ndjeshëm për sa i përket shkarkimeve të GES-ve vërehet në kombinim me rritjen e prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme. Të gjitha masat që rezultojnë në konsum më të madh të energjisë elektrike në favor të një lënde djegëse tjetër, kërkojnë një rregullim kapacitetit të prodhimit të energjisë elektrike ose interkonektorëve ndërkufitarë. Kështu, përmirësimet ndaj efikasitetit të energjisë duhet të përfshihen në planifikimin e furnizimit me energji elektrike.

Në mungesë të masave për efikasitetin e energjisë, nevojitet një kapacitet më i madh për prodhimin e energjisë elektrike për të shmangur varësinë nga importet. Masat për efikasitetin e energjisë mund të reduktojnë presionin si mbi prodhimin, ashtu edhe mbi kapacitetin e transmetimit. Duke marrë në konsideratë aspektet e furnizimit, rritjes dhe kërkesës së sistemeve të energjisë, shkarkimet e GES-ve dhe kostot për investimet e tepërta në kapacitetet e prodhimit mund të shmangen.

Figura 125 Paraqet kursimet në shkarkimet e GES-ve për politikat dhe masat e zbatuara në skenarin WAM. Vini re se disa nga PaM-et nuk janë zbatuar në modelim pasi nuk veprojnë drejtpërdrejt në sistem, por sidoqoftë është me rëndësi që të respektohen. Disa nga PaM-et janë zbatuar në kombinim, prandaj një analizë më vete nuk është e mundur. PaM-et e tjera (për kapacitetet e burimeve të rinovueshme) janë ndarë në kategori. Efektet e G-LF1 dhe G-LF2 nuk janë përfshirë në imazh për lehtësi kuptueshmërie, por paraqiten në Figura 127. Efekti i përgjithshëm i të gjitha politikave paraqitet në Figura 126. Siç bëhet e qartë, efekti i përbashkët i politikave në skenarin WAM (kursime prej 2347 kilotonë të ekuivalentëve të dyoksidit të karbonit në vitin 2030) është më i madh se sa totali i efekteve të marra më vete (2321 kilotonë të ekuivalentëve të dyoksidit të karbonit në vitin 2030), me këtë efekt që rritet gradualisht. Kjo diferencë vjen për shkak të ndërveprimit të politikave të ndryshme, veçanërisht për PaM-et për efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme, të përshkruara më sipër.

Implantet e burimeve të energjisë së rinovueshme rezultojnë në kursim të shkarkimeve vetëm kur zëvendësojnë termocentralet, siç është rasti vetëm pas vitit 2030, me përjashtim të viteve me klimë të thatë. Në vitet e tjera, ata mund të zëvendësojnë energjinë elektrike të importuar, shkarkimet e së cilës përfshihen në prodhimin e energjisë elektrike të vendit. Nga ana tjetër, termocentrali i Korçës rezulton në shkarkime në vitet me klimë të thatë, të cilat nuk paraqiten në imazh. PaM-et për efikasitetin e energjisë kanë një ndikim të vogël për sa kohë ato vetëm reduktojnë kërkesën për energji elektrike në sistem, duke qenë se ka furnizim të bollshëm të energjisë elektrike të rinovueshme në çdo rast. Megjithatë, edhe siç

përshkruhet më lart, duhet të ndiqet parimi i parë për efijencën e energjisë. Në skenarin WAM, vetëm disa PaM-e kanë objekt shkarkimet nga burimet jo-energjetike. Për sa i përket totalit të kursimeve të shkarkimeve, deri më tani, menaxhimi i pyjeve ka ndikimin më të madh.

Trajtesa paraqet kufizimet e atribuimit të kursimeve të shkarkimeve në PaM-e individuale. Sistemi referencë, në të cilin zbatohet PaM-i, duhet të merret në konsideratë. Ndërkohë që PKEK-u përfshin hartimin e një plani të integruar, efekti i ndërveprimeve ndërmjet PaM-eve është me rëndësi thelbësore.




Figura 125: Kursimet në shkarkimet e GES-ve [kt CO₂eq] për disa masa të caktuara që janë objekt i skenarit WAM. Menaxhimi i pyjeve nuk paraqitet për lehtësi kuptueshmërie




Figura 126: Kursimet në shkarkimet e GES-ve për të gjitha politikat dhe masat e zbatuara individualisht (kolonat e sipërme) dhe të zbatuara bashkërisht në skenarin WAM (kolonat e mesit) Efekti i G-LF1 dhe G-LF2 paraqitet këtu për qëllime plotësie të të dhënave.

Shkurtimi	Emri i shkurtuar	2020	2025	2030	2035	2040
G LF1 LF2	Menaxhimi i pyjeve	0	-836,1	-1672,3	-1672,3	-1672,3
R T2	Biokarburantet e qëndrueshme	0	-106,2	-214,3	-215,9	-216,5
EE T2	Përqindja e EV	0,2	-47,1	-169,6	-209,4	-394,4
G T2	Menaxhimi i mallrave	0	-81,9	-125,5	-142,5	-149,2
EE E1	Auditet energjetike dhe menaxhimi	-1	-14,7	-38,7	-80,3	-111,3
G T1	Autobusët e linjave ekstra urbane	0	-20,3	-36,8	-40	-38,5
R I1	ER e industrisë joushqimore	0	0	-27	-25,9	-74,7
ES O2	Gazi në BRE dhe shërbimet	0	-2,9	-13,3	-22,9	-22,8
Spektori banesave	PaM-et për EE L1 O1	-0,8	-5,2	-12	-36,4	-28,8
G I1	Zbatimi i ETS-së	0	0	-11,7	-2,9	-32,3
Shërbimet	PaM-et për EE L2 P1	0	-1,6	-2,9	-7,7	-4,2
G LF3	Menaxhimi i kullotave dhe tokave bujqësore	0	0	0	0	0
ES P2	HEC-i i Skavicës	0	0	0	-17	-6
R E1	Panelet diellore në soleta	0	0	0	-6,9	-1,2
R E2	Impiantet fotovoltaike dhe eolike të tenderuara	0	0	0	-17	-49,8
ES O2	Gazi në sektorin e industrisë	0	0	0	0	0
ES O2	Korca Gas	0	0	0	0	0
EE C1	Etiketimi i energjisë dhe dizajni ekologjik	0,2	1,6	3	-12,3	6,3
	WAM - Përmbledhja e totalit të PaM-eve	-1,4	-1114,4	-2321,1	-2509,4	-2795,7
	WAM	-2,4	-1134,8	-2347,1	-2576,9	-2882,3

Tabela 48: Kursimet e shkarkimit të GES-ve në ekuivalentë të dyoksidit të karbonit në kilotonë për PaM-et që janë objekt i skenarit WAM.

iii. Vlerësimi i ndërveprimeve ndërmjet politikave dhe masave ekzistuese dhe politikave dhe masave të planifikuara, si dhe ndërmjet këtyre politikave dhe masave dhe politikave dhe masave të BE-së për klimën dhe energjinë

Tre politikat që janë aktive në nivel BE-je janë pjesë e PaM-eve të përfshira në modelimin e skenarit WAM të sistemit të energjisë së Shqipërisë. Ndërtimet e reja kërkohen për të ndjekur rregullat e EPBD-

së, zbatohet një ETS dhe prezantohet dizajni ekologjik dhe etiketimi i energjisë. Politikat e tjera të BE-së janë ndërkohë pjesë përbërëse e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

5.2 Ndikimet makroekonomike dhe të llojeve të tjera të politikave dhe masave të planifikuara, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.

Ky seksion trajton ndikimet makroekonomike dhe të llojeve të tjera, deri në masën e mundshme, ndikimet shëndetësore, mjedisore, arsimore, sociale, të arsimit dhe të aftësive, duke përfshirë aspektet e tranzicionit të drejtë (për sa i përket kostove, si dhe efikasitetit të kostos) të politikave dhe masave të planifikuara, të përshkruara në seksionin 3, të paktën deri në vitin e fundit të periudhës së mbuluar nga plani, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.

Ky seksion parashikon specifikisht një vlerësim të ndikimeve joenergjetike dhe politikave për klimën, siç përfshihet në këtë PKEK. Efektet mjedisore të politikave për energjinë dhe klimën, që synojnë të shtojnë burimet e energjiave të rinovueshme (ER) në sistemin e energjisë, si dhe të përmirësojnë efikasitetin e energjisë (EE) në sektorë të ndryshëm të konsumit, në pjesën më të madhe janë të qarta dhe të mirëstudiuara. Në masë të madhe, zbatimi i masave në lidhje me EE-në dhe për të shtuar përqindjen e ER-së nxitet nga objektivi për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, zbutjen e ndryshimit klimatik dhe respektimit të synimeve të Marrëveshjes së Parisit. Megjithatë, si masat për EE-në dhe ER-në mund të kenë një larmi ndikimesh në familje, në punësim, në shoqëritë private dhe në sektorin publik. Këto ndryshime mund të jenë thelbësore dhe mund të dokumentohen në dimensione të ndryshme, p.sh., që variojnë nga efektet makroekonomike (ndikimet në punësim, në buxhetin e shtetit, në krijimin e vlerës, etj.), ndikimet shëndetësore (për shkak të reduktimit të ndotjes së ajrit dhe të ujit në nivel lokal), ndikimet sociale (reduktim i varfërisë energjetike ose për lëndë djegëse, rehati dhe mirëqenie më e madhe, reduktim i pabarazisë), ndër të tjera (për një përmbledhje, shihni Bouzarovski (2014)). Një vlerësim gjithëpërfshirës i efekteve të shumëfishta të politikave për energjinë dhe klimën për të gjithë aktorët dhe dimensionet është përtej objektit të këtij studimi. Ky seksion jep një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve joenergjetike në tre dimensionet kyçe, përkatësisht: 1) të ardhurat familjare të disponueshme, si një tregues kyç për matjen e ndikimit mbi varfërinë energjetike dhe për lëndë djegëse 2) buxheti i shtetit, për të kuptuar nëse masat kanë mundësi për të shtuar ose pakësuar burimet e të ardhurave shtetërore dhe 3) punësimi, pasi politikat për energjinë dhe klimën mbartin potencial të madh për të ofruar vende pune ekologjike.

Të ardhurat familjare të disponueshme

Arritja e një niveli dekarbonizimi të konsiderueshëm në sektorin e energjisë do të kërkojë përpjekje madhore në sektorët e ndërtimit. Në nivel BE-je, shkarkimet e gazeve me efekt serrë në sektorin e ndërtimit përbëjnë më shumë se një të tretën e shkarkimeve totale. Ndërtesat rezidenciale përbëjnë 75% të stokut të ndërtesave evropiane, nga të cilat më shumë se 40% janë ndërtuar përpara vitit 1960, ndërsa më shumë se 90% përpara vitit 1990. Familjet me të ardhura të ulëta përbëjnë rreth 17% të familjeve në BE (Eurostat, 2014), ndërsa numri i banorëve të BE-së që vuajnë nga varfëria për lëndë djegëse varion ndërmjet 50-160 milionë, që përkon me pothuajse 6–21 % të totalit të popullsisë së BE-së (Bouzarovski (2014); BPIE (2015); Bird et al. (2010)). Politikat për efikasitetin e energjisë në sektorin e banesave kanë potencial të madh për përmirësimin e të ardhurave familjare të disponueshme. Të ardhurat familjare të disponueshme mund të rriten përmes përmirësimit të EE-së për ngrohjen e hapësirave, prodhimin të ujit të ngrohtë ose për produktet që punojnë me energji, si p.sh., frigoriferët ose televizorët, duke marrë parasysh që përqindja më e madhe e të gjitha masave të kosto-efikase (Yushchenko and Patel 2017; Doodoo et al. 2017). Si rezultat, EE-ja mbart potencial të madh për reduktimin e varfërisë energjetike, por krahas kësaj sjell përfitimet e shumta të EE-së, të tilla si përmirësimi i shëndetit të njerëzve, pakësimi i subvencioneve të energjisë përmes politikave sociale, rritja e vlerës së pronave, shpenzimet lokale dhe punësimi, shkarkime të reduktuar etj.,. Investimet fillestare në EE për rinovimin e ndërtesave, zakonisht

shpërblehen për sa i përket reduktimit të kostove për ngrohje, gjë që iu mundëson konsumatorëve të shpenzojnë paratë e tyre për gjëra të tjera në planin afatgjatë. Megjithatë, siç thekson programi gjerman për Rinovimin e ndërtesave sipas parimit të efikasitetit të energjisë nga banka KfW, duhet të theksohet se këto investime janë fitimprurëse pas disa dekadash (KfW Group (2018)). Prandaj, mospërfshirja e kostove të investimit është një thjeshtësim dhe kështu neglizhim i efekteve kursyese dhe efekteve negative domino.

Buxheti i shtetit

Politikat për EE-në dhe ER-në ndikojnë në aspekte të ndryshme në buxhetin e shtetit. Për shembull, ndryshimet në buxhetin e shtetit mund të nxiten nga vendet e punës të krijuara rishtazi (p.sh., përmes masave për EE-në në sektorin e ndërtimit). Nga ana tjetër, politikat në lidhje me reduktimin e taksave dhe subvencionet për disa aktivitete specifike për të përmirësuar EE-në dhe shfrytëzimi i një pjese më të madhe të ER-së mund të shkojnë në paralel me shpenzime më të mëdha publike ose reduktim të të ardhurave tatimore. Si një tregues i ndikimit në buxhetin e shtetit, mund të llogariten të ardhurat shtesë nga tatimi mbi të ardhurat për një punë tipike mesatare në sektorët/nënsektorët përkatës, duke përdorur normat e tatimit mbi të ardhurat që janë specifike për vendin. Humbjet e tatimit mbi të ardhurat në sektorin e energjisë, këtu mund të merren në konsideratë në këtë mënyrë. Qasja mund të shtrihet edhe në ndikimet e tjera lidhur me buxhetin e shtetit, të tilla si TVSH-ja dhe taksat mbi energjinë për të llogaritur efektet pozitive ose negative në buxhetin e shtetit.

Efektet në punësim

Efektet në punësim mund të kenë rëndësi të madhe, pasi ofrimi i mundësive të punësimit dhe reduktimi i shkallës së papunësisë përbëjnë objektiva kyçe të politikave. Efektet e drejtpërdrejta të EE-së në punësim bazohen në dy aspekte nxitëse kryesore, të tilla si investimet në masat për EE-në dhe kursimet përkatëse të energjisë. Teksa e para nxit kërkesën impulsive në industrinë që prodhojnë teknologjitë përkatëse, e dyta redukton kërkesën për furnizim me energji në plan afatgjatë. Në të dyja rastet, këto ndikime prekin tërthorazi sektorët e tjerë, p.sh. prodhuesit dhe shpërndarësit e energjisë. Siç kanë treguar disa studime, shtimi neto i punësimit ka gjasa të ndodhë gjatë kalimit nga shpenzimi për konsumin e energjisë në investimin e masave për EE-në (Wei et al. 2010; Scott et al. 2008; Bacon and Kojima 2011). Me kusht që masat për EE-në të jenë kosto-efikase, ato gjithashtu shtojnë të ardhurat familjare të disponueshme, të cilat stimulojnë krijimin e vendeve të punës në planin afatgjatë. Masat që përmirësojnë efikasitetin e energjisë përmes aktiviteteve intensive ndërtimore, të tilla si rinovimi i zarfit të ndërtesave, kanë rezultuar me potencial të madh për krijimin e vendeve të punës.

Tabela 49 paraqet një vlerësim cilësor të ndikimeve joenergjetike të disa PaM-eve të caktuara, që trajtojnë dimensionet e të ardhurave familjare të disponueshme, e buxhetit të shtetit dhe të punësimit **Error! Hyperlink reference not valid.** Vlerat e treguara në tabelë janë “të ulëta”, “mesatare”, “të larta” (ku “të ulëta” nënkupton që një PaM ka efekt të vogël pozitiv në ndikimin përkatës joenergjetik) nëse një PaM ka potencial për efektet përkatëse të dimensioneve të shqyrtuara dhe “neutral” nëse nuk ka asnjë efekt. Disa PaM-e kërkojnë fonde publike për t'u vënë në zbatim ose kanë nevojë për përjashtime nga taksat për të nxitur disa aktivitete të caktuara, duke ndikuar kështu

18 Duhet pasur parasysh, se disa PaM-e që nuk janë të përfshira kanë natyrë ndërsektoriale ose mbështesin apo bëjnë të mundur që PaM-et e konsideruara të arrijnë ndikimet e tyre jo-energjetike. Një shembull i përhapur mund të jenë tarifët “feed-in”, të cilat duke qenë tarifa nxitëse nuk sjellin efekte në punësim, në ndryshim nga zhvillimi i suksesshëm i impianteve.

negativisht në buxhetin e shtetit. Këto efekte paraqiten me vlerë “negative” lidhur me ndikimin përkatës në buxhetin e shtetit. Në parim, politikat që përmirësojnë EE-në në sektorin e banesave, si në stokun e ndërtesave, ashtu dhe në atë të pajisjeve elektro-shtëpiake dhe pajisjeve të tjera, kanë potencial për të përmirësuar të ardhurat familjare të disponueshme dhe për të reduktuar varfërinë energjetike. Për sa i përket punësimit, politikat lidhur me punimet e ndërtimit, të tilla si rinovimi i ndërtesave apo projektet në lidhje me infrastrukturën, kanë potencialin për të krijuar vende pune ekologjike. Duke marrë në konsideratë buxhetin e shtetit, politikat që nxisin një shkallë të lartë punësimi mund të përmirësojnë edhe arkëtimet nga tatimi mbi të ardhurat, duke përmirësuar kështu buxhetin e shtetit. Kësisoj, politikat që përmirësojnë EE-në për përdorim publik të energjisë, të tilla si EE-ja e përmirësuar në ndërtesat publike, mund të reduktojë shpenzimet publike për energjinë dhe të sjellë përfitime për buxhetin e shtetit.

Nr.	Emri i PaM	Vlerësimi cilësor i ndikimeve joenergjetike të PaM-eve		
		Të ardhurat familjare të disponueshme	Buxheti i shtetit	Punësimi
EE-E1	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	neutral	neutral	i ulët
EE-E3	Kuadri për aplikimin e energjisë së rinovueshme (skemat e energjisë diellore, eolike, hidrocentralët e vegjël, biomasa dhe biogazi) për përdorim industrial	n.a.	n.a.	n.a.
EE-O1	Skema detyruese e efikasitetit të energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Mesatar	i ulët	i ulët
EE-T1	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	i ulët	neutral	neutral
EE-T2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të makinave.	i ulët	negativ	neutral
EE-T3	Incentivat financiare për automjetet e pastra dhe eficientë nga pikëpamja energjetike (në rang kombëtar dhe lokal)	i ulët	negativ	neutral
EE-L1	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	I lartë	mesatar	I lartë
EM-P1	Eliminimi i varfërisë energjetike	I lartë	negativ	neutral
ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit (Sektori i industrisë)	neutral	mesatar	mesatar
ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit (Sektori i banesave dhe shërbimeve)	i ulët	mesatar	mesatar
ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuar në Master Planin e Gazit (Korca Gas)	neutral	i ulët	mesatar
EE-C1	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	mesatar	i ulët	neutral
G-I1	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	negativ	i ulët	neutral
G-T1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra urbanë	i ulët	neutral	neutral
G-T2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave	neutral	i ulët	neutral
ES-O4	Shtimi i kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	neutral	neutral	i ulët
EE-P1	Masat për efikasitetin e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	neutral	i ulët	neutral
R-T2	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	neutral	negativ	i ulët

EE-L2	Rinovimi i stokut të ndërtesave publike	neutral	mesatar	I lartë
R-E1	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla nga burimet e rinovueshme	i ulët	negativ	mesatar

Tabela 49: Vlerësimi cilësor i ndikimeve joenergjetike të disa PaM-eve të caktuara, të marra në konsideratë në skenarin WAM.

Efektet në punësim - Efiçenca e energjisë

Për sa i përket efekteve në punësim, PaM-et që nxisin rinovimin e ndërtesave kanë zakonisht ndikimet më të mëdha. Pjesa më e madhe e vendeve të punës po krijohen në fushat e ndërtimit dhe prodhimit, teksa shihet një efekt disi negativ në sektorin minerar dhe të gurorëve, si dhe në fushat që lidhen drejtpërsëdrejti me furnizimin e energjisë. PaM EE-L1 dhe EE-L2 pritet të kenë ndikim të ndjeshëm në nivelin e punësimit si rezultat i kursimeve të energjisë që gjenerojnë dhe në investimet shtesë, si rezultat i tyre. Efekti i kombinuar pritet që të krijojë 3500 deri në 12 000 ekuivalentë me kohë të plotë¹⁹ në periudhën 2019-2030. Teksa përqindja e ndërtesave publike në totalin e stokut të ndërtesave është relativisht e vogël, pjesa më e madhe e këtyre efekteve shtesë në punësim do të vijë si rezultat i zbatimit të standardeve për performancën e energjisë për ndërtesat dhe efektit të saj në veprimtarinë e rinovimit, që përmirëson ndërtesat rezidenciale.

Efektet në punësim - Energjia e rinovueshme

Zhvillimi i impianteve të burimeve të energjisë së rinovueshme mbart potencial të madh për krijimin e vendeve të punës. Teksa impiantet e energjisë së rinovueshme nuk do të prodhohen në Shqipëri, ekziston edhe një efekt i konsiderueshëm që mund t'i atribuohet fazës së ndërtimit të impianteve të ER-së, ndërkohë që funksionimi i tyre nuk kërkon forcë punëtore të madhe. Prandaj, pjesa më e madhe e vendeve të punës pritet të krujohen gjatë fazës së ndërtimit të impianteve. Figura 127 tregon një parashikim të krijimit të vendeve të punës gjatë fazave të ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së impianteve eolike dhe diellore fotovoltaike. Është bazuar në faktorë punësimi të normalizuar, ndërsa normalizimi është kryer nga njësia person-vite/MW në njësinë punë/MW, duke supozuar një kohëzgjatje 20-vjeçare për projektet. Rezultatet janë bazuar në faktorët e punësimit, të raportuar nga Cameron and van der Zwaan (2015) në parashikimin e nivelit maksimal, i cili analizon bibliografinë shkencore të rishikuar nga kolegët e disponueshëm për këtë aspekt. Në veçanti, përdorimi i impianteve diellore fotovoltaike ka potencial për krijimin e vendeve ekologjike të punës.

Në skenarin WEM, rreth 280 MW e paneleve diellore fotovoltaike i shtohen sistemit të energjisë deri në vitin 2030. Kjo gjë bën të mundur hapjen e 460 vendeve pune në fazën e instalimit dhe 460 punë të tjera në fazën e operimit dhe mirëmbajtjes, duke rezultuar në një total prej 900 punësh në sektorin e impianteve diellore fotovoltaike deri në vitin 2030. Sipas një standardi të ngjashëm, një total prej 150 vendesh pune krijohen në sektorin e impianteve eolike, me përqindjen më të madhe (dy të tretat) që i atribuohet fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

Skenari WAM përfshin një shtim kapaciteti prej 770 MW deri në vitin 2030 për impiantet diellore fotovoltaike dhe 450 MW në të njëjtën periudhë kohore për impiantet eolike. Kjo gjë sjell krijimin e 1300 vende pune si në fazën e operimit, ashtu dhe në atë të mirëmbajtjes për impiantet diellore

¹⁹ Efekti bruto pa marrë në konsideratë efektet shkakore dhe kufizimet e tilla si mungesa e fuqisë punëtore.

fotovoltaike, ose një total prej 2600 vendesh pune. Për sa i përket impianteve eolike, një total prej 460 vendesh pune krijohen në skenarin WAM.




Figura 127: Numri total i të punësuarve deri në vitin 2025 dhe 2030 për impiantet diellore fotovoltaike dhe eolike për fazat e instalimit dhe të operimit dhe mirëmbajtjes (përgatitur nga ne në bazë të Cameron and van der Zwaan (2015))

5.3 Përmbledhje e nevojave të investimeve

i. *Flukset e investimeve dhe supozimet e investimeve të ardhshme lidhur me politikat dhe masat e planifikuara*

Në përshkrimin e PaM-eve në kreun 3, buxheti dhe investimet paraqiten për PaM. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e investimeve të parashikuara.

Dimensioni	Kodi PaM	Emri i PaM	Investimet financiare	WEM ose WAM
Dekarbonizimi/emetimet eliminimi i GES-ve	G-A1	Promovimi i bujqësisë organike	Në total, masat agro-mjedisore, klimatike dhe ato të bujqësisë organike, sipas parashikimit në skemën IPARD II (2014-2020), kanë një buxhet orientues prej 1,7 mln eurosh dhe një kohë nisjeje në 2018 (programi IPARD, 2014-2020)	WEM
	G-A2	Përmirësimi i monitorimit bujqësor në Shqipëri	Nuk është identifikuar asnjë buxhet specifik	WAM
	G-A3	Rregullimi i praktikave të djegies në bujqësi	Nuk është identifikuar asnjë buxhet specifik	WEM
	G-B1	Politikat për mbështetjen e BRE për ngrohjen dhe ftohjen	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, kostoja e skemës do të	WEM

			mbulohet nga tarifat e energjisë elektrike	
	G-I1	Zbatimi i ETS-së në Shqipëri	2 mln euro (shifër treguese e bazuar në një analizë krahasuese)	WAM
	G-I2	Ngritja e një mekanizmi për zbatimin e MMR-së	1 mln euro	WAM
	G-LF1	Rritja e kapacitetit natyror të përthithjes së karbonit të pyjeve dhe kullotave	Fonde shtetërore në vlerën 6,5 mln euro (çdo vit, për sektorin e pyjeve, megjithëse nuk specifikohet nga masat) nga fondet shtetërore	WAM
	G-LF2	Menaxhimi ekologjik i pyjeve		WAM
	G-T1	Përmirësimi i rrjetit të autobusëve ekstra urbanë	Buxheti specifik nuk është i disponueshëm por buxheti total i parashikuar për investime në sektorin e transportit për një periudhë 20-vjeçare (2019-2038) është 4,888.03 mln euro. Nga këto, 4,458.53 mln euro janë të destinuara për projekte të zhvilluara nga sektori publik, ndërsa 429.5 mln euro janë investime private	WAM
	G-T2	Menaxhimi i integruar i transportit të mallrave		WAM
	G-T3	Tarifat e makinave bazuar në efikasitet dhe incentivat për rinovimin e flotës		WEM
	G-W1	Reduktimi i emetimeve nga mbetjet	Vlera e parashikuar për rehabilitimin e vendgrumbullimit është rreth 76 mln euro; vlera për grumbullimin e materialeve të riciklueshme të thata rreth 18,5 mln euro dhe ajo për grumbullimin e mbetjeve organike dhe kompostimin rreth 13 mln euro. (Të gjitha vlerat janë llogaritur për periudhën 2018-2032.)	WEM
	G-W2	Përdorimi i impianteve të incinerimit të mbetjeve për procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në Shqipëri	Kostot e parashikuara për periudhën 2018-2022 për investimet në impiantet e incinerimit me zgarë të lëvizshme në Fier dhe Tiranë janë përkatësisht 25,5 dhe 76 milionë euro.	WEM
	G-W3	Shtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura dhe mbulimit të tyre përkatës	(Projekt) Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2019-2030 ka një kosto prej rreth 1500 mln euro, nga të cilat 99,2% i zë infrastruktura dhe 0,8% asistencë teknike.	WEM
Energjitë e rinovueshme	R-E1	Mekanizmi i tarifës “feed-in” për kapacitetet e vogla nga burimet e rinovueshme	Nuk është parashikuar financim nga buxheti i shtetit, pasi kostoja e skemës do të mbulohej nga tarifat e energjisë elektrike. Megjithatë, ka një ndikim në buxhetin e blerësit, i cili është në pronësi të shtetit.	WEM dhe WAM
	R-E2	Ankandet për kapacitetet e reja nga burimet e rinovueshme (eolike dhe diellore) dhe kontrata për diferencë		WEM
	R-E3	Mekanizmi i matjes neto për instalimet deri në 500 kW		WEM
	R-E4	Rrjet i fuqishëm elektrik për t’iu përgjigjur kapacitetit në rritje të energjisë së rinovueshme	Sipas disa vlerësimeve paraprake, për rinovimin e rrjetit të shpërndarjes për një trajtim më të mirë të injektimit të ndryshueshëm të energjisë së	WEM

			rinovueshme në terma afatshkurtër nevojiten rreth 40 deri në 80 mln euro investime.	
	R-E5	Lehtësimi i lidhjes fizike dhe rregullatore	Nuk është parashikuar buxhet, pasi lidhet kryesisht me masat rregullatore	WEM
	R-E6	Sistemet e menaxhimit të kërkesës dhe akumulimit të energjisë për fleksibilitetin e rrjetit elektrik	Do të përcaktohet në vazhdim	WAM
	R-E7	Strategjia e matjes dhe digjitalizimi i sektorit energjetik	Do të përcaktohet në vazhdim	WEM
	R-I1	Mbështetja e shfrytëzimit të aplikimeve të energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël në sektorin joushqimor	2 milionë euro	WAM
	R-T1	Burimet e energjisë së rinovueshme në transport	Do të përcaktohet në vazhdim	WAM
	R-T2	Biokarburantet e qëndrueshme/të avancuara	124,000 euro (burimi: Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri, 2015-2020)	WAM
Eficienta e energjisë	EE-C1	Prezantimi i kërkesave të etiketimit të energjisë dhe të dizajnit ekologjik	70 milionë euro	WAM
	EE-E1	Auditimet e energjisë për konsumatorët e mëdhenj, me fokus në aktivitetet industriale	Kostot e auditimeve të energjisë pritet të vlerësohen.	WAM
	EE-E2	Sistemet e menaxhimit të energjisë për konsumatorët e mëdhenj dhe NMV-të	Është përlogaritur shuma prej 3 mln euro (duke marrë në konsideratë mbështetjen shumëvjeçare).	WAM
	EE-L1	Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë në ndërtesa	Nuk disponohet një total i përlogaritur i buxhetit, por disa nga fondet e dedikuara janë: (i) Ndihma shtetërore për "bizneset e reja të gjelbra" në Tiranë, me një vlerë totale të fondit për dy vite prej rreth 0,3 mln euro; dhe (ii) 6,5 mln euro "për eficientë të energjisë për qytetin studentit" nga banka KfW	WAM
	EE-L2	Strategjia afatgjatë e rinovimit (për ndërtesat publike dhe private)	1 milionë euro	WAM
	EE-L3	Rikonstruksioni i ndërtesës ekzistuese të qeverisjes qendrore (me përjashtim të ndërtesave të tjera publike në pronësi të bashkive, etj.)	Parashikohet përmirësim i moderuar i skenarit: 500 mln euro gjatë viteve 2015-2030 (Kostoja e rinovimit të ndërtesave për ndërtesat publike, e vlerësuar për SLED 2)	WAM
	EE-L4	Rikonstruksioni i stokut të ndërtesave publike (të gjitha ndërtesat publike me përjashtim të atyre të qeverisjes qendrore)	Kostot totale të investimit për rikonstruksionin e ndërtesave publike për periudhën 2015- 2030 janë 1800 mln euro.	WAM
	EE-L5	Skemat e mbështetjes financiare për përmirësimin e eficientës së energjisë në ndërtesa	Ndërtesat e sektorit privat, duke përfshirë banesat rezidenciale, duhet të vlerësohen	WAM

	EE-O1	Skema detyruese e efijencës së energjisë dhe masat alternative për Shqipërinë	Duke qenë se ka probleme rregullatore, buxheti lidhet më së shumti me mbështetjen teknike (në bazë të vlerësimit të parë, parashikohen 10-20 mijë euro).	WAM
	EE-P1	Masat për efijencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike	Për momentin nuk është përllogaritur një buxhet i caktuar.	WAM
	EE-P2	Planet bashkiake të veprimit për efijencën e energjisë, zbatimi dhe raportimi	Është përllogaritur një buxhet paraprak prej 45 000 euro për asistencë teknike.	WAM
	EE-S1	Adoptimi i modeleve ESCO	Për momentin nuk është përllogaritur një buxhet i caktuar	WAM
	EE-T1	Etiketimi i energjisë për makinat e reja	2 milionë euro	WAM
	EE-T2	Rritja e përqindjes së automjeteve elektrike në flotën kombëtare të makinave.	Rreth 5 mln euro CAPEX (shpenzime kapitale) për infrastrukturën e stacioneve të karikimit; Përmirësim i flotës së taksive elektrike ose hibride me kosto kapitali rreth 0,5 mln euro.	WAM
	EE-T3	Mekanizmat mbështetës për EE-në dhe automjetet ekologjike	Për të arritur objektivin e 15,5% për EE-në deri në vitin 2030 (460 ktoe në krahasim me skenarin BaU-Figura 4, SKE) përllogaritet një investim prej rreth 228 mln euro.	WEM
	EE-T4	Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (rrugët, hekurudhat dhe rrugët detare)	Asnjë vlerë e vetme pasi ekzistojnë disa projekte në lidhje me disa ndërhyrje për sistemin e transportit	WEM
Siguria energjetike	ES-O1	Kuadri i plotë ligjor për një furnizim të besueshëm e të sigurt me gaz për konsumatorët	Të papërcaktuara	WAM
	ES-O2	Zbatimi i projekteve me përparësi të identifikuara në Master Planin e Gazit	Buxheti për linjën e re të transmetimit të gazit, i parashikuar nga 150 mln euro deri në 185 mln euro, nga të cilat 67 mln euro për 186 km janë për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (IAP)	WAM
	ES-O3	Lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit	“Studimi i Para-fizibilitetit për Gazsjellësin Shqipëri-Kosovë” (projekti ALKOGAP), i zbatuar nga IPF4 TA, i financuar nga WBIF me një fond prej 0,3 mln euro (u përfundua në fund të vitit 2018) 67 mln euro për 168 km janë për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian (IAP)	WEM
	ES-O4	Shtimi i kërkim-prodhimit të hidrokarbureve	Nuk është vlerësuar asnjë buxhet pasi kostot e investimeve për studimet e rehabilitimit dhe modernizimit të dy rafinerive varen drejtpërsëdrejti në situatën reale të instalimeve, pajisjeve dhe nivelit të ndotjes së mjedisit. Ministria e Energjisë dhe Industrisë po	WEM

			merr në konsideratë opsionin e ndërtimit të rafinerive të reja me kapacitete prej 3,2 milionë tonësh.	
	ES-O5	Plani i emergjencës për gazin natyror	Nuk është vlerësuar asnjë buxhet	WEM
	ES-O6	Projekt-ligji “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.	N/A	WEM
	ES-P1	Furnizimi me gaz për termocentralin e Vlorës	Rreth 58 mln euro	WAM
	ES-P2	Ndërtimet e reja të centraleve – Skavica, Vau i Dejës, Moglica	Do të kontrollohet	WEM dhe WAM
	ES-R1	Gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe Gazsjellësi Shqipëri – Kosovë	67 mln euro për 168 km janë për Gazsjellësin Adriatiko-Jonian	WEM
Tregu i energjisë	EM-I1	Interkonektorët e energjisë elektrike	Buxheti nga operatori i sistemit të transmetimit	WEM
	EM-I2	Reformat në sektorin e energjisë elektrike	Buxheti indikativ: 2 milionë euro	WEM
	EM-I3	Caktimi i një operatori BRE dhe transformimi i tarifave “feed-in”	Nuk është përlogaritur asnjë buxhet për këtë PaM	WAM
	EM-P1	Eliminimi i varfërisë energjetike	Nuk është përlogaritur asnjë buxhet për këtë PaM	WAM
Kërkimi, novacioni dhe konkurrenca	RIC-E1	Përmirësimi i bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për kërkimin shkencor në lidhje me sektorin energjetik	Buxheti i parashikuara është rreth 8,24 mln euro	WEM
	RIC-E2	Programi kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit	0,6 mln euro (të parashikuara për vitin 2021)	WEM
	RIC-E3	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve (BIDS)	Nuk janë vlerësuar	WAM
	RIC-E4	Demonstrimi i novacionit dhe konkurrencës	Studim fizibiliteti: përlogaritja e kostos 150,000 euro; sugjerim për projektin e financuar nga donatorët. Kostoja dhe financimi i projektit demonstrues do të përcaktohet nga studimi i fizibilitetit.	WAM

Tabela 50: Përmbledhje e investimeve të parashikuara

ii. faktorët e riskut ose barrierat sektoriale ose të tregut në kontekstin kombëtar dhe rajonal

Një nga risqet që mund të kufizojë shtimin e BRE-ve është kufizimi i buxhetit të shtetit. Në fakt, pjesa më e madhe e kapacitetit të ri do të mbështetet, qoftë me FIT/CfD ose matjen neto. Këto skema mbështetjeje kanë një ndikim në buxhetin e shtetit, përmes shërbimeve utilitare shtetërore dhe çmimit të energjisë elektrike.

5.4 Ndikimet e politikave dhe masave të planifikuara në shtetet e tjera anëtare dhe në bashkëpunimin rajonal, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politika dhe masa ekzistuese.

Ky seksion trajton ndikimet e politikave dhe masave të planifikuara të përshkruara në seksionin 3 në shtetet e tjera anëtare dhe bashkëpunimin rajonal, të paktën deri në vitin e fundit të periudhës së mbuluar nga plani, duke përfshirë krahasimin me projeksionet me politikat dhe masat ekzistuese.

i. Ndikimet në sistemin e energjisë në shtetet fqinje dhe ato anëtare në rajon, për aq sa është e mundur

Nuk parashikohet asnjë ndikim për sektorin e benzinës. Ndikimet në sektorin e gazit përfshijnë kapacitetin e shtuar për transmetimin e gazit përmes TAP-it dhe Gazjellësit Adriatiko-Jonian (IAP).

Ndikimi më i rëndësishëm është në sektorin e energjisë elektrike. Intensifikimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe reformat e vazhdueshme në sektorin e energjisë elektrike, më i rëndësishmi, prezantimi i një burse të energjisë, do të bëjë të mundur eksportin e energjisë elektrike në vendet fqinje. Në fakt, nga ana tjetër, energjia elektrike nga Shqipëria do të jetë më e lirë se sa në vendet fqinje, duke rezultuar në reduktim të prodhimit kombëtar në këto vende. Kjo gjë është veçanërisht e vërtetë falë kapacitetit të madh të transmetimit që ekziston ndërkohë në rajon. Figura 121 paraqet sasinë e energjisë elektrike që planifikohet të eksportohet në vendet fqinje.

ii. Ndikimet në çmimet e energjisë, shërbimet utilitare dhe në integrimin e tregut të energjisë

Siç u përmend më lart, intensifikimi i burimeve të rinovueshme do të rezultojë në energji elektrike me çmim më të lirë për bursën e energjisë elektrike, e cila do të ketë ndikim në çmimet e energjisë elektrike në nivel rajonal.

Duke marrë në konsideratë integrimin e tregut të energjisë dhe projektet gazsjellëse, veçanërisht Gazsjellësin Adriatiko-Jonian, integrimi rajonal i tregjeve të energjisë pritet të përmirësohet. Krahas kësaj, krijimi i bursës shqiptare të energjisë elektrike, e cila do të kombinohet me të Kosovës, do të rezultojë në integrim më të madh në treg. Si përfundim, interkonektorët e energjisë elektrike do të bëjnë të mundur shtimin e tregtisë me vendet fqinje.

iii. Ndikimet sipas rastit në bashkëpunimin rajonal

Integrimi i përmirësuar i sektorëve të gazit dhe energjisë elektrike në Shqipëri me vendet fqinje përmes projekteve të planifikuara për interkoneksionet dhe përmes liberalizimit të këtyre sektorëve do të ndikonte në dobi të bashkëpunimit rajonal.

6 Referencat:

DOKUMENTET PËRKATËSE

Rregullorja e BE/KE “Për qeverisjen” e vitit 2018, “RREGULLORJA (BE) 2018/1999 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 11 dhjetor 2018 “Për qeverisjen e unionit të energjisë dhe veprimi për klimën, që ndryshon rregulloret (KE) Nr. 663/2009 dhe (KE) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/KE dhe (BE) 2015/652 që shfuqizojnë Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, Bruksel më 11 dhjetor 2018, e disponueshme në:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018R1999&from=EN>

Komuniteti i Energjisë (KE) 2018/1/Këshilli Ministerial (KM) i KE, 2018: “REKOMANDIMI I KËSHILLIT MINISTERIAL TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË 2018/1/KM-KE për përgatitjen e zhvillimit të planeve kombëtare të integruara për energjinë dhe klimën nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë”, Vienë më 3 janar 2018, i disponueshëm në:

https://www.energy-community.org/dam/jcr:de3adce9-e047-4fb3-a632-f63c64a5c9c6/REC_2018_01_MC_CLI.pdf

KE PG 03/2018: “Udhëzimet për politikën (PG) nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për zhvillimin e planeve kombëtare për energjinë dhe klimën, sipas Rekomandimit 2018/01/KM-KE”, Vjenë: Qershor 2018, i disponueshëm në:

https://www.energy-community.org/dam/jcr:c9886332-a1f5-43ee-b46c-31c637aedfa6/PC_03_2018_ECS_NECF.pdf

Dokumentet e përdorura për hartimin e krerëve 1 dhe 2 (duke plotësuar burimet e përmendura drejtpërsëdrejti në tekst)

Studimi u përgatit nga konsulentët:

- Raporti referencë: Politika kombëtare aktuale, strukturimi ligjor dhe institucional për Planin e Shqipërisë për Energjinë dhe Klimën. Përgatitur nga Narin Panariti, me kërkesë të GIZ në kuadër të Zhvillimit të Kapaciteteve për Politikën e Klimës në Vendet e Evropës Juglindore dhe Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, faza III, Tiranë më 30.11.2019

Dokumentet e përgjithshme të politikave:

- Konsolidimi i proceseve të planifikimit klimatik në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, New Climate Institute, maj 2019
- Strategjia Kombëtare e Sektorit të Energjisë 2018-2030, miratuar nga VKM nr. 480, datë 31.7.2018
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015–2020), miratuar nga VKM nr. 348, datë 11.05.2018
- WINDOW 3 – IPA III Përgjigja Strategjike Sektoriale për Energjinë

Kuadri ligjor për efikasitetin e energjisë:

- Shqipëri: Raporti i dytë vjetor sipas Direktivës “Efikasitetin e Energjisë”
- Plani për Transportin e Qëndrueshëm në Shqipëri (versioni draft, 2016)
- Përmbledhje ekzekutive: Plani i dytë dhe i tretë Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë, 2017-2020
- Ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”
- Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për efikasitetin e energjisë”
- Ligji nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”
- Raporti i monitorimit të strategjisë së energjisë
- Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë 2010-2018, VKM nr. 619, datë 7.09.2011

- Plani i Dytë dhe i Tretë Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, 2017-2020, miratuar me VKM nr. 709, datë 01.12.2017
- Strategjia sektoriale e transportit dhe Plani i veprimit 2016 – 2020, VKM nr. 811, datë 16.11.2016

Kuadri ligjor për energjinë e rinovueshme:

- Vendimi nr. 179, datë 28.3. 2018, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë”, 2018-2020
- Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri, 2015-2020, shtator 2015 (miratuar në janar të vitit 2016)
- Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKKVBRE 2019 – 2020), VKM nr. 580, datë 31.7.2018

Kuadri ligjor për shkarkimet e gazeve me efekt serrë, 2015, Marrëveshja e Parisit:

- Kontributet Kombëtare të Përcaktuara (INDC) të Republikës së Shqipërisë, pas vendimit 1/CP.19 dhe vendimit 1/CP.20
- Dokumenti i parë për përcaktimin e kontributit kombëtar të përcaktuar (NDC) kundrejt arritjes së pikësnyimit të KKKBNK-së, miratuar me VKM Nr. 762, datë 16.9.2015

Kuadri ligjor për Sigurinë e furnizimit me energji:

- Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar
- Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë, i miratuar me VKM nr. 87, datë 14.2.2018
- Deklarata e përditësuar e sigurisë së furnizimit e Republikës së Shqipërisë, përgatitur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me ERE dhe TSO. Tiranë, maj 2009

Bibliografi tjetër:

Energy Poverty in South East Europe – Surviving the Cold. Programi Politik i Evropës Juglindore për Energjinë e Qëndrueshme (SEE SEP), 2016

Dokumentet e përdorura për hartimin e kreut 3 renditen në fillim të secilit dimension

BIBLIOGRAFIA E BOTIMEVE për krerët 4 dhe 5

Bacon, Robert; Kojima, Masami (2011): Issues in Estimating the Employment Generated by Energy Sector Activities. I disponueshëm në internet, në adresën <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/16969>.

